

UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË

# Studime juridike

1

*Tiranë, Korrik 2013*

## REDAKSIA

Prof. Dr. Paskal Haxhi, Kryetar  
Prof. Dr. Kudret Çela, Anëtar  
Prof. Luan Omari, Anëtar  
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Anëtare  
Prof. Dr. Skënder Kacupi, Anëtare  
Prof. Dr. Vasilika Hysi, Anëtare  
Prof.as. Dr. Argita Berisha, Anëtare  
Prof. Asoc. Dr. Enkelelda Olldashi

### Sekretare shkencore:

Prof. Asoc. Dr. Enkelelda Olldashi

### Adresa e redaksisë:

FAKULTETI I DREJTËSISË  
TIRANË, ALBANIA  
Tel/Fax: + (355) (4) 22 25 37

© Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

*Revista botohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe me fondet e Fakultetit të Drejtësisë*

**Redakore:** Anila Konomi

**Faqosja dhe kopertina:** Ilmi Shahu

### Shtypi:

Shtypshkronja: "MILENIUMI I RI"  
Adresa: Autostradë Tiranë - Durrës, km 26  
Mobile: +(355) 682064654; +(355) 672063702  
E-mail: info@mileniumiri.de, [Http://www.mileniumiri.de](http://www.mileniumiri.de)

ISSN: 2220-3990

# PËRMBAJTJA

Doktorant Klodjan SKËNDERAJ dhe Dr. Sokol MËNGJESI	Vështrim evolutiv i legjislacionit procedural penal mbi gjykimet e posaçme	5
Drnt. Evisa KAMBELLARI	Vështrim teorik i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe demokratike	31
MA. Laura VORPSI	Roli i gjyqtarit dhe i ligjvënësit	50
Nadia RUSI (Doktorante)	Decentralizimi dhe barazia gjinore	60
Doktorante Juliana BYLYKBASHI	Të drejtat e autorit në shqipëri në përjasje me acquis e BE-së	80
Valbona PAJO (BALA), MA	Konstitucionalizmi popullor	97
MA. Rasim DODA	Aspekte dhe probleme të marrëdhënieve juridike civile	116
Dr. Ela ELEZI	Zbatimi i vendimeve të gjykatës kushtetuese në lidhje me kodin penal	139
MA. Artan ÇELA - Prof. Dr. Kudret ÇELA.	Paga e punës si kategori juridike, ekonomike dhe sociale	152
MA. Erajd DOBJANI	Llojet e padisë administrative dhe regjimi juridik i tyre	173
Valbona NDREPEPAJ, Nevila KULLOJKA	Kodi penal European	188

# ABSTRACT

Doktorant Klodjan SKËNDERAJ dhe Dr. Sokol MËNGJESI	Vështrim evolutiv i legjislacionit procedural penal mbi gjykimet e posaçme	209
Drnt. Evisa KAMBELLARI	A theoretical overview of criminal acts against free and democratic elections	211
MA. Laura VORPSI	The role of the judge and the lawmaker	213
Nadia RUSI (Doktorante)	Equal gender and decentralisation	215
Valbona PAJO (BALA), MA	“Popular Constitutionalism”	216
Dr. Ela ELEZI	The execution of the decisions of Constitutional Court regarding Criminal Code	217
MA. Artan ÇELA - Prof. Dr. Kudret ÇELA.	Work salary as legal, economical, and social category	219
MA. Eradj DOBJANI	Types of administrative lawsuit and their legal regime	220
Valbona NDREPEPAJ, Nevila KULLOJKA	Penal Europien Code	222

## VËSHTRIM EVOLUTIV I LEGJISLACIONIT PROCEDURAL PENAL MBI GJYKIMET E POSAÇME

Doktorant Klodjan SKËNDERAJ dhe Dr. Sokol MËNGJESI

### 1. Gjykimet e posaçme në legjislacionin pas shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1939

E drejta procedurale penale, ashtu si çdo e drejtë tjetër, ka ekzistuar që në etapat e para të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Kryerja e veprave penale, nxiste domosdoshmërinë e vendosjes së personave përpara përgjegjësive dhe në mënyrë të pashmangshme lindjen e normave procedurale për gjykimin e tyre. Edhe në vendin tonë, normat procedurale penale datojnë që para shpalljes së Pavarësisë, edhe pse këto norma ishin të trashëguara nga legjislacioni i Perandorisë Otomane. Krahas legjislacionit procedural penal, i cili kishte karakteristika laike e shpeshherë dhe fetare (sheriati), në Shqipëri është zbatuar edhe e drejta zakonore, e cila përmbante edhe rregulla procedurale (kanunet). Me krijimin e Shtetit të Pavarur Shqiptar, e për shkak të kushteve në të cilën u krijua Qeveria e Vlorës, ishte e pamundur që në Shqipëri të zbatohet një legjislacion shqiptar. Për këto arsye, Shteti i Ri i Pavarur vendosi, se derisa të bëhen kanunet e tjera të drejtësisë<sup>1</sup>, në fuqi do të mbeteshin ligjet osmane.

<sup>1</sup> Përmbledhje aktesh të Qeverisë së Vlorës, Shtypshkronja “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.

Pavarësisht këtij vendimi, Qeveria e Vlorës nuk i ndali përpjekjet për krijimin e legjislacionit shqiptar. Kështu që më 10 maj 1913, u miratua akti i parë me përmbajtje penale “Kanuni i Zhurisë”<sup>2</sup>. Aktet e para legjislative, të kësaj qeverie kishin tiparet e sanksionimit në një farë mënyre të së drejtës zakonore. Kjo vihet re si në aspektin e organizimit, ashtu edhe në të drejtën materiale (Kanuni i Zhurisë)<sup>3</sup>. Kanuni parashikonte norma penale në fushën materiale dhe procedurale. Normat procedurale rregullonin mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të një gjykimi. Procedimi zhvillohej kryesisht në tre faza: a) faza përgatitore, b) hetimi gjyqësor dhe c) shpallja e vendimit. Subjektet e procedimit sipas dispozitave të sipërpërmendura ishin, prokurori, akuzuesi (vajtori) dhe i akuzuari (nëngjyqësi).

Një karakteristikë e veçantë e Kanunit, ishte sanksionimi i zhvillimit të gjykimit përpara një jurie qytetarësh<sup>4</sup>, në bazë të rregullave të gjykimit mbi debatin gjyqësor. Sikurse mund të konstatohet nga vetë emërtimi i ligjit, sanksionimi i procedurës me pjesëmarrjen e jurisë, afirmon traditën zakonore dhe atë të frymës së legjislacionit europian. Juria, si një institut i pjesëmarrjes në gjykim kishte karakteristikat e gjykatave të common law<sup>5</sup>. Vetëm pas shpalljes së Pavarësisë mund të flitej për gjykata të mirëfillta shqiptare, si një pjesë e rëndësishme e aparatit shtetëror<sup>6</sup>.

### ***1.1 Kodi Penal Ushtarak në kohë paqe i vitit 1932***

Në vitet pas konstituimit të Shtetit të Ri Shqiptar, miratimi i akteve ligjore në fushën procedurale, duke marrë për bazë standardet e vendeve perëndimore, do të njohë një zhvillim të madh. Gjykimet

<sup>2</sup> Kanuni i Zhurisë, Gazeta Qeveritare ‘Përlindja e Shqypnjes’ nr.13-14-15, viti I, shkurt 1914.

<sup>3</sup> Shih Ilir Panda, Mikrotezë “Organizimi Gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë”, 2005, f. 5.

<sup>4</sup> Aurela Anastasi, “Kanuni i Zhurisë”, Revista “Studime Juridike” Nr.1, shtator 2001, Botim i Fakultetit të Drejtësisë në UT, Tiranë, 2001.

<sup>5</sup> Aurela Anastasi, “Historia e të drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)”, Tiranë, 2007, f. 30.

<sup>6</sup> Shih Koço Nova, “Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri (1912-1939), Pegi, Tiranë, f. 172.

e posaçme do të konstatohen in *primis* në Kodin Penal Ushtarak në kohë paqe<sup>7</sup>.

Ky kod përmbante dispozita me karakter material, si dhe dispozita me karakter procedural. Përveçse rregullimit të procedurës së zakonshme të zhvillimit të gjykimit, kodi parashikonte një procedurë të veçantë të zhvillimit të gjykimit, i cili ishte procedimi shkurtimor për dërgimin e drejtpërdrejtë në gjyq<sup>8</sup>. Në zhvillimin e këtij lloj gjykimi, eliminohej faza e veprimeve hetimore, duke u kryer vetëm veprime hetimore të nevojshme për ngritjen e akuzës në gjykatë<sup>9</sup>. Por edhe në këtë lloj gjykimi, prokurori kishte për detyrë të kryente të gjitha veprimet hetimore për zbardhjen e së vërtetës dhe nxjerrjen e personave përgjegjës që kishin kryer vepra penale ushtarake. Prokurori e realizonte hetimin, me ndihmën e hetuesisë dhe gjindarmësisë.

Sipas Nenit 107 të këtij kodi, në rast se procedohej me këtë formë gjykimi, organet e hetimit nuk mund të kryenin një kategori të caktuar veprimesh hetimore, siç ishin ekspertimet, pyetjet, perkuizimet shtëpiake etj. Megjithatë, kur prokurori mendonte se nuk kishte vend për ushtrimin e ndjekjes penale, bënte një kërkim analog për hetuesin, i cili kryente veprimet e nevojshme hetimore dhe në fund merrte një vendim. Më tej pasi kishte kryer hetimet që i çmonte të nevojshme, prokurori formulonte aktakuzën ndaj të pandehurit dhe e dërgonte çështjen në gjykatë.

Kjo procedurë hetimore në ndryshim nga hetimi i zakonshëm, kishte si karakteristikë faktin se afati maksimal 15 ditor i hetimeve ishte më i shkurtër se afati i hetimit të zakonshëm, i cili ishte 30 ditë. Sipas dispozitave të kodit, procedura shkurtimore aplikohet si në rastin e gjyqit ushtarak të përhershëm, ashtu edhe në gjyqin e posaçëm për oficerat. Janë pikërisht elementet si p.sh. shkurtimi i afatit

<sup>7</sup> Kodi Penal Ushtarak në kohë paqe hyri në fuqi më 19.06.1932, botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, viti 1932.

<sup>8</sup> Po aty, Kaptina 3, Nenet 106-107.

<sup>9</sup> Sipas Nenit 111 të ligjit të mësipërm, akuzat në gjykatë ngrihen nëpërmjet një akti formal që titullohet Akt-Akuzë, i cili duhet të përmbante: emrin, mbiemrin, moshën, cilësitë identifikuese të të pandehurit, veprën që ka kryer, rrethanat e saj, ligjin e zbatueshëm.

të periudhës së hetimeve si dhe dërgimi i çështjes për gjykim (duke kryer hetime të shpejta dhe të mjaftueshme) që e përafrojnë këtë procedurë gjykimi me konceptin e gjykimit të drejtpërdrejtë. Kjo pasi ligji procedural penal ushtarak, nuk parashikonte kushte specifike për gjykimin e drejtpërdrejtë të një çështjeje penale, siç parashikohet në kodin aktual të procedurës penale.

### **1.2 Ligji datë 12.05.1937 “Mbi disa gjykime të posaçme të çështjeve penale”<sup>10</sup>**

Në lëmin e legjislacionit procedural penal për herë të parë në vitin 1937 hyri në fuqi ligji “Mbi disa gjykime të posaçme të çështjeve penale”. Ky ligj i hartuar sipas influencës së legjislacioneve perëndimore të kohës, e posaçërisht atij italian, përbën rastin e vetëm në historinë e legjislacionit procedural penal shqiptar, ku rregullimi i procedurave të posaçme të gjykimit të çështjeve penale, realizohet nëpërmjet një ligji të posaçëm. Sipas ligjit të sipërpërmendur, parashikoheshin dy lloje gjykimesh penale të posaçme siç ishin, gjykimi i drejtpërdrejtë dhe gjykimi me dekret penal.

#### **a) Gjykimi i drejtpërdrejtë**

Gjykimi i drejtpërdrejtë aplikohet gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, por në rastet kur çështja ishte në kompetencë të Gjyqtarit të Paqit, edhe ky i fundit mund të kërkonte aplikimin e këtij lloj gjykimi. Gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, prokurori gjatë fazës së hetimeve mbi çështjen penale, zhvillonte disa veprime të shpejta e të nevojshme dhe nëse në përfundim të tyre, çmonte se nuk kishte nevojë për hetime të tjera, mund të merrte vendimin për ta dërguar të pandehurin përpara gjykatës. Një nga veprimet e detyrueshme gjatë këtij procedimi ishte marrja në pyetje e të pandehurit me qëllim nxjerrjen prej tij të të dhënave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes konkrete.

<sup>10</sup> Ligji datë 12.05.1937 “Mbi disa gjykime të posaçme të çështjeve penale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, f. 24-27.

Pasi prokurori merrte vendim për dërgimin e çështjes në gjykim pranë gjykatës kompetente<sup>11</sup>, kjo e fundit duhet të caktonte seancën e gjykimit e të zhvillonte pa vonesë gjykimin e të pandehurit. Zhvillimi i menjëhershëm i gjykimit kryhej kur gjykata ishte mbledhur në seancë penale. Në rastet kur gjykata nuk ishte mbledhur, ligji parashikonte detyrimin e saj për t’u mbledhur brenda 5 ditëve nga momenti i arrestimit të personit. Parashikimi i këtij afati të shkurtër përbënte një garanci më tepër për të pandehurin, megjithëse ligji nuk parashikonte ndonjë afat brenda të cilit prokurori duhet të dërgonte çështjen në gjykatë. Gjykata ishte e detyruar të respektonte këtë afat, në rastet kur ajo nuk ishte mbledhur. Përveç respektimit të parimit *habeas corpus* (paraqitjen përpara gjykatës) ligji i kohës i garantonte një sërë të drejtash për të pandehurin ku më kryesorja ishte e drejta për pasjen e mbrojtësit që në fazën e hetimeve.

Në gjykimin e drejtpërdrejtë vihej re një ndryshim midis fazës së hetimeve dhe asaj të gjykimit. Në fazën e hetimeve, i pandehuri kishte të drejtën të zgjidhte vetë mbrojtësin, në rast të kundërt prokurori e caktonte atë kryesisht. Në fazën e gjykimit, përfaqësimi me mbrojtës ishte i detyrueshëm, por në këtë fazë mbrojtësi caktohej nga gjykata e nuk zgjidhej nga vetë i pandehuri. I pandehuri që përfaqësohej nga mbrojtësi, kishte të drejtë të kërkonte një afat të arsyeshëm për të përgatitur mbrojtjen. Ky afat ishte 5 ditor, brenda të cilit gjykata caktonte datën e zhvillimit të seancës tjetër.

Për aplikimin e procedurës së gjykimit të drejtpërdrejtë, ligji specifik për gjykimin e drejtpërdrejtë parashikonte ekzistencën e disa kushteve, të cilat ishin si në vijim: *së pari* çështja në gjykim duhet të ishte në kompetencën e Gjykatës së Shkallës së Parë, *së dyti* duhet të ekzistonte gjendja e flagrancës apo kapja e të pandehurit në flagrancë, *së treti* i pandehuri të akuzohej për një nga deliktet e parashikuar nga Kodi Penal i vitit 1928, e *së katërti* ekzistenca e qartë e fajësisë së të pandehurit.

Përsa i përket kushtit të parë kërkohej që vepra për të cilën akuzohej i pandehuri të hynte në rastet e kompetencës së Gjykatës

<sup>11</sup> Po aty, Kaptina 1, Neni 1.

së Shkallës së Parë. Një veçori paraqiste kushti i dytë i ekzistencës së gjendjes së flagrancës së të pandehurit. Gjendja e flagrancës nuk ishte parashikuar në mënyrë të qartë nga ligjvënësi. Por pavarësisht këtij fakti, ligji parashikonte detyrimin, që përveç kërkimit nga ana e prokurorit të gjyqimit të drejtpërdrejtë, ky i fundit duhet të kërkonte dhe vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë. Ky kusht del nga analiza e Nenit 4 të ligjit, në të cilin parashikohet se *“kjo gjykatë mund ta mbajë të pandehurin të arrestuar ose të urdhërojë lirimin provizor të tij”*. Gjykata përpara se të fillonte me gjykimin duhet të kontrollonte ligjshmërinë e masës së sigurimit, duke u bazuar në kushtet e tij, gjendjen e flagrancës etj. Gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit, mund të vendoste edhe lirimin provizor të të pandehurit, duke mos vleftësuar në këtë mënyrë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë.

Pasi gjykata verifikonte dhe caktonte masën e sigurimit, kalonte në gjykimin e çështjes. Procedura e gjyqimit të çështjes zhvillohej njësoj si te procedura e zakonshme e gjyqimit. Palët thërrisnin dëshmitarët, por gjykata mund të thërriste dëshmitarë me anë të letër porosisë ose edhe telegrafikisht, mund të caktonte ekspertë si dhe të merrte prova të tjera, mbi bazën e të cilave realizohej debati i plotë gjyqësor dhe respektohej parimi i kontradiktoritetit të palëve. Një karakteristikë që vihet re gjatë zhvillimit të këtij lloj gjykimi ishte roli aktiv i gjykatës, ku gjykata kishte të drejtën të thërriste dëshmitarë, ekspertë etj. Një element tjetër ishte respektimi, përveç të tjerave i parimit të kontradiktoritetit. Gjithashtu, kur gjykata konstatohej që hetimi ishte i paplotë dhe fajësia e të pandehurit ishte e paqartë, kishte të drejtën të kthente aktet mbrapsht. Në rast se ndodhte një gjë e tillë atëherë instauron procedura e zakonshme e gjyqimit. Ligji nuk parashikonte një afat brenda të cilit duhet të përfundonte gjykimi. Mund të themi se ky ligj përmbante standarde të legjislacionit të vendeve perëndimore dhe parashikimet e tij ngjasojnë me parashikimet e Kodit aktual të Procedurës Penale<sup>12</sup>.

Këto ngjashmëri mund të konstatohen lehtësisht në elementet si në vijim:

<sup>12</sup> Shih Kodi i Procedurës Penale aktual, nenet 400 – 403,

- a. së pari në rastet e aplikimit të gjyqimit të drejtpërdrejtë, si në ligjin e kohës, por edhe në Kodin aktual të Procedurës Penale kërkohet ekzistenca e gjendjes së flagrancës si dhe në rastin kur i pandehuri gjatë marrjes në pyetje ka pohuar fajësinë e tij<sup>13</sup>.
- b. së dyti mund të konstatohet eliminimi i fazës së hetimeve paraprake, në ndryshim kjo nga gjykimi i zakonshëm. Ky fakt mund të vërehet lehtësisht edhe në dispozitat e Kodit aktual të Procedurës Penale, ku hetimet paraprake në rastin e gjyqimit të drejtpërdrejtë kryhen në një afat kohor mjaft të reduktuar.
- c. së treti, përsa i përket dërgimit të personit përpara gjykatës, në ligjin e kohës kërkohet menjëhershmeria e dërgimit përpara gjykatës në rastet kur kjo e fundit ishte e mbledhur, ose brenda afatit 5 ditor në rastet kur gjykata nuk ishte e mbledhur. Kodi aktual i Procedurës Penale nga interpretimi i dispozitave të tij parashikon në këtë rast një afat limit prej 96 orësh, brenda të cilit gjykata duhet të shprehet në lidhje me vleftësimin e arrestimit në flagrancë si dhe për gjykimin e njëkohshëm të të pandehurit.
- d. një element tjetër ngjashmërie midis ligjit të kohës si dhe ligjit procedural në fuqi është garantim i së drejtës së mbrojtjes me avokat dhe respektimi i parimit të kontradiktoritetit dhe të drejtës për të përgatitur mbrojtjen.

### **b) Gjykimi me dekret penal**

Ky lloj gjykimi ishte parashikuar në Nenin 7 të Ligjit, datë 12.05.1932. Gjykimi me dekret penal, mund të thuhet se bazohej tërësisht sipas parashikimeve të legjislacionit procedural penal italian. Procedura e gjyqimit me dekret penal, ndryshonte tërësisht nga rruga

<sup>13</sup> Neni 400 i K.P.P. aktual paragrafi 1 citon se *“Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë, prokurori mund të paraqesë në gjykatë brenda dyzet e tetë orëve, kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe gjykimin e njëkohshëm”*, ndërsa në paragrafin 3 citon se *“Prokurori mund të procedojë në gjykimin e drejtpërdrejtë edhe ndaj të pandehurit që gjatë marrjes në pyetje ka pohuar dhe fajësia e tij është e qartë...”*.

e zakonshme e zhvillimit të gjykimet. Në këtë gjykim eliminohej faza e zhvillimit të debatit gjyqësor. Gjykata vendoste dekretin penal (i cili në fakt përbënte edhe vendimin e saj) mbi aktet dhe provat e mbledhura nga ana e prokurorit. Këto akte dhe prova nuk i nënshtroheshin debatit gjyqësor, por çmoheshin si prova nga ana e gjykatës e në bazë të të cilave nxirrej dekreti penal i gjykatës.

Megjithatë, gjykimi me dekret penal nuk mund të kryhej për të gjitha llojet e veprave penale. Procedimi me dekret penal aplikohet përgjithësisht ndaj atyre veprave që ndiqeshin kryesisht prej prokurorisë, në rastet kur bëhej fjalë kundërvajtje penale, të cilat dënoheshin me gjobë jo më tepër se 300 franga ari ose me burgim jo më shumë se 1 muaj si dhe për krimet e lehta që dënoheshin në maksimum jo më tepër se 300 franga ari. Prokurori pasi zhvillonte hetimet paraprake e kur çmonte të nevojshme për të ngritur një akuzë të bazuar, merrte vendim për dërgimin e çështjes në gjykatë. Gjyqtari që kishte kompetencën për zhvillimin e këtij lloj gjykimi ishte gjyqtari fillor ose ai i paqit. Vepra penale konsiderohej e provuar në bazë të hetimit të kryer nga ana e prokurorit e si pasojë e rezultatit të hetimit nxirrej vendimi nga ana e gjykatës.

Përsa i përket elementëve të dekretit ligji sanksiononte<sup>14</sup> se duhet të përmbante: a) deklarimin e fajësisë së të pandehurit; b) llojin dhe masën e dënimit të dhënë; c) personin e detyruar për pagimin e shpenzimeve të gjykimet; d) disponimin e gjykatës mbi sendet e sekuestruara, duke vendosur sipas rastit konfiskimin ose kthimin e tyre.

Ligji parashikonte, se ndaj dekretit penal mund të ushtrohej ankim. I pandehuri kishte të drejtë që brenda 15 ditëve nga dita e lëshimit të dekretit të bënte ankim. Gjykata që shqyrtonte ankimin mund ta pranonte ose rrëzonte atë. Nëse e gjente të drejtë dhe të mbështetur në ligj, gjykata mund të revokonte dekretin penal dhe të nxirrte letër ftesë për gjykim me bisedim sipas rregullave të gjykimet të zakonshëm. Në këtë rast gjykata, gjatë gjykimet sipas rregullave të shqyrtimit të zakonshëm gjyqësor, mund të deklaronte të pandehurin

<sup>14</sup> Sipas Nenit 8 Dekreti duhet të përmbante: emrin, atësinë, mbiemrin e të pandehurit, banimin dhe mjeshtërinë e tij, përmbledhje të faktit, provat dhe faktet, titullin e fajit, ligjin e aplikuar, datën e depozitimit, firmën dhe vulën e gjyqtarit.

të pafajshëm ose ta deklaronte atë fajtor, duke dhënë dënim (brenda kufijve të përcaktuara në ligj) edhe më të rëndë se dënimi i dhënë me anë të dekretit penal të shfuqizuar. Edhe ky vendim i gjykatës mund të ankimohej. Ligji parashikonte se kur ankimi pranohej dhe dekreti shfuqizohej me arsyetimin se i pandehuri ishte i pafajshëm për këtë vepër, ose vepra penale nuk ekzistonte, vendimi i gjykatës sillte pasoja edhe për bashkë të pandehurit e tjerë jo ankimues.

Dekreti merrte formë të prerë në rastet kur: a) i pandehuri nuk bënte ankim brenda afatit e për pasojë parashkruhej afati i ankimit; b) gjykata që shqyrtonte ankimin, e linte në fuqi dekretin; c) i pandehuri kishte ushtruar ankim brenda afatit ligjor, por nuk ishte paraqitur në seancën e parë; ç) kur ankimi ishte bërë nga një person që nuk legjitimohej.

Në rastet kur gjykata që gjykonte mbi bazën e ankimit, dispononte për lënien në fuqi të dekretit penal, dekreti penal merrte formë të prerë dhe fillonte ekzekutimi i tij. Nga një analizë e kushteve të kërkuara, si dhe mënyrës së zhvillimit të gjykimet me dekret penal, mund të arrihet në konkluzionin se midis këtij lloj gjykimi dhe gjykimet të shkurtuar të parashikuar nga Kodi aktual i Procedurës Penale mund të vërehen mjaft ngjashmëri. Ky rezultat mund të konstatohet pasi si te gjykimi me dekret, por edhe në gjykimin e shkurtuar vërehet eliminimi i fazës së shqyrtimit gjyqësor, fakt i cili sjell zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet në fashikullin e gjykimet. Megjithatë, diferenca midis këtyre lloj gjykimesh mund të vërehen përsa i përket subjekteve të legjitimuara për instaurimin e tyre, garancive të ndryshme procedurale apo dhe afateve të ndryshme procedurale për zhvillimin dhe përfundimin e tyre<sup>15</sup>.

## **2. Gjykimet e posaçme në legjislacionin procedural penal në vitet 1939-1945**

Gjatë kësaj periudhe të zhvillimit të legjislacionit procedural penal, gjykimet e posaçme i gjejmë të rregulluar në *“Ligjin e procedurës penale ushtarake”* të vitit 1941, ligj i cili ishte nxjerrë nga autoritetet

<sup>15</sup> Shih nenet 403 -406 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi.

fashiste. Në kaptinën 3 të këtij ligji parashikoheshin tre lloje gjykimesh të posaçme: a) gjykimi në mungesë; b) gjykimi i përdrejtshëm dhe c) gjykimi me dekret penal. Duhet të theksohet se këto gjykime zbatoheshin ndaj personave ushtarakë, të cilët akuzoheshin për kryerjen e veprave penale ushtarake.

a) Përsa i përket gjykimin në mungesë, ky lloj gjykimi aplikohet në rastet kur i pandehuri për arsye të ndryshme i fshihej drejtësisë. Është pikërisht ky fakt, i cili sillte si pasojë aplikimin e një gjykimi, i cili pavarësisht nga emërtimi nuk karakterizohej nga ndonjë ndryshim thelbësor nga aplikimi i gjykimin të zakonshëm. Aplikimi i gjykimin në mungesë justifikohet në faktin se i pandehuri me vullnetin e tij i fshihej procedurave të hetimit apo gjykimin. Por nga zbatimi i gjykimin në mungesë nuk parashikohet ndonjë benefit në drejtim të ekonomizimit të procesit gjyqësor dhe as nuk përbënte aplikimin e procedurave të thjeshtëzuara të procesit gjyqësor. Në kuptimin e Kodit aktual të Procedurës Penale, fakti i gjykimin në mungesë të pandehurit nuk do të justifikonte aplikimin e një riti procedural të ndryshëm nga ai i gjykimin të zakonshëm. Kjo gjë vërehet lehtësisht nga dispozitat e Kodit aktual sipas të cilave në rastet e mungesës së pandehurit, këtij të fundit në rast se nuk ka zgjedhur mbrojtës, ky i fundit caktohet nga organi procedues pasi të jenë ezauruar detyrimet në lidhje me njoftimin e tij. Megjithatë, sipas ligjit të kohës mungesa e të pandehurit sillte për pasojë instaurimin e një gjykimi të posaçëm për nga emërtimi, por që në thelb duke analizuar zhvillimin e hetimit dhe të gjykimin nuk ishte veçse një gjykim i zakonshëm.

b) Gjykimi i përdrejtshëm ngjason me gjykimin e drejtpërdrejtë të parashikuar nga ligji i vitit 1937. Ky gjykim konsiston në eliminimin e fazës së hetimeve paraprake. Prokurori duhet të zhvillonte vetëm disa hetime të shpejta, të cilat ishin të nevojshme për të ngritur akuzën në gjykatë, pasi prokuroria bindej mbi fajësinë e të pandehurit dhe pasi e kishte marrë atë në pyetje vendoste dërgimin e çështjes në gjykatë. Më pas, gjykimi zhvillohej sipas procedurës së zakonshme, i pandehuri kishte të drejtën të thërriste dëshmitarë, të sillte prova etj. Provat i nënshtroheshin debatit gjyqësor dhe pasi ato ishin çmuar nga gjykata, gjykata merrte vendimin. Që të ishim përpara zhvillimit të procedurës

së gjykimin të përdrejtshëm, duhej që i pandehuri të ishte kapur në flagrancë, gjë që hidhte më shumë dritë mbi fajësinë e tij. Personi duhej të dërgohej menjëherë përpara gjykatës, në rastet kur gjykata ishte e mbledhur, ose brenda 10 ditëve kur ajo nuk ishte mbledhur. I pandehuri kishte të drejtën për t'u mbrojtur me përfaqësues të zgjedhur nga ai ose të caktuar kryesisht si gjatë fazës së hetimeve ashtu edhe gjatë fazës së gjykimin. Gjithashtu ai kishte të drejtë të kërkonte kohë për të përgatitur mbrojtjen. Ky afat ishte 5 ditë. Ky gjykim paraqet disa specifika të cilat e dallojnë nga gjykimi i drejtpërdrejtë i parashikuar nga ligji i vitit 1937.

Dallimet konsistojnë si në vijim: Së pari gjykata kompetente për zhvillimin e këtyre lloje gjykimesh. Në rastin e gjykimin të drejtpërdrejtë gjykatë kompetente ishte gjykata fillore ose gjykata e paqit, ndërsa për zhvillimin e gjykimin të përdrejtshëm ishte gjykata ushtarake. Së dyti gjykimi i përdrejtshëm kërkonte si kusht kryesor për aplikimin e tij ekzistencën e subjektit të posaçëm siç ishin ushtarakët, ndërsa në aplikimin e gjykimin të drejtpërdrejtë subjekti ishte i përgjithshëm pa kërkuar ekzistencën e ndonjë cilësie të veçantë apo ushtrimin e ndonjë detyre të caktuar. Së treti në lidhje me afatet e dërgimit të të pandehurit përpara gjykatës. Afati ishte i ndryshëm, ku në rastin e gjykimin të drejtpërdrejtë kërkohej mos kalimi i afatit 5 ditor nga momenti i arrestimit në flagrancë, në ndryshim nga gjykimi i përdrejtshëm ku afati maksimal ishte 10 ditor.

c) Gjykimi me dekret ishte një tjetër lloj gjykimi i posaçëm i parashikuar nga ligji i sipërpërmendur. Ky gjykim eliminonte fazën e shqyrtimit dhe debatit gjyqësor duke arritur në dhënien e vendimin mbi bazën e gjendjes në të cilën ndodhen aktet. Ndryshe nga gjykimi me dekret penal i parashikuar nga ligji "Mbi gjykimet e posaçme" i vitit 1937, zbatimi i këtij gjykimi ishte shumë i kufizuar. Kjo pasi kushtet e kërkuara për zbatimin e këtij gjykimi ishin disa: së pari kërkohej që vepra penale të ishte kryer nga një subjekt i posaçëm që kishte detyrën e ushtarakut, së dyti aplikohet për veprat penale që ligji penal ushtarak parashikonte një dënim jo më shumë se 1 vit burgim



(me kushtin që organi procedues të çmonte se i pandehuri duhet të dënohej jo më shumë se 6 muaj burgim, ose parashikonte dënim me gjobë dhe çmohej se i pandehuri duhet të dënohej jo më shumë se 500 lira gjobë); *së treti*, kur gjykohej një delikt, i cili dënohej sipas ligjit me burgim jo më tepër se 2 vjet në maksimum ose me gjobë. Pra, aplikimi i kësaj procedure të posaçme ishte në varësi të plotë të llojit të veprës penale ushtarake ndaj së cilës procedohej penalisht dhe marzheve të dënimit të parashikuara nga ligji për këtë veprë.

### 3. Gjykimet e posaçme në legjislacionin procedural penal në vitet 1945-1995

Gjatë periudhës kohore të viteve 1945-1990 u miratua një kuadër i plotë normash juridike. Këto norma ishin një bazë e mirë për rregullimin e marrëdhënieve juridike, megjithëse nuk duhet të harrojmë që normat u miratuan në jo pak raste sipas rrymave ideologjike të kohës. Rregullat e miratuara kishin përmbajtje materiale dhe procedurale. Disa nga ligjet me përmbajtje procedurale, të cilat kishin për objekt gjykimet e posaçme do të analizohen në vijim.

Ligji i parë procedural pas periudhës së luftës ishte ligji “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake”<sup>16</sup> i vitit 1945. Neni 20 i këtij ligji parashikonte kompetencën e prokurorit për hetimin e veprave penale, ku procedura hetimore duhet të ishte e shpejtë e plotë dhe pa shumë hollësira. Rregullimi i gjykimeve të posaçme do të parashikohej edhe në Ligjin nr. 59 “Mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor” i vitit 1945<sup>17</sup>. Forma e gjyimit të posaçëm e parashikuar nga ky ligj ishte gjykimi me dekret penal. Ky gjykim zbatohet nga gjyqtari i vetëm që gjykonte çështjen, i cili kur çmonte se mund të jepej një zgjidhje e shpejtë vetëm në bazë të akteve dhe provave të marra gjatë hetimeve pa realizuar shqyrtimin gjyqësor të çështjes, merrte vendim për nxjerrjen e dekretit penal, me anë të cilit e zgjidhte çështjen duke vendosur mbi fajësinë e të pandehurit. Ky

<sup>16</sup> Fletore Zyrtare nr.3 biss, 1945, f.1.

<sup>17</sup> Fletore Zyrtare nr.12, viti 1945, f.1-12.

gjykim aplikohet në rastet e procedimeve për kundërvajtje penale ose veprave penale për të cilat parashikohej dënim me gjobë.

Lehtësisht mund të konstatohet një dallim thelbësor midis gjyimit me dekret të parashikuar nga ky ligj dhe gjyimit me dekret penal të parashikuar nga ligji i vitit 1932. Dallimi konsiston në organin që merrte vendimin për paraqitjen e kërkesës për zhvillimin e këtij gjykimi. Sipas ligjit të vitit 1945 ishte vetë gjykata e cila kryesisht “*d’ufficio*” merrte vendimin për zhvillimin e këtij gjykimi (kur e çmonte të nevojshme), ndërsa te gjykimi me dekret penal tagra për çmuarjen e zhvillimit të procedimit të gjyimit me dekret ishte lënë organit të prokurorisë.

Në vitin 1946 doli një Urdhëresë e Ministrisë së Drejtësisë “Mbi disa norma procedurale”<sup>18</sup>, e cila parashikonte mundësinë që për vepra penale të lehta, të procedohej nga gjykata me dekret penal, domethënë të evitohet shqyrtimi gjyqësor i çështjes dhe zgjidhja të jepej mbështetur mbi aktet hetimore.

Sipas urdhëresës së lartpërmendur gjykimi me dekret penal zhvillohej përpara gjyqtarit të vetëm të gjykatës së rrethit në rastet e fajeve që ndiqeshin kryesisht e vetëm kur gjykata çmonte se mund të jepte dënim me gjobë deri në shumën prej 1350 lekë ose me punë të detyrueshme deri në një muaj. Në këtë procedurë nuk thirrej në gjykim i pandehuri dhe as nuk ishte i pranishëm prokurori, pasi veprat ndiqeshin kryesisht nga gjykata. Së bashku me dënimin përfundimtar me anë të dekretit mund të disponohej edhe konfiskimi i pasurisë së të pandehurit (vetëm ajo pasuri e ardhur si produkt i kryerjes së veprës penale. Në këtë procedurë konstatohet një regres i dukshëm përse i përket mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të pandehurit. Mosthirra e të pandehurit në gjykim, përbente një shkelje të rëndë të të drejtave të tij. Dekreti mund të kundërshtohet brenda 5 ditëve nga komunikimi, në gjykatën e rrethit dhe vendimi i saj kundërshtohet në gjykatën e prefekturës. Gjykata që shqyrtonte ankimin mund të jepte dënim edhe më të rëndë se ai i dhënë me anë të dekretit<sup>19</sup>.

<sup>18</sup> Urdhëresë e Ministrisë së Drejtësisë nr.2579, datë 13.10.1946, Fletore Zyrtare nr.102, datë 09.10.1946.

<sup>19</sup> Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së Lartë, nr.64, datë 05.04.1948, revista “Drejtësia

Gjithashtu në një ligj procedural që i paraprinte Kodit të vitit 1953, parashikohej një procedurë specifike e ngjashme me gjykimin e drejtpërdrejtë. Kështu pasi prokurori që hetonte çështjen pyeste përmbledhtazi të pandehurin për rrethanat e çështjes dhe vendoste arrestimin e tij, i njoftonte atij akuzën dhe merrte vendim për dërgimin e drejtpërdrejtë të çështjes në gjykim. Në këtë ligj vërehej një ndryshim i rëndësishëm përse i përket subjektit të legjitimuar, i cili kërkonte zhvillimin e gjykimit. Ndërsa në rastet e mësipërme ishte vetë gjykata e cila vendoste për zhvillimin e këtij gjykimi; në këtë ligj është prokuroria, e cila pasi konstatonte se faji ishte i dukshëm e çështja ishte e qartë dhe nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme (kjo pasi vetë i pandehuri pohonte fajësinë), merrte vendimin për dërgimin e çështjes në gjykatë dhe zhvillimin e gjykimit me dekret.

### 3.1 Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953<sup>20</sup>

Në vitin 1953 do të hyjë në fuqi kodi i ri, i cili për herë të parë do të parashikonte, një kuadër të plotë të normave që rregullonin procedimin penal<sup>21</sup>. Në të nuk parashikohej asnjë gjykim i posaçëm, por në fakt servireshin të detajuara të gjitha veprimet e organeve proceduese për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale duke ndjekur rregullat e procedurës së zakonshme të gjykimit. Ky ligj nuk specifikonte asnjë rregull, që në funksion të drejtësisë penale, të përbënte një devijim nga procedurat e zakonshme (*ordinare*). Megjithatë, në Nenin 99, paragrafi 2 të Kodit mund të konstatohen elemente të gjykimit të drejtpërdrejtë. Në fakt, në këtë kapitull bëhet fjalë për fillimin e çështjes penale. Në rastet kur prokurori çmonte se kishte vend për fillimin e ndjekjes penale, merrte vendim për dërgimin e çështjes për hetime sipas kompetencës tek organet e hetuesisë ose gjurmimit ose kur ishte rasti ia dërgonte drejtpërdrejtë gjykatës. Pra, për ato raste kur prokurori ishte vënë në dijeni ose ishte referuar për

Popullore” nr.3, viti 1948, fq.66-67.

<sup>20</sup> Ligji nr.1650, datë 30.03.1953, Kodi i Procedurës Penale i RPSH, ndryshuar me Ligjin nr. 1776, datë 3 dhjetor 1953 dhe me Ligjin nr. 2805, datë 4 dhjetor 1958.

<sup>21</sup> Halim Islami, “Demokratizimi i Legjislacionit Penal”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 2000, f. 18.

ekzistencën e një veprë penale dhe pas veprimeve të para hetimore arrinte në përfundimin se vepra ishte e qartë dhe nuk kishte nevojë për hetime të tjera, ai e dërgonte çështjen direkt për gjykim. Përse i përket ndjekjes së kësaj procedure Kodi i kohës nuk parashikonte rregulla dhe afate të caktuara.

Me Dekretin nr. 5265, datë 29.01.1975 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, u pranua gjykimi i drejtpërdrejtë, sipas të cilit për vepra penale me karakter flagrant dhe me rrezikshmëri shoqërore të vogël nuk kishte nevojë për hetime, por çështja kalonte në gjykatë me kërkesën e të dëmtuarit. Në këtë kuptim, për disa vepra të lehta, çështjet penale kalonin në gjykatë nga policia, e cila kryente disa veprime paraprake të ngutshme<sup>22</sup>. Gjykimi i drejtpërdrejtë zhvillohej për gjykimin e veprave penale, ndjekja e të cilave bëhej drejtpërdrejtë në gjykatë në bazë të kallëzimit. Kallëzimi bëhej nga i dëmtuari (i cili mund të ishte një shtetas, ndërmarrje, institucion shtetëror ose nga komandat e njësisë), nga policia dhe nga ana e prokurorit.

Kishte raste kur procedimi mund të fillonte edhe kryesisht nga ana e gjykatës<sup>23</sup>. Në aktin normativ të sipërpërmendur, parashikohej edhe mënyra e procedimit si dhe veprimet që ishin të detyrueshme për t’u kryer në momentin që bëhej kallëzimi drejtpërdrejtë në gjykatë. Në rastin kur kallëzimi bëhej nga policia, kjo e fundit kishte detyrimin të kryente disa veprime si p.sh.: këqyrjen e vendit të ngjarjes, fiksimin dhe marrjen e provave materiale, ndalimin e personit në rastet kur plotësoheshin kushtet e Nenit 109 të Kodit të Procedurës Penale (rasti i flagrancës), kontrolli i banesës, caktimin e ekspertit mjeko-ligjor, si dhe të përpilimi i listës së personave që kishin dijeni për kryerjen e krimit. Veprimet e sipërpërmendura nuk mund të shtyheshin dhe policia ishte detyruar që brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për kryerjen e krimit, të dërgonte çështjen në gjykatë.

Në rastet e çështjeve që gjykoreshin drejtpërdrejtë nga gjykata, pa qenë i nevojshëm zhvillimi i hetimeve nga organi i hetimit, gjyqtari

<sup>22</sup> Po aty, f.21

<sup>23</sup> Dekreti nr. 5265, datë 29.01.1975 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, Neni 1 paragrafi 2.

i vetëm kryente një sërë veprimesh si p.sh.: vendoste nëse do të fillonte ndjekja penale duke thërritur të pandehurin në gjyq, refuzimi i fillimit të ndjekjes penale, komunikimi i akuzës së të pandehurit, pyetja e të pandehurit nëse kërkonte të merren prova të tjera në gjyq, caktimi i masës së sigurimit kundrejt të pandehurit, kthimi i dosjes hetimore organeve të policisë kur, sipas rastit nuk ishin kryer veprimet e para që nuk mund të shtyhej caktimi i seancës së zhvillimit të gjykimit, urdhëronte thirrjen në gjykatë të të pandehurve, të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe lajmëronte për ditën e gjykimit paditësin civil, të paditurin civil dhe prokurorin, kur ky kishte njoftuar se do të merrte pjesë në gjykim. Pas caktimit të datës së gjykimit, procedura e gjykimit i nënshtrohej rregullave të gjykimit të zakonshëm, duke u bazuar në kontradiktoritetin e debatin gjyqësor midis palëve. Në fakt, veprimet e mësipërme procedurale që realizoheshin nga gjyqtari i vetëm, i përkisnin fazës së veprimeve përgatitore gjatë gjykimit në shkallë të parë. Kur gjyqtari i vetëm e gjente akuzën të bazuar dhe çmonte se hetimet ishin të mjaftueshme, merrte vendim për dërgimin e të pandehurit në gjyq. Ai sigurohej për komunikimin e aktakuzës së të pandehurit dhe caktonte ditën e gjykimit jo më përpara se 3 ditë nga dita e komunikimit të akuzës. Megjithatë me vendim të gjyqtarit, për raste të jashtëzakonshme, gjykimi mund të bëhej edhe më parë, por jo më përpara se 24 orë nga komunikimi i akuzës. Kur gjyqtari i vetëm nuk e gjente të bazuar akuzën, apo kur çmonte se hetimet duhet të plotësoheshin ose ndjekja penale duhet të pushohej e kthente çështjen te prokurori. Kundër vendimit të gjykatës për mosfillimin e ndjekjes penale, mund të bëhej ankimi i veçantë brenda 5 ditëve në Këshillin Gjyqësor.

Kompetencat dhe roli që kishte gjyqtari në këtë lloj gjykimi parashikoheshin në një udhëzim<sup>24</sup> të Gjykatës së Lartë. Në të parashikohej se gjatë afatit 5 ditor gjyqtari i vetëm duhet të merrte masa për thirrjen e të akuzuarit, kualifikimin e veprës penale,

<sup>24</sup> Udhëzim nr.2, datë 17.08.1977 i Plenumit të Gjykatës së Lartë, “Mbi veprat penale që ndiqen drejtpërdrejt në gjykatë pa qenë e nevojshme zhvillimi i hetimeve”, Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH, përmbledhje 1974-1977, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1977.

mbajtjen e procesverbalit dhe përcaktimin e provave të nevojshme për gjykim. Gjykata udhëzonte respektimin e afatit 15 ditor për gjykimin në shkallë të parë e 30 ditor për gjykimin në shkallë të dytë. Gjyqtari duhet të zhvillonte hetim të gjithanshëm, të merrte prova edhe kryesisht e në rastet kur çmonte se nevojiteshin hetime të tjera, merrte vendim për kthimin e dosjes organeve të hetimit. Gjykata e Lartë udhëzonte që në seancë përgatitore nuk duhet të bëhej vlerësim i provave dhe për rrjedhojë gjykata nuk mund të vendoste mosfillimin e ndjekjes penale për pamjaftueshmëri provash, pasi një veprim i tillë mund të realizohej vetëm në gjykimin e themelit të çështjes.

Konstatohet lehtësisht se sipas këtij udhëzimi është gjykata organi që kryente një pjesë të konsiderueshme të veprimeve procedurale, veprime të cilat në procedimin sipas rregullave të zakonshme duhet të realizoheshin nga ana e prokurorit. Duhet theksuar se veprime të tilla, të cilat i ishin ngarkuar gjykatës binin në kundërshtim me rolin që duhet të kishte si organ i dhënies së drejtësisë gjatë një procesi gjyqësor.

Kryerja e këtyre veprimeve e bënte gjykatën të kishte një rol mjaft aktiv, e cila vinte si pasojë e përqafimit të modelit inkuizitor të procedimit penal. Megjithatë gjykimi i drejtpërdrejtë i parashikuar nga dekreti i vitit 1975 rezultoi të ketë dallime thelbësore në krahasim me gjykimin e drejtpërdrejtë që rregullohet nga Kodi aktual i Procedurës Penale. Këto dallime mund të konstatohen te subjekti, i cili ka të drejtën për të kërkuar zhvillimin e gjykimit të drejtpërdrejtë, ku sipas modelit të vitit 1975 këtë të drejtë e kishin i dëmtuari, policia popullore, prokuroria dhe gjykata, ndërsa sipas ligjit aktual procedural këtë të drejtë e ka prokurori e në asnjë rast nuk i njihet e drejta gjykatës që “ex officio” të kërkojë zhvillimin e këtij lloj gjykimi. Një aspekt i fundit për t’u theksuar është se sipas dekretit të vitit 1975, gjykimi i drejtpërdrejtë zhvillohej vetëm ndaj veprave për të cilat lejohej ankimi drejtpërdrejtë në gjykatë, ndërsa në kodin aktual nuk parashikohet zhvillimi i procedurës së posaçme, duke u bazuar në llojin e veprës penale, i cili nënkupton në këtë mënyrë se ky gjykim mund të aplikohet për çdo vepër vetëm pasi të ekzistojnë kushtet e parashikuara në Nenet 400 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.

### 3.2 Kodi i Procedurës Penale i viti 1979<sup>25</sup>

Në vitin 1979 hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, i cili shfuqizoi kodin e vitit 1953. Kodi i ri ishte ndërtuar mbi ideologjinë e pastër të pushtetit, e nuk njohu as formalisht disa prej parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor. Ai parashikonte ashtu si dhe Dekreti i vitit 1975, gjykimin e drejtpërdrejtë si një formë alternative e gjykimit. Procedura me gjykim të drejtpërdrejtë, iniciohej nga organet e policisë, ndryshe nga parashikimi i Dekretit, në të cilin rrethi i subjekteve që kërkonin këtë lloj gjykimi ishte më i gjerë. Organet e policisë, pasi merrnin dijeni për një veprë penale e kryen disa veprime hetimore të zakonshme mund ta dërgonin drejtpërsëdrejti çështjen për gjykim. Në këtë rast, ishin organet e policisë ato që çmonin së çështja ishte e qartë dhe se nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme. Kjo procedurë ndiqej kryesisht në rastet e flagrancës, në të cilat qartësia e çështjes ishte e dukshme. Natyrisht procedimi i referohej gjykatës, e cila më pas bënte dhe kontrollin e tij, duke vendosur fillimin ose jo të çështjes penale si dhe marrjen apo jo të të hetuarit në cilësinë e të pandehurit. Ndër veprimet hetimore që nuk mund të shtyheshin mund të përmendim<sup>26</sup>, këqyrjen e vendit të ngjarjes, fiksimin e provave materiale dhe marrjen e tyre, përpilimin e listës së personave që kishin dijeni për kryerjen e veprës penale, ndalimin e personit kur ishin kushtet e flagrancës dhe kryerjen e raportit mjeko-ligjor. Këto veprime dhe dërgimi i materialeve në gjykatë duhet të bëheshin brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm, kur çmonte se hetimet ishin të plota dhe nuk kishte pengesa ligjore, e kur vërente se akuza ishte e bazuar mbi kryerjen e hetimeve të mjaftueshme, merrte vendim për dërgimin e çështjes për gjykim, duke urdhëruar thirrjen në gjykatë të palëve, dëshmitarëve, ekspertëve etj. Në lidhje me mundësinë e disponimit të gjyqtarit për dërgimin e çështjes për gjykim ekzistonte mendimi

<sup>25</sup> Ligji nr.6069, datë 25.12.1979, ndryshuar me Ligjin nr.6300, datë 27.03.1981, Kodi i Procedurës Penale i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë, 1982, f.547-647.

<sup>26</sup> Po aty, neni 127.

se kur çështja dërgohet për gjykim nga hetuesi, gjyqtari vendoste dërgimin për gjykim jo kur e gjente akuzën të bazuar e hetimet e plota, por kur çmonte se hetimet ishin të mjaftueshme e nuk kishte pengesa ligjore<sup>27</sup>.

Data e seancës gjyqësore caktohej jo më parë se tri ditë nga data e njoftimit të akuzës të pandehurit, por në raste të jashtëzakonshme, e me vendim të gjykatës, gjykimi mund të bëhej edhe më parë, por në çdo rast jo më parë se 24 orë nga njoftimi i akuzës së të pandehurit<sup>28</sup>. Më pas vazhdohej me debatin gjyqësor, duke iu nënshtruar rregullave të zakonshme të administrimit, vlerësimit e çmuarjes së provave. Karakteristikë e këtij gjykimi është fakti se gjyqtari i vetëm, krahas verifikimit të elementeve ligjore të mësipërme, vleftësonte edhe masën e sigurimit ndaj të pandehurit, që do të thotë se kontrollonte edhe ligjshmërinë e arrestimit. Kur gjyqtari çmonte se duhej ndryshuar akuza pasi kjo rëndonte pozitën e të pandehurit, apo kur çmonte se çështja duhet të pushohej ose se hetimet duheshin integruar nga hetuesia, merrte vendim për dërgimin e çështjes në seancë përgatitore, duke ndjekur rregullat e gjykimit të zakonshëm. Në seancë përgatitore gjykata vlerësonte mjaftueshmërinë e hetimeve si dhe faktin nëse ekziston apo jo një bazë faktike e ligjore për fillimin e çështjes penale. Si rrjedhojë, gjykata mund të vendoste në disa mënyra si p.sh., për dërgimin e çështjes për gjykim, pushimin/pezullimin e procedimit, apo kthimin e akteve për hetime të mëtejshme.

Përcaktimi për kryerjen e veprimeve të mësipërme si atribut i gjykatës ishte mendim i gabuar, pasi binte në kundërshtim me funksionet e saj e me rolin që duhet të kishte gjykata në sistemin akuzator. Kjo gjë vinte si pasojë e suprimimit të figurës së prokurorit dhe kalimit të kompetencave të tij, organit të policisë. Disa prej karakteristikave kryesore të gjykimit të drejtpërdrejtë ishin si në vijim. Ky gjykim fillonte me iniciativë të organeve të policisë, e mund të

<sup>27</sup> Ali Zanko, “ Mbi disa çështje të gjykimit në shkallë të parë”, revista “Drejtësia Popullore”, nr.1, viti 1979, f.59-71.

<sup>28</sup> Ligji nr.6069, datë 25.12.1979, ndryshuar me Ligjin nr.6300, datë 27.03.1981, Kodi i Procedurës Penale i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë, 1982, f.547-647, Neni 128.

aplikohej për vepra penale të lehta, si plagosje e lehtë, heqja e paligjshme e lirisë, fyerja, goditja për shkak të detyrës, kundërshtimi i punonjësit të shtetit, plagosja e rëndë nga pakujdesia, rrahja etj.<sup>29</sup>. Gjatë zhvillimit të këtij gjykimi, gjykata kishte të drejtën e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale<sup>30</sup>.

#### 4. Kodi i Procedurës Penale i vitit 1995

Në legjislacionet e ndryshme procedurale penale vihet re tendenca për të thjeshtëzuar, apo kur janë kushtet, për të eliminuar ndonjë fazë të procedimit. Pikërisht eliminimi i një faze të procedimit penal, e cila zbatohet në gjykimin e zakonshëm, sjell si pasojë aplikimin e procedurës alternative të gjykitimit ose ndryshe gjykimin e posaçëm<sup>31</sup>.

Edhe në Kodin aktual të Procedurës Penale janë parashikuar format e gjykimeve të posaçme. Zbatimi dhe rregullimi i tyre në mënyrë të hollësishme ka filluar të zbatohet, pikërisht në momentin kur sistemi ynë procedural penal kaloi nga modeli i sistemit të pastër “**inkuizitor**”, në atë të sistemit “**akuzator të përzier**”<sup>32</sup>. Kodi aktual i Procedurës Penale nëpërmjet rregullave të tij, synon të realizojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur në këtë mënyrë liritë dhe të drejtat e të pandehurit, pasi kjo do të sillte forcimin e rendit juridik<sup>33</sup>.

<sup>29</sup> Ligji nr.5591, datë 15.06.1977, i ndryshuar, Kodi Penal i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë 1982.

<sup>30</sup> Shih Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë datë 25.01.1979, në të cilin qartësohej e drejta e gjykatës për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës që ndiqet drejtpërdrejtë në gjykatë, pa qenë i nevojshëm zhvillimi i hetimeve, por: “*Gjykata ka detyrimin t’ia komunikojë akuzën e re të gjykuarit dhe ta pyesë në lidhje me të, duke mos pasur detyrimin të zbatojë rregullat e nenit 213 të K.Pr.P; të cilat i japin të pandehurit një afat 3 ditor për të organizuar mbrojtjen*”, revista “Drejtësia Popullore”, nr.2, viti 1979, fq.127-128.

<sup>31</sup> Shih Tartale.G, “Gjykimet e posaçme si alternativa gjykimi”, f.8

<sup>32</sup> Shih, Maksim Haxhia, ‘Gjykimi i shkurtuar dhe problemet gjate zbatimit të tij në praktik’, revista “Avokatia”, nr.2, Tiranë, 2012, f. 35.

<sup>33</sup> Halim Islami, “Demokratizimi i Legjislacionit Penal”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 2000, f. 26.

Gjykimet e posaçme parashikohen në Nenet 400 deri 406 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas dispozitave të sipërpërmendura, parashikohen dy lloje gjykimesh të posaçme, gjykimi i drejtpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar. Tipar karakteristik për këtë kod është përcaktimi i gjykitimit të shkurtuar brenda kuadrit të gjykimeve të posaçme. Në fakt, në këtë kod gjykimi i shkurtuar parashikohet për herë të parë në legjislacionin tonë procedural, megjithëse një formë mjaft elementare e tij ka qenë gjykimi me dekret penal. Gjykimi me dekret përafrohet me gjykimin e shkurtuar, pasi të dy këto lloje gjykimesh kryhen vetëm mbi bazën e akteve dhe evitojnë fazën e shqyrtimit gjyqësor. Në dallim nga dy të parët, gjykimi i drejtpërdrejtë ka qenë i pranishëm gjatë gjithë zhvillimit të legjislacionit procedural penal, ndonëse është shfaqur me karakteristika të ndryshme. Në tërësi kodi procedural dhe veçanërisht gjykimet e posaçme janë ndërtuar mbi bazën e legjislacioneve më të zhvilluara perëndimore.

##### a) Gjykimi i drejtpërdrejtë

Në Nenet 400 deri 403 të Kodit aktual të Procedurës Penale, parashikohet procedura e zhvillimit të gjykitimit të drejtpërdrejtë. Për aplikimin e këtij lloje gjykimi duhet të plotësohen kryesisht dy kushte. Së pari kërkohet që i pandehuri të jetë arrestuar në flagrancë<sup>34</sup> e së dyti në rastet kur gjatë pyetjes së tij nga prokurori, ai pohon fajësinë dhe ajo është e qartë<sup>35</sup>. Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë bëhet nga prokurori, i cili përveç kërkesës për vleftësimin e masës së sigurimit, në rastet kur personi është arrestuar në flagrancë kërkon dhe gjykimin e njëkohshëm të tij. Siç vihet re në gjykimin e drejtpërdrejtë eliminohet (edhe pse jo *in integrum*) faza e zhvillimit të hetimeve paraprake,

<sup>34</sup> Sipas nenit 252 parg. 1 të Kodit të Procedurës Penale “Është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale”.

<sup>35</sup> Neni 400 par. 3 i Kodit të Procedurës Penale “Prokurori mund të procedojë në gjykimin e drejtpërdrejtë edhe ndaj të pandehurit që gjatë marrjes në pyetje ka pohuar dhe fajësia e tij është e qartë”.

ndërsa gjykimi zhvillohet sipas procedurës së zakonshme. Duhet të theksohet se është gjykata ajo që vendos nëse do të kalohet në gjykim të drejtpërdrejtë, duke vleftësuar masën e sigurimit në bazë të akteve të depozituara nga prokurori. Në rast se gjykata nuk e vleftëson masën e sigurimit, i kthen aktet prokurorit, përveç rasteve kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin që gjykata të procedojë me gjykimin e drejtpërdrejtë. Personi i arrestuar në flagrancë duhet të dërgohet para gjykatës brenda 48 orëve, ndërsa në rastin kur i pandehuri pohon fajësinë duhet të dërgohet përpara gjykatës brenda 15 ditëve. Siç mund të konstatohet, faza e hetimit është mjaft e kufizuar ku në rastin e flagrancës është 48 orë, ndërsa në rastin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit afati maksimal është 15 ditë<sup>36</sup>. Gjykimi zhvillohet nga gjyqtari monokratik ose me trup gjykues në varësi të masës së dënimit duke iu referuar në këtë mënyrë parashikimeve të Nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale.

### ***b) Gjykimi i shkurtuar***

Gjykimi i shkurtuar është një tjetër lloj gjykimi i posaçëm, i cili rregullohet nga Nenet 403 deri 406 të Kodit të Procedurës Penale. Ky gjykim ka në vetvete natyrën e një “*akti personal të shprehjes së vullnetit*”, bazuar ky në “*afësinë*” për të kërkuar zbatimin e mekanizmit për një gjykim të diferencuar, e diktuar kjo nga gjendja në të cilën ndodhen aktet në dosjen objekt gjykimi<sup>37</sup>. Të drejtën për të kërkuar zhvillimin e këtij gjykimi e ka i pandehuri, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm. Kërkesa duhet të dorëzohet të paktën tre ditë përpara datës së caktuar për seancën ose në seancë mund të kërkohet edhe me gojë. Arsyeja pse është përcaktuar ky afat, është lënia e kohës së mjaftueshme gjykatës për t’u njohur me kërkesën dhe aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore. Është gjykata ajo që vendos, nëse jemi përpara kushteve për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar. Pasi gjykata vendos për pranimin e kërkesës, zhvillohet gjykimi, i cili bazohet vetëm në gjendjen që janë aktet, duke eliminuar fazën e diskutimit, respektimin e parimit të kontradiktorialitetit etj.

<sup>36</sup> Shih Halim.I, Hoxha.A, Panda.I, “Procedura Penale”, Tiranë, 2010, f. 512.

<sup>37</sup> Shih, Maksim Haxhia, ‘Gjykimi i shkurtuar dhe problemet gjatë zbatimit të tij në praktikë’, revista “Avokatia”, nr.2, Tiranë, 2012, f. 37.

Nga zhvillimi i këtij gjykimi, rrjedhin disa përfitime, pasi nga njëra anë kemi realizimin e shpejtë të drejtësisë, si dhe një ekonomizim të procesit gjyqësor e nga ana tjetër, i pandehuri përfiton një ulje me 1/3 e masës së dënimit. Në procedimet me disa bashkë të pandehur ku një ose disa kërkojnë gjykimin e shkurtuar, ndërsa pjesa tjetër jo, gjykata mund të vendosë për ndarjen e çështjes, e kur çështja nuk mund të ndahet ndiqet procedura normale e gjykimit të zakonshëm.

### **Përfundime**

Siç u parashtrua në këtë punim legjislacioni procedural penal, përta i përket pjesës mbi gjykimet e posaçme, duke e parë në këndvështrimin evolutiv ka pësuar mjaft ndryshime, ku herë-herë janë parashikuar modelet më elementare të gjykimeve të posaçme e herë të tjera janë marrë si modele ritet alternative, të cilat për nga origjina kanë qenë të frymëzuara nga legjislacionet perëndimore e më konkretisht nga ai italian. Megjithatë, në ditët e sotme siç u konstatua më lart, ligji procedural penal, parashikon si lloje gjykimesh të posaçme binomin gjykim i drejtpërdrejtë dhe gjykim i shkurtuar. Nga një analizë e zbatimit të tyre në praktikë vërehet se përgjithësisht këto modele kanë ecur mirë e kanë sjellë impakt pozitiv në drejtim të një drejtësie penale sa më efektive. Por, në jo pak raste vërehet se kryesisht në zbatimin e gjykimit të shkurtuar, ky i fundit është kuptuar si një benefit që gëzon i pandehuri në kuptim të uljes së dënimit.

Kohët e fundit në komunitetin e juristëve po hidhen mjaft mendime mbi mundësinë e parashikimit në kod edhe të llojeve të tjera të gjykimeve të posaçme e kjo në funksion dhe në interes të një drejtësie sa më efektive. Megjithatë, duhet pasur kujdes<sup>38</sup> në zgjedhjen e modeleve të gjykimeve të posaçme. Mund të thuhet se në mjaft vende të rajonit janë shtuar nëpër kodet e procedurave penale respektive, marrëveshjet për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve. Ekzistojnë mendime të juristëve të ndryshëm

<sup>38</sup> Shih Skënderaj K., Hoxha A. “Disa mendime në lidhje me amendimin e Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë”, botuar në Revista Shkencore “Politikja” nr.1/2012, f. 135.

për implementimin në Kodin e Procedurës Penale të gjyqimit të dhënies së dënimit mbi bazën e marrëveshjes midis palëve (patteggiamento).

Edhe pse nuk ka asgjë kundër zbatimit të këtij riti, duhet theksuar se duhet kryer një analizë e kujdesshme, kjo gjithmonë duke parë dhe kushtet në të cilat ndodhet vendi ynë. Në përfundim mund të thuhet se Kodi aktual i Procedurës Penale edhe pse ka pak vite nga hyrja në fuqi e tij, përsa i përket pjesës mbi gjykimet alternative duket se e ka përmbushur qëllimin e ligjvënësit, duke arritur në këtë mënyrë të mbajë baraspeshën midis nevojës së një drejtësie sa më efektive me atë të parashikimit të benefiteve për personat objekt të këtyre lloje gjykimesh.

## Bibliografia

1. Anastasi, Aurela., “Kanuni i Zhurisë”, revista “Studime Juridike” Nr.1, shtator 2001, Botim i Fakultetit të Drejtësisë në UT, Tiranë, 2001.
2. Anastasi, Aurela., “Historia e të drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)”, Tiranë 2007.
3. Halim.I, Hoxha.A, Panda.I, “Procedura Penale”, Tiranë, 2010.
4. “Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri”, Grup autorësh, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 2001.
5. Zanko, Ali., “Mbi disa çështje të gjyqimit në shkallë të parë”, revista “Drejtësia Popullore”, nr.1, viti 1979.
6. Islami, Halim., “Demokratizimi i Legjislacionit Penal”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 2000.
7. Haxhia, Maksim., Gjykimi i shkurtuar dhe problemet gjatë zbatimit të tij në praktikë, revista “Avokatia”, nr.2, Tiranë, 2012,
8. Panda, Ilir., Mikrotezë “Organizimi Gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë”, 2005.

9. Nova, Koço., Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri (1912-1939), Botimi “Pegi”, Tiranë.
10. Tartale, Gerti., Gjykimet e posaçme si alternativë gjykimi, Tiranë, 2010.
11. Code D’Instruction Criminelle de 1808, (en plusieurs livraisons, a partir du 18 novembre 1808).
12. Kanuni i Zhurisë, Gazeta Qeveritare ‘Përlindja e Shqypnijos’ nr.13-14-15, viti I, shkurt 1914.
13. Kodi Penal Ushtarak në kohë paqe i vitit 1932, Fletore Zyrtare nr.28, viti 1932.
14. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (1995).
15. Fletore Zyrtare nr.3 biss, 1945.
16. Fletore Zyrtare nr.12, viti 1945.
17. Përmbledhje aktesh të Qeverisë së Vlorës, Shtypshkronja “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.
18. Ligji datë 12.05.1937 “Mbi disa gjykime të posaçme të çështjeve penale”, Fletore Zyrtare nr.40.
19. Ligji nr.1650, datë 30.03.1953, Kodi i Procedurës Penale i RPSH, ndryshuar me Ligjin nr. 1776, datë 3 dhjetor 1953 dhe me Ligjin nr. 2805, datë 4 dhjetor 1958.
20. Ligji nr.6069, datë 25.12.1979, ndryshuar me Ligjin nr.6300, datë 27.03.1981, Kodi i Procedurës Penale i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë, 1982.
21. Ligji nr.6069, datë 25.12.1979, ndryshuar me Ligjin nr.6300, datë 27.03.1981, Kodi i Procedurës Penale i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë, 1982, f. 547-647.
22. Ligji nr.5591, datë 15.06.1977, i ndryshuar, Kodi Penal i RPSSH, Kodet e RPSSH, përgatitur për botim nga Byroja Juridike pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë, 1982.
23. Urdhëresë e Ministrisë së Drejtësisë nr.2579, datë

- 13.10.1946, Fletore Zyrtare nr.102, datë 9.10.1946.
24. Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së Lartë, nr.64, datë 05.04.1948, revista “Drejtësia Popullore” nr.3, viti 1948.
25. Dekreti nr. 5265, datë 29.01.1975 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, Neni 1/2.
26. Udhëzim nr.2, datë 17.08.1977 i Plenumit të Gjykatës së Lartë, “Mbi veprat penale që ndiqen drejtpërdrejtë në gjykatë pa qenë e nevojshme zhvillimi i hetimeve”, Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH, përmbledhje 1974-1977, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1977.
27. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 25.01.1979, revista “Drejtësia Popullore”, nr.2, viti 1979.
28. Skënderaj K./Hoxha A. “Disa mendime në lidhje me amendimin e Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë”, botuar në Revista Shkencore “Politikja” nr.1/2012, Shtëpia Botuese West Print.

## **VËSHTRIM TEORIK I VEPRAVE PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE DEMOKRATIKE**

Drnt. Evisa KAMBELLARI  
Departamenti i të Drejtës Penale,  
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës  
E-mail: evisa.kambellari@yahoo.com

### **1. Hyrje**

Integriteti dhe funksionimi eficient i sistemit zgjedhor, janë elemente me rëndësi thelbësore për garantimin e shprehjes së lirë të vullnetit politik në shoqëri. Parashtrimi i rregullimeve dhe kërkesave të qarta për organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, si dhe për ndërtimin e një sistemi zgjedhor të bazuar tërësisht në parimet demokratike, duhet domosdoshmërisht të pasohet nga vendosja dhe zhvillimi i mekanizmave të nevojshëm për zbatimin efektiv të këtyre rregullimeve, si një parakusht i rëndësishëm për ekzistencën e një shoqërie demokratike.

Në këtë kontekst, normat juridiko-penale u bashkëngjiten mekanizmave të tjerë juridikë në përmbushje të qëllimit final të mbarëvajtjes së një sistemi zgjedhor demokratik nëpërmjet inkriminimit të sjelljeve të caktuara, të cilat paraqesin kërcënim serioz për funksionimin normal të tij dhe për garantimin e të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me zhvillimin e një procesi të rregullt zgjedhor.



Këto kategori veprash penale parashikohen në kreun X të Kodit Penal, të emërtuar ‘Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve’. Dispozitat në fjalë, parashikojnë një numër figurash, veprash penale që lidhen kryesisht me moscenimin e të drejtës së votës së lirë dhe të fshehtë, pengimet në ushtrimin e aktivitetit elektoral, ndëshkimin e formave të ndryshme të ndikimit apo shtrëngimit me qëllim përfshirjen e subjekteve të ndryshme në veprimtari elektorale, si dhe me garantimin e paprekshmërisë dhe vërtetësisë së rezultateve të votimit.

Punimi synon pikësisht, të paraqesë veçoritë kryesore që paraqet konsumimi i këtyre veprave penale, bazat e aplikimit të përgjegjësisë penale për këtë kategori veprash, evidentimin e qartë të rasteve kur sjelljet e paligjshme që cenojnë sistemin demokratik zgjedhor sjellin lindjen e përgjegjësisë penale dhe dallimin e tyre nga llojet e tjera të shkeljeve, të cilat, sipas rastit mund të sjellin përgjegjësi disiplinore apo administrative. Një hapësirë e veçantë e këtij punimi, i është kushtuar gjithashtu prezantimit të aspekteve krahasuese duke ballafaquar dispozitat përkatëse të kodit tonë penal me dispozitat respektive në legjislacionin francez, dhe atë gjerman. Gjatës kësaj trajtëse shpjegohet se si mbrojtja e ofruar nga legjislacioni penal synon të garantojë edhe më tej mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor demokratik, i cili, t’i shërbejë shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësve dhe pasqyrimin të saktë të këtij vullneti.

## 2. Rëndësia e mbrojtjes së zgjedhjeve të lira dhe demokratike

Mekanizmi i marrjes së pushtetit nëpërmjet organizimit të zgjedhjeve të lira konsiderohet se ndikon drejtpërsëdrejti në ndërtimin e një qeverisjeje të bazuar mbi llogaridhënien ndaj qytetarëve, e si rrjedhim përbën një aspekt thelbësor në fitimin e legjitimitetit nga ana e saj<sup>39</sup>. Parimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike bazohet në

<sup>39</sup> Shiko : Collier. P., dhe Vicente. P. C. (2010). *Violence, Bribery, and Fraud: The Political Economy of Elections in Sub-Saharan Africa*, f. 2.

vendosjen dhe respektimin e disa kriterëve të rëndësishme, të njohura edhe nga komuniteti ndërkombëtar në instrumentet kryesore mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kështu në Nenin 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut parashikohet se “*vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje të lira dhe periodike, të cilat, duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe të organizohen nëpërmjet votimit të fshehtë ose sipas procedurave ekuivalente të votimit të lirë*”. Po kështu në Protokollin e parë shtesë të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore gjen shprehje e drejta për zgjedhje të lira, në kuadër të garantimit të së cilës, shtetet palë marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës<sup>40</sup>.

Rëndësia e këtij parimi është përcaktuar qartë edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke e renditur atë si një nga parimet themelore kushtetuese. Në Nenin 1 të Kushtetutës thuhet se “*qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike*”.

Organizimi i zgjedhjeve periodike midis kandidatëve që veprojnë në një sistem të vërtetë pluralizmi politik, i udhëhequr nga parime të cilat sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë subjektet për të marrë pjesë në procesin konkurrues, për dëgjimin e mesazheve të tyre elektorale, që sigurojnë mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të kandidatëve dhe mbështetësve të tyre përbejnë themelet e një shoqërie demokratike<sup>41</sup>. Respektimi i këtyre standardeve është kusht i domosdoshëm për ndërtimin e një qeverisjeje, e cila të jetë shprehje e vullnetit të lirë dhe të përgjithshëm të zgjedhësve. Duke pasur parasysh që interesat e përfshira në këtë proces i përkasin një natyre të mirëfilltë

<sup>40</sup> Shiko Nenin 3 të Protokollit të parë shtesë të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.

<sup>41</sup> Shiko: Rajasingham, S. K. *Essentials of Free and Fair Elections*, punim i prezantuar në Konferencën Rajonale mbi Zgjedhjet e Lira, të Ndershme dhe të Besueshme, Islamabad, Pakistan, qershor, 2005, fq. 2.

publike, angazhimi i të drejtës penale për mbrojtjen e tyre nga sjellje të caktuara të paligjshme është i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit final të mbarëvajtjes efektive të një sistemi zgjedhor demokratik.

### 3. Mbrojtja juridiko-penale

Mbrojtja e zgjedhjeve të lira dhe demokratike nga veprime ose mosveprime që cenojnë të drejtën e votës së lirë dhe të fshehtë, pengojnë ushtrimin e aktivitetit elektoral apo synojnë të prekin vërtetësinë e rezultateve të votimit, përbën një interes primar në një shoqëri demokratike. Rëndësia e interesave që cenohen ose mund të cenohen në raste të tilla sjell domosdoshmërinë e angazhimit të ligjit penal, si një mekanizëm që synon parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve të caktuara të kundërligjshme që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Në vijim të këtij punimi, parashtrihen parashikimet që përmban legjislacioni ynë penal në këtë fushë të shoqëruara me analizën përkatëse teorike.

#### *3.1 Pengimi i subjekteve zgjedhore dhe i pjesëmarrësve në zgjedhje*

Për të garantuar efektivisht mbarëvajtjen e rregullt të procesit zgjedhor është e rëndësishme që të sigurohen kushtet për ushtrimin normal të aktivitetit të subjekteve zgjedhore dhe pjesëmarrësve në zgjedhje nga çdo ndikim i paligjshëm. Në këtë kontekst, sipas legjislacionit tonë penal dënohet pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore<sup>42</sup>. Subjekte zgjedhore në kuptim të ligjit janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore<sup>43</sup>. Si rrjedhim, veprimet me natyrë penguese mund të drejtohen ndaj veprimtarisë së një kandidati ose të një partie politike. Pengimi i një

<sup>42</sup> Shiko Nenin 325 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>43</sup> Shiko Nenin 1/20 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

kandidati mund të konsistojë në ushtrimin e dhunës fizike ndaj tij, kanosjen serioze për cenim të integritetit të tij fizik, ose kanosjen për cenim të integritetit moral nëpërmjet kërcënimit të publikimit të informacioneve të caktuara rreth jetës së tij private që mund të jenë denigruese për personin e tij. Gjithashtu, pengimi mund të shprehet në ndalimet për të ushtruar aktivitetin e tij elektoral, për të zhvilluar takime me zgjedhësit etj.

Për sa i përket, pengesave që mund të krijohen ndaj partive politike, si subjekte zgjedhore për të ushtruar aktivitetin e tyre përmendim: krijimin e pengesave të pajustificuara në lidhje me regjistrimin e tyre si subjekte zgjedhore, ndalimi për të zhvilluar takime me elektoratin, i cili mund të shprehet në vendosjen e pengesave fizike në mjediset ku është planifikuar të zhvillohet takimi ose në mosdhënien e lejes për organizimin e tubimit, në rastin kur do të organizohet në një vend të caktuar publik, dhe për këtë arsye është e nevojshme dhënia e autorizimit nga organet kompetente.

Gjithashtu, në Kodin Penal ka parashikime të veçanta që dënojnë pengimin e zgjedhësve në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar. Ndër veprimet që dënohen janë: kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar; pengimi për të votuar duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit apo në forma të tjera<sup>44</sup>, siç mund të jenë ushtrimi i dhunës fizike ndaj tij; privimi në mënyrë të paligjshme i lirisë etj. Sipas ndryshimeve më të fundit të Kodit Penal<sup>45</sup>, janë vendosur parashikime të veçanta edhe në rastin kur veprimet me natyrë penguese drejtohen kundër komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet. Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet këtyre subjekteve për t'i penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tyre në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

<sup>44</sup> Veprime të tilla, janë parashikuar në mënyrë të posaçme nga Neni 330 i Kodit Penal.

<sup>45</sup> Shiko Nenin 329/2 të Kodit Penal, shtuar me Ligjin nr. 23/2012.

### 3.2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe i rezultateve të zgjedhjeve

Sjelljet që inkriminohen në këtë aspekt konsistojnë në kryerjen me dashje të veprimeve të paligjshme që kanë si synim final ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet manovrave të ndryshme mashtruese mbi mjetet e përdorura për përfitim të këtij rezultati. Në literaturën e huaj veprimet me natyrë falsifikuese që cenojnë integritetin e rezultatit të zgjedhjeve përfshihen në konceptin e mashtrimit elektoral. Nëse do të jepnim një përkufizim të përgjithshëm të këtij termi mund të shpreheshim se *‘mashtrimi elektoral nënkupton çdo shkelje me dashje të ligjit, të kryer nga punonjësit zgjedhorë ose pjesëmarrësit e tjerë në zgjedhje, si rezultat i së cilës, shtrembërohet vullneti individual ose kolektiv i votuesve’*<sup>46</sup>. Tipologjia e kësaj vepre penale, në kuadër të ligjit tonë penal, materializohet në forma të ndryshme, si falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme.

Falsifikimi mund të kryhet nëpërmjet paraqitjes së shifrave ose të dhënave që dihet se janë të pasakta në dokumentet dhe materialin zgjedhor, nëpërmjet zëvendësimit të fletëvotimeve të sakta me fletë të tjera votimi të pasakta<sup>47</sup>, apo duke vlerësuar fletë votimi të pavlefshme si të vlefshme dhe anasjelltas. Vepra mund të konsumohet gjithashtu edhe nëpërmjet vendosjes së kutive të votimit që përmbajnë fletë votimi të plotësuar paraprakisht ose futjes pas mbylljes së procesit të votimit të fletëve të tjera shtesë. Ndërkohë veprimet e parregullta që lidhen me mospërfshirjen me dashje në listat e zgjedhësve të subjekteve që kanë të drejtën e zgjedhjes në bazë të ligjit, ose regjistrimin në këto lista të subjekteve që nuk e kanë të drejtën e zgjedhjes, janë strukturuar në një dispozitë të veçantë, të emërtuar ‘shkelja e së drejtës së zgjedhjes’.

<sup>46</sup> Shiko: Vickery. C., dhe Shein. E. *Assessing Electoral Fraud in New Democracies: Refining the Vocabulary*. IFES White Paper Series, 2012, f. 9.

<sup>47</sup> Shiko. I. Elezi. *E Drejta Penale (Pjesa e Posaçme)*. Botimet ERIK, Tiranë, 2007, f. 616.

Te falsifikimi i materialit zgjedhor një element i rëndësishëm për ekzistencën e figurës së veprës penale është kryerja me dashje e veprimeve nga ana e subjektit me qëllim që në mënyrë mashtruese të pasqyrojë një rezultat të ndryshëm zgjedhor. Nuk do të ishim përpara konsumimit të kësaj vepre penale nëse pasqyrimi i gabuar i të dhënave ka ardhur si shkak i mungesës së njohurive përkatëse administrative ose keqkuptimit të procedurës nga ana e punonjësit të ngarkuar me këtë detyrë. Të tilla rrethana mbeten në sferën e aplikimit të përgjegjësisë administrative, por jo asaj penale. Në këtë kuptim, autorë të ndryshëm evidentojnë dallimin tradicional që qëndron midis “shkeljeve të kryera si rezultat i gabimeve, mungesës së njohurive ose të përgatitjes profesionale dhe shkeljeve të vullnetshme gjatë një procesi zgjedhor<sup>48</sup>”. Megjithatë pranohet se në praktikë vendosja e një kufiri ndarës midis këtyre dy kategorive shkeljesh paraqitet e paqartë, pasi mund të jetë e vështirë të vërtetohet dashja në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin elektoral<sup>49</sup>.

### 3.3 Ndikimi i paligjshëm në vullnetin e zgjedhësve

Legjislacioni penal, përmban norma të veçanta, të cilat ndëshkojnë veprime të ndryshme që cenojnë apo synojnë të ndikojnë në mënyrë të paligjshme në vullnetin e zgjedhësve. Sipas Nenit 328 të Kodit Penal *“ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim...për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashë muaj gjer në dy vjet”*. Për më tepër, me synimin e parandalimit sa më të plotë dhe efektiv të këtyre praktikave dënohet edhe pranimi i të hollave, të mirave materiale dhe favorizimeve të tjera kundrejt kryerjes së veprimeve të mësipërme<sup>50</sup>. Një vëmendje e

<sup>48</sup> Shiko: H. Davalos. dhe Dong, N. H. *“Fraud and Fraud Prevention”*, punim i prezantuar në Konferencën e 8-të Evropiane mbi Organet Administruese të Procesit Zgjedhor, Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), maj 2011.

<sup>49</sup> Po aty.

<sup>50</sup> Në kuptim të dispozitës, të tilla veprime përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

veçantë i kushtohet gjithashtu ndëshkimit të veprimeve kanosëse që bëhen ndaj zgjedhësve për të influencuar në vendimmarrjen e tyre për të votuar ose jo apo për të votuar në një mënyrë të caktuar<sup>51</sup>.

Sipas formulimit aktual të dispozitës dënohet kanosja e kryer ndaj zgjedhësve ndërkohë që nuk ka parashikime në lidhje me forma të tjera të shtrëngimit të kryera për të njëjtin qëllim. Nëse i referohemi shpjegimit tradicional që doktrina e të drejtës penale i bën veprës penale të kanosjes, vëmë re se në këtë koncept përfshihen veprime të kërcënimit serioz për jetën ose dëmtimin e rëndë të shëndetit. Në këto kushte, mund të dënohen vetëm ato forma të dhunës psikike ndaj zgjedhësve, të cilat për nga përmbajtja dhe formulimi janë të një natyre serioze dhe që konsistojnë në kërcënimin për jetën ose plagosjen e rëndë të personit.<sup>52</sup> Megjithatë, në terma praktikë vullneti i zgjedhësve mund të ndikohet dhe të shtrembërohet edhe nëpërmjet formave të tjera të shtrëngimit, të cilat nuk përbëjnë kërcënime për cenim të rëndë të shëndetit apo jetës së personit. Ndër këto forma përmendim: dhunime që cenojnë integritetin fizik të personit, por që nuk rezultojnë në dëmtim të rëndë të shëndetit, kërcënimet për shkatërrim ose dëmtim të pronës, për dëmtim të interesave financiare, presionet për humbjen e vendit të punës etj. Në mënyrë që dispozita t'i përgjigjet sa më mirë qëllimit për të cilin është vendosur, do të ishte mirë që në përmbajtje të saj të gjenin parashikim të posaçëm edhe forma të tjera të shtrëngimit, që kanë për synim të ndikojnë në vullnetin e lirë të zgjedhësve.

Një perspektivë tjetër në të cilën shprehet vullneti i lirë i zgjedhësve është edhe ajo e vlerësimit për të marrë pjesë ose jo në një aktivitet të caktuar elektoral. Në një shoqëri demokratike, pjesëmarrja në të tilla veprimtari është një çështje që duhet lënë tërësisht në sferën e vullnetit personal të qytetarëve. Në kuadër të ndryshimeve që pësoi Kodi Penal në bazë të Ligjit nr. 23/2012<sup>53</sup>, në grupin e veprave penale

<sup>51</sup> Në Nenin 329/1 të Kodit Penal parashikohet se "Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga tre muaj gjer në dy vjet."

<sup>52</sup> Shiko. I. Elezi. E Drejta Penale (Pjesa e Posaçme). Botimet ERIK, Tiranë, 2007, f. 72 dhe 619.

<sup>53</sup> Ligji nr. 23/2012 'Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995

që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve u shtua një dispozitë e veçantë mbi detyrimin e shtetasve për të marrë pjesë në veprimtari elektorale kundër vullnetit të tyre. Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj<sup>54</sup>. Nga interpretimi i dispozitës kuptojmë që detyrimi në këtë rast kryhet nga një subjekt që ka nën varësi administrative shtetasit dhe shpërdoron këtë raport për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në vullnetin e tyre për të marrë pjesë në veprimtari elektorale. Në praktikë do të ishim përpara konsumit të kësaj veprë penale nëse një kryetar i një njësie të qeverisjes vendore detyron punonjësit e administratës apo banorë të thjeshtë brenda njësisë administrative që ai drejton, për të marrë pjesë në një aktivitet elektoral, nën kërcënimin e marrjes së masave administrative ndaj tyre apo formave të tjera të shtrëngimit.

### **3.4 Vepra të tjera penale**

Dispozita të tjera penale marrin në mbrojtje aspekte të caktuara të veprave penale që cenojnë mbarëvajtjen dhe realizimin e rregullt të procesit zgjedhor. Ndër veprimet që ndëshkohen në këtë drejtim janë dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor<sup>55</sup> apo braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit<sup>56</sup>. Zbatimi i përgjegjësisë penale në rastet e braktisjes me dashje të detyrës i përgjigjet rrezikshmërisë së

"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>54</sup> Shiko Nenin 328/a të Kodit Penal.

<sup>55</sup> Në Nenin 326/a të Kodit Penal parashikohet se "dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasojë të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë gjer në shtatëqind mijë lekë."

<sup>56</sup> Shiko Nenin 330/a të Kodit Penal.

sjelljes së subjekteve në fjalë, duke pasur parasysh rolin e veçantë që ato kanë për të garantuar pasqyrimin e vullnetit të votuesve nëpërmjet numërimit të saktë të votave dhe hartimit të procesverbaleve të votimit dhe gjithë dokumentacionit përkatës zgjedhor, apo në rastin e vëzhguesve në monitorimin e respektimit të standardeve të zgjedhjeve të lira dhe demokratike gjatë procesit të votimit. Mospërbushja e detyrave nga ana e tyre në përputhje me ligjin mund të sjellë si pasojë pավlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve në zonën përkatëse zgjedhore.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu parregullsisve në lidhje me procesin e votimit. Në këtë kontekst sjelljet që dënohen janë ato që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet duke mos garantuar natyrën fshehtë të dhomës së votimit apo duke lejuar praninë në qendrat e votimit të personave të paautorizuar si dhe shkelje të kryera nga subjekte të përgjithshme që konsistojnë në votimin më shumë se një herë, votimin për persona të tjerë duke përdorur dokumente identifikimi të rreme ose që iu përkasin shtetasve të tjerë. Një parashikim i veçantë i referohet rastit kur të tilla veprime lejohen me dashje nga komisionerët zgjedhorë duke rritur edhe masën e dënimit maksimal që mund të aplikohet<sup>57</sup>.

#### 4. Vështrim krahasues i rendit juridiko-penal në fushën e zgjedhjeve.

Studimi krahasues ligjor është kurdoherë i dobishëm. Ky proces mundëson që ta vlerësojmë kuadrin normativ kombëtar nga një pikëpamje më e pasuruar në sajë të kontrasteve dhe informacionit të gjerë që ai siguron. Studimi krahasues ligjor është konsideruar më së miri si shpjegimi analitik dhe ndërmjetësues i formave të ndryshme të përvojës juridike brenda një gjuhe përshkruese dhe kritike me natyrë gjithëpërfshirëse<sup>58</sup>. Thuhet, se e drejta e krahasuar është në të njëjtën

<sup>57</sup> Shiko Nenin 327/a të Kodit Penal.

<sup>58</sup> Shiko: Legrand, P., "The Impossibility of 'Legal Transplants'", seksioni 10, 'Comparative Legal Studies Otherwise'. *Maastricht Journal of European and Comparative Law*, 1997, f.123.

kohë një mjet i vlerësimit të efektshmërisë të modeleve të ndryshme si dhe i njohjes së vazhdueshmërisë të traditave të caktuara kombëtare në "evoluimin" drejt dobishmërisë<sup>59</sup>. Hapësira në vazhdim e këtij punimi, i është kushtuar prezantimit të aspekteve krahasuese duke ballafaquar dispozitat përkatëse të Kodit tonë Penal me dispozitat respektive në legjislacionin francez dhe atë gjerman.

#### 4.1 Legjislacioni francez

Në legjislacionin francez veprat penale në fushën e zgjedhjeve nuk përfshihen në dispozitat e Kodit Penal, por janë të përfshira në një kre të veçantë të Kodit Zgjedhor. Konkretisht këto vepra parashikohen në Librin I, kreu VII të Kodit Zgjedhor, i emërtuar 'Dispozita penale'.

Në një panoramë të përgjithshme, ligji paraqitet mjaft i plotësuar, duke i kushtuar vëmendje ndëshkimit të çdo lloj sjelljeje apo praktike që cenon apo rrezikon të cenojë shprehjen e lirë të vullnetit të shtetasve nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës, mbarëvajtjen e rregullt të procesit zgjedhor, apo veprimeve mashtruese në lidhje me të dhënat që përmbahen në listat zgjedhore.

Për sa i përket shkeljeve në lidhje me vërtetësinë e të dhënave që pasqyrohen në listat e zgjedhësve ndër veprimet kryesore që dënohen janë:

- regjistrimi në listat zgjedhore me emër të rremë, ose paraqitja e rrethanave të tjera të rreme, si dhe regjistrimi me dashje në dy lista në kundërshtim me ndalimin ligjor në këtë drejtim.
- përpjekja për t'u regjistruar ose regjistrimi në listën e zgjedhësve, duke shtuar ose hequr në mënyrë të padrejtë emrin e një zgjedhësi nëpërmjet mashtrimit ose certifikatave të falsifikuara.
- mashtrimi në lëshimin apo hartimin e certifikatave të regjistrimit në listat zgjedhore ose në lidhje me çregjistrimin nga këto lista<sup>60</sup>.

<sup>59</sup> Shiko: Glenn, H.P. *Aims of Comparative Law*, në Smits, J.M. Elgar Encyclopedia of Comparative Law, Edward Elgar Publishing Ltd, 2008, f. 60-62.

<sup>60</sup> Këto shkelje parashikohen posaçërisht nga nenet 86, 87 dhe 88 të kreut VII, Libri

Dispozita të tjera parashikojnë në mënyrë të posaçme *shkeljet që mund të kryhen nga ana e punonjësve të administratës zgjedhore*. Kështu, çdo person i cili është i ngarkuar pranë një qendre votimi me detyrën për të mbledhur, llogaritur ose numëruar votat e qytetarëve, dënohet me burgim për pesë vjet, si dhe një gjobë prej 22.500 euro, nëse heq ose shton fletë votimi, ndryshon përmbajtjen e tyre, ose lexon një emër tjetër nga ai i shënuar. Gjithashtu dënohen edhe vepra të dhunshme të ndërmarrja nga anëtarët e kolegjit zgjedhor kundrejt anëtarëve të tjerë të kolegjit apo kërcënimet, të cilat kanë sjellë si pasojë mosfillimin ose vonesa në procesin e votimit<sup>61</sup>. Për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë që ka për përfundimin me sukses të procesit zgjedhor mbrojtja e integritetit të kutive të votimit, dënohen edhe veprimet e dëmtimit të tyre nga anëtarët e komisionit zgjedhor ose nga personat e ngarkuar me ruajtjen e tyre<sup>62</sup>.

*Veprime të dhunshme kundër veprimtarisë së punës së kolegjeve zgjedhore*. Në mënyrë që komisionet zgjedhore të ngritura pranë çdo qendre votimi të kryejnë rregullisht aktivitetin e tyre është e rëndësishme që të garantohet kjo veprimtari nga veprime të ndryshme të dhunshme apo me natyrë kërcënuese. Në këtë drejtim, dispozitat e Kodit Zgjedhor francez parashikojnë aplikimin e përgjegjësive penale për sjellje të tilla si: tubimet apo demonstratat kërcënuese që pengojnë punën e kolegjeve zgjedhore ose cenojnë të drejtën e votës së lirë, ndërmarrja e një sulmi të dhunshëm apo tentativa për të kryer një sulm të tillë në mjediset e punës të një kolegji zgjedhor për të ndikuar në vendimmarrjen e tij si dhe hyrja e dhunshme në këto mjedise.

*Pengimi i zgjedhësve dhe veprimtaritë korruptive elektorale*. Një kujdes i veçantë i është kushtuar ndëshkimit të atyre shkeljeve, të cilat nëpërmjet dhunës, kërcënimit apo praktikave të tjera korruptive synojnë të ndikojnë në mënyrë të pandershme mbi vullnetin e zgjedhësve për të bërë ose jo një zgjedhje të caktuar politike. Ndër veprat që dënohen janë:

I, të Kodit Zgjedhor Francez dhe sanksionet që zbatohen në të tilla raste janë dënimi me një vit burg dhe me gjobë prej 15 000 euro.

<sup>61</sup> Shiko Nenin 102 të Kodit Zgjedhor Francez.

<sup>62</sup> Për këtë shkelje aplikohet vetëm dënimi me burgim, i cili shkon deri në 10 vjet.

- *ushtrimi i dhunës* ose kërcënimet kundrejt një votuesi, duke e frikësuar për humbjen e vendit të punës, shkaktimin e një dëmi kundrejt tij apo familjes ose pasurisë së tij, me synimin për të penguar atë të votojë apo për të ndikuar në mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës.
- përhapja e lajmeve të rreme, informacioneve që dihet se janë të pavërteta ose përdorimi i manovrave të tjera mashtruese për të siguruar vota apo për të penguar një ose më shumë persona që të votojnë.
- ofrimi i shumave në të holla, i të mirave materiale, favoreve ose përfitimeve të tjera ndaj zgjedhësve<sup>63</sup>, për të ndikuar në mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e tyre<sup>64</sup>.

Praktikat korruptive nga ana e subjekteve zgjedhore të kryera në mënyrë direkte ose jo, dënohen edhe në rastin kur këto sjellje synojnë të ndikojnë në veprimtarinë e kolegjeve zgjedhore. Kushdo që, duke dashur të ndikojë në votën e një kolegji zgjedhor ose të një pjese të tij, bën donacione apo dhurata, premtime dhuratash ose favore administrative, qoftë në një komunë, qoftë në ndonjë komunitet të çfarëdoshëm qytetarësh, dënohet me dy vjet burg dhe me gjobë prej 15.000 euro.

Rëndësi të veçantë në kodin zgjedhor francez paraqesin edhe sanksionet penale në lidhje shkeljen e dispozitave për transparencën e burimeve financiare të përdorura nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës elektorale.<sup>65</sup>

<sup>63</sup> Cilido që, me donacione ose dhurata në para apo në natyrë, me premtime dhuratash, favoresh, punësimesh private ose publike ose të tjera përfitime të veçanta, synon të ndikojë në votën e një ose më shumë zgjedhësve, ka marrë ose ka tentuar të marrë votat e tyre, qoftë drejtpërdrejt qoftë nëpërmjet një pale të tretë, kushdo qoftë, që me të njëjtat mënyra, ka vendosur ose ka tentuar të vendosë që një ose më shumë prej tyre të abstenojnë, dënohet me dy vjet burgim dhe një gjobë prej 15.000 euro (neni 106, kap.7, Libri 1, i kodit zgjedhor francez)

<sup>64</sup> Këto figura veprash penale parashikohen në nenet 97, 106 dhe 107 të Kodit Zgjedhor francez.

<sup>65</sup> Në Nenin 113-1, të kreut VII, Libri I, thuhet se "Shkelja e dispozitave që lidhen me transparencën e burimeve financiare të përdorura nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës elektorale dënohet me një gjobë prej 3750 euro dhe me një vit burgim ose

#### 4.2 Legjislacioni gjerman

Në Kodin Penal të Republikës Federale Gjermane, në Kapitullin IV të tij janë parashikuar “*Veprat penale kundër organeve kushtetuese dhe në kontekstin e zgjedhjeve dhe fletëve të votimit*”.

Edhe në legjislacionin gjerman, ashtu sikurse në legjislacionin francez përmbahen parashikime të veçanta për ndëshkimin e formave të paligjshme të ndikimit në vullnetin e lirë të zgjedhësve. Format që dënohen në këtë drejtim janë:

- shtrëngimi i votuesit nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit, abuzimit me detyrën ose varësinë financiare apo forma të tjera të presionit financiar për ta detyruar ose penguar të votojë apo të votojë në një mënyrë të caktuar.
- përdorimi i manovrave mashtruese ndaj votuesit për të ndikuar në një mënyrë votimi të ndryshme nga ajo që dëshiron apo për të shkaktuar pavlefshmërinë e votës së tij.
- korruptimi i votuesve nëpërmjet ofertave, dhuratave apo favoreve të tjera për të mos votuar ose për të votuar në një mënyrë të caktuar.

Dispozitat të tjera i referohen garantimit të realizimit të rregullt të procesit zgjedhor dhe të përfundimit të rezultateve të këtij procesi. Në Nenin 107, të emërtuar ‘*pengimi i procesit zgjedhor*’ sanksionohet se ‘*kushdo që me dhunë apo kërcënim ndalon ose pengon zhvillimin e procesit zgjedhor apo përcaktimin e rezultatit zgjedhor, do të dënohet me burgim jo më shumë se pesë vjet ose gjobë, dhe në raste veçanërisht të rënda me burgim jo më pak se një vit.*’ Veprime të tilla do të jenë të dënueshme edhe nëse mbeten në tentativë.

Falsifikimi i rezultateve të zgjedhjeve është një tjetër veprim që përbën vepër penale sipas Kodit Penal Gjerman. Konsumimi i kësaj vepre penale konsiston në kryerjen e veprimeve të paligjshme që lidhen me përpunimin e një rezultati të pasaktë zgjedhor, falsifikimin e rezultatit, apo shpalljen ose njoftimin me vetëdije të një rezultati të

me njërin prej këtyre dënimeve”.

gabuar zgjedhor. Veprime të tjera të dënueshme janë ato që lidhen me falsifikimin e të dhënave të listave zgjedhore si dhe shkelja e rregullave të vendosura për të siguruar fshehtësinë e votimit<sup>66</sup>.

Në lidhje me infrastrukturën e ngritur për hetimin e shkeljeve të dispozitave penale në fushën e zgjedhjeve vlen të përmendet fakti se në strukturën e Prokurorisë Federale Gjermane është krijuar një seksion i veçantë për hetimin e krimeve elektorale. Ky seksion gjithnjë e më shumë ka konsoliduar rolin e tij në luftën ndaj krimeve elektorale të tilla si: financimi jo i ligjshëm i partive politike; pastrimi i parave nëpërmjet fushatave elektorale; korrupsioni, mashtrimi elektoral etj. Ngritja dhe funksionimi brenda organit të prokurorisë i një strukture të veçantë dhe të specializuar për hetimin e krimeve elektorale, i shërben më së miri funksionit praktik të hetimit më me efektivitet të shkeljeve të dispozitave penale në fushën e zgjedhjeve.

#### Konkluzione

Në përfundim të kësaj trajtесе teorike vlen të ndalemi në disa momente kryesore që shoqërojnë zbatimin e ligjit penal për vepra që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Ndryshimet më të fundit që ka pësuar Kodi ynë Penal në këtë drejtim, përcaktojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë nëpërmjet parashikimit të formave të reja të konsumimit të veprave penale në fushën e zgjedhjeve si dhe plotësimin të mëtejshëm të formave të shprehura në dispozitat ekzistuese. Në këto kushte, legjislacioni penal siguron mekanizmat e nevojshëm për një mbrojtje sa më efektive nga veprime të paligjshme që cenojnë apo tentojnë të cenojnë lirinë e vullnetit të zgjedhësve, pengojnë aktivitetin e subjekteve zgjedhore dhe të pjesëmarrësve në zgjedhje, të prekin vërtetësinë e dokumenteve zgjedhore ose rezultatit zgjedhor apo cenojnë administrimin e rregullt të procesit zgjedhor.

Megjithatë, në ballafaqimin e këtyre parashikimeve me rregullimet përkatëse në legjislacionet e vendeve të marra në krahasim

<sup>66</sup> Parashikohen si shkelje në Nenin 107/b dhe 107/c të Kodit Penal të Republikës Federale Gjermane.

vëmë re se veprime të caktuara të paligjshme që lidhen me ndikimin në vullnetin e zgjedhësve apo financimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore nuk përfshihen në përmbajtje të dispozitave aktuale të Kodit tonë Penal.

Në kushtet aktuale nuk dënohet përdorimi i manovrave mashtruese për të siguruar vota apo për të penguar një ose më shumë persona që të votojnë ose për të shkaktuar pavlefshmërinë e votës së tij, ndërkohë që rezultati që sjellin këto veprime mund të jetë i njëjtë me rastin kur një person pengohet për të votuar ose kanoset për të votuar në një mënyrë të caktuar ose për të marrë pjesë në votime ose jo. Mashtrimi i votuesve nëpërmjet paraqitjes së informacioneve apo rrethanave të rreme në lidhje me situatën në të cilën ata po veprojnë mund të cenojë totalisht shprehjen e vullnetit të lirë të zgjedhësve në të njëjtën mënyrë që mund të rezultonte edhe nga veprimet e tjera të dënueshme siç janë pengimi apo kanosja e votuesve.

Një rast tjetër që vlen të merret në shqyrtim lidhet me sjelljet e dënueshme sipas nenit 329 të kodit penal. Dispozita në fjalë, *dënon veprën penale të kanosjes së kryer ndaj zgjedhësve por nuk përmban parashikime në lidhje me forma të tjera të shtrëngimit të kryera për të njëjtin qëllim*. Nëse i referohemi shpjegimit tradicional që doktrina e të drejtës penale i bën veprës penale të kanosjes, vëmë re se në këtë koncept përfshihen veprime të kërcënimit serioz për jetën ose dëmtimin e rëndë të shëndetit. Megjithatë, në terma praktikë vullneti i zgjedhësve mund të ndikohet dhe të shtrembërohet edhe nëpërmjet formave të tjera të shtrëngimit, të cilat nuk drejtohen ndaj kërcënimeve për cenim të rëndë të shëndetit apo jetës së personit. Ndër këto forma përmendim: dhunime që cenojnë integritetin fizik të personit por që nuk rezultojnë në dëmtim të rëndë të shëndetit, kërcënimet për shkatërrim ose dëmtim të pronës, për dëmtim të interesave financiare, presionet për humbjen e vendit të punës etj. Në mënyrë që dispozita t'i përgjigjet sa më mirë qëllimit për të cilin është vendosur, do të ishte mirë që në përmbajtje të saj të gjenin parashikim të posaçëm edhe forma të tjera të shtrëngimit që kanë për synim të ndikojnë në vullnetin e lirë të zgjedhësve. Në legjislacionin francez këto veprime janë parashikuar shprehimisht si forma të konsumimit

të veprës penale<sup>67</sup>.

Një aspekt tjetër që vlerësojmë se duhet të ishte objekt i rregullimit juridiko-penal është ai që lidhet me shkeljet e dispozitave mbi transparencën e burimeve financiare të përdorura nga subjektet zgjedhore për realizimin e veprimtarisë së tyre elektorale. Është e kuptueshme se për të funksionuar në mënyrën e duhur, partitë politike duhet të ruajnë organizimin e tyre, të punësojnë staf për të punuar në strukturat e partisë, të drejtojnë fushata zgjedhore dhe të komunikojnë me elektoratin e gjerë. Për të përmbushur këto funksione partitë politike duhet të disponojnë burime financiare. Veprimtaria e partive politike konsiderohet se përfaqëson shpenzime që duhet të shihen si kosto të nevojshme dhe të pashmangshme të demokracisë<sup>68</sup>. Nga ana tjetër mbi partitë politike rëndon detyrimi që për mbështetjen e veprimtarisë së tyre të përdorin vetëm të ardhura që rrjedhin nga burime të ligjshme dhe për të qenë transparentë në paraqitjen e këtyre burimeve ndaj autoriteteve përkatëse të kontrollit. Shkelja e këtyre detyrimeve, sipas legjislacionit tonë mund të sjellë lindjen e përgjegjësive administrative. Kështu sipas Nenit 173 të Kodit Zgjedhor, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga ana e përgjegjësit të financës të partisë politike, mosbashkëpunimi me auditin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana e subjektit zgjedhor, apo refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të fushatës, apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e auditit. Duke pasur parasysh që shkelja e dispozitave mbi transparencën e burimeve financiare të përdorura gjatë fushatave elektorale mund të shërbejë si mjet për pastrimin e produkteve të ardhura nga veprimtaria kriminale, do të ishte mirë që në funksion të një parandalimi sa më efektiv të kësaj praktike të paligjshme, të tilla shkelje të sillnin edhe lindjen e përgjegjësive penale.

<sup>67</sup> Sipas Nenit 107 të Kodit Zgjedhor Francez dënohen kërcënimet e bëra kundrejt një votuesi, duke e frikësuar për humbjen e vendit të punës, shkaktimin e një dëmi kundrejt tij apo familjes ose pasurisë së tij, me synimin për të penguar atë të votojë apo për të ndikuar në mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës.

<sup>68</sup> Ingrid van Biezen. Udhëzues-Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore, Botim i Këshillit të Europës, Strasburg, 2003, f. 12.



**Bibliografia:**

1. Collier, P, dhe Vicente. P. C. (2010). *Violence, Bribery, and Fraud: The Political Economy of Elections in Sub-Saharan Africa*.
2. Davalos, H., dhe Dong, N. H. “*Fraud and Fraud Prevention*”, punim i prezantuar në Konferencën VIII Evropiane mbi Organet Administruese të Procesit Zgjedhor, Komisioni European për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), maj, 2011.
3. Elezi, I., E Drejta Penale (Pjesa e Posaçme). Botimet ERIK, Tiranë, 2007.
4. Glenn, H.P. *Aims of Comparative Law*, në Smits, J.M. Elgar Encyclopedia of Comparative Law, Edward Elgar Publishing Ltd, 2008.
5. Ingrid van Biezen. *Udhëzues-Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore*. Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg 2003.
6. Legrand, P., ‘*The Impossibility of “Legal Transplants”*’, seksioni 10, ‘Comparative Legal Studies Otherwise’. *Maastricht Journal of European and Comparative Law*, 1997.
7. Rajasingham, S. K. *Essentials of Free and Fair Elections*, punim i prezantuar ne Konferencën Rajonale mbi Zgjedhjet e Lira, të Ndershme dhe të Besueshme, Islamabad, Pakistan, qershor, 2005.
8. Vickery. C., dhe Shein. E. *Assessing Electoral Fraud in New Democracies: Refining the Vocabulary*. IFES White Paper Series, 2012.
9. Akte ndërkombëtare dhe legjislacion
10. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948.
11. Protokollin e parë shtesë i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të
12. Lirive Themelore, 20 mars 1952.
13. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.
14. Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
15. Ligji nr. 23/2012 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
16. Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
17. Kodi Penal Gjerman, i disponueshëm në: [www.iuscomp.org](http://www.iuscomp.org).
18. Kodi Zgjedhor Francez, i disponueshëm në: [www.legifrance.gouv.fr](http://www.legifrance.gouv.fr).

## ROLI I GJYQTARIT DHE I LIGJVËNËSIT

MA. Laura VORPSI

### Hyrje

1. Në kuadër të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, roli i gjyqtarit në Shqipëri, po bëhet një element kyç i shtetit të së drejtës. Gjyqtari i sotëm, po bëhet gjithnjë e më shumë aktiv në funksionet e tij gjyqësore. Pikërisht ky punim, konsiston në analizimin e faktit, nëse gjyqtari është një deklaruues “mekanik” i ligjit apo edhe krijues i tij, për të konkluduar më tej në dallimin e rolit të gjyqtarit dhe ligjvënësit.

Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve ende e kuptojmë si një postulat, nga i cili duhet të rrjedhë domosdoshmërisht fakti se: funksioni normativ, interpretues dhe ai zbatues janë të ndara dhe për këtë shkak ato u besohen degëve të ndryshme të qeverisjes. Kështu, funksioni normativ i njihet kryesisht Kuvendit, ai zbatues – pushtetit ekzekutiv dhe funksioni interpretues – gjykatës<sup>69</sup>. Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara<sup>70</sup>

<sup>69</sup> Kristaq Traja, Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Koha e precedentëve, revista “Jeta Juridike”, Bot.Shkolla e Magjistraturës, nr.1, shtator 2005, f.5.

<sup>70</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.05.2004.

Pavarësia e gjyqësorit nuk mund të kuptohet pa pavarësinë e gjyqtarit brenda vetë strukturës së gjyqësorit, nëpërmjet të cilës sigurohet që asnjë gjyqtar të mos mund të ndërhyjë në veprimtarinë dhe bindjen e një gjyqtari tjetër”. Në Nenin 145 të Kushtetutës sanksionohet, se “gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.

Interpretimi është një nga funksionet më kryesore të gjykatave si institucion dhe gjyqtarit si person i drejtpërdrejt që realizon dhënien e drejtësisë. Konstitucionalisti francez Moris Duverger përcaktonte funksionin e trefishtë të gjykatave si më poshtë:

1. Respektimi i hierarkisë së normave; 2. Interpretimi i së drejtës;

3. Zbatimi i së drejtës. Në këtë veprimtari, interpretimi i normës juridike, ka kufij të gjerë përzgjedhjeje, pasi jo gjithmonë përmbajtja e normës është e njëkuptimshme. Shpeshherë, mund të lindin kundërshti gjatë interpretimit të saj. Prandaj, është e nevojshme që shteti të zotërojë instrumentet e tij për të siguruar vullnetin normativ të vlefshëm për çdo rast konkret, gjë që lidhet sidomos me ekzistencën e gjyqësorit<sup>71</sup>. Nga kjo pikëpamje, roli i gjykatave kombëtare për interpretimin e legjislationit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, është i padiskutueshëm. Jeremy Bentham në përshkrimin e common law ka përdorur termin “ligj gjyqësor” për të theksuar pikëpamjen se gjyqtari, megjithëse, sikurse thuhet, normalisht nuk bën gjë tjetër veçse deklaron ligjin ekzistues, në të vërtetë mund të thuhet se e krijon atë. Kjo deklaratë presupozon se nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm ndërmjet interpretimit dhe bërjes së ligjeve<sup>72</sup>. E përgjithshmja dhe abstraktja (ligji) në nivel konkret (vendimi gjyqësor) nuk mund të zbresin vetiu, pa gjyqtarin që i interpreton dhe i zbaton. Ligji në gjykatë është një normë lartësisht e personalizuar në formën e rregullës konkrete që formulon gjyqtari<sup>73</sup>.

<sup>71</sup> Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Aurela Methasani, Shtet i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Adelprint, 2011.

<sup>72</sup> Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Xomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Botimet Shkolla e Magjistraturës, 2006.

<sup>73</sup> Kristaq Traja, Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Koha e precedentëve, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, shtator 2005, f. 6.

Funksionin e tij si “*krijues të ligjit*” e gjejmë në këto aspekte:

## 1. Roli i gjyqtarit të gjykatave të zakonshme, në bazë të Nenit 145 të Kushtetutës

**1.1** Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i njeh të drejtën gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

**1.2** Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, gjykata apo gjyqtari është i kushtëzuar në dërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese nga kriteri procedural “lidhje e drejtpërdrejtë”, përcaktuar nga Neni 68 i Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.<sup>74</sup> *Gjykata Kushtetuese është shprehur, gjatë jurisprudencës së saj, se gjykata ose gjyqtari duhet të sqarojë me kujdes lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.*

- Nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. *Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor*<sup>75</sup>. Ai duhet të jetë njohës i mirë i parimeve të përgjithshme të së drejtës që e udhëheqin kur ka konflikt ligjesh, paqartësi apo ometim ligjor.
- Kështu, mund të përmendim edhe rastin kur, ligji është në kundërshtim me Nenin 17 të Kushtetutës. *Sipas Nenit 17, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë është i justifikuar, nëse ai vendoset me ligj, për një interes publik, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka*

<sup>74</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 04.05.2009.

<sup>75</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 03.02.2010.

*diktuar atë dhe në asnjë rast nuk duhet të prekë thelbin e lirive dhe të të drejtave apo të tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNj.*<sup>76</sup>

Në këtë rast gjyqtari kur pezullon çështjen dhe e dërgon në gjykatën kushtetuese, ai duhet të argumentojë që kufizimi mund të ketë cenuar thelbin e të drejtës. Për të përcaktuar thelbin e të drejtës nuk është e thjeshtë, sepse ky term në vetvete mund të shkaktojë debate rast pas rasti, duke pasur parasysh që as jurisprudenca e gjykatës europiane nuk ka vënë kufij të qartë për “*garancinë e thelbit*”. Në raste të tjera, ai mund të argumentojë që ligji ka privuar të drejta në mënyrë jo proporcionale. Pra, duhet të argumentojë pse është shkelur parimi i proporcionalitetit midis ndërhyrjes dhe nevojës që ka diktuar atë.

## 2. Funksionet që i ka dhënë gjyqtarit ligji procedural civil

**2.1** Neni 1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se “*Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë*”. Gjyqtari në bazë të bindjes së tij të brendshme dhe parimeve të përgjithshme do të duhet t’u japë përgjigje kërkesave të palëve edhe pse ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë”.

**2.2** Në një vendim Gjykata Kushtetuese shprehet se... “*gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjykata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese*”<sup>77</sup>. Pra, në këtë vendim Gjykata Kushtetuese, ka evidentuar

<sup>76</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 06.03.2009.

<sup>77</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 16.12.2008.

punën krijuese të gjykatave të zakonshme. Ometimi legjislativ është një dukuri e shpeshtë në të drejtën tonë. *Ometimi legjislativ mund të eliminohet jo vetëm nga institucionet ligjberëse dhe Gjykata Kushtetuese, por edhe nga gjykatat e zakonshme, nëpërmjet interpretimit të ligjeve, zbatimit të ligjit me analogji, respektimit të parimeve të përgjithshme etj. Plotësimi i ometimit legjislativ nga gjykatat e zakonshme është i kufizuar vetëm për marrëdhënien juridike konkrete, të lidhur me çështjen që shqyrtohet prej saj*<sup>78</sup>.

### 3. Vendimet unifikuese dhe funksioni i gjyqtarit si krijues

**3.1** Kushtetuta jonë, në Nenin 141/2, njih shprehimisht të drejtën e Gjykatës së Lartë për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, pra, njih vendimet me karakter rregullues, të cilat merren në kuadrin e shqyrtimit të çështjeve të veçanta. Vendimet unifikuese bëjnë rregullim vetëm brenda çështjes konkrete dhe metoda e përdorur është tipike gjyqësore. Këto vendime unifikuese, në thelb, nuk janë gjë tjetër, veçse një precedent i i sistemeve ligjore common law. *Thelbi i precedentit qëndron në imponimin e rregullës së të drejtës, të nxjerrë nëpërmjet interpretimit të ligjit në një çështje konkrete, mbi zgjidhjen e një çështje të ngjashme. Gjithë loja e gjykatave më të ulëta zhvillohet në terrenin e fakteve, të cilat duhet të krahasohen me modelin faktik të çështjes precedent, për të zbuluar analogjinë dhe që këtej kalohet në zbatimin e atij kuptimi të ligjit që është përcaktuar ose saktësuar në precedentin përkatës*<sup>79</sup>.

**3.2** Vendimet Unifikuese Civile kanë sjellë debate rreth rolit të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin dhe ligjberjen.

- a.** Vendimi Unifikues nr.1, datë 06.01.2009 në lidhje me Nenin 83 të Kodit Civil solli shumë debate lidhur me faktin nëse

<sup>78</sup> Sokol Sadushi, Ometimi legjislativ, si xështje specifike për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, mars 2010, f.46.

<sup>79</sup> Kristaq Traja, Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Koha e precedentëve, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, shtator 2005, f.5.

Gjykata e Lartë e tejkaloi kompetencën e saj që lidhet me unifikimin e praktikës gjyqësore apo krijoi ligj. Kolegjet e Bashkuara, nuk janë mbështetur vetëm në interpretimin literal të Nenit 83, por kanë bërë interpretimin sistematik dhe logjik të të gjitha dispozitave të Kodit Civil e të ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

- b.** Të njëjtat argumente ka përdorur Gjykata e Lartë edhe në Vendimin Unifikues nr.5, datë 31.05.2011 në lidhje me parashkrimin e padisë së rivendikimit. Qëndrimi jo konsekuent i jurisprudencës në lidhje me parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit janë rrjedhojë e mungesës së një dispozite konkrete në legjislacionin tonë, e cila në mënyrë të shprehur të përcaktonte karakterin e paparashkrueshëm të padisë së kthimit të sendit. Pra, Gjykata e Lartë pretendon se në këto vendime ajo ka mbetur në kufijtë e interpretimit të Kodit Civil dhe nuk ka krijuar ligj në kuptimin formal. *Precedenti nuk lejon luhajtje të papranueshme të praktikës gjyqësore, vendime kontradiktore për çështje analoge dhe pabarazi në zgjidhjet juridike. Pra, është një rregullator dhe nuk lejon që gjykatat e zakonshme në emër të parimit të lirisë interpretuese të cenojnë parimin e sigurisë juridike. Precedenti është ligj i çështjes dhe, prandaj shmangia prej tij është një përgjegjësi e njëjtë me atë që gjyqtarët duhet të mbajnë kur shkelin ligjin. Kështu bie mbështetja në teorinë e turbullt të bindjes së brendshme të pakontrolluar*<sup>80</sup>.

Në momentin që gjyqtari bën interpretim gjyqësor ai është “krijues”. Është tashmë e ditur ndryshimi i dukshëm midis interpretimit gjyqësor dhe ligjberjes gjyqësore. Gjyqtari duhet të jetë i kujdesshëm në momentin e “krijimit të ligjit”, sepse hapësira e tij diskrecionale, nuk duhet të kalojë limitet që vendos “pranueshmëria e ligjberjes nga gjykata”. *Çdo sistem ligjor i civilizuar është përpjekur realisht të përcaktojë dhe të zbatojë disa kufizime të lirisë gjyqësore, procedurale dhe materiale*<sup>81</sup>.

<sup>80</sup> Kristaq Traja, Drejtësia Kushtetuese, Luarasi, 2000.

<sup>81</sup> Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Xomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Botimet Shkolla e Magjistraturës, 2006.

#### 4. Në lidhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese

Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. *Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë*<sup>82</sup>.

4.2 Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, si autoritet që kryen “interpretimin përfundimtar të kushtetutës”<sup>83</sup> dhe ushtron “kontrollin kushtetues të normës juridike”<sup>84</sup>, nuk mund të ndalohet të bëjë interpretimin e ligjeve. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që gjen një normë juridike në kundërshtim me Kushtetutën shkakton mosfillimin e pasojave të caktuara juridike dhe nga kjo pikëpamje, veprimtaria e institucioneve të Kontrollit Kushtetues përshkruhet si “legjislator negativ”. Krahas shfuqizimit të normave antikushtetuese nga sistemi juridik, Gjykata Kushtetuese interpreton Kushtetutën pa qenë nevoja për një shfuqizimi të normës juridike. *Në këto raste, Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet metodave të interpretimit, zbulon përmbajtjen e rregullimeve kushtetuese dhe në mënyrë të tërthortë duket se krijon një rregullim të ri, që nuk e dallon shumë nga funksioni i ligjvënësit pozitiv*<sup>85</sup>. Me këtë qëndrim, Gjykata Kushtetuese thuhet se orienton gjykatat e sistemit të zakonshëm qoftë kjo në formën e një ligjbërje pozitive apo negative.

<sup>82</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 03.06.2009.

<sup>83</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 30.01.2004, shfuqizon një normë juridike të Kodit Zgjedhor.

<sup>84</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 11.02.2004 përcakton kuptimin e termit “torturë”.

<sup>85</sup> Sokol Sadushi, Ometimi legjislativ, si xështje specifike për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese”, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, mars 2010, f.46.

#### 5. Dilema e gjyqtarit midis vendimeve unifikuese dhe të gjykatës kushtetuese

5.1 Mund të ndodhë që gjyqtari i zakonshëm të gjendet përballë një Vendimi Unifikues që është në kundërshtim me një Vendim të Gjykatës Kushtetuese apo me vetë Kushtetutën. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Në ligjin për organizimin gjyqësor është parashikuar se përbën shkelje disiplinore nëse gjyqtarët nuk zbatojnë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë<sup>86</sup>. Pavarësisht kësaj, gjyqtari duhet që të luajë një rol aktiv kur gjendet përballë dilemave të tilla duke interpretuar dhe zbatuar kushtetutën dhe ligjin. Kushtetuta në Nenin 116 të saj ka parashikuar hierarkinë e akteve normative dhe nga interpretimi që duhet t’i bëjë gjyqtari këtij neni ai duhet t’i japë përparësi Vendimit të Gjykatës Kushtetuese çdo herë që ndodhet përpara kësaj zgjedhje, duke argumentuar edhe faktin e moszbatimit të Vendimit Unifikues.

#### 6. Konkluzion dhe Rekomandim

Gjyqtari në evoluim, duhet të jetë një aktor “sa më shumë aktiv” i të drejtës, brenda limiteve që ofron Kushtetuta dhe ligji, duke vepruar në mënyrë të ekuilibruar. *Gjyqtarët detyrohen të interpretojnë, d.m.th. të integrojnë, të qartësojnë, të modelojnë dhe jo rrallë, të krijojnë ligjin e novo. Megjithatë, ky fakt nuk i bën ata ligjbërës, sepse vazhdon të mbetet një ndryshim thelbësor mes proceseve legjislative dhe gjyqësore*<sup>87</sup>. Gjyqtari - “krijues i ligjit”, nuk do të thotë se është ligjvënës në kuptimin e organit që nxjerr ligje formale, sepse një gjë të tillë nuk e lejon një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës “parimi i ndarjes së pushteteve”.

<sup>86</sup> Neni 32 i Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>87</sup> Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Xomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Botimet Shkolla e Magjistraturës, 2006.

## Bibliografia

### A. Doktrinee

1. Simoni, Alessandro., Sadushi,Sokol., Çomo, Sokol., *Vështrim krahasues mbi procedurën civile*, Botimet Shkolla e Magjistraturës, 2006.
2. Traja, Kristaq., *Drejtësia Kushtetuese*, Luarasi, 2000.
3. Traja, Kristaq., *Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Koha e precedentëve*, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, shtator 2005.
4. Sadushi, Sokol., *Ometimi legjislativ, si çështje specifike për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*, revista “Jeta Juridike”, Botimet Shkolla e Magjistraturës, nr.1, mars 2010.
5. Berberi,Sokol., *Arsyetim dhe shkrim ligjor*, Botimet Shkolla e Magjistraturës, 2011.
6. Zaganjori, Çhezair., Anastasi, Aurela., Methasani,Aurela., *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, Adelprint, 2011.

### B. Legjislacioni

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”.
2. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”.
3. Ligji nr. 151 datë 30.05.2013 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë*”.
4. Ligji nr.9877, datë 18.02.2008, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”.
5. Ligji nr.8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile”.

### C. Jurisprudenca

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 03.02.2010.
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 06.03.2009.
3. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 04.05.2009.
4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 03.06.2009.
5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 16.12.2008.
6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.05.2004.
7. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 30.01.2004.
8. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 11.02.2004.
9. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 07.02.2001.
10. Vendim Unifikues Civil nr.1, datë 06.01.2009.
11. Vendim Unifikues Civil nr.5, datë 31.05.2011.

për decentralizimin, i cili miratoi “Strategjinë kombëtare për decentralizim dhe autonomi vendore”. Kjo u pasua nga zhvillimi i një pakete ligjesh për të orientuar administrimin e vetëqeverisjes, si Ligji nr.8652/00 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverive vendore” dhe Ligji nr. 8653/00 “Për ndarjen administrative-territoriale”.

Pra, parimi i decentralizimit është parimi thelbësor mbi të cilin funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes.

Decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit “ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve.”.

Decentralizimi është një mënyrë për të promovuar një shoqëri demokratike dhe pjesëmarrëse. Në të njëjtën kohë një shoqëri e tillë është një kusht i rëndësishëm dhe favorizues për një decentralizim demokratik.

Pjesa më e madhe e diskutimeve rreth decentralizimit fokusohen në aspektin e decentralizimit vertikal i njohur si transferimi i fuqive, përgjegjësive dhe burimeve nga niveli qendror në atë vendor. Por, një pjesë e rëndësishme e këtij koncepti, si pjesë e qeverisjes së mirë, është nocioni i promovimit të një shoqërie demokratike, ku vendimmarrja bëhet më pjesëmarrëse dhe e ndjeshme nga personat që preken nga këto vendime.

Nëse fokusohemi te kriteri gjinor, decentralizimi nënkupton pjesëmarrje të barabartë të të dyja gjinive në të gjitha institucionet dhe proceset qeverisëse, hapësirë të barabartë të tyre në shprehjen e ideve dhe përcaktimin e problematikave shqetësuese, transparencë dhe barazi në shpërndarjen e burimeve për të dyja gjinitë, hartimi i një legjislacioni eficient për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave si dhe krijimi i mekanizmave të posaçëm për vënien në zbatim të këtij legjislacioni. duke i hapur rrugë integritit sistematik të

## DECENTRALIZIMI DHE BARAZIA GJINORE

Nadia RUSI<sup>88</sup> (Doktorante)

Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë Departamenti i të Drejtës Publike

E-mail: nrusi@hotmail.com

### 1. Kuptimi i decentralizimit në Shqipëri

Decentralizimi si proces, ka filluar të jetë pjesë e politikave shtetërore që në vitin 1992, me miratimin e “Aktit të Qeverisë vendore”, duke synuar gjithmonë e më shumë forcimin e pushtetit vendor nëpërmjet transferimit të pushtetit, përgjegjësive dhe burimeve nga nivelet më të larta të qeverisjes qendrore drejt autoriteteve në nivel vendor. Nëpërmjet tij synohet të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve në nivel vendor dhe njëkohësisht të rritet pjesëmarrja vendore në proceset vendimmarrëse.

Decentralizimi luan një rol të rëndësishëm në arritjen e një qeverisjeje sa më afër qytetarëve, referuar kjo edhe parimit kryesor që e udhëheq atë si proces, ai i subsidiaritetit. Edhe pse përmendëm, aktin e parë në vitin 1992, funksionimi me efikasitet i këtij procesi, filloi vetëm në vitin 1998, kur Shqipëria iu bashkëngjiti “Kartës së vetëqeverisjes vendore” të Këshillit të Evropës dhe përfshiu parimet e vetëqeverisjes në Kushtetutë. Kushtetuta përcakton se qeveria vendore ngrihet në bazë të “parimin e decentralizimit” dhe ushtrohet sipas “parimit të autonomisë vendore”<sup>89</sup>. Për funksionimin sa më të mirë të tij, në vitin 1999 qeveria krijoi Komitetin kombëtar ndërministror

<sup>88</sup> As Pedagog “Të drejtat e Njeriut”, në proces doktorature.

<sup>89</sup> Shih Nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

grave në qeverisjen vendore. Në këtë drejtim, i gjithë boshti që ka në qendër qeverisja vendore duhet të përqëndrohet te nevojat e veçanta të burrave dhe grave dhe të ndërtohet mbi eksperiencat e secilës prej gjinive, përmes një përfaqësimi të barabartë në të gjitha nivelet dhe fushat e vendimmarrjes.

## 2. Rregullimi juridik i barazisë gjinore në nivel ndërkombëtar e rajonal

Trajtimi i barabartë gjinor ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes së ligjvënësit shqiptar. Bazat e këtij trajtimi i gjejmë në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në të cilën përcaktohet barazia e të gjithëve përpara ligjit<sup>90</sup> si dhe mosdiskriminimi padrejtësisht për shkak të gjinisë në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, sociale, kulturore<sup>91</sup>. Ky parim kushtetues plotësohet edhe me akte të tjera ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale, pjesë e legjislacionit shqiptar. Vlen të përmendim në këtë pjesë, nënshkrimin nga vendi ynë, në vitin 1993, të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila ka si qëllim si arritjen e barazisë së plotë në ligj dhe në administratën publike të të dyja gjinive, si edhe përmirësimin de facto të gjendjes së grave.

### 2.1 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Konventa i kushton një vëmendje të veçantë afirmimit të gruas në nivel të përgjithshëm si dhe eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit ndaj saj. CEDAW është konventa e parë e të drejtave të njeriut, e cila i detyron Shtetet Palë të modifikojnë dhe heqin dorë prej qëndrimeve sociale, modeleve dhe praktikave kulturore, të cilat mbështeten në idenë e inferioritetit apo superioritetit të secilit seks<sup>92,93</sup>.

<sup>90</sup> Shih Nenin 18 / 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

<sup>91</sup> Shih Nenin 18 / 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

<sup>92</sup> Aurela Anastasi, Aurela Bozo, Arta, Mandro, Ermira Shkurti, "Barazia Gjinore dhe Mosdiskriminimi", Tiranë, 2012, f. 52.

<sup>93</sup> Për më tepër shih Nenin 5 të CEDAW-ut.

Shqetësimi i shteteve për faktin se në situata varfërie, gratë përfitojnë të drejtë minimale të ushqimit, të shërbimeve mjekësore, të arsimit, të përgatitjes profesionale, dhe të rasteve për punë dhe për nevoja të tjera si dhe bindja e tyre se zhvillimi i plotë dhe i gjithanshëm i një vendi, mirëqenia e botës dhe çështja e paqes kërkojnë pjesëmarrjen maksimale të grave, në të njëjtat kushte me burrat ndikoi në krijimin e një terreni të përbashkët e bashkëpunues midis shteteve palë për të përcaktuar elementët më të rëndësishëm në eliminimin e barrierave ndaj grave<sup>94</sup>.

Në plotësim të detyrimeve të parashikuara në këtë konventë, Shqipëria, ka marrë një sërë masash të veçanta për të minimizuar diskriminimin ndaj grave në sferën ekonomike, në proceset vendimmarrëse e politike, në fushën e arsimit, politikave të punësimit, brenda kuadrit të jetës private e shoqërore. Është e rëndësishme të theksohet se Konventa i kushton vëmendje sidomos arritjes së rezultateve të barabarta nëpërmjet krijimit të instrumenteve të përshtatshme të vlerësuar nga vetë shtetet.

### 2.2 Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Në nivel rajonal dokumenti më i rëndësishëm i nënshkruar dhe ratifikuar është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e vitit 1996, e cila reformoi dhe përqasi gjithë legjislacionin shqiptar me standardet dhe praktikën ligjore të vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Parimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimi gjendet i sanksionuar në Nenin 14 të kësaj Konvente, në të cilin parashikohet se gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë konventë do të sigurohet pa diskriminim për çdo lloj arsyeje, përfshirë këtu edhe seksin, për të cilin po flasim në të gjithë punimin. Plotësimi i Konventës me Protokollin Nr 12 ishte një hap para në sanksionimin e ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj. Në këtë kontekst e drejta e grave për të marrë pjesë në jetën politike në nivel vendor, e drejta për të qenë pjesë e

<sup>94</sup> Për më tepër shih pjesën hyrëse të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, OKB, më 18 Dhjetor 1979.



procese vendimmarrëse, e drejta për arsim, e drejta për punësim brenda juridiksionit vendor apo e drejta për të përfituar të mira dhe shërbime publike është e mbrojtur edhe në nivel Europian. Në çdo rast cenimi i këtyre të drejtave për shkaqe diskriminuese gjinore, do të hapte rrugën për t'iu drejtuar Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si mekanizmi institucional më efikas në mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, pas ezaurimit të të gjitha instancave kombëtare. Në vendimet e saj, GJEDNJ ka vendosur se qeveritë kanë detyrime 'pozitive', për të bërë të mundur që të të drejtat tona të jenë "praktike dhe efektive" jo "teorike apo iluzionare"<sup>95</sup>.

Të dy dokumentet e mësipërme kanë ndihmuar në përmirësimin e statusit të gruas në këto dekada, por nuk mund të flasim për arritjen e barazisë së vërtetë gjinore. Gratë janë ende të marginalizuara si në jetën politike ashtu edhe në atë publike e për më tepër ato mbeten në një shkallë të konsiderueshme viktimat e varfërisë, dhunës dhe papunësisë. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Sekretari i Përgjithshëm në Këshillin e Evropës sipas të cilit "Gratë vazhdojnë të fitojnë më pak, të vendosin më pak, dhe të numërohen më pak se meshkujt. Ka vetëm një fushë ku gratë numërohen më shumë se meshkujt: në regjistrat e viktimave të dhunës"<sup>96</sup>.

### **2.3 Karta Europiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore**

*"Nëse duam të krijojmë një shoqëri të bazuar në barazi, është thelbësore që qeveritë vendore dhe rajonale ta marrin plotësisht në konsideratë dimensionin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre. Dhe në botën e sotme dhe në atë të nesërme, barazia e vërtetë e grave dhe burrave është gjithashtu çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe social - jo vetëm në nivel europian dhe kombëtar, por dhe në rajonet, qytetet dhe komunitetet tona lokale"<sup>97</sup>.*

<sup>95</sup> Artico vs Italy (1981) 3 EHRR 1 para 33.

<sup>96</sup> Fjalim i promovimit të Komisionit të Ri për Barazinë Gjinore në Këshillin e Europës nga Sekretari i Përgjithshëm **Thorbjørn Jagland**.

<sup>97</sup> Shih Kartën Europiane për barazinë e burrave dhe të grave në jetën lokale, në pjesën hyrëse të saj, paragrafi 13.

Duke pasur parasysh rolin që ka Karta Evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore e shoh me interes për ta përfshirë në këtë punim, edhe pse tematika kryesore i referohet akteve juridike, pjesë e legjislacionit shqiptar.

Këshilli i bashkive dhe rajoneve europiane dhe partnerët e tij, hartuan Kartën Europiane të barazisë së burrave dhe grave në jetën vendore, nisur nga konstatimet se barazia midis gjinive në jetën e përditshme nuk përbënte akoma një realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë dhe pabarazitë sociale, politike, ekonomike dhe kulturore vazhdojnë të jenë një problem i madh, sidomos në jetën vendore. Në parimet bazë të kartës, përcaktohet se në sferën e qeverisjes sa më pranë qytetarëve, autoritetet vendore përfaqësojnë mekanizmat më të rëndësishëm për të luftuar pabarazitë si dhe për të promovuar një shoqëri të vërtetë të barabartë. Këto autoritete, nëpërmjet kompetencave dhe bashkëpunimit me aktorët e tjerë të përfaqësimit vendor, kanë mundësi të marrin masa në favor të arritjes së barazisë midis burrave dhe grave<sup>98</sup>.

Parimi bazë dhe më i rëndësishëm i kartës është përcaktimi i barazisë midis burrave dhe grave si një e drejtë themelore<sup>99</sup>. Në këtë drejtim qeveritë vendore duhet ta përfshijnë atë në të gjitha fushat e përgjegjësi të tyre, si dhe duhet të marrin masat për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit direkt apo indirekt<sup>100</sup>. Në çdo rast autoritetet në nivel vendor duhet të promovojnë eliminimin e stereotipave gjinorë, të cilët ndikojnë në rritjen e pabarazive në trajtim lidhur me rolet e burrave dhe grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore<sup>101</sup>.

Parimi i barazisë gjinore është një para-kusht themelor i demokracisë në çdo vend. Për këtë arsye një shoqëri demokratike nuk mund të injorohet aftësitë, njohuritë, përvojën dhe kreativitetin e grave<sup>102</sup>.

<sup>98</sup> Po aty, paragrafi 6-11.

<sup>99</sup> Shih pjesën e parë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, parimet, pika 1.

<sup>100</sup> Po aty.

<sup>101</sup> Shih pjesën e parë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, parimet, pika 4.

<sup>102</sup> Shih pjesën e tretë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, Neni 1.

Në të gjitha nenet e saj Karta trajton afirmimin e trajtimit të barabartë gjinor në aspekte të veçanta të jetës. Vëmendje e veçantë i kushtohet sanksionimit të së drejtës të barabartë të burrave dhe grave për të votuar dhe për të qenë pjesë e përfaqësimit politik, duke synuar gjithmonë arritjen e një balance gjinore në të gjithë procesin vendimmarrës, edhe nëpërmjet marrjes së masave që çdo qeverie vendore i duken të përshtatshme<sup>103</sup>. Më tej Karta trajton parimin e barazisë gjinore, në jetën sociale, të drejtën për edukim<sup>104</sup>, të drejtën për të përfituar një trajtim cilësor në rastet e paaftësive mendore dhe fizike<sup>105</sup>, të drejtën për të përfituar njëlloj qendrat sociale, përfshirë këtu edhe përfitimin e asistencës sociale<sup>106</sup> etj.

Për arritjen e qëllimeve të kësaj karte, qeveritë vendore janë jo vetëm të detyruara të sigurojnë që sistemet e tyre të qeverisjes t'u përgjigjen nevojave, interesave dhe përparësive të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, por edhe të krijojnë instrumentet e posaçme që qeverisja vendore e përgjegjshme gjinore të jetë jo më një aspiratë, por pjesë e pandarë e të gjitha politikave dhe projekteve vendore.

### 3. Sanksionimi i parimit të barazisë gjinore në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, kuadri juridik që rregullon çështjet e trajtimit të barabartë gjinor plotësohet nga ligji “Për barazinë gjinore në Shoqëri”<sup>107</sup>, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>108</sup> si dhe ligji “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”<sup>109</sup>. Meqenëse punimi hedh dritë më tepër mbi arritjen e barazisë në nivel vendor, do të ndalemi vetëm në dispozitat që e parashikojnë më mirë atë.

<sup>103</sup> Shih pjesën e tretë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, Neni 2.

<sup>104</sup> Shih pjesën e tretë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, Neni 13.

<sup>105</sup> Shih pjesën e tretë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, Neni 14.

<sup>106</sup> Shih pjesën e tretë të Kartës për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale, Neni 15.

<sup>107</sup> Ligj nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>108</sup> Ligj nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>109</sup> Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Qëllimi i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” është të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë si dhe të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore edhe në nivel vendor për të hartuar dhe zbatuar aktet normative si dhe politikave që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri<sup>110</sup>. Ligji përcakton detyrimin e njësive të qeverisjes vendore për të bashkëpunuar me institucionet e qeverisë qendrore në kuadër të zbatimit të legjislationit gjinor dhe politikave kombëtare për barazinë gjinore<sup>111</sup> si dhe bashkëpunimin me organizatat jofitimprurëse që punojnë brenda territorit të tyre për të arritur barazinë gjinore në fusha të ndryshme<sup>112</sup>. Këto njësi merren me mbledhjen dhe analizimin e statistikave vendore sipas gjinisë për të njohur më mirë situatën dhe problematikave të çështjeve gjinore dhe për të marrë masat e duhura<sup>113</sup>. Në zbatim sa më efikas të parashikimeve ligjore, njësitet e qeverisjes vendore caktojnë një ose disa nëpunës të barazisë gjinore vendore të aftë për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore<sup>114</sup>.

Ligji “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” ka si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje me anë të masave të përshtatshme ligjore. Për ta arritur këtë qëllim në nivel vendor ligji vendos detyrime ndaj autoriteteve vendore për t'u angazhuar në ngritjen e strukturave të shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje. Ata duhet të kujdesen të instalojnë linja telefonike rajonale 24-orëshe pa pagesë, për të vendosur lidhje me njësitet vendore, policinë, ekipet e urgjencës mjekësore dhe OJF-të në çdo rast të konstatimit të dhunës në familje. Gjithashtu është e domosdoshme ngritja e qendrave sociale dhe rehabilituese për viktimat dhe dhunuesit për të trajtuar me kujdesin e duhur çdo rast të dhunës në familje<sup>115</sup>.

Realizimi më përgjegjës dhe korrektesë i detyrimeve të sipërpërmendura mendoj do të ndihmonte në zgjidhjen e problematikave

<sup>110</sup> Shin Nenin 2 të ligjit “Për Barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>111</sup> Shih Nenin 14/1 të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>112</sup> Shih Nenin 14/2 të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>113</sup> Shih Nenin 14/3 të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>114</sup> Shih Nenin 14/4 të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>115</sup> Shih Nenin 7/4 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

gjinore në nivel vendor dhe do t'i hapte rrugë përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në çdo aspekt të jetës vendore.

#### 4. Parimi i barazisë gjinore në nivel vendor

Procesi i decentralizimit në Shqipëri është konceptuar në terma neutrale gjinore. Termi barazi gjinore në këtë këndvështrim nënkupton aksesin e barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në asetet materiale dhe jomateriale dhe në burimet e ndryshme të shoqërisë. Decentralizimi si pjesë e qeverisjes së mirë, që respekton parimin e barazisë gjinore nënkupton jo vetëm transferimin e fuqive, përgjegjësi, burimeve në nivel vertikal, por siguron edhe një proces horizontal më përfshirës që kërkon që fuqitë, përgjegjësitë dhe burimet të ndahen njëjloj midis burrave dhe grave. Praktikant tregojnë se decentralizimi dhe zhvillimi në nivel vendor kanë krijuar mundësi të reja për të stimuluar dhe rritur pjesëmarrjen e grave si në proceset vendimmarrëse ashtu edhe në përfitimin nga shërbimet. Gratë në përgjithësi, ashtu si dhe grupet e tjera margjinale të shoqërisë si dhe ata me të ardhura të ulëta, priten të përfitojnë më shumë nga përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, në kushtet e një qeverisjeje sa më afër qytetarëve, ku programet sociale me rëndësi për këto grupe me të disfavorizuar zhvillohen dhe menaxhohen në nivel vendor, duke përfshirë programet e kujdesit shëndetësor, arsimimit, punësimit, shërbimeve sanitare etj.

Nga ana tjetër, qeverisja vendore është parë si një mundësi e mirë ku gratë mund të përsosen në nivelin politik. Pengesat për hyrjen e tyre, si nevoja për të udhëtuar, harxhimi i kohës larg familjes, të ardhura të shumta në dispozicion, niveli i arsyeshem i arsimit, eksperiencat e konkurrimeve politike janë më të pakta në nivel vendor. Për këtë arsye pjesëmarrja e tyre në këtë nivel është parë si mundësia më e mirë për të filluar karrierën e tyre në politikat kombëtare.

Po ashtu politikat vendore shihen më interesante për gratë, meqenëse ato janë të njohura më mirë me komunitetin e tyre, duke qenë përdorueset më të mëdha të hapësirave dhe shërbimeve komunitare në nivel vendor (uji, elektriciteti, hedhja e mbeturinave, klinikat shëndetësore etj.). Ato gjithashtu marrin pjesë aktivisht në

organizatat ku ato jetojnë dhe është më e thjeshtë të përfshijnë këto organizata në politik-bërjen në nivel vendor. Prandaj, shpeshherë mendohet që decentralizimi është në interesin e grave<sup>116</sup>.

Për të pasur një menaxhim dhe shpërndarje sa më të mirë të burimeve në nivel vendor, është shumë e rëndësishme që të kontrollohet se si secila nga burimet ndikon për secilën prej gjinive. Procesi i konsultimit me autoritetet kompetente vendore, me të dyja gjinitë lidhur me nevojat, ndikimet që shpërndarja e burimeve sjell, është një element kritik në gjithë procesin e zhvillimit vendor. Kjo pasi decentralizimi në nivel vendor, nënkupton që femrat dhe meshkujt të kenë akses të barabartë së përfitimit nga shërbimet dhe gjithashtu të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në planifikimin e shpërndarjes së tyre. Integrimi i qasjes gjinore, në këtë mënyrë, e bën qeverisjen vendore, jo vetëm më të drejtë, por edhe më efektive.

Në nivel vendor pjesëmarrja e grave është e rëndësishme edhe për njohjen e problemeve që ato kanë dhe marrjen parasysh të interesave që ato përfaqësojnë. Duke qenë se në nivel vendor qeverisja është më afër qytetarëve, autoritetet duhet të marrin më shumë informacion rreth problematikave kyç që shqetësojnë shoqërinë, për të vepruar më pas nëpërmjet nismave të ndryshme si politike ashtu edhe ligjore. Nëse gratë, që përfaqësojnë pothuaj gjysmën e numrit të popullsisë së të gjitha ndarjeve administrative vendore, nuk përfshihen dhe përfaqësohen në këtë nivel, edhe interesat që ato mbrojnë do të jenë pre e shkeljeve dhe abuzimeve, duke krijuar premisat për një shoqëri të padrejtë. Në këtë kuptim interesat e grave nuk mund të përfaqësohen më mirë nga burra të zgjedhur në autoritetet drejtuese. Interesat e grave përfshijnë kryesisht politikat sociale dhe të mirëqenies, mbrojtjen e mjedisit, politikat e shanseve dhe mundësive të barabarta, politikat e çarmatimit dhe ato të arsimit, ndërkohë që interesat e burrave ecin në drejtim të politikave ekonomike dhe industriale, çështjet energjetike, transporti, siguria kombëtare dhe punët e jashtme<sup>117</sup>.

<sup>116</sup> Evertzen Annette (2001), "Gender and local governance", f.2.

<sup>117</sup> Evertzen Annette (2010), "VNG International committed to strengthening democratic local government worldwide". Për më tepër shih [http://www.vnginternational.nl/fileadmin/user\\_upload/Documenten/PDF/Gender](http://www.vnginternational.nl/fileadmin/user_upload/Documenten/PDF/Gender) -

Duke qenë përgjegjëset kryesore për aktivitetet riprodhuese, gratë kanë një interes të veçantë në shpërndarjen e burimeve dhe shërbimeve vendore, të tilla, si ujë, lëndë djegëse, energji elektrike, kanalizime, strehimin, sigurinë publike dhe shërbimet shëndetësore.<sup>118</sup> Ato mund të jenë aktorët kryesor në promovimin e qeverisjes së ndjeshme gjinore duke përfaqësuar interesat e përbashkëta të grave dhe burrave. Në disa vende gratë kanë pasur sukses në ndryshimin e agjendës politike duke bërë pjesë të tyre çështjet dhe interesat e grave (shërbimet sociale, kujdesi ndaj fëmijëve, të drejtat riprodhuese, të drejtave të grave mbi tokën, dhuna kundër grave etj.)<sup>119</sup>. Ky është një hap i mirë përpara në arritjen e barazisë gjinore pasi në çdo vend ka raste ku të drejtat e grave për pagë të barabartë, zë dhe njohje të barabarta janë mohuar. Në vende të tjera ligjet zakonore, i kanë mohuar grave të drejtën të trashëgojnë pronën e tyre apo të kërkojnë arsimim, ligjet statutores kanë dështuar në njohjen e të drejtës së grave për të mos qenë viktime të dhunës në familje, ndërkohë që në shumë vende të tjera gratë ende luftojnë për të drejtën e tyre të votës<sup>120</sup>. Kjo sepse çështjet e përfaqësimit politik apo pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse janë parë si çështje të interesit të burrave.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e grave në institucionet dhe proceset qeverisëse mund të sjellë ndryshime në pabarazitë dhe problematikat gjinore. Për shembull, përfshirja e një numri të madh grash në hartimin e kurikulave shkollore, mund të ndihmojë në minimizimin e stereotipave gjinore, shpesh të përforcuara nga tekstet shkollore; përfshirja dhe dhënia e mundësive të barabarta në zhvillimin e kuadrit ligjor, mund të ndihmojë në forcimin e ligjeve jo-diskriminuese dhe rritjen e rolit të akteve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Për sa më sipër procesi i planifikimit vendor duhet t'i kushtojë vëmendje të vazhdueshme trajtimit të pabarabartë gjinor, paragjykimeve dhe nevojave të ndryshme të burrave dhe grave, vajzave dhe djemve. Nëse i referohemi në këtë kontekst fushës së shëndetit,

Changing the Face of Local government.PDF

<sup>118</sup> Evertzen Annette (2001), "Gender and local governance", f. 8

<sup>119</sup> Evertzen Annette (2001), "Gender and local governance", f. 9

<sup>120</sup> Brody Alyson (2009), "Gender and Governance, Overview Report".

ndërkohë që femrat dhe meshkujt kanë nevoja të ngjashme ndaj gripit apo sëmundjeve të tjera, nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe për shëndetin riprodhues, ku nevojat e grave janë më të mëdha dhe të ndryshme<sup>121</sup>. Pikërisht janë këto ndryshime që duhet të merren në konsideratë nga autoritetet në nivel vendor, për të qenë gjithmonë e më afër në kushtet e një barazie reale midis femrave dhe meshkujve.

## 5. Buxhetimi lokal gjinor

Buxheti i pushtetit lokal është programi kryesor financiar vjetor i pushtetit lokal në të cilën përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara me ligj për kryerjen e funksioneve që kanë organet e pushtetit lokal në territorin ku ato veprojnë.<sup>122</sup> Nga njëra anë planifikimi i buxhetit ndikon në rritjen e nivelit të ardhurave dhe punësimit në nivel vendor dhe nga ana tjetër reflekton prioritetet politike më të rëndësishme të qeverisjes.

Përgjithësisht politikat dhe instrumentet e planifikimit të buxhetit janë konsideruar nga qeveritë dhe nga qytetarët në terma neutralë gjinore, si të mos kishin ndikime të ndryshme në lidhje me burrat dhe gratë. Megjithatë, fakti se gratë ende kanë më pak pushtet ekonomik, social dhe politik sesa meshkujt tregon se buxheti i planifikuar edhe në nivel vendor ka njëimpakt të ndryshëm mbi secilën prej gjinive.

Buxhetimi gjinor lidhet kështu me analizën e shpenzimeve publike, të ardhurave të tjera financiare dhe buxhetit nisur nga pasojat dhe ndikimi që ato kanë mbi vajzat dhe gratë në krahasim me djemtë dhe burrat, duke identifikuar si disavantazhet e njërit apo tjetrit seks ashtu edhe duke parë nëse shpërndarja e burimeve në këtë mënyrë forcon apo pakëson pabarazitë gjinore.

Në momentin që planifikimi i buxhetit publik do të shihet nga perspektiva gjinore, është e qartë që mosmarrja parasysh e ndryshimeve

<sup>121</sup> [http://uncdf.org/gffd/docs/session\\_7.pdf](http://uncdf.org/gffd/docs/session_7.pdf), p. 34

<sup>122</sup> Neni 2/2 I Ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë"

midis burrave dhe grave si edhe e kushteve të tyre të jetesës do të çonte në rezultate të padrejta dhe të pabarabarta në politikat publike.

Me rëndësi në këtë drejtim mund të shohim parashikimet e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore e cila përcakton në çdo rast se perspektiva gjinore duhet të merret në konsideratë në të gjithë procesin e zhvillimit të politikave në të gjitha funksionet e qeverisë.

Si pjesë e procesit për të zhvilluar prioritetet e politikave dhe buxhetet, autoritetet përkatëse duhet të konsultohen gjerësisht në mënyrën se si propozimet e buxhetit ndikojnë në mundësitë e barabarta. Planifikimi dhe zbatimi i programeve për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në nivel vendor, do të duhet të përfshihen në buxhetet e programuara. Ato duhet të përshtaten për të plotësuar nevojat specifike të grave. Vendimet për buxhetet të marra në bazë të një politike të tillë që integron përkatësinë gjinore do të reflektojnë ndryshimet/përshtatjet e bëra në atë politikë për të promovuar barazinë gjinore sipas Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri<sup>123</sup>.

Finalizimi i një politike të tillë gjinore është pjesë e një procesi të vazhdueshëm duke filluar me përcaktimin e objektivave specifike gjinore dhe treguesve të përshtatshëm për matjen e ndikimit të drejtpërdrejtë të politikave të planifikuara. Mbledhja e të dhënave nga të gjithë aktorët pjesëmarrës në këtë proces duhet të bazohet në gjendjen aktuale të burrave, grave, djemve dhe vajzave, në drejtim të përfitimeve, nevojave dhe interesave; duhet përcaktuar se kush përfiton nga politikat buxhetore dhe në ç'mënyrë si dhe çfarë i kufizon apo pengon burrat/ gratë e kategorive të ndryshme për të përfituar nga finalizimi i procesit, duke mundësuar kështu parashikimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për përfitim të barabartë gjinor. Hartimi i detajuar i të dhënave buxhetore mbi baza gjinore, do t'i hapë rrugë diskutimit të buxhetit me grupet e interesit dhe strukturat përkatëse në nivel lokal, për të mundësuar më pas adoptimin dhe miratimin e tij në këshillat e komunave apo bashkive. Fazat e fundit pas implementimit të buxhetit përfshijnë auditimin dhe vlerësimin

<sup>123</sup> Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave Dhe dhunën në familje, 2011-2015

e buxhetit nga strukturat lokale, nëse buxheti i miratuar kënaq dhe plotëson nevojat e parashikuara në fillim të procesit.

Në këtë kontekst disa nga masat, pjesë e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore lidhen me shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare për programet që avancojnë fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore, identifikimin e shpenzimeve specifike me bazë gjinore nga drejtoritë e qeverisë lokale (p.sh., për programet e shëndetit të grave, ose programe të veçanta për arsimitin e vajzave); planifikimin e shpenzimeve për mundësi të barabarta punësimi nga drejtoritë e ndryshme për punonjësit e tyre (p.sh., trajnim të grave në pozicione drejtuese dhe përshkrime të punës që reflektojnë mundësi të barabarta punësimi; integrimin gjinor të shpërndarjes së buxheteve dhe shpenzimeve (për shembull, alokime për të mbështetur gratë rurale që punojnë në bujqësi) etj.<sup>124</sup>

Nga sa më sipër mund të konkludojmë se buxhetimi gjinor përfshin të gjitha hapat e procesit të analizimit, vlerësimit dhe ristrukturimit të buxhetit nga pikëpamja gjinore, duke pasur si objektiv kryesor promovimin e barazisë gjinore si pjesë integrale e të drejtave të njeriut<sup>125</sup>.

## 6. Pjesëmarrja politike e grave në nivel vendor

Pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë dhe qeverisje është esenciale në ndërtimin e një sistemi demokratik. Në parimet themelore të çdo shteti përcaktohet shprehimisht se të gjithë kanë mundësi të barabarta për t'u përfaqësuar në proceset politike vendimmarrëse. Përbërja e organeve të zgjedhura nga qytetarët duhet të pasqyrojë dhe të marrë parasysh në të gjithë procesin vendimmarrës diversitetin e elektoratit.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe aksesit i tyre në proceset vendim-marrëse mund të shihet si indikator i kyçi barazisë

<sup>124</sup> Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave Dhe dhunën në familje, 2011-2015, f. 33-34

<sup>125</sup> Directorate General of Human Rights, Gender Budgeting, Strasbourg 2005, f. 11

gjinore në shoqëri. Në procesin vendim-marrës kjo barazi duhet të shihet në kontekstin nëse gratë mund të ndërmarrin ose të ndikojnë në vendimet e publikut njësoj si burrat. Pjesëmarrja e tyre në këto procese përbën një kusht të rëndësishëm edhe në marrjen parasysh të interesave që ato përfaqësojnë.

Historikisht ka pasur një disnivel midis numrit të popullsisë së grave dhe nivelit të përfaqësimit të tyre në shoqëri. Edhe pse gratë sot, si në nivel qendror ashtu edhe lokal, zënë numrin më të madh të popullsisë, vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara edhe si votuese edhe si të zgjedhura apo liderë politike. Kjo gjendje nuk vjen nga indiferentizmi i grave për t'u përfshirë në politikë dhe as nuk dëshmon paaftësinë e grave në këtë drejtim. Ajo është e lidhur me vështirësitë me të cilat ndeshen gratë për t'u përshtatur realitetit të sotëm të politikës shqiptare dhe pasqyron mungesën e standardeve dhe mekanizmave efikase, për përcaktimin e përparësive që do të mundësonin rritjen e pranisë së grave në drejtimin e vendit, një rol për të cilin dhe vetë gratë duhet të jenë edhe më këmbëngulëse. Niveli i ulët i përfaqësimit të grave në strukturat vendimmarrëse është tregues i faktit se aspiratat dhe nevojat e grave nuk janë të përfaqësuara, si dhe që gratë kanë pak mundësi për të nxitur politika që adresojnë problemet e tyre, përfshirë edhe varfërinë e pabarazinë gjinore, apo për të përmirësuar statusin dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik e social të vendit.<sup>126</sup>

### **6.1 Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në politikë**

Arsyet e mos përfshirjes së grave në proceset vendimmarrëse politike lidhen me një numër të konsiderueshëm faktorësh, duke filluar nga ata ideologjikë që shohin shoqërinë patriarkale si një sistem të dominimit të burrave, duke kërkuar gjithmonë e më shumë përqendrimin e grave brenda sferës së jetës private. Roli i tyre si gra dhe nëna është më i rëndësishëm se sa pjesëmarrja e tyre në jetën publike politike. Në momentin që krijohet një hierarki e tillë dominimi është e kuptueshme që niveli i përfaqësimit të grave në të gjithë procesin

<sup>126</sup> Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në familje 2007-2010.

politik, edhe vendor, do të jetë i ulët<sup>127</sup>.

Në të njëjtin drejtim, faktorët social-kulturorë theksojnë se rolet dhe diferencat gjinore midis burrave dhe grave si dhe nënvlefëtimi dhe nën-përfaqësimi i këtyre të fundit derivon edhe nga stereotipat gjinore shoqërore referuar fushës së riprodhimit. Përcaktimi i rroleve të ndryshme në shoqëri midis të dyja gjinive do ta rriste hendekun ndarës midis tyre dhe do ta bentë gjithmonë e më të pakapshëm sferën publike nga gratë “të lindura” për të kontribuar vetëm në domenin privat familjar<sup>128</sup>.

Ndërkohë nëse i referohemi faktorëve ekonomikë, një politikë gjithmonë e më shumë e komercializuar, do të kufizonte pjesëmarrjen e gruas brenda kornizave të saj, për shkak të nivelit më të ulët të të ardhurave që ato si shtresë kanë në kontrast me meshkujt, pronarët më të mëdhenj të burimeve prodhuese<sup>129</sup>.

### **6.2 Përfaqësimi politik vendor dhe kuotat gjinore**

Të gjithë faktorët e marrë në shqyrtim bënë që në zgjedhjet vendore 2011, si kryetar bashkie/komune të arrihej një përfaqësim prej 1,31%, ndërkohë që si këshilltare gra, të zgjidheshin vetëm 12,4%<sup>130</sup>. Nëse i referohemi listës së kandidatëve fitues për postin e kryetarit të bashkisë, komunës dhe njësisë bashkiake në Zgjedhjet Vendore të datës 8 maj 2011, sipas qarqeve vërejmë se në Qarkun Berat, për të tre Rrethet pjesë e tij nga 25 kandidatë fitues, asnjë prej tyre nuk përfaqëson gjininë femërore; në Qarkun Dibër nga 35 kandidatë fitues vetëm 1 është e gjinisë femërore; në Qarkun Durrës të 16 kandidatët fitues përfaqësojnë gjininë mashkullore; në Qarkun Elbasan nga 50 kandidatë fitues vetëm 1 kandidate është e gjinisë femërore; në Qarkun Fier nga 42 kandidatë fitues, 2 prej tyre janë femra; në Qarkun Gjirokastrë 32 kandidatë fitues janë meshkuj; në Qarkun Korçë 37 kandidatë fitues janë meshkuj; në Qarkun Kukës 27 kandidatë fitues janë meshkuj; në Qarkun Lezhë 21 kandidatë

<sup>127</sup> Farzana Bari (2005) “Women’s Political Participation: Issues and Challenges”, f.3.

<sup>128</sup> Po aty, f.5.

<sup>129</sup> Po aty, f. 5.

<sup>130</sup> Anastasi Aurela, Garantimi i përfaqësimit gjinor të barabartë në reformën zgjedhore, Gazeta Shqip, maj 2012

fitues janë meshkuj; në Qarkun Shkodër 33 kandidatë fitues janë meshkuj; në Qarkun Tiranë nga 40 kandidatë fitues, 2 janë femra dhe në Qarkun Vlorë nga 26 kandidatë fitues, vetëm 1 është femër<sup>131</sup>.

Nisur nga këto nivele të ulëta përfaqësimi të grave në nivel të politikbërjes, është parë e arsyeshme sanksionimi i “kuotave gjinore” si një instrument i veçantë në arritjen e baraspeshës gjinore në të gjitha institucionet. Përcaktimi i kuotave gjinore në politikën vendore synon të rrisë pjesëmarrjen në të, të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Vendi ynë parashikon të ashtuquajturat “kuota ligjore”, rregullimi i të cilave bëhet më ligje të veçanta. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” si dhe Kodi Zgjedhor shqiptar. Kështu ligji “Për barazinë gjinore në Shoqëri” përcakton se pjesëmarrja e barabartë gjinore në nivel vendor arrihet kur sigurohet përfshirja mbi 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore. Në funksion të zbatimit të këtij parashikimi në Kodin Zgjedhor parashikohen edhe rregullat e renditjes së secilës prej gjinive në listat e kandidatëve, në të cilin parashikohet detyrimi i respektimit të raportit një emër i secilës prej gjinive në çdo tre emra të vendosura në listë. Mosrespektimin dhe mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara më lart, Kodi zgjedhor dhe Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” e shoqëron me sanksionet përkatëse<sup>132</sup>, për t’i bërë më të përgjegjshëm subjektet politike në afirmimin e parimit të trajtimit të barabartë dhe rritjen e integritimit gjinor në shoqëri.

Për sa më sipër implementimi dhe zbatimi i kuotave gjinore ndiqet nga një rritje të numrit të grave të përfaqësuar në proceset vendimmarrëse në nivel vendor, edhe pse ka ende shumë punë për t’u bërë. Megjithatë, pavarësisht masave të veçanta të përkohshme që shteti ka ndërmarrë në favor të gjinisë më pak të përfaqësuar, moszbatimi me efikasitet dhe korrektesë i këtyre masave nga subjektet zgjedhore në nivel vendor, i hap rrugë abuzimeve dhe shkeljes së të

<sup>131</sup> Shih për më tepër [http://www.cec.org.al/images/stories/Legjislacioni\\_2011/Vendime\\_2011/VENDIM%201229/Lidhja%201.pdf](http://www.cec.org.al/images/stories/Legjislacioni_2011/Vendime_2011/VENDIM%201229/Lidhja%201.pdf)

<sup>132</sup> Mosrespektimi i kushtit renditjes së kandidatëve të përcaktuar në pikën 5 të Nenin 6 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja me 30000 lekë për çdo zonë zgjedhore.

drejtave të grave për t’u përfaqësuar dhe për të mbrojtur interesat e tyre në të gjitha aspektet e fushat e jetës sociale, kulturore, ekonomike.

## Konkluzione

Afirmimi i parimit të trajtimit të barabartë brenda qeverisjes vendore, shënon një hap të rëndësishëm përpara në zhvillimin e të gjitha sferave të jetës në nivel vendor. Marrja parasysh e interesave dhe nevojave të ndryshme midis meshkujve dhe femrave krijon themelet e një qeverisjeje demokratike sa më pranë qytetarëve si dhe kushte të favorshme për të dyja gjinitë për t’u përfaqësuar në nivel vendor.

Qëllimi i këtij artikulli ishte të tregonte se decentralizimi në nivel vendor, krijon një terren të përshtatshëm për rritjen e pjesëmarrjes së grave në fushën ekonomike, politike, sociale dhe kulturore. Në ndihmë të kësaj autoritetet përkatëse detyrohen të marrin masa të veçanta për realizimin sa më efikas të parimit të trajtimit të barabartë gjinor.

Artikulli tregoi se cilat ishin kriteret dhe si mund të kishim një buxhet të përgjithshëm gjinor apo një qeverisje të përgjithshme gjinore.

Kuadri ligjor ekzistues ka krijuar kornizën bazë të promovimit të barazisë gjinore në nivel vendor, por megjithatë nuk mund të flasim për një kuadër të përsosur juridik. Është i nevojshëm forcimi i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” nëpërmjet rritjes së sanksioneve për zbatimin efikas të kuotës gjinore në masën e përcaktuar në Kodin Zgjedhor, apo forcimit të mekanizmave mbikëqyrës për respektimin e saj. Në nivel lokal është e rëndësishme të ngrihen Komisionet e Shanseve të Barabarta dhe të vijohet me emërimin e Nëpunësve gjinore në bashkitë dhe komunat e vendit për të monitoruar zbatimin e angazhimeve të qeverisjes vendore për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave. Në të njëjtën kohë është i rëndësishëm hartimi i projekteve dhe politikave sociale në ndihmë të grave në nevojë, si dhe mbajtja parasysh e ndryshimeve gjinore në krijimin e mekanizmave të përshtatshëm në kuadër të eliminimit të të gjitha barrierave gjinore në nivel vendor, duke ngritur mekanizmin e referimit

të rasteve të dhunës në të gjitha njësitë si dhe qendrat sociale për pritjen dhe rehabilitimin e viktimave dhe dhunuesve si dhe ngritjen e linjave rajonale falas për vajzat dhe gratë e dhunuara/abuzuara në përputhje me Legjislacionin për Dhunën në Familje<sup>133</sup>.

## Bibliografi:

### Akte ligjore:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. CEDAW-Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
3. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
4. Karta Evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën lokale.
5. Ligj nr 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.
6. Ligj nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë”.
7. Ligj Nr 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
8. Ligj Nr 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.
9. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (2007-2010).
10. Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, 2011-2015.

### Artikuj dhe Botime

1. Anastasi, Aurela., *Barazia gjinore dhe sistemet e kuotave zgjedhore per gratë*, në [www.crca.org.al](http://www.crca.org.al)
2. Anastasi, Aurela., *Garantimi i përfaqësimit gjinor të barabartë në reformën zgjedhore*, Gazeta “Shqip” 2012.
3. Anastasi, Aurela., Bozo, Aurela., Mandro, Arta., Shkurti, Ermira., *Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi*, Tiranë, 2012.

<sup>133</sup> Për më tepër shih “Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, 2011-2015” f. 42-45.

4. Dahlerup, Drude., “Gender Quotas – Controversial But Trendy. On Expanding the Research Agenda”, *International Feminist Journal of Politics*, 2008.
5. UN WOMAN, Qendra Shqiptare për Kërkim Ekonomik, ASET (2010), “Studim mbi situatën në Shqipëri të Grave Lider në nivel Vendor”, Tiranë.
6. *Local Government and Human Rights: Doing Good Service*, (2005). International Council on Human Rights Policy. Versoix, Switzerland.
7. *Gender, Decentralization and Local Governance. The World Bank Institute Roxanne Scott*, May 2004.
8. *UNDP CONSOLIDATED REPLY: Lao PDR/ Gender Budgeting Alternatives/ Comparative Experiences, November 2005*.
9. Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe- Situation of local and regional democracy “ALBANIA”, 201
10. Haile, Jane (2006), Briefing note On mainstreaming gender equality In decentralisation, Public administration reform And local development.
11. Olsen, Hans Bjørn (2007) Decentralisation and Local Governance.
12. UNDP, (2004): Decentralised Governance for Development, A Combined Practice Note on Decentralisation, Local Governance and Urban/Rural Development.
13. Maclean, Melissa (2003) “Developing a Research Agenda on the Gender Dimensions of Decentralization”.
14. Manor, James. (1999). *The Political Economy of Democratic Decentralization*. Washington: The World Bank.
15. Myers Roxanne (2002), “Local Government, Decentralization and Gender Presented at the Caribbean Conference on Local Government Decentralization, June 25-28
16. Hamadeh-Banerjee, Lina (2001) “Women’s Agency in Governance”, in Women’s Political Participation and Good Governance: 21st Century Challenges. UNDP.
17. Directorate General of Human Rights Strasbourg, (2005) “Gender Budgeting”



## **TË DREJTAT E AUTORIT NË SHQIPËRI NË PËRQASJE ME ACQUIS E BE-SË**

Doktorante Juliana BYLYKBASHI

E-mail: juliblykbashi74@gmail.com

### **HYRJE**

E drejta e pronësisë intelektuale është një koncept juridik, i cili i referohet krijimeve të mendjes njerëzore prej së cilës rrjedhin një tërësi të drejtash ekskluzive dhe të drejta të mbrojtura<sup>134</sup>. Pronësia intelektuale nënkupton jo vetëm patentat, dizenjot industriale, modelet e përdorimit, markat tregtare, topografinë e gjysmëpërcjellësve dhe treguesit gjeografikë, por edhe të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, megjithëse kjo është trajtuar shpesh si një kategori e veçantë e ligjit.

E drejta e autorit<sup>135</sup> siguron mbrojtje për një sërë kategorish, veprash të listuara në disa akte ligjore ndërkombëtare e kombëtare. Konkretisht, me Ligjin nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, në Nenin 7, të tij thuhet: “Objekt i së drejtës së autorit në fushën e letërsisë, artit ose shkencës, produkt i punës krijuese të mendjes së njeriut, pa marrë parasysh mënyrën e krijimit, mjetet ose format praktike të të shprehurit dhe pavarësisht nga vlerat e tyre ose destinacioni janë: a) Shkrimet letrare dhe publicistike, leksionet, predikimet,

<sup>134</sup> Intellectual Property Licensing: Forms and Analysis, by [Richard Raysman](#)

<sup>135</sup> Shprehja të drejtat e autorit i referohet krijuesit të punës artistike, autorit të saj.

programet e kompjuterit; krijimet shkencore etj.; c) kompozimet muzikore; d) krijimet dramatike; e) krijimet kinematografike; f) krijimet fotografike, të arteve të bukura; g) veprat e artit të aplikuar, pa cenuar ato vepra si diseno industriale, që mbrohen nga ligji: “Për pronësinë industriale”; h) krijimet arkitekturore; k) krijimet tredimensionale etj., si dhe veprat e prejardhura<sup>136</sup>. E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të janë thelbësore për krijimtarinë njerëzore, duke i dhënë krijuesve mundësinë e përfitimeve pasurore dhe jopasurore nga shfrytëzimi i drejtë i veprës së tyre.

### **1. Kuptimi i së drejtës së pronësisë intelektuale**

**1.1** Sipas një sistemi mbrojtës të së drejtës së autorit, krijuesit janë të garantuar që veprat e tyre nuk do të përdoren në mënyrë të paautorizuar dhe as nuk do të piratizohen. Ky sistem mbrojtës ndihmon në përhapjen e drejtë të kulturës, dijes dhe argëtimit në të gjithë botën, pa cenuar origjinalitetin e veprës dhe duke i siguruar autorit të saj përfitimin që i takon si rezultat i punës së tij krijuese. Një vepër quhet e mbrojtur nga e drejta e autorit që në momentin e parë që ajo realizohet në një formë materiale, të perceptueshme nga shqisat e njeriut. Sipas Konventës së Bernës “Për mbrojtjen e krijimeve letrare dhe artistike” veprat letrare dhe artistike mbrohen pa qenë nevoja e ndonjë formaliteti në vendet të cilat janë palë të Konventës. Po ashtu Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (EİPO) nuk ofron një sistem të mirëfilltë regjistrimi të veprës, sidoqoftë, shumë shtete e kanë një zyrë kombëtare për të drejtën e autorit, si dhe me ligj rregullojnë regjistrimet e veprave për të përfituar nga mbrojtja ligjore.

**1.2** Zhvillimi i pronësisë intelektuale në Shqipëri, në një periudhë relativisht më të vonë se në Europë, përkon me zhvillimet historike të vetë konceptit të shtetit të së drejtës, koncept i cili përcillet me rregullimin e së drejtës së autorit që nga Kodi Civil i vitit 1929 dhe

<sup>136</sup> Vepër e prejardhur do të quhet çdo krijim intelektual që e ka prejardhjen nga një vepër origjinale, por duke plotësuar kushtin pa e cenuar atë, Neni 8 i ligjit për të drejtën e autorit.

deri te ligji aktual i vitit 2005<sup>137</sup>. Fazat e ndryshme nëpër të cilat ka ecur rregullimi i kësaj të drejte ka pasuruar dhe perfeksionuar vetë nocionin e pronësisë intelektuale, duke garantuar një mbrojtje më specifike dhe më të gjerë brenda një kornize europiane.

**1.3** Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila konsiderohet si një nga dokumentet më të rëndësishëm, e adaptuar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, nuk formon vetëm një lloj besimi kolektiv në vlerat supreme të personit njerëzor, por në planin juridik, formon një lloj baze për të përcaktuar të drejtat të cilat më parë ishin konsideruar më tepër objekt i normave morale. Në Nenin 27 të saj, thuhet se: “E drejta për të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit njerëzor për të gëzuar nga ato dhe pjesëmarrja, në progresin shkencor apo të të mirave që rrjedhin prej tyre, janë të drejta të pamohueshme të njeriut, të cilat garantohen dhe mbrohen nga qeveritë e shteteve aderuese. *Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë*”<sup>138</sup>.

## 2. E drejta e pronësisë intelektuale në këndvështrimin e BE-së

Pronësia intelektuale u njoh për herë të parë në Konventën e Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” më 1883 dhe në Konventën e Bernës “Për Mbrojtjen e Punëve letrare e artistike” në vitin 1886. Sipas Konventës së Bernës, të drejtat e autorit të punëve krijuese nuk kanë nevojë të njihen apo të deklarohen, pasi ato hyjnë në fuqi automatikisht me krijimin e tyre: një autor nuk ka nevojë t’i regjistrojë apo të aplikojë për të drejtat e autorit në vendet nënshkruese të Konventës së Bernës. Sapo një punë është “fiksuar”<sup>139</sup>, që është, shprehja e saj me shkrim ose regjistruar në disa mjete fizike,

<sup>137</sup> Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”.

<sup>138</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 27

<sup>139</sup> Vepra duhet të ketë një formë jo vetëm materiale, por edhe një formë fizike, pavarësisht nga forma e të shprehurit.

autori i saj ka të drejtë automatike për të gjitha të drejtat e autorit, si dhe të veprave të prejardhura, derisa autori shënohet shprehimisht poshtë tyre, ose deri kur skadon e drejta e autorit. Konventa e Bernës gjithashtu përcakton se autorët e huaj duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë me autorët vendas, në çdo vend që ka nënshkruar Konventën.

**2.1** Bashkimi Europian i filloi përpjekjet e tij për të harmonizuar legjislacionet e shteteve anëtare me anë të nënshkrimit të Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare të vitit 1886. Të gjitha vendet anëtare të BE-së e kanë nënshkruar këtë Konventë, dhe ky përfaqëson edhe një kusht paraprak për vendet kandidatë për anëtarësim në BE. Hapi i parë madhor i vendeve të komunitetit europian për harmonizimin e legjislacionit mbrojtës të të drejtave të autorit ishte vendimi për zbatimin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave të autorit në programet kompjuterike që u ligjërua me anë të Direktivës për Programet Kompjuterike në vitin 1991. Implementimi i direktivave të të drejtës së autorit ka hasur vështirësi më tepër se fushat e tjera të së drejtës siç shihet edhe nga gjykimet para Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me mungesën e transferimit të Direktivës për të Drejtat e Autorit. Tradicionalisht e drejta e autorit varion në bazë të shtetit, sidomos midis shteteve të sistemit common law dhe atij civil law. Diferencat në të drejtën e autorit janë lidhur edhe me qëndrimet kundër Organizatës Botërore të Tregtisë dhe globalizmit në përgjithësi.

Shtetet në përgjithësi kanë ligjet e tyre për mbrojtjen e pronësisë intelektuale për dy arsye; Njëra për t’i dhënë shprehje institucionale të drejtave morale dhe ekonomike krijuesve për krijimet e tyre dhe të drejtave të aksesit për publikun në këto krijime. Arsyeja e dytë është promovimi i krijimit, shpërndarjes dhe realizimit të saj, si dhe për të inkurajuar tregtinë e ndershme, që kontribuon në zhvillimin ekonomik.

Të drejtat e autorit janë të drejta territoriale, që do të thotë që nuk shtrihen më tej se territori i shteteve, përveç rasteve ku një shtet është pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare. Edhe pse të drejtat e autorit në nivel kombëtar janë standardizuar në bazë të standardeve të vendosura nga marrëveshjet ndërkombëtare, çdo shtet ka karakteristikat e veta të mbrojtjes të së drejtës së autorit. Siç janë

për shembull ndryshimet e kohëzgjatjes që variojnë sipas shtetit, jeta e autorit plus 50-100 vjet pas vdekjes, apo rasti i njohjes zyrtare të të drejtës së autorit që disa vende e kanë automatike, ndërsa për të tjerë nevojitet një regjistrim. Gjithashtu, edhe rasti i kufizimeve në ushtrimin e të drejtës së autorit etj.

**2.3** E drejta e autorit në Bashkimin European ka lindur si një përpjekje për të harmonizuar legjislacionet kombëtare të shteteve anëtare të Bashkimit European. Siç u përmend më sipër, Konventa e Bernës për Mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike, është një marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtën e autorit, e cila u nënshkrua në Bernë, Zvicër në vitin 1886. Krijimet e lidhura tradicionalisht me të drejtën e autorit janë objekt i konventës dhe rrjedhimisht ajo mbulon veprat letrare, dramatike, muzikore dhe artistike dhe gjithashtu filmat kinematografikë dhe ato analoge audio-vizuale. Sipas Konventës, të drejtat e autorit për veprat krijuese janë automatikisht në fuqi me krijimin e tyre. Autorët e huaj u përcaktuan të trajtoheshin në mënyrë ekuivalente me autorët vendas, në çdo vend që nënshkruan Konventën.

Konventa e Bernës kërkon nga nënshkruesit e saj të njohin të drejtën e autorit të veprave, për autorët shtetas të njërit nga anëtarët e Konventës së Bernës në të njëjtën mënyrë si njeh autorët si shtetas të vet. Përveç kësaj, në këtë marrëveshje kërkohej gjithashtu për shtetin anëtar të sigurojë standardet minimale të vendosura në Konventë. Konventa e Bernës thekson se të gjitha të drejtat e autorit për të gjitha veprat, përveç atyre fotografike dhe kinematografike kanë një kohëzgjatje për të paktën 50 vjet pas vdekjes së autorit, por anëtarët janë të lirë për të siguruar një kohëzgjatje më të madhe. Bashkimi European me Direktivën e vitit 1993 vendosi mbi harmonizimin e afatit të mbrojtjes të të drejtave të autorit.

**2.4** Konventa e Romës për Mbrojtjen e Interpretuesve, të Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave Transmetuese u nënshkrua më 26 tetor 1961. Konventa kërkon që çdo shtet anëtar të aplikojë atë në trajtimin kombëtar të respektimit të të drejtave, të cilat ajo ju akordon interpretuesve, prodhuesve dhe organizatave të transmetimit. Konventa zgjeroi mbrojtjen e të drejtës së autorit nga krijuesit, duke përfshirë edhe pronarët e manifestimeve të veçanta

fizike të pronësisë intelektuale, të tilla si kasetat audio ose DVD. Transmetuesve ju garantohen të drejtat ekskluzive mbi riprodhimin, ri-transmetimin dhe përcjelljen në publik. Trembëdhjetë shtetet që hartuan Konventën në përgjigje të teknologjive të reja, si regjistrimi në kasetë që e bëri riprodhimin e tingujve dhe imazheve të lehtë dhe më të lirë se kurrë më parë. Ndërsa ligji i mëparshëm për mbrojtjen e të drejtave të autorit, duke përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa e Bernës e vitit 1886, ishte shkruar për të rregulluar qarkullimin e materialeve të shtypura.

Konventa e Romës iu përgjigj rrethana të reja të ideve të përfaqësuara në njësi të ndryshme të riprodhuara me lehtësi, duke i përfshirë interpretuesit dhe prodhuesit e regjistrimeve në të drejtat e autorit. Konventa garanton një mbrojtje për një afat prej 20 vjetësh, nga kryerja e performancës apo transmetimi në mënyrë të përshtatshme.

**2.5** Traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI) themeluar në vitin 1970, është një organizatë ndërkombëtare e përkushtuar për të ndihmuar dhe për të siguruar që të drejtat e krijuesve dhe pronarëve të pronësisë intelektuale në mbarë botën të jenë të mbrojtura dhe se shpikësit dhe autorët të njihen dhe shpërblehen. Kjo mbrojtje ndërkombëtare vepron si një nxitje për kreativitetin njerëzor, shtyn përpara kufijtë e shkencës dhe teknologjisë dhe synon pasurimin e botës së letërsisë dhe arteve, duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për marketingun e produkteve të pronës intelektuale. OBPI është një nga 16 agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara. Ajo i dha mbrojtje shtesë të drejtës së autorit për të përmbushur sfidat e paraqitura nga teknologjia. Neni 4 i Traktatit siguron se programet kompjuterike mbrohen si vepra letrare, dhe Neni 5 siguron se marrëveshja dhe përzgjedhja e materialeve në bazat e të dhënave është e mbrojtur. Artikujt 6-8 u sigurojnë autorëve kontroll mbi qiratë e veprave të tyre dhe shpërndarjen e veprave të tyre, të cilat nuk janë përfshirë në fillim nga Konventa e Bernës. Këshilli i Bashkimit European e miratoi traktatin në emër të Komuniteti European.

**2.6** Marrëveshja TRIPS, e cila hyri në fuqi më 1 janar 1995, është deri më sot marrëveshja shumëpalëshe më e plotë në fushën e

pronësisë intelektuale. Tre karakteristikat kryesore të marrëveshjes janë: Standardet; marrëveshja përcakton minimumin e standardeve të mbrojtjes që duhet të sigurohen nga çdo anëtar. Marrëveshja përcakton këto standarde duke kërkuar, së pari, detyrimet substanciale e kryesore nga Konventat e OBPI, Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike në versionet e tyre më të fundit, duhet të jenë në përputhje me këto dokumente ndërkombëtare. Me përjashtim të dispozitave të Konventës së Bernës mbi të drejtat morale, të gjitha dispozitat kryesore substanciale të këtyre konventave janë të inkuorporuar me referenca dhe kështu bëhen detyrime sipas Marrëveshjes TRIPS. Së dyti, Marrëveshja TRIPS shton një numër të konsiderueshëm detyrimesh shtesë mbi çështjet ku konventat para-ekzistuese kanë heshtur ose shiheshin si të pamjaftueshme. Kështu ndonjëherë i referohen Marrëveshjes TRIPS si një marrëveshje Bernë dhe Paris-plus. Zbatimi;Grupi i dytë kryesor i dispozitave trajton procedurat dhe mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. *Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*; Detyrimet sipas Marrëveshjes do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha vendet anëtare, por vendet në zhvillim do të ketë një periudhë më të gjatë në faza. Marrëveshja TRIPS është një marrëveshje që përcakton një minimum standardesh, e cila lejon për Anëtarët të sigurojë mbrojtje më të gjerë të pronësisë intelektuale në qoftë se ata dëshirojnë. Anëtarët janë lënë të lirë për të përcaktuar metodën e duhur të zbatimit të dispozitave të marrëveshjes në kuadër të sistemit të tyre ligjor dhe praktikës.

### 3. E drejta e autorit në Shqipëri

**3.1** Për sa i përket të drejtës së autorit në Shqipëri legjislacioni ekzistues u referohet dispozitave ligjore europiane (Acquis të BE-së) të mëposhtme:

- Direktiva 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që

zbatohen në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë”<sup>140</sup> - Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një veprë arti origjinale”<sup>141</sup> - Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit, si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale” (version i kodifikuar i 92/100/KEE)<sup>142</sup> - Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (version i kodifikuar i 93/98/KE)<sup>143</sup> Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”<sup>144</sup>- Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”<sup>145</sup>.

**3.2** Plani kombëtar për zbatimin e MSA-së, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.463, datë 5 korrik 2006<sup>146</sup> në përputhje me Nenin 73 dhe shtojcën V të MSA-së<sup>147</sup> parashikon një listë me konventa shumëpalëshe në të cilat janë palë shtetet anëtare të BE-së dhe në të cilat Shqipëria synon të bëhet palë.

Në mbështetje të ligjit “Për të drejtën e autorit e të drejta të tjera të lidhura me të “është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.232, datë 19 prill 2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”. Kjo Zyrë është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

**3.3** Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit është zhvilluar si rezultat i nevojës emergjente në luftën kundër piraterisë dhe shkeljes

<sup>140</sup> Celex nr.31993L0083/ Fletorja Zyrtare 1993L248/15.

<sup>141</sup> Celex nr.32001L0084/ Fletorja Zyrtare 2001 L 272/32.

<sup>142</sup> Celex nr.32006L0115/ Fletorja Zyrtare 2006 L 376/28.

<sup>143</sup> Celex nr.32006L0116/ Fletorja Zyrtare 2006 L372/12.

<sup>144</sup> Celex nr.31996L0009/ Fletorja Zyrtare 1996 L 77/20.

<sup>145</sup> Celex nr.32009L0024/ Fletorja Zyrtare 2009 L 111/16.

<sup>146</sup> Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr.80, datë 02.08.2006, f. 2409-2414.

<sup>147</sup> Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr.87, datë 14.08.2006, f. 3028.

së pronësisë intelektuale që ekziston në Shqipëri. Ngritja e Zyrës është, gjithashtu, një detyrim që rrjedh nga Neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, në të cilin palët konfirmojnë rëndësinë e sigurimit të nivelit të posaçëm të mbrojtjes dhe vendosjes së të drejtave të pronësisë intelektuale. Roli i ZSHDA-së si organ arbitrazhi dhe vendimmarrës, është i rëndësishëm edhe në aspektin e funksionimit të agjencive të administrimit kolektiv dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre me përdoruesit e produkteve të pronësisë intelektuale (produkte të mbrojtura nga e drejta e autorit). “Administrimi kolektiv” është ushtrimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të nga ana e agjencive, të cilat veprojnë në interes dhe në emër të mbajtësve të të drejtave. Sipas ligjit shqiptar për të drejtën e autorit, agjencitë e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, janë organizata jofitimprurëse të licencuara nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me propozim të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit. Deri më tani, janë licencuar 4 agjenci: Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “ALBAUTOR” në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike;- Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “FMAA” për mbrojtjen e të drejtave të drejtorëve dhe skenaristëve të kinematografisë shqiptare dhe veprave audio-vizuale;- Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Lidhura me të Drejtën e Autorit “AKDIE” për mbrojtjen e interpretuesve dhe artistëve;- Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Lidhura me të Drejtën e Autorit “AMI” përt ë drejtat e prodhuesve të fonogramit.

**3.4** Gjithashtu në iniciativat e reja ligjore përmendet procesi për përgatitjen e ligjit të ri për të drejtën e autorit, nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme të ekspertëve të Bashkimit Europian dhe të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO). Hartimi i këtij ligji po kryhet duke marrë në konsideratë përafrimin me direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2000/48/KE, datë 29 prill 2004, për zbatimin e plotë të të drejtave të pronësisë intelektuale.

#### **4. Jurisprudenca europiane mbi të drejtën e pronësisë intelektuale**

**4.1** Si në çdo fushë të së drejtës, edhe në prizmin e pronësisë intelektuale nuk mungojnë debatet dhe mendimet e ndryshme të studiuesve të së drejtës. Një ndër aspektet që shqetëson sot ligjvënësit, shtetet, por sidomos zotëruesit e të drejtave të autorit është raporti midis aksesit të pakufizuar në internet, lirisë për të shfrytëzuar mundësitë që të ofron ky shërbim dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale si një e drejtë personale. Që nga shpikja e tij e deri më sot interneti përbën mjetin më të shpejtë dhe të përsosur që shkenca ka arritur të zhvillojë për të krijuar ura të reja komunikimi, akses të pakufizuar në informim, si dhe përdorim dhe shfrytëzim personal i të gjithave mundësive që ky opsion mund të ofrojë. Megjithatë, një fuqi e tillë në duart e secilit prej nesh sjell me vete edhe problematika të shumta, shpesh përdorime të pamoralshme, të cilat shkojnë deri në shkelje e cenime të të drejtave individuale, duke ushtruar presion mbi mbrojtjen ligjore që ofron pronësia intelektuale.

Plagjiatura, pirateria në Web, shkarkimi i muzikës, filmave etj., konsiderohen një fenomen jo vetëm në rritje, por shqetësues për autorët e këtyre punimeve, interesat ekonomike dhe morale të të cilëve preken. Pirateria nuk është një nocion juridik, por ka lindur si term për të përshkruar shkeljet apo mashtrimet e së drejtës së autorit të bëra me qëllim përfitimi tregtar. Çdo kopjim, riprodhim, shpërndarje pa autorizimin e autorit për përfitime tregtare, duke i sjellë dëm ekonomik, do të konsiderohet pirateri.

**4.2** Në një rast të trajtuar në Gjykatën Europiane të Drejtësisë, në të cilën kërkohej nga njëra palë vendosja e një sistemi filtrimi nga një ISP në rrjetet e saj, nuk mund të thuhet se vendos një balancë midis, në njërin anë të të drejtave të bartësit të pronësisë intelektuale dhe në anën tjetër të të drejtave të ofruesve të aksesit të internetit dhe klientëve të tyre.

Gjykata Europiane e Drejtësisë më 24 Nëntor 2011, mori vendimin gjyqësor që detyronte ISP-të<sup>148</sup> të instalonin sisteme filtrimi në rrjetet e tyre për të respektuar të drejtat e autorit. Çështja përfshinte

<sup>148</sup> Internet service provider është organizatë që ofron akses në internet.

një konflikt midis Scarlet Extended SA, një ofrues aksesi interneti që vepronte në Belgjikë, dhe organizatës belge të menaxhimit kolektiv<sup>149</sup>. SABAM inicioi procedurën duke pretenduar që Scarlet ka lejuar me qëllim downloadimin joligjor nga palët e treta të punëve të tij të mbrojtura nëpërmjet sharing-ut të file-eve grup – grup (peer-to-peer) në rrjetet e tij.

Gjykata e Shkallës së Parë e Brukselit pranoi kërkesën e SABAM-it dhe me vendimin gjyqësor detyronte ISP të instalonte software për menaxhimin e përmbajtjes dhe identifikimin në bazë të gjurmës së gishtit me qëllim parandalimin e shkëmbimeve të paautorizuara nga ana e personave të pajtuar në materialet e mbrojtura<sup>150</sup>. Scarlet e apeloj vendimin dhe Gjykata e Apelit i parashtroi një kërkesë Gjykatës së Drejtësisë për një vendim paraprak, nëse ligji European lejonte shtetë anëtare të autorizonin gjykatat kombëtare për të urdhëruar ISP-në të instalonte me shpenzimet e veta dhe për një periudhë të pacaktuar, kryesisht si masë parandaluese, një sistem për filtrimin e të gjitha komunikimeve elektronike me qëllim identifikimin e downloadimeve joligjore të file-eve. Gjykata në fillim vuri në dukje që, sipas Direktivës së të Drejtave të Autorit dhe Direktivës së Zbatimit, gjykatat dhe autoritetet administrative mund të japin vendime që urdhërojnë ofruesit e shërbimit të ndërpresin shkeljet e nisura apo të parandalojnë shkeljet e ardhshme të të drejtave të autorit. Megjithëse vendimet që drejtojnë urdhra të tillë janë çështje të legjislacionit kombëtar, vendimet kombëtare mund të jenë në përputhje me kufizimet që rrjedhin nga ligji European, si p.sh. ndalimi me ligj i detyrimeve të monitorimit të përgjithshëm siç parashikohet në Nenin 15 E- të Direktivës Komerciale. Gjykata vendosi, që kërkesa që një ISP të instalojë një sistem filtrimi do të ishte në shkelje me këtë ndalim. Gjykata më pas vijoi me shqyrtimin e përputhshmërisë së vendimit për filtrim me kuadrin ligjor themelor të BE-së. Gjykata vuri në dukje se, megjithëse mbrojtja e pronësisë intelektuale është sanksionuar në Nenin 17(2) Të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European, asnjë fjalë e dispozitës nuk sugjeron që e drejta është e padhunueshme dhe duhet

<sup>149</sup> Shoqëria e Autorëve, Kompozitorëve dhe Publikuesve – SABAM.

<sup>150</sup> shih IRIS 2011-6//2 dhe IRIS plus 2009-4.

mbrojtur patjetër. *Përkundrazi, mbrojtja e pronësisë intelektuale duhet të balancohet me mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore.*

Në këtë pikëvështrim, Gjykata konstatoi që natyragjithëpërfshirëse dhe e kushtueshme e vendimit në diskutim, i cili do të kërkonte monitorim të të gjitha komunikimeve elektronike të bëra në rrjetin e ISP pa kufizime në kohë dhe me shpenzime të ISP, do të rezultonte në shkelje serioze të lirisë së Scarlet për të bërë biznes. Për më tepër, do të shtonte efekte të kundërta për klientët e ISP: *së pari*, vendimi do të përfshinte një analizë sistematike të të gjithë përmbajtjes dhe mbledhjen e identifikimin të të gjitha adresave IP të përdoruesve nga të cilat janë dërguar në rrjet përmbajtjet e paligjshme, që përmbajnë të dhëna personale të mbrojtura. *Së dyti*, meqë sistemet e filtrimit nuk mund të bëjnë dallim të qartë midis përmbajtjes së ligjshme dhe asaj të paligjshme, parathënia e tyre mund të çojë në bllokim të komunikimeve të ligjshme, duke dëmtuar lirinë e informimit. Gjykata arriti në konkluzion se një vendim që kërkon instalimin e një sistemi filtrimi nga një ISP, përjashtohet nga ligji European<sup>151</sup>.

**4.3** Janë pikërisht të rejtat shkencore, të cilat kanë çuar në nevojën e ndryshimit të konventave origjinale duke inkorporuar aspekte të domosdoshëm si: mbrojtja e programeve kompjuterike dhe databazëve origjinale, masa të cilat synojnë një impakt specifik në teknologjinë e digjitalizuar etj. Si shembuj ilustrues të masave të kësaj natyre mund të përmendim *WIPO Internet Treaties* e krijuar posaçërisht për të përditësuar marrëveshjet tashmë ekzistuese të Bernës dhe Romës në përgjigje të sfidave që imponon epoka e digjitalizimit<sup>152</sup>.

“*E.U. Copyright Directive*” 2001/29/EC e përshtatur nga Parlamenti dhe Komisioni European mbi harmonizimin e të drejtës së kopjimit dhe të drejtave të tjerave të lidhura me të, ka për qëllim implementimin e detyrave të reja ndërkombëtare sipas ndryshimeve të traktatit të WIPO. Përveç përpjekjeve në kontinentin european është me vend të përmendim edhe Digital Millennium Copyright Act

<sup>151</sup> Çështja C-70/10 Scarlet Extended SA v Societe belge des auteurs, compositeurs et éditeurs SCRL (SABAM), 24 Nëntor 2011 <http://merlin.obs.coe.int/redirect.php?id=15552>

<sup>152</sup> The Impact of Internet on Intellectual Property, WIPO website.

(DMCA) në SH.B.A dispozitat e të cilit kryejnë të njëjtin funksion me atë të dispozitës së BE, ku krahas të tjerave inkuadron masat teknologjike dhe të drejtat e menaxhimit informativ në lidhje me pronësinë intelektuale<sup>153</sup>.

Një tjetër ekuilibër delikat midis autorit dhe përdoruesve të veprës është edhe përplasja e të drejtave të tyre, siç në më të shumtën e rasteve ndodh në të drejtën e informimit apo të lirisë së fjalës. Ky është i vetmi rast ku e drejta e autorit përplasë me të drejtat e njeriut, por deri tani nuk ka asnjë rast në Gjykatën Europiane të të drejtave të njeriut, por ka raste në shtetet anëtare dhe një rast i shqyrtuar nga Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut<sup>154</sup>. Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një rast të tillë mbrojtja për lirinë e shprehjes trajtohet si përdorim i drejtë i veprës dhe jo si mbrojtje e veçantë<sup>155</sup>.

## Përfundime dhe rekomandime

Nga analiza e çështjeve të sipërpërmendura, mund të nxjerrim disa përfundime dhe rekomandime:

1. *Rishikimi i të drejtave krijuese në epokën e Internetit.* Zhvillimet e jashtëzakonshme të shoqërisë digjitale kanë prishur dukshëm balancat midis të drejtave të autorëve të punimeve intelektuale, investitorëve dhe publikut të gjerë, duke ngritur pyetje mbi funksionimin e demokracisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatueshmërinë e sundimit të ligjit. Gjithashtu, ngrihen pyetje etike dhe pyetje në lidhje me pronësinë, veçanërisht pronësinë intelektuale.

2. Mundësia për të shpërndarë dokumente të shkruara, muzikë, fotografi dhe filma pa respektuar të drejtat e autorit, si dhe planet për biblioteka elektronike, janë shembuj të këtij zhvillimi. Pasojat janë të shumëfishta. Rënia drastike e shitjeve të punimeve muzikore dhe kinematografike është realitet dhe e njëjta tendencë mund të shihet

te publikimet me ardhjen e bibliotekave elektronike. Për më tepër, disa shtete po marrin në konsideratë nxjerrjen e ligjeve për të lejuar mbikëqyrje të shkëmbimeve digjitale midis individëve.

3. Instrumentet për mbrojtjen e të drejtës së autorit nuk janë më në gjendje të garantojnë krijuesit dhe investitorët për një përfitim të drejtë të aktiviteteve të tyre respektive ndërkohë që i sigurojnë publikut akses në informacione dhe respekt për privatësinë. Në njërin anë, është në rrezik vetë mbijetesa e profesioneve krijuese; dhe në anën tjetër, ka rrezik për shfaqjen e shteteve policore që kontrollojnë të gjithë informacionin e shkëmbyer nga qytetarët e tyre.

4. “Palët pirate” po lindin në të gjithë Europën dhe në mbarë botën, duke u rebeluar kundër çdo kontrolli shtetëror mbi komunikimet në Internet; duke kërkuar mbrojtje të privatësisë dhe të drejtës për informim, për të shkëmbyer muzikë, filma dhe produkte të tjera artistike, shkencore apo krijime letrare pa pagesë. Partia Pirate Suedeze ka një anëtar në Parlamentin Europian, dhe Partia Pirate Gjermane, deri në zgjedhjet e ardhshme, ka një anëtar në Bundestag.

5. Nuk duket se ka ndonjë rrezik për të drejtën e publikut për të aksesuar informacione dhe s’ka arsye për sigurimin e muzikës, filmave dhe punimeve letrare apo shkencore pa pagesë. Asambleja Parlamentare Europiane konsideron që, aksesit pa kufizim dhe pa pagesë për informacion në asnjë mënyrë nuk presupozon aksesin pa pagesë për produktet artistike, shkencore apo krijimet letrare, edhe pse duhet të mbetet liria për të kopjuar për përdorim vetjak. Përrjashtimet përkatëse në fushën e arsimit dhe kërkimit duhet të mbrohen siç duhet.

6. Është detyrë e autoriteteve publike që të punojnë për vendosjen e balancës midis të drejtave të pjesëtarëve të ndryshëm në procesin e krijimeve intelektuale, ndërsa garantojnë respekt të privatësisë. Këshilli i Europës, vlerat themelore të të cilit janë saktësisht demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit, ka për detyrë të përfshihet në vlerësimin e zhvillimeve të parashikuara dhe në përpilimin e standardeve të kërkuara në nivel europian.

Disa rekomandime, mendojmë se do të ishin të dobishëm, në këtë rast. Kështu, dihet në ditët e sotme ku zhvillimi i pronësisë intelektuale

<sup>153</sup> The Impact of Internet on Intellectual Property WIPO website.

<sup>154</sup> Case 30262/96, 15 janar 1997 Komisioni Europian i të drejtave të njeriut.

<sup>155</sup> Kalem co kundër Harper Brothers, 222 US 55.

ecën me ritme të shpejta shihet si një domosdoshmëri që ndryshime të përshtatshme të realizohen edhe në sistemin tonë ligjor, se:

Pronësia intelektuale si një tërësi dhe kompleksitet të drejtash ofron një mbrojtje të gjerë dhe të përshtatshme për të gjitha llojet dhe kategoritë e krijimeve të mendjes njerëzore. Njohja dhe ndërgjegjësimi i publikut, për kufizimet dhe përjashtimet e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, është një nga format e parandalimit të piraterisë si një nga fenomenet që dëmton rëndë interesat ekonomike të autorit.

Zhvillimet teknologjike dhe shoqërore kërkojnë masa më adekuate për të ruajtur balancin e duhur midis të drejtës së autorit të krijimit të veprës dhe përdorimit që publiku ushtron mbi të, duke pasur parasysh këtu përdorimin dhe shfrytëzimin e tyre nëpërmjet internetit. Lind raporti midis mbrojtjes financiare dhe morale të autorit kundrejt lirisë së informacionit dhe aksesit në Web. Kjo situatë e re teknologjike kërkon të gjejë shprehje edhe në praktikën e vendit tonë.

Në këtë problematikë nuk ka ende një qëndrim të konfirmuar dhe debati mbetet i hapur, megjithatë shihet një përpjekje e vazhdueshme nga instancat ndërkombëtare për të ofruar një mbrojtje, e cila është konform zhvillimeve më të reja të epokës digjitale. Përshtatja e kuadrit ligjor në Shqipëri me aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në këtë fushë, në kuadër edhe të integritimit europian, mbetet një detyrë e rëndësishme për t'u përmbushur nga shteti shqiptar.

Duhet të sigurohet që autorët, përformuesit, prodhuesit dhe transmetuesit të kenë të drejta të mjaftueshme në lidhje me format e reja të shfrytëzimit dhe përdorimit të punimeve, kontributeve dhe performancave të tyre për të mbrojtur interesin e tyre dhe për të luftuar piratimin në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme.

Implementimi i një regjistrimi në linjë (on line) apo në forma të tjera të veprave të autorëve që qarkullojnë në treg për të krijuar mundësinë e formimit të një baze të dhënash mbi veprat origjinale. Kjo mbron autorin dhe veprën nga pirateria, por mbron edhe konsumatorin në garancinë që ofron për origjinalitetin e veprës.

## Bibliografi

1. Raysman, Richard., *Intellectual Property Licensing: Forms and Analysis*.
2. Tutulani-Semini Mariana, E drejta e autorit në Shqipëri, Scanderbeg, Tiranë, 2007.
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Alb-Juris, Tiranë, 2009.
4. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, Tiranë, 2006.
5. Akti i Parisit i Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Punimeve Letrare dhe Artistike (1971).
6. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Përformuesve, Prodhuesve të Fonogrameve dhe të Organizatave Transmetuese (Romë, 1961).
7. Konventa për Mbrojtjen e Prodhuesve të Fonogrameve kundër Dublikimit të Paautorizuar të Fonogrameve të tyre (Gjenevë, 1971).
8. Marrëveshja mbi aspektet që kanë lidhje me tregtinë të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (Marrëveshja TRIPS) (1994).
9. Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”.
10. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.232, datë 19 prill 2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”.
12. E.U. Copyright Directive” 2001/29/EC.
13. Direktiva 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë”.
14. Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale”.
15. Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit, si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale” (version i



- kodifikuar i 92/100/KEE).
16. Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (version i kodifikuar i 93/98/KE).
  17. Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”.
  18. Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”.
  19. Kalem co kundër Harper Brothers, 222 US 55.
  20. Çështja C-70/10 Scarlet Extended SA v Societe belge des auteurs, compositeurs et editeurs SCRL (SABAM), 24 Nëntor 2011.
  21. The Impact of Internet on Intellectual Proprety, WIPO website.
  22. Case 30262/96, 15 janar 1997, Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut.

## KONSTITUCIONALIZMI POPULLOR

Valbona PAJO (BALA), MA<sup>156</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

E-mail: valbonapajo@gmail.com

### 1. Konstitucionalizmi popullor

Nëse përcaktimi i kuptimit të konceptit “konstitucionalizëm” në disa sisteme qeverisjeje, ende të brishta e në tranzicion të vazhdueshëm (si sistemi shqiptar) është kryefjala e çdo dite, kur bëhet fjalë për përjasje dhe diskutime mbi nocione të tjera si konstitucionalizmi popullor apo raporti i tij me supremacinë gjyqësore, apo mbi rolin që duhet të ketë individit në ditët e sotme në përcaktimin e kuptimit të Kushtetutës dhe interpretimin e saj, ato tingëllojnë disi jashtë prioriteteve që imponon realiteti. Në fakt, diskutimi në këtë rast nuk shtrohet për instrumentet e ushtrimit të demokracisë së drejtpërdrejtë, si për shembull referendumit, ku vota popullore është përcaktues i rezultatit, por për një “ndërrhyrje” të vazhdueshme, energjike dhe të vullnetshme të vetë popullit në ushtrimin e kontrollit gjyqësor të Kushtetutës, pushtet që prej kohësh u është besuar gjykatave, prej nga buron supremacia e tyre gjyqësore. Kështu, dashje pa dashje, këto trajtesa të kohëve moderne mbi konstitucionalizmin popullor, ngjallin kërshtëri për t’i analizuar më thellë dhe për t’i përcjellë, veçanërisht, tek ai grup lexuesish që ndajnë të njëjtin pasion dhe kuriozitet për

---

<sup>156</sup> Këshilltare e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të RSH, Doktorante pranë Fakultetit të Drejtësisë, UT.

zhvillimin e të drejtës, në përgjithësi dhe, veçanërisht, të së drejtës kushtetuese dhe asaj të krahasuar.

Konstitucionalizmi popullor përkufizohet si doktrina sipas së cilës kushdo - njerëzit e angazhuar politikisht, përfaqësuesit e tyre politikë dhe gjykatat - ofron interpretime kushtetuese dhe ndërveprimi midis këtyre aktorëve politikë prodhon ligjin kushtetues. Tipari dallues për konstitucionalizmin popullor është qëndrimi se gjykatat nuk kanë prioritet normativ në këtë bashkëbisedim ndërveprues, i cili sipas rastit mund të përfundojë me pranimin e vendimeve gjyqësore nga legjislativi, ekzekutivi dhe vetë populli, kurse në raste të tjera, në zbatimin e politikave të legjislativit dhe ekzekutivit, duke injoruar “mallkimet” dhe/ose “ofendimet” që hedhin mbi ta gjykatat dhe partizanët e supremacisë së gjyqësorit. Konstitucionalizmi popullor i përngjan luftës midis “tiranisë së mazhorancës” dhe “zbatimit gjyqësor të Kushtetutës”<sup>157</sup>.

Doktrina e konstitucionalizmit popullor, edhe pse rishfaqet si një debat i kohëve moderne, rrënjët i ka në SHBA, në kohën përpara hartimit të Kushtetutës federale, kohë në të cilën konsiderohej si diçka e zymtë, e shpërndarë, e paqartë dhe me disa kuptime. Revolucioni i Lavdishëm i vitit 1688 është përgjigja e qartë dhe prova për lindjen e konstitucionalizmit popullor para Revolucionit Amerikan. E drejta kushtetuese në këtë periudhë përfshiu ndikimin e vetë popullit mbi rregullimin e çështjeve që kishin të bënin me zyrtarët publikë, pasi ligjshmëria ishte e domosdoshme, sepse lidhej me autoritetin. Në këtë periudhë ekzistonin përpjekje për gjetjen e një rregulli që t'i jepte dikujt pushtetin për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të sigurt dhe përfundimtare. Konstitucionalizmi i shekullit XVIII ishte më pak i shqetësuar për zgjidhje të shpejta dhe të qarta dhe nocioni i tij për ligjshmërinë ishte më pak i ngurtë dhe më i shpërndarë, tolerues i mosmarrëveshjeve të vazhdueshme mbi interpretime të besueshme të Kushtetutës, por me vullnet për t'i dhënë pushtetin një ideje aq të pa fokusuar sa “vetënjerëzit”. Pas Revolucionit Amerikan konstitucionalizmi mori një formë të re për shkak të Neneve të

<sup>157</sup> Mark V. Tushnet, *Popular Constitutionalism as a political law*, Chicago-Kent Law Review, vol.80, 2006, fq.999

Konfederatës si dhe për shkak të kushtetutave të reja të shteteve, por në Kohën e Themelimit, kushtetutat e reja të shkruara nuk e përfshinë kuptimin e hershëm të së drejtës kushtetuese si “popullore dhe jo ligj i zakonshëm”, ndërsa, në shekullin XVIII, kuptimi i rolit të popullit në ndryshimet kushtetuese ishte i ndryshëm nga kuptimi i sotëm. Procesi i ndryshimeve kushtetuese nuk kishte për qëllim të kufizonte pushtetin e hartimit të kushtetutës nga njerëzit, por përkundrazi synonte “të respektonte dhe të siguronte autoritetin popullor mbi kushtetutat”<sup>158</sup>.

Po në këtë periudhë u pranua se edhe kontrolli gjyqësor kishte lindur shumë më herët se çështja *Marbury kundër Madison*, e cila përsëriti argumentet e përpunuara në vendimmarrjet e mëparshme<sup>159</sup>. Megjithatë, edhe praktika me e hershme e kontrollit gjyqësor kishte pak ngjashmëri me kontrollin gjyqësor të ditëve të sotme, pasi ai më i hershmi nuk ishte veprim i interpretimit të ligjit të zakonshëm, por ishte veprim politik. Gjyqtarët, kur refuzonin zbatimin e ligjeve jo kushtetuese, ushtronin autoritetin e popullit për të rezistuar, duke siguruar një zgjidhje shtesë për aktet legjislative të nxjerra *ultravires*, çka parandalonte nevojën për mobilizimin e kundërshtisë popullore. Në mes të viteve 1790, kontrolli gjyqësor ishte popullor dhe mbizotërues dhe do t'i jepte jetë një doktrine modeste, në të cilën, në përputhje me thelbin e konstitucionalizmit popullor, gjyqtarët vepronin si agjentë të popullit.<sup>160</sup>

Për konstitucionalistët popullorë sot, roli i popullit nuk kufizohet në aktet rastësore të hartimit të Kushtetutës, por përfshin kontrollin aktiv dhe të vazhdueshëm mbi interpretimin dhe zbatimin

<sup>158</sup> Larry Alexander & Lawrence B. Solum, *Popular Constitutionalism: The People Themselves: Popular Constitutionalism and Judicial Review*, Harvard Law Review, 2005, f.1594-1640.

<sup>159</sup> *Shih vendimet në çështjet: Hollingsworth v. Virginia* (3 U.S. (3 Dall.) 378 (1798), *Hayburn's Case*, 2 U.S. (2 Dall.) 408 (1792), *Hylton v. United States*, 3 U.S. (3 Dall.) 171 (1796), *Ware v. Hylton*, 3 U.S. (3 Dall.) 199 (1796), *Cooper v. Telfair*, 4 U.S. (4 Dall.) 14 (1800) përmenden në literaturën bashkëkohore si shembuj të pranimit dhe zbatimit të doktrinës së kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së akteve legjislative dhe traktateve ose të procedurave administrative përpara vitit 1803.

<sup>160</sup> Kramer, shënim 4, f.964.

e ligjit kushtetues. Ky pushtet nuk u është lënë ekskluzivisht dhe përfundimisht gjykatave, por qëndron te politika dhe te “*vetë populli*”. Me fjalë të tjera, populli mban autoritetin në administrimin e përditshëm të ligjit themelor, në kontrast me konstitucionalizmin ligjor, i cili ia transferon gjyqësorit autoritetin përfundimtar të interpretimit dhe zbatimit të ligjit themelor.<sup>161</sup> Kjo dëshirë dhe, njëkohësisht, qëllim i përbashkët i konstitucionalistëve popullorë për reduktimin e kontrollit gjyqësor, mendohet se mund të arrihet duke eliminuar tërësisht kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë, për të kthyer vendimmarrjen kushtetuese te njerëzit, të cilët veprojnë politikisht<sup>162</sup>. Konstitucionalistë të tjerë popullorë mbrojnë idenë e mos eliminimit të kontrollit gjyqësor, por të zhvlerësimit të veprimeve të degëve të qeverisjes dhe respektimit gjyqësor më të madh të zgjedhjeve të shumicës, me argumentin se ndryshimi midis vendimit të gjykatës dhe vendimit të legjislaturës (federale) ose të elektoratit nuk është një ndryshim në procedurën e vendimmarrjes, por është një ndryshim i një shumice prej nëntë anëtarësh (të Gjykatës Supreme) krahasuar me një shumicë votuese që numëron qindra (për zgjedhjet e përgjithshme) ose miliona zgjedhës (elektorati i Shteteve)<sup>163</sup>. Një qasje e tretë është ajo kundër “zgjidhjes përfundimtare gjyqësore” dhe “supremacisë gjyqësore”, që mbron idenë se çdo degë e qeverisjes duhet të interpretojë Kushtetutën dhe çdo interpretim është njësoj detyrues, ndërsa gjykatat nuk kanë të drejtën e vlerësimit përfundimtar<sup>164</sup>.

Parë në këndvështrimin historik, evolucioni i doktrinës së konstitucionalizmit popullor dhe përplasjet e mëpasshme me pushtetin e gjykatave për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve ose traktateve me kushtetutën e bëjnë të kuptueshme përpjekjen e konstitucionalistëve popullorë për një dimension të ri të rolit të vetë

<sup>161</sup> Larry D. Kramer, *People themselves: popular constitutionalism and judicial supremacy*, California Law Review, 2004, f.959-1011.

<sup>162</sup> Ibid, f.1000

<sup>163</sup> Ky grup përfaqësohet nga Jeremy Waldron, Profesor në New York University of Law, SHBA dhe kërkues në fushën e të drejtës kushtetuese, filozofisë së të drejtës dhe teorisë politike

<sup>164</sup> Erwin Chemerinsky, *In defense of judicial review; the perils of popular constitutionalism*, University of Illinois Law Review, 2004, f. 673-690.

popullit. Megjithatë, kjo doktrinë krahas përfaqes moderne mbi rolin e individit, i përngjan më shumë një përpjekjeje nostalgjike mbi të kaluarën e lavdishme të këtij autoriteti. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e individit në procesin kushtetues, në kushtet e supremacisë gjyqësore të konsoliduar, mbetet e diskutueshme sa në aspektin parimor aq dhe në atë praktik.

## 2. Modele të konstitucionalizmit popullor<sup>165</sup>

Raporti ndërmjet autoritetit të një kushtetute, identitetit të saj dhe metodologjive të mundshme të interpretimit është i një rëndësie të veçantë. Nëse autoriteti buron prej pranimit nga qeveria, atëherë potencialisht identiteti i kushtetutës mund të ndryshojë nga momenti në moment, sepse varet prej asaj që pranohet si autoritet supreme. Identiteti i një kushtetute mund të duket, gjithashtu, i pandarë prej faktit se cila metodologji interpretimi është e drejtë dhe interpretimi i kujt duhet të konsiderohet autoritar. Këto lidhje të mundshme midis autoritetit legjitim, identitetit dhe interpretimit tregojnë se debati lidhur me interpretimin kushtetues dhe kontrollin gjyqësor duhet të fokusohet në atë çfarë pranohet dhe çfarë duhet të pranohet si autoritet suprem<sup>166</sup>. Mungesa e një emëruesi të përbashkët në qëndrimet e konstitucionalistëve popullorë mbi autoritetin përfundimtar interpretues, natyrshëm ka çuar në krijimin e disa modeleve të kësaj shkolle mendimi ligjor, bazuar në: (i) sa e lehtë ose e vështirë duhet të jetë për aktorët jashtëgjyqësorë të përmbysin interpretimin gjyqësor; (ii) cilët aktorë duhet të luajnë rol kryesor për të arritur këtë qëllim.<sup>167</sup>

*Modeli i parë* është “*Konstitucionalizmi Popullor Modest*”, mbështetësit e të cilit, në përgjithësi, refuzojnë idenë se populli ose përfaqësuesit e tij mund të injorojnë vendimin gjyqësor, thjesht për shkak se nuk janë dakord me të. Ata pranojnë se gjykatat, herë

<sup>165</sup> Pozen, David, *Judicial elections as popular constitutionalism*, Columbia Law Review, 2010, fq. 2060

<sup>166</sup> Larry Alexander, *Constitutionalism: Philosophical basis*, Cambridge University Press, 2005, fq.1

<sup>167</sup> Pozen, shënim 10, f. 2060

pas here, mund të shfuqizojnë ligje ose të kundërshtojnë zgjedhjet ose preferencat e mazhorancës, në përmbushje të rolit kushtetues që u është ngarkuar. Gjithsesi, për të siguruar se ky qëndrim nuk e ndërpret bashkëbisedimin midis aktorëve, pra që vendimet gjyqësore nuk e zëvendësojnë mobilizimin popullor si makinë e ligjberjes, ata insistojnë se aktorët jashtëgjyqësore luajnë një rol aktiv, të ndërgjegjshëm në artikullimin, kundërshtimin dhe kodifikimin e normave kushtetuese si mënyrë për t'u përfshirë në jetën politike. Ky model kategorizohet si “konstitucionalizëm popullor” sepse i jep vlerë angazhimit politik të popullit në çështje kushtetuese dhe “modest” sepse nuk sfidon në mënyrë direkte institucionin e kontrollit gjyqësor apo karakterin përfundimtar të vendimeve gjyqësore. Thelbi i këtij modeli qëndron te “ndryshimi në sjellje” nga degët e politikës, të cilave u kërkohet t'i kushtojnë seriozitetin e duhur interpretimit kushtetues dhe të zbatojnë dënimet kushtetuese me ose pa udhëzime gjyqësore. Kurse popullit i kërkohet të refuzojë pikëpamjen mbi Kushtetutën si një koncept legalist, i pandryshueshëm ose përtej njohurive të tyre. Njëkohësisht, aktorët jogjyqësorë nuk duhet ta shohin Gjykatën e Lartë si një “orakull” me monopolin e të vërtetës kushtetuese, por duhet të ndjekin më nga afër punën e saj, ta kritikojnë kur nuk janë dakord me të dhe të ndërmarrin veprime kur ndajnë mendime të ndryshme. Me pak fjalë, ky model i kërkon popullit të përqafojë në masë më të gjerë “lirinë aktive” që hartuesit e Kushtetutës kërkuan t'ua besonin atyre. Në këtë kuptim, konstitucionalizmi popullor modest mund të përkufizohet si një “tonifikues” për pasivitetin dhe injorancën që përshkronë kaq shumë kulturën kushtetuese.<sup>168</sup>

*Modeli dytë* është “*Konstitucionalizmi Popullor Robust*”, i cili e tkurr fushën e interpretimit gjyqësor të detyrueshëm dhe, në këtë mënyrë, autoriteti interpretues i popullit merr vlerë krahasuar me atë të gjyqësorit sa herë populli është i gatshëm dhe dëshiron ta përdorë atë. Ky model jo vetëm inkurajon përshtatjen e Kushtetutës ndaj disa formave aktive dhe të qëndrueshme, por u jep prioritet pikëpamjeve të personave që përfshihen në këtë proces dhe po ashtu, kërkon jo vetëm të zhvendosë supremacinë gjyqësore, por, gjithashtu, edhe vendimet

<sup>168</sup> Ibid, f.2061.

gjyqësore si norma mbizotëruese në kulturën kushtetuese. Rasti tipik do të përfshinte një përpjekje të përbashkët të qytetarëve të zakonshëm për të përmbushur besimin e tyre kushtetues, përmes ushtrimit të së drejtës së organizimit ose të tubimeve, të cilat mund të ishin efektive për t'u dhënë përgjigje pyetjeve ligjore të veçanta dhe të drejtpërdrejta. Për të realizuar bindjet e tij popullit do t'i duhet, përgjithësisht, të veprojë përmes institucioneve ndërmjetëse të tilla si organizatat civile, partitë politike dhe degët e zgjedhura të qeverisjes. Përsa kohë këto institucione janë konsideruar se u përgjigjen më shumë qytetarëve sesa gjykatat, modeli në fjalë synon të ndryshojë autoritetin interpretues në drejtim të institucioneve. Me këtë frymë, disa mbështetës të konstitucionalizmit popullor<sup>169</sup> përkrahin idenë e braktisjes së kontrollit gjyqësor, duke sugjeruar vazhdimësi formale, por pakësim funksional të tij, bazuar në parimin se është e pranueshme jo vetëm kritika ndaj argumentit kushtetues që paraqitet nga gjyqtarët, por gjithashtu edhe mosbindja ndaj tyre. Kjo do t'i jepte hapësira lirie legjislativitetit dhe ekzekutivitetit të impononin pikëpamjet e tyre mbi atë se çfarë kërkon Kushtetuta<sup>170</sup>.

*Modeli i tretë* është emërtuar “*Departamentalizëm*” dhe fokusohet jo vetëm te “populli”, por edhe tek institucionet politike që ata krijojnë. Ky model i referohet idesë se degët e koordinuara të qeverisjes gëzojnë autoritet të pavarur për interpretimin e Kushtetutës. Ky autoritet i veçantë bën të mundur që secila degë të ushtrojë kontroll ekskluziv mbi fusha interpretimi të veçanta dhe, në këtë mënyrë, evitohet mbivendosja dhe interpretimet, potencialisht, konfliktuese mbi të njëjtën çështje. Për rrjedhojë, legjislativi dhe ekzekutivi njihen si ekspozues të kuptimit kushtetues dhe zbatues të normave kushtetuese. Autorët që mbështesin konstitucionalizmin popullor pranojnë ndikimin e departamentalizmit në dy drejtime: *së pari*, në ndryshimin dhe zgjerimin e debatit mbi kuptimin kushtetues duke paraqitur zëra të rinj të fuqishëm krahas atyre ekzistues dhe *së dyti*, në fuqizimin e popullit në debat duke fuqizuar rolin interpretues të agjentëve të zgjedhur kundër zërit të anëtarëve të pazgjedhur (Gjykatës së Lartë në SHBA).

<sup>169</sup> Tushnet, Waldrom.

<sup>170</sup> Pozen, shënim 10, f.2062.

Krahas tri modeleve të mësipërme, akademikët kanë përpunuar edhe modelin e "Konstitucionalizmit Popullor Ndërmjetësues", sipas të cilit gjyqësori luan një rol të rëndësishëm në identifikimin e atyre vlerave kushtetuese, që marrin mbështetje të gjerë popullore me kalimin e kohës. Edhe pse ky nuk është ekskluzivisht roli i gjyqësorit, nisur nga funksionet që kryejnë degët e ndryshme të qeverisjes një detyrë e tillë i takon, gjerësisht, atij. Mbi të gjitha, degët politike të qeverisjes po ngarkohen gjithmonë e më shumë me parashikimin dhe plotësimin e dëshirave të popullit, kurse gjyqtarët, nga ana tjetër, shprehin me "po" ose "jo" ndaj veprimeve të degëve popullore, bazuar në interpretimin kushtetues të kërkesave kushtetuese. Në ushtrimin e pushtetit të kontrollit gjyqësor, gjyqtarët bazohen (ose duhet të bazohen) në vlerat ekzistuese të shoqërisë. Por ajo çka harrojnë ata të cilët ankohen për kontrollin gjyqësor është fakti se në përputhje me konceptin e konstitucionalizmit popullor, vetoja gjyqësore duhet të pranohet nga gjykimi popullor me kalimin e kohës. Vendimet gjyqësore nuk duhet të jenë menjëherë popullore ose të pranuar, pasi kjo është mënyra përmes të cilës "ndërmjetëson" konstitucionalizmi popullor. Të ndash preferencat e menjëhershme nga vlerat ekzistuese kushtetuese kërkon kohë, ndërkohë që pyetja që shtrohet është nëse një vendim gjyqësor do të fitojë ose jo mbështetje popullore përmes reflektimit.<sup>171</sup>

Ekzistenca e modeleve të ndryshme të konstitucionalizmit popullor është tregues i mungesës së një përjasje të njëjtë ndaj rolit që duhet të ketë populli si mbajtës dhe ushtrues i autoritetit suprem të interpretimit kushtetues. Edhe pse emëruesi i përbashkët për konstitucionalistët popullorë është dëshira për të reduktuar kontrollin gjyqësor, mënyra sesi synohet të arrihet ky qëllim, i shprehur në thelbin e modeleve, përçon një ndjesi pasigurie mbi mundësinë e realizimit të qëllimit të tyre dhe mbi vetë seriozitetin e kësaj iniciative. Roli i popullit, ndërsa duhet të jetë ai i autoritetit suprem, vjen i zbehur dhe i fshehur nën hijen ose mbështetjen e autoriteteve të tjera interpretuese, çka të bën të mendosh se

<sup>171</sup> Barry Friedman, *Mediated Popular Constitutionalism*, Michigan Law Review, 2003, f. 2596-2636.

mungon një ide tërësisht e kristalizuar mbi mënyrën sesi funksionon praktikisht konstitucionalizmi popullor dhe, për këtë arsye, përjasjet tingëllojnë parimore dhe abstrakte.

### 3. Mekanizmat e konstitucionalizmit popullor

Pavarësisht kundërshtive të vazhdueshme ndaj doktrinës së konstitucionalizmit popullor, përfaqësuesit e kësaj të fundit nuk kanë reshtur për asnjë çast së përpunuar teza, ide, qëndrime për ta bërë të pranueshme atë. E nëse do të ndodhte një ditë kështu a mund të imagjinohet në kohët moderne konstitucionalizmi popullor apo, e thënë ndryshe, një sistem plebishitar, i vërtetë, i fuqishëm, ku pyetjet e natyrës kushtetuese bëhen në mënyrë të njëtrajshme dhe të përsëritur nga populli?

Nëse tej argumenteve hipotetike, abstrakte dhe parimore, dikush do të pyesë a ekziston ndonjë mekanizëm për të konkretizuar konstitucionalizmin popullor, në formën autoritare pa qenë anarkik, i aksesueshëm nga masat përmes ndërmjetësimit nga profesionistët, transformues, por realist, përgjigja që do të merrte është pozitive. Nëse në mendje dikujt i vjen mekanizmi kushtetues i ndryshimit të Kushtetutës, sigurisht që ky proces nuk është asnjëherë i mjaftueshëm dhe rishikimet formale janë shumë të rralla dhe të vështira për të siguruar kontroll popullor të vazhdueshëm mbi administrimin e të drejtave themelore. Nëse ndryshimet do të ishin lehtësisht të arritshme, atëherë askush nuk do të ndiente kaq ankth për supremacinë gjyqësore.

Alternativat e mundshme të përfshirjes së popullit, sipas konstitucionalistëve popullorë, përfshijnë nga ato më të butat dhe pa objektiv në vetvete (edukimi civil, kundërshtimi i normës, lëvizjet e advokacisë, retorika presidenciale) në ato më të ngadalta dhe të shkëputura (tubime, mosfinancim i gjykatave, moszbatimi i vendimeve të tyre, zhveshja nga juridiksioni). Megjithatë, këto alternativa sërish vlerësohen si modeste, me përdorim dhe mbështetje të gjerë, por me pak efikasitet, sepse marrin shumë kohë dhe pushtet politik për arritjen e rezultateve. Nga ana tjetër, alternativat radikale

nuk kanë krijuar shumë mbështetës dhe kjo për arsye të dukshme, sepse t'i japësh vlerë mosbesimit të gjykatat përbën dëm serioz për qëndrueshmërinë, parashikueshmërinë, zbatimin e të drejtave, objektiva këto që duhet të përmbushen nga gjykatat.<sup>172</sup>

Pavarësisht këtyre shqetësimeve, konstitucionalistët popullorë ndihen të sigurt për suksesin e doktrinës së tyre për shkak të ekzistencës së një mekanizmi sistemik dhe të përhapur, i cili mund t'i japë jetë zbatimit praktik të konstitucionalizmit popullor. Ky mekanizëm ka ekzistuar për pothuaj dy shekuj dhe përkufizohet si i vetmi institucion popullor që ka lidhje me gjykatat (në SHBA dhe jo vetëm), i cili është instituti i zgjedhjeve të gjyqtarëve në nivelin e Shteteve në përbërje të Federatës. Zgjedhjet përkufizohen si momente kritike për shprehjen e sovranitetit aktiv dhe të vazhdueshëm të popullit; si një mekanizëm përgjegjshmërie dhe instrument praktik për përkthimin e sovranitetit në arritje konkrete, për të siguruar se Kushtetuta përfaqëson një dialog dhe, veçanërisht, opinionin publik, si agjent i ndryshimit kushtetues. Zgjedhja e gjyqtarëve në një mënyrë periodike u jep qytetarëve një mjet të fuqishëm përmes të cilit ata vlerësojnë interpretimet e tyre si dhe një mundësi të vazhdueshme për të nxitur dhe strukturuar vendimmarrjen kushtetuese. Nëse zgjedhjet nuk cenojnë natyrën përfundimtare të vendimeve dhe kushtet e punës së gjyqtarëve, atëherë ato përbëjnë mekanizmin më të përshtatshëm për të krijuar lidhjen midis qytetarëve dhe vendimmarrjes, duke mundësuar pjesëmarrjen publike, duke pakësuar pretendimet e gjyqtarit heroik, përfshi dhe supremacinë e popullit ndaj gjykatave. Gjykatat (e Shteteve) zgjidhin më shumë çështje, ato ushtrojnë funksionet tyre në raport të afërt me njerëzit; ecin në të njëjtin hap me zhvillimet e së drejtës kushtetuese në çështje që lidhen me martesat midis të njëjtës gjini, të drejtat e mirëqenies, financimin e edukimit; luajnë një rol, jo vetëm drejtues në detajimin e kushtetutave, por edhe domethënës në interpretimin dhe zbatimin e Kushtetutës (Federale)<sup>173</sup>.

Studiues dhe akademikë të tjerë argumentojnë se asgjë nuk e pengon rolin domethënës që mund të luajë populli në interpretimin

<sup>172</sup> Pozen, shënim10, f.2050.

<sup>173</sup> Ibid, f.2051.

kushtetues. Individët mund të prezantojnë mënyrën se si ata e lexojnë Kushtetutën, të ndërmarrin veprime si votimi, peticionet, tubimet, të cilat i japin formë asaj çka aktorët e qeverisjes besojnë dhe shprehen për Kushtetutën. Ata mund të zgjedhin ligjvënësit (e shteteve dhe ata federalë), të cilët mund të marrin iniciativën për ndryshimin e Kushtetutës. Ata mund të zgjedhin një President dhe një Senat, të cilët mund të përdorin procesin e emërimeve për të ndryshuar përbërjen e gjykatave federale dhe, për rrjedhojë, edhe orientimin e tyre. Megjithatë, duke e kundërshtuar tezën e konstitucionalistëve popullorë, ata shprehen se ende nuk ka ndonjë mekanizëm formal përmes të cilit vetë populli të përcaktojë drejtpërdrejt ose të vendosë për kuptimin e Kushtetutës. Ndërsa populli mund të ndërmarrë aksione në situata të jashtëzakonshme, në përgjithësi, ata janë vëzhgues të procesit të përditshëm të interpretimit të Kushtetutës. Vetë populli nuk disponon kohën ose dëshirën për të shqyrtuar çdo interpretim kushtetues dhe, për rrjedhojë, ta vlerësojë atë.<sup>174</sup>

Kundërshtarët e konstitucionalizmit popullor mbrojnë tezën se as mbështetësit e kësaj shkolle të mendimit ligjor nuk e kanë diskutuar kurrë një sistem të tillë ku populli, në mënyrë të njëtrajshme dhe të përsëritur, vendos për kuptimin e Kushtetutës, ndoshta sepse një sistem i tillë plebishitar nuk ka bazë kushtetuese. Asnjë nga veprimet popullore që trumbetojnë konstitucionalistët popullorë nuk i jep mundësi popullit të përcaktojë rregullisht kuptimin e Kushtetutës. Votimi popullor është episodik, zgjedhja e zyrtarëve federalë çdo dy, katër ose gjashtë vjet nuk mund të bëjë të mundur qartësimin e normave kushtetuese komplekse, pasi votimet nuk janë shumë të shpeshta që të shërbejnë si mënyrë për të zgjidhur qindra çështje të kundërshtuara të së drejtës kushtetuese. Në teori, peticioni dhe tubimet nuk prezantojnë të njëjtat vështirësi si votimi. Vetë populli mund të hartojë peticione ose të tubojë për të kundërshtuar ose për të mbrojtur çdo interpretim kushtetues zyrtar. Megjithatë, disa rrethana kombinohen në mënyrë të tillë që e bëjnë këtë “interpretim” popullor të papëlqyeshëm dhe me disa kuptime, çka do të thotë se do të jetë e pamundur që të dallohet kuptimi “popullor”

<sup>174</sup> Saikrishna Prakash & John Yoo, *Against Interpretive Supremacy*, Michigan Law Review 2005, fq.1539

për çdo normë kushtetuese. Po ashtu, dyshohet se më pak individë ushtrojnë të drejtën e peticionit dhe tubimit krahasuar me ata që ushtrojnë të drejtën e votës, si një detyrë civile. Madje në ditët e sotme, shumë pyetje mbi çështje kushtetuese nuk shkaktojnë ndonjë emocion popullor të mjaftueshëm për të bërë peticione apo për t'u tubuar, çka është tregues se për shumicën e çështjeve kushtetuese, populli nuk do të dalë në rrugë.<sup>175</sup>

Nëse sjelljet e popullit do të reflektonin kërkesat që imponon kultura kushtetuese, si një faktor vendimtar, përcaktues dhe nxitës i mënyrave të reagimit popullor dhe ndjeshmërisë ndaj çështjeve të ndryshme kushtetuese, atëherë jo vetëm konstitucionalistët popullorë do të kishin arritur pjesërisht misionin e tyre, por edhe kundërshtarët e kësaj doktrine do të ishin të kënaqur me faktin e ndërgjegjësimit popullor dhe veçanërisht të tonifikimit të pasivitetit dhe të injorancës popullore. Përsa kohë qytetarët do të jenë të bindur se Kushtetuta nuk është thjesht një tekst me norma të shkruara, por një "dokument i gjallë", një tërësi normash të cilat jetojnë bashkë me ta dhe orientojnë jetën e tyre drejt një zhvillimi të vazhdueshëm, atëherë zëri i individit ose i "vetë popullit" mund të jetë vendimtar për t'u dhënë jetë ndryshimeve dhe autoritetin suprem të merituar.

#### 4. Konstitucionalizmi popullor versus supremacisë gjyqësore

Lufta midis konstitucionalizmit popullor dhe kontrollit gjyqësor tashmë zgjat prej dekadash. Kontrolli gjyqësori referohet shfuqizimit të ligjeve të nxjerra gjatë një procesi të rregullt legjislativ, sepse ato bien ndesh me ligjin më të lartë, tipikisht, kushtetutën ose traktatet, proces që ndryshe njihet si kontrolli gjyqësor i ligjit më të lartë. Kontrolli gjyqësor nuk siguron përputhje midis ekzekutivit me parimet politike të sjelljes së drejtë, që, para së gjithash, është detyrë e Parlamentit përmes mekanizmave të ndryshëm të përgjegjësive,

<sup>175</sup> Ibid, f.1542.

me anë të të cilave ai realizon funksionin e kontrollit të sjelljes së ekzekutivit. Kontrolli gjyqësor nuk ka të bëjë as me vendosjen dhe sigurimin e parimeve burokratike të "administrimit të mirë", por është një nga mekanizmat e kontrollit të përgjegjësive që përbëjnë rrjetin e dendur të sistemeve të "kontrollit, trajtimit të ankimeve, vendosjes së standardeve, mbikëqyrjes dhe vlerësimit". Sipas modelit të interesit publik, kontrolli gjyqësor shpreh aspiratën për një shoqëri më të drejtë. Sipas modelit të shtetit të së drejtës, kontrolli gjyqësor promovon vizionin e një raporti të drejtë midis qeverisësve dhe të qeverisurve. Sipas modelit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, kontrolli gjyqësor përfshin parime me rëndësi politike për krijimin e institucioneve. Kontrolli gjyqësor mund të përmbushë funksione simbolike jo instrumentale thjesht duke ekzistuar dhe duke qenë në dispozicion. Ky lloj kontrolli është simbolikisht i rëndësishëm për vetë vlerat që ai përmban dhe mbron.<sup>176</sup>

Pushteti i kontrollit gjyqësor nuk përmendet në asnjë nen të Kushtetutës së SHBA-ve, megjithatë, John Marshall, në rastin *Marbury v. Madison*, bëri të mundur lindjen e argumentit bindës se klauzola e supremacisë së Kushtetutës dhe pushteti i Gjykatës Supreme për të vendosur mbi çështjet justifikon ushtrimin e kontrollit gjyqësor. Studiuesit kanë diskutuar me forcë nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ishte t'i jepnin Gjykatës këtë pushtet dhe bazuar në argumentet e tyre, lindën tri shkolla të mendimit ligjor. *Shkolla e parë* mbron qëndrimin se hartuesit nuk synonin një pushtet të kontrollit gjyqësor, se ky lloj kontrolli ishte i padëgjuar dhe kishte vetëm disa precedentë të papërfunduar. Por edhe nëse hartuesit e Kushtetutës synonin që këtë pushtet impresionues ta ushtronte Gjykata Supreme, natyrisht, do ta kishin parashikuar shprehimisht këtë synim. Me fjalë të tjera, nuk ekzistojnë baza kushtetuese për qëndrimin se kur nuk ka konflikt të qartë midis një akti të Kongresit dhe një norme të shprehur kushtetuese, gjyqtarët mund të ndryshojnë pikëpamjet e tyre me ato të përfaqësuesve të zgjedhur nga populli. Për rrjedhojë, edhe pse mund të jetë e arsyeshme të nënkuptosh një ushtrim të ngushtë të kontrollit

<sup>176</sup> Peter Cane, *Understanding judicial review and its impact*, Cambridge University Press, 2004

gjyqësor për shkak të natyrës së pushteteve të ndara, nuk është veçse abuzim me pushtetin nga ana e Gjykatës për të shfuqizuar aktet legjislativë që cenojnë vetëm një doktrinë gjyqësore që interpreton në mënyrë të vakët përmbajtjen e normave kushtetuese<sup>177</sup>.

*Shkolla e dytë e mendimit* argumenton se hartuesit e trashëguan konceptin e kontrollit gjyqësor nga koncepti i konstitucionalizmit dhe prisnin nga Gjykata që të ushtronte këtë pushtet në raste të rralla kur Kongresi do të tejkalonte kufijtë e tij kushtetues. Arsyeja e mosparashikimit shprehimisht të kontrollit gjyqësor në Kushtetutë është thjesht për shkak të pushteteve të prezumuara dhe detyrimit të anëtarëve të Kongresit për t'iu bindur ligjit. Për më tepër, është e arsyeshme të pranosh se hartuesit besonin se ndarja e pushtetit legjislativ midis Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit do të siguronte se asnjë legjislacion, i cili dukshëm binte ndesh me Kushtetutën nuk do të miratohej nga të dy dhomat e Kongresit dhe se, nëse rastësisht kjo do të ndodhte, me siguri Presidenti do të ushtronte të drejtën e vetos. Garantuesi i Kushtetutës, natyrisht, do të ishte Gjykata dhe se ky ishte synimi i hartuesve.<sup>178</sup>

*Një shkollë e tretë e mendimit* mbron qëndrimin se shumë hartues nuk u menduan shumë për kontrollin gjyqësor të akteve legjislativë dhe se koncepti, në rastin më të mirë, ishte në fazat e formatimit të tij. Shumë prej hartuesve nuk e konsideruan seriozisht mundësinë se Kongresi dhe Presidenti do të cenonin qëllimisht ligjin më të lartë të vendit dhe, për rrjedhojë, kontrolli gjyqësor nuk ishte çështje për ta. Natyra e pasigurt e konceptit të kontrollit gjyqësor mbi aktet e kongresit në vitet e para karakterizohet nga deklaramë të kujdesshme të gjyqtarëve në çështjet e para të rëndësishme në të cilat ata vendosën në lidhje me kushtetutshmërinë e akteve të Kongresit<sup>179</sup>. Hartuesit dhe miratuesit e Kushtetutës dhe të ndryshimeve kushtetuese që pasuan do të luftonin për zhvillimin e një koncepti të gjerë të kontrollit gjyqësor për shkak të përfshirjes të frazave jo të qarta dhe rezultat të

<sup>177</sup> Sheldon Goldman, *Constitutional Law, Cases and Essays*, Second Edition, 1991, f.158-160.

<sup>178</sup> Letrat e Federalistit 78

<sup>179</sup> Shih çështjen "Hylton kundër SHBA"

papërcaktuar. Ushtrimi i një koncepti të gjerë të kontrollit gjyqësor ka stimuluar mosmarrëveshje të vazhdueshme midis studiuesve dhe gjyqtarëve, debat i cili shtrihet edhe në terma të aktivizimit përballë kufizimit ose një strukture të gjerë të Kushtetutës përballë një strukture të ngushtë.<sup>180</sup>

Natyra e shpërndarë e konstitucionalizmit popullor e kombinuar me pasigurinë për mënyrat me të cilat ai shprehej krijuan hapësira për mbijetesën e supremacisë gjyqësore dhe mbështetjen e saj nga elita e profesionit ligjor. Me kalimin e kohës, edhe pse rezultati ishte një luftë dialektike, konservatorët dhe liberalët arritën marrëveshje në lidhje me parimin e supremacisë gjyqësore, duke marrë të mirëqenë faktin se u takonte gjyqtarëve të bënin interpretimin, i cili do të ishte përfundimtar dhe i detyrueshëm. Megjithatë, nuk u eliminuan mosmarrëveshjet lidhur me juridiksionin dhe, më tepër, për teknikën që duhet të përdornin gjyqtarët në interpretimin e tekstit kushtetues. Ishte pikërisht ky momenti kur ideja e konstitucionalizmit popullor u vanit<sup>181</sup> dhe konstitucionalistët popullorë e përkufizuan "supremacinë gjyqësore" si armikun e tezës që ata mbronin<sup>182</sup>.

Sot, ata pretendojnë për një botë ku gjykatat janë të përgjegjshme për interpretimin e Kushtetutës sipas gjykimit të tyre më të mirë, por edhe të ndërgjegjshme se ekziston një autoritet më i lartë që ka pushtetin për të ndryshuar vendimet e tyre, një autoritet aktual dhe jo disa individë abstraktë për të cilët flitej njëqind ose dyqindvjet më parë, të cilët prej vitit 1980 u zhdukën për shkak të supremacisë gjyqësore që "u bë norma" dhe pasiviteti qytetar nënprodukti i saj. Qytetarët e humbën interesin për rolin që luan bindja popullore në interpretimin kushtetues, pasi një kushtetutë juricentrike çon në shtrirjen e gjyqësorit dhe pasivitetin e qytetarëve dhe, të dyja, së bashku, kërcënojnë elementet e rëndësishme të kulturës kushtetuese. Edhe pse populli mund të sigurojë një Kushtetutë që u korrespondon vlerave të tij, besimi i popullit në imagjinimin dhe ndjekjen e këtyre

<sup>180</sup> Goldman, shënim 22, f.158-160

<sup>181</sup> Kramer, shënim 4, f.962-963.

<sup>182</sup> Larry D. Kramer, *The Supreme Court, 2000 Term – Foreword: We the Court*, 115 Harvard Law Review, 4, 13, 2001.



vlerave varet në masë jo të vogël në kufijtë që ata i përcaktojnë të drejtës kushtetuese.<sup>183</sup>

Raporti midis konstitucionalizmit popullor dhe supremacisë gjyqësore është analizuar nga shumë studiues, të cilët kanë arritur në konkluzionin se supremacia gjyqësore nuk do të thotë se gjykatat janë veshur me pushtetin për të ndikuar mbi besimin që qytetarët kanë mbi Kushtetutën. Po ashtu, supremacia gjyqësore nuk ka kuptimin e autorizuesit të gjykatave për të ndaluar qytetarët në përpjekjet e tyre për t'i siguruar autoritet ligjor besimit të tyre kushtetues. Në këtë kuptim, supremacia gjyqësore dhe konstitucionalizmi popullor, më tepër se dy sisteme reciprokisht përjashtues të rendit kushtetues, duhet të kuptohen si forma të dallueshme dhe konkurruese të rendit kushtetues. Megjithatë, disa forma të vendimeve gjyqësore janë thelbësore për shtetin e së drejtës, i cili është i nevojshëm në një demokraci funksionale. Në këtë vështrim, studiuesit bien dakort për ekzistencën e tensionit të thellë midis supremacisë gjyqësore dhe konstitucionalizmit popullor, por përsëri gjenden ndërvarësi jetësore midis të dy koncepteve, pasi janë të lidhur në mënyrë dialektike dhe kanë bashkekzistuar për një kohë të gjatë. Çështja më e rëndësishme, sipas këtij grupi studiuesish, është t'i japësh përgjigje pyetjes se si kombi mund të gjejë një baraspeshë praktike midis shtetit të së drejtës dhe autoritetit të tij (popullit) për të ngritur zërin për çështje me natyrë kushtetuese<sup>184</sup>. Rreziku i supremacisë gjyqësore nuk qëndron te mohimi i autoritetit të popullit për të vendosur mbi çështje të caktuara, por në faktin se ata do të heqin dorë nga përfshirja energjike dhe e fuqishme në procesin e vetëqeverisjes kushtetuese. Edhe nëse popullit i takon fjala e fundit mbi kuptimin e Kushtetutës, çka padyshim është kështu, ata nuk do të jenë dakord me vendimet e Gjykatës për një kohë jo shumë të gjatë, e për rrjedhojë, do të humbasin motivacionin e nevojshëm dhe vullnetin për pjesëmarrje civile<sup>185</sup>

<sup>183</sup> Ibid, 4, 13, 2001.

<sup>184</sup> Robert Post dhe Reva Siegel mbështesin tezën e Kramerit se e drejta kushtetuese mund të gjejë legjitimitetin në kulturën kushtetuese të aktorëve jashtëgjyqësorë, ndërkohë që nuk bien dakord me përkufizimin e tij për raportin midis konstitucionalizmit popullor dhe supremacisë gjyqësore.

<sup>185</sup> Robert Post dhe Reva Siegel, shënim 9, f.1042-1043.

Qytetarët sot jetojnë në kohën e supremacisë gjyqësore, qoftë kjo supremaci interpretuese apo supremaci vendimi<sup>186</sup>. Supremacia gjyqësore nënkupton se gjyqësori përcakton kuptimin e Kushtetutës në mënyrë të tillë që i gjithë kombi duhet të pranojë mënyrën se si gjyqësori e lexon Kushtetutën. Bazuar në këtë version ekstrem të supremacisë gjyqësore është jo vetëm detyra, por edhe e drejta e gjyqësorit për të përcaktuar kuptimin e Kushtetutës. Populli ka hequr dorë gjerësisht nga autoriteti kolektiv për të përcaktuar kuptimin e Kushtetutës. Edhe pse historia është mbushur me shembuj të rezistencës popullore dhe qeveritare ndaj interpretimeve gjyqësore të Kushtetutës, ka pasur raste në të shkuarën kur brezat e vetë qytetarëve arritën në përfundimin se kuptimi i Kushtetutës shkon përtej aftësisë së tyre për të kuptuar diçka që u duhej lënë të tjerëve.<sup>187</sup> Megjithatë, nëse qytetarët mund të kundërshtojnë aktivisht një vendim, kjo do të varet nga fakti nëse ata mendojnë se vendimi është legjitimim dhe qëndrimet e tyre lidhur me legjitimitetin varen jo vetëm nga rënia dakord ose jo me vendimin e Gjykatës, por edhe nga fakti nëse ata ndihen titullarë të kundërshtimit dhe, më e rëndësishmja, të veprimit.<sup>188</sup>

## Konkluzione

Kuptimi i Kushtetutës buron nga argumentet që prezantohen në kontradiktoritet dhe nga opinione gjyqësore, të cilat, së bashku, përbëjnë kulturën ligjore. Interpretimet gjyqësore duhet të vlerësohen jo vetëm në mënyrë konvencionale, por si përpjekje për të nxjerrë kuptim nga dokumenti dhe si shprehje konkrete e kulturës intelektuale të juristëve dhe gjyqtarëve, si në aspektin e stilit analitik ashtu dhe të atij komunikues. Interpretimet kushtetuese kanë rëndësi për një sërë politikash, përfshi ato që lidhen me martesat, marrëdhëniet prind-fëmijë, abortin, administrimin publik, praktikat policore, ndihmën ndaj arsimimit privat, shpifjen, të huajt, gratë, votimin, veprimin

<sup>186</sup> Prakash and Yoo, shënim 19, f.1539-1566.

<sup>187</sup> Pozen, shënim10, f.2055.

<sup>188</sup> Kramer, shënim4, f. 974.

afirmativ etj.<sup>189</sup>

Dëshira e popullit për të marrë pjesë dhe për të qenë një zë i fortë në vendimmarrje mbetet evidente pavarësisht formës së qeverisjes apo organizimit shtetëror. Por në një botë që po ecën me ritme të shpejta drejt globalizimit, veçanërisht atij ligjor, është e vështirë të kesh pritshmëri si ato të konstitucionalistëve popullorë që lidhen me zhvendosjen e autoritetit interpretues nga gjykatat te populliapo në ushtrimin prej tij të funksionit të hartuesit të sistemeve apo politikave ose të artikulesit dhe zbatuesit të vlerave kushtetuese, funksione që u janë ngarkuar bartësve legjitimë të supremacisë gjyqësore. Por nga ana tjetër, është po aq e vërtetë se nuk ka asnjë pengesë që qytetarët të jenë pjesë e këtij procesi kaq jetësor përmes ushtrimit të të drejtave të tyre kushtetuese, madje këto të fundit do të shfaqeshin në dimensionin e tyre të vërtetë dhe do të përmbushnin thelbin e tyre. Padyshim që kontrolli gjyqësor do të mbetet kompetenca kryesore e gjykatave, qofshin supreme apo kushtetuese, të cilat do të vazhdojnë të garantojnë vlerat kushtetuese themelore përmes procesit të interpretimit që përbën çelësin e suksesit të jurisprudencës së tyre. Ndërkohë, sa më shumë populli të jetë i ndërgjegjësuar për rëndësinë e çështjeve kushtetuese, për nevojën e një rendi kushtetues të qëndrueshëm, për rolin që ata mund dhe duhet të kenë në këtë drejtim, aq më shumë do të jetë me vlerë zëri i popullit në forcimin e shtetit të së drejtës ku supremacia e kontrollit gjyqësor është një nga elementët kryesorë.

Doktrina e konstitucionalizmit popullor duket se e ka të vështirë të gjejë mbështetjen e duhur në realitetin amerikan dhe më gjerë, apo mekanizmat e përshtatshëm për të qenë e suksesshme ashtu siç synohet nga mbështetësit e saj jo të paktë. Megjithatë, pavarësisht suksesit të munguar, në një mënyrë apo tjetër kësaj doktrine duhet t'i njihet një vlerë e rëndësishme që ka të bëjë me ndërgjegjësimin e popullit për të mos qenë i pamotivuar, jo energjik, për të rigjetur vullnetin e humbur që i mundëson atij pjesëmarrjen aktive në jetën civile. Në fund të fundit, zgjedhjet e zgjuara bëhen nga popuj të kulturuar.

<sup>189</sup> Nagel, shënim 14, f.2.

## Referenca:

1. Alexander, L. & Solum, L. Book Review, *Popular Constitutionalism: The People Themselves: Popular Constitutionalism and Judicial Review*, Harvard Law Review, Vol. 118, No. 5, 2005.
2. Alexander, L. *Constitutionalism: Philosophical Foundations*, Cambridge University Press, 2005.
3. Cane, P. *Understanding judicial review and its impact*, Cambridge University Press, 2004.
4. Canon, B. "Constitutional Culture: Policies in the United States: Conceptual and methodological approaches, 1989.
5. Chemerinsky, E. In defense of judicial review; the perils of popular constitutionalism, University of Illinois Law Review, 2004.
6. Chemerinsky, E. In difence of judicial revieë; a reply to Professor Kramer, California Law Review, 2004.
7. Friedman, B. *Mediated Popular Constitutionalism*, Michigan Law Review, Vol. 101, No. 8, Symposium: Judging Judicial Review: Marbury in the Modern Era, 2003.
8. Goldman, Sh. *Constitutional Law, Cases and Essays*, Second Edition, 1991.
9. Kramer, L. *The Supreme Court, 2000 Term – Foreëord: We the Court*, Harvard Laë Review, 2001.
10. Kramer, L. *The people themselves: the popular constitutionalism and the judicial review*, California Law Review, vol.92, no.4, 2004.
11. Nagel, R. *Constitutional Culture: The mentality and consequences of the judicial review*, University of California Press, 1989, chapter 7, 1989.
12. Pozen, D. *Judicial elections as popular constituionalism*, Columbia Law Review, 2010.
13. Prakash, S. & Yoo, J. *Against Interpretive Supremacy: Larry D.Kramer Book revieë, The People Themselves: Popular Constitutionalism and Judicial Review*, Michigan Law Review, Vol. 103, No. 6, 2005.
14. Tushnet, M. *Popular constitutionalism as political law*, Chicago-Kent Law Review, vol.80, 2006.

## **ASPEKTE DHE PROBLEME TË MARRËDHËNIEVE JURIDIKE CIVILE**

MA. Rasim DODA

### **HYRJE**

Doktrina juridike, marrëdhëniet juridike civile i përkufizon si marrëdhënie që vendosen midis personave, të cilët dalin në këto marrëdhënie si mbajtës të së drejtës subjektive dhe detyrimeve juridike civile. Marrëdhëniet juridike civile janë pjesë e kompromisit, vullnetit që vendosin subjektet e së drejtës, me qëllim realizimin e objektivave të tyre në fusha të ndryshme të veprimtarisë ekonomike dhe shoqërore.

Nga kjo nxjerrim përfundimin, se marrëdhëniet juridike civile bazohen mbi marrëdhëniet kapitaliste në prodhim, shkëmbim dhe shpërndarjen e të mirave materiale ose jo materiale.

Marrëdhënie juridike civile, janë vetëm ato marrëdhënie shoqërore, të cilat ligji i rregullon përmes normave të së drejtës.

Pra marrëdhëniet juridike civile janë ajo pjesë e marrëdhënieve shoqërore që legjislatori, për shkak të rëndësisë që ato kanë në veprimtarinë njerëzore, i ka rregulluar me norma juridike të cilat gjejnë pasqyrim në ligjin material civil.

Kjo formë rregullimi, garanton palët pjesëmarrëse për ekzekutim të pasojave që burojnë nga një marrëdhënie juridike civile konkrete.

Palët në një marrëdhënie juridike civile janë të garantuara nga

ligji për realizimin e interesave të tyre që rrjedhin nga marrëdhënia.

Ligji në këto raste jo vetëm garanton të drejtat, por edhe nxit palët të përmbushin detyrimet, pasi në të tilla raste një të drejtë i korrespondon të paktën një detyrim dhe e kundërta.

Këto norma juridike konkretizohen në jetën shoqërore, pikërisht me anë të marrëdhënieve juridike civile, nëpërmjet krijimit, ndryshimit ose të shuarjes së të drejtave dhe detyrimeve.

### **1. Kuptimi i marrëdhënieve juridike civile**

**1.1** Marrëdhëniet juridike civile, duke qenë se lindin nga një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur me ligj, mbartin në vetvete zakonet e mira dhe filozofinë e ligjit.

Ligjin, filozofet e konsiderojnë: “...si rregullore dhe masë aktesh përmes të cilave, njeriu ftohet (grishet) të veprojë ose kufizohet në veprime, sepse ligji (lex) rrjedh nga angazhimi (ligare), sepse angazhon dike që të veprojë. Mirëpo, rregullorja dhe norma e veprimit njerëzor është arsyeja e cila është parimi i parë i veprave njerëzore...”.

Në vlerësimin e interesave të kundërta, interesi që mbështetet më mirë në arsye dhe që meriton më shumë të mbrohet nga ligji, në një rast konflikti që lind gjatë përmbushjes së një marrëdhënieje juridike civile, duhet ndihmuar që të fitojë.

Kjo frymë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike civile, ndikon në zgjidhjen si të drejtë të çështjes dhe në konsolidimin e një praktike të drejtë.

Marrëdhëniet juridike rregullohen nga normat e së drejtës, por në shumicën e rasteve në përmbajtjen e tyre, ato shprehin vullnetin e personave ose të palëve.

Arsyeja e ekzistencës së të drejtës, qëndron në karakterin e perjetshëm kontradiktor, që mbart bashkëjetesa njerëzore: në konfliktet që lindin brenda asaj forme elementare të bashkëjetesës në familje ose në konfliktet e mëdha që kanë përshkuar shoqërinë, në kontradiktën midis njerëzve për përfitimin e burimeve natyrore dhe

në atë për ndarjen e pasurisë së krijuar. Funkzioni i të drejtës qëndron mbi të gjitha, në ndalimin e përdorimit të dhunës për zgjidhjen e konflikteve, që do të thotë në zgjidhjen e konflikteve me anë të zbatimit të rregullave të paracaktuara, të cilat vendosin se cila midis interesave në konflikt është e arsyeshme për t'u mbrojtur dhe cila duhet të humbë.

Ky sistem rregullash ndryshon në kohë dhe në hapësirë. Ky është dhe shpjegimi se pse çdo etapë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka pasur rregullat e saj, megjithëse gjejmë elemente të vazhdimësisë nga një epokë në tjetrën.

**1.2** Këto fakte po i ilustrojmë me një vendim të Gjykatës së Strasburgut.

1-Jahn dhe të tjerë kundër Gjermanisë, 22 janar 2004 dhe 30 qershor 2005.

Gjykata e Strasburgut përfshihet në debatin nëse privimi nga prona pa asnjë kompensim përbën apo jo shkelje të së drejtës së pronës. Kërkuesit janë pesë shtetas gjermanë dhe jetojnë në Gjermani.

Ata kishin trashëguar parcela toke, të cilat iu ishin dhënë familjeve të tyre pas reformës agrare të vitit 1945 në zonën e pushtimit rus të Gjermanisë.

Pas ribashkimit të Gjermanive, disa individë<sup>190</sup> që kishin trashëguar troje pas reformës agrare, përfshirë këtu edhe kërkuesit, iu kërkua që, në bazë të amendamentit të dytë të Ligjit mbi të Drejtat Pasurore të 14 korrikut 1992, t'jua transferonin pronësinë e tyre, autoriteteve tatimore të Landit të tyre pa kompensim. Ky ligj, parashikonte që personat që trashëgonin troje në sajë të reformës agrare, por që nuk kishin punuar në sektorët e bujqësisë, pemëtarisë ose prodhimit ushqimor deri më 15 mars 1990 ose gjatë dhjetë vjetëve të mëparshme, apo që nuk kishin qenë anëtarë të një kooperative bujqësore në RDGJ, duhet t'ia transferonin trojet autoriteteve tatimore.

<sup>190</sup> Vendimi nr. 19, datë 19.06.2006 i Gjykatës Kushtetuese. Vendimi "Krombach kundër Francës", datë 03.02.2000, jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Botim i Qendrës Europiane, 2005, f.390.

Gjykata, në lidhje me këtë pretendim është shprehur: "Cilado të ketë qenë pozita e tyre përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Modrow, ata e kishin fituar ligjërisht pronësinë e plotë të trojeve në bazë të këtij ligji, i cili ishte miratuar nga parlamenti i RDGJ-së dhe ishte bërë pjesë përbërëse e së drejtës së brendshme gjermane pas bashkimit të Gjermanive."<sup>191</sup>

Për rregullimin e marrëdhënieve në një shoqëri të caktuar sipas së drejtës, është e domosdoshme ekzistenca e një autoriteti suprem, të cilit duhet t'i njihet autoriteti i krijimit të rregullave për zgjidhjen e konflikteve dhe një pushtet tjetër i ndarë nga i pari që të ketë si atribut kontrollin e zbatimit të këtyre rregullave në konfliktet që lindin në çdo rast.

Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen. Faktet për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga palët në dobi së të cilës është prezumimi.

Rregullat ligjore që i kanë rezistuar kohës në etapa të ndryshme të shoqërisë tregojnë për kohezionin, saktësinë dhe largpamësinë që ka pasur legjislatori në momentin e miratimit të tyre.

Stabiliteti juridik, ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore të vendit ku ata veprojnë.

Kultura, tradita, shkenca dhe teknika si dhe marrëdhëniet në prodhim janë katalizator i stanjacionit ose ndryshimit të normave juridike që veprojnë.

Ndjeshmëria e ligjeve, varet tërësisht nga marrëdhëniet shoqërore, të cilat nxisin progresin ekonomik, shoqëror të një vendi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.

Kjo e drejtë e individit për të fituar me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

<sup>191</sup> Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve zyrtare, mars 2002, Neni 13, f. 14. Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006 i Gjykatës Kushtetuese. Livio Paladini, "Diritto Costituzionale" CEDAM, Padova, 1991, f. 166-175.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet të kuptohet si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj.

Mund të themi se në shtete me demokraci të konsoliduar, në shumicën e marrëdhënieve juridike qëndron vullneti njerëzor, që do të thotë, që edhe pse marrëdhëniet juridike rregullohen nga ligji (në kuptimin formal) dispozitat ligjore priren për të qenë dispozita lejuese me qëllim që palët në përputhje me kërkesat dhe interesat e tyre, të futen në marrëdhënie juridike civile. Në thelb marrëdhëniet juridike, ndryshojnë nga marrëdhëniet shoqërore për faktin se marrëdhënieve juridike, normat e së drejtës iu japin fuqi detyruese, zbatimimi i tyre bëhet i detyrueshëm.

E drejta, lind si rezultat i besimit të vlerat, por në vetvete mbart karakterin detyrues. Kjo do të thotë se respektimi i kushteve të parashikuara në një marrëdhënie juridike të lidhur, në të cilën palët janë futur me dëshirën e tyre, nëse nuk respektohen detyrimet që burojnë prej saj vepron sanksioni i parashikuar në ligjin material civil, i cili të detyron të respektohet të drejtat e tjetrit<sup>192</sup>.

Megjithatë, në demokracitë moderne forca e saj nuk qëndron te pushteti, por te konsensusi (vullneti). Në themel të nismave që ndërmerren nga gjigantë të prodhimit të të mirave materiale, qëndron kompromisi, konsensusi.

## 2.Elementet e marrëdhënies juridike civile

**2.1** Në vetvete marrëdhënia juridike civile është abstrakte, ajo ngjason me një rast të përgjithshëm (hipotetik), e cila merr trajtë konkrete, vetëm atëherë kur subjektet hyjnë në këto marrëdhënie.

Marrëdhëniet juridike, janë marrëdhënie shoqërore të rregulluara nga normat e së drejtës, me qëllim që pjesëmarrësit të jenë ligjërish të disponueshëm për t'i përmbushur.

<sup>192</sup> Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, çështjet "Qufaj" kundër Shqipërisë ose çështja "Bageta" kundër Italisë.

Marrëdhëniet juridike civile nisur nga natyra e tyre kanë karakter pasuror ose vetjak jo pasuror që vendoset ndërmjet personave, dhe rregullohen nga normat e së drejtës civile<sup>193</sup>.

Këto të fundit, duke rregulluar një marrëdhënie shoqërore pasurore ose vetjake jo pasurore nuk krijojnë një marrëdhënie juridike civile, por ato janë kusht i domosdoshëm për lindjen e një marrëdhënieje juridike civile, pasi nuk mund të ketë marrëdhënie juridike në qoftë se marrëdhënia shoqërore nuk është e rregulluar nga norma juridike.

Normat e së drejtës, shërbejnë për t'u dhënë mundësi personave, që hyjnë në marrëdhënie juridike të ndryshme të jenë të mbrojtur nga arbitrariteti, i cili mund të shfaqet në formën e veprimit ose mosveprimit të palëve që veprojnë në një marrëdhënie juridike.

Rregullat, janë ato norma formale ligjore që drejtojnë gjyqtarin për t'iu përgjigjur fakteve të paraqitura të një rasti të dhënë në një mënyrë të përcaktuar dhe duke bërë përlllogaritje<sup>194</sup>.

Në të kundërt, standardet janë ato norma ligjore formale që drejtojnë gjyqtarin, të përshtatë vendimin gjyqësor sipas fakteve të një rasti të veçantë.

Marrëdhënia juridike civile ka elementet e saj.

Me elemente të marrëdhënies juridike kuptohen ato karakteristika apo rrethana, të cilat janë të domosdoshme për ekzistencën e marrëdhënies juridike, pa të cilat ajo nuk mund të lindë, krijohet dhe ekzistojë.

Duke mos e krijuar marrëdhënien juridike civile, ligji parashikon rrethanat, kushtet në të cilat ajo mund të lindë, të ndryshohet dhe shuhet.

Por, që të lindë një marrëdhënie juridike civile duhet të ekzistojë vullneti, dëshira e palëve pjesëmarrëse në këtë marrëdhënie.

**2.2** Marrëdhënia juridike civile në përbërjen e saj ka tre elemente të rëndësishme: subjektet, objekti dhe përmbajtja.

### 2.3 Subjektet e marrëdhënies juridike civile.

<sup>193</sup> Monografi - autor Andrea Nathanaili, f.21.

<sup>194</sup> Benxhaman N. Kardozo, Natyra e procesit gjyqësor.

Të tillë janë personat fizike, juridikë, të cilët mund të marrin pjesë në një marrëdhënie juridike civile si mbajtës të drejtash dhe detyrimesh civile.

Subjekte të marrëdhënies juridike civile janë personat fizikë dhe juridikë, të cilët duhet të plotësojnë disa kriterë ligjorë për të qenë palë pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike.

Kriter themelor, është që këta persona duhet të kenë zotësi juridike për të vepruar, pra ata duhet të kenë personalitet juridik.

Në marrëdhëniet juridike civile, personat që marrin pjesë në të duhet të jenë jo më pak se dy, në të kundërt nuk mund të ekzistojë marrëdhënia juridike civile.

Person fizik është një individ i caktuar, një njeri konkret, që është mbajtës i pakufizuar i kapacitetit juridik.

Një person fizik (njeriu) që të jetë subjekt i marrëdhënies juridike duhet të plotësojë dy kushte: të ketë zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar. Zotësinë juridike e ka çdo person fizik, pasi ajo lind së bashku me njeriun (që lind i gjallë) dhe përfundon me vdekjen biologjike të tij.

Përsa i përket zotësisë për të vepruar, që një person ta fitojë atë duhet, të plotësojë dy kriterë themelore, të cilat janë: kriteri juridik dhe ai mjekësor.

I pari ka të bëjë me arritjen e një moshe të caktuar, ndërsa kriteri i dytë lidhet me zhvillimin normal mendor të individit.

Person juridik është çdo subjekt i së drejtës, i ndryshëm nga personi fizik, çdo entitet i aftë të shprehë vullnet, por i ndryshëm nga individi konkret. Këto kategori personash, kanë grupimet e tyre të cilat bëjnë identifikimin e tyre.

Personat juridikë, janë formacione shoqërore kolektive që krijohen dhe organizohen në mënyrën e përcaktuar në ligj.

Persona juridikë shtetërorë dhe persona juridikë privatë.

Kategoria e parë: Personat juridikë shtetërorë, ndryshojnë nga ata privatë për faktin se të parët përfaqësojnë një organizëm shtetëror në një fushë të caktuar, ndërsa të dytët përfaqësojnë iniciativa private.

E përbashkëta e tyre mund të lidhet me fushën në të cilën ata e

ushtrojnë aktivitetin.

Shpërblimi i drejtë, në kuadrin e Nenit 41 të Konventës, analizohet edhe në lidhje me një çështje, ku Gjykata kishte vendosur më parë për shkelje të Nenit 6 dhe 1 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit 1 të saj.

Kërkuesi në këtë çështje, është një shtetas rumun, Dan Brumarescu, pensionist, i lindur më 1926 dhe që jetonte në Bukuresht<sup>195</sup>.

Më 1950 shtëpia e prindërve të kërkuesit në Bukuresht u shtetëzua, pa u shoqëruar me

kompensim përkatës. Më 9 dhjetor 1993, gjatë procedurave të ngritura nga kërkuesi, gjykata e shkallës së parë të Bukureshtit vendosi se shtetëzimi kishte qenë i paligjshëm.

Gjykata në vendimin kryesor të 28 tetorit 1999, konstatoi shkelje të Nenit 6 të Konventës (e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe gjykimi i drejtë) dhe Nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtje të së drejtës së pronësisë) se nuk kishte vendosur mbi çështjen e shpërblimit të drejtë.

Gjykata (Dhoma e Madhe) vendosi me unanimitet se shteti përgjegjës duhet t'i kthejë kërkuesit, brenda gjashtë muajve, shtëpinë për të cilën bëhej fjalë në çështje dhe truallin në të cilin ajo ishte ndërtuar...".

Në kontekstin e shoqërive demokratike e drejta, ligji, paraqitet si një nga mekanizmat qendrorë më të rëndësishëm, që garanton pjesëmarrjen e popullsisë në qeverisjen e vendit, si dhe si një rezultat i qeverisjes në formën e vendimeve legjislativë e lidhur me standardet e demokracisë.

Në marrëdhënien juridike numri i personave mund të jetë i ndryshëm, por gjithmonë jo më pak se dy persona. Ata mund të jenë mbajtës të drejtash dhe detyrimesh juridike civile, por ka raste të tjera që ai mund të jetë vetëm mbajtës të drejtash ose vetëm mbajtës detyrimesh<sup>196</sup>.

<sup>195</sup> *Brumarescu kundër Rumanisë (kërkesa numër 28342/95)* 23 janar 2001. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.

<sup>196</sup> Kodi Civil, Neni 469.

Në rast se jemi përpara rastit të fundit, emërtimi i subjekteve bëhet në vartësi të të drejtave dhe detyrimeve.

Personit të cilit i takon e drejta quhet kreditor, ndërsa personi që i ngarkohet detyrimi quhet debitor.

Gjatë kohëvazhdimet të një marrëdhënieje juridike civile, mund të ndodhë që subjektet të ndryshojnë duke u zëvendësuar.

Zëvendësimi i palëve në marrëdhënien juridike quhet suksedim.

Suksedimin e kemi suksedim të përgjithshëm ose universal, suksedim të veçantë ose singular.

Suksedimi universal ndodh në ato raste kur zëvendësimi i personit bëhet në të gjitha marrëdhëniet juridike civile, ku ai ka qenë palë. Ky zëvendësim nuk mund të bëhet vetëm në rastet kur përmbushja e detyrimit juridik civil është e lidhur ngushtësisht me cilësitë personale të subjektit ose në rastet kur ligji e ndalon një gjë të tillë.

#### **2.4 Përmbajtja**

Përmbajtja e marrëdhënies juridike civile është tërësia e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve që marrin pjesë në marrëdhënien juridike civile.

Të drejtat dhe detyrimet e palëve, përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënies juridike civile. Të drejtat dhe detyrimet civile që përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënies juridike civile, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, pasi të drejtës së njëjës palë i përgjigjet, korrespondon detyrimi i palës tjetër dhe anasjelltas.

Përmbajtja e të drejtave mund të zbulohet vetëm me anë të detyrimit juridik përkatës, po ashtu si kundër edhe përmbajtja e detyrimit, përcaktohet nga përmbajtja e së drejtës.

Mundësitë juridike të mbajtësit të së drejtës quhen të drejta subjektive.

Në vetvete e drejta subjektive është mundësia juridike e mbajtësit të së drejtës subjektive për të kryer vetë veprime të caktuara si dhe mundësia për të kërkuar nga personi i detyruar kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara, mundësi kjo e garantuar me

mundësinë për të kërkuar në rast nevojë, mbrojtje ligjore me qëllim që mbajtësi i së drejtës subjektive të kënaqë interesat e tij të ligjshme.

Ushtrimi i të drejtave ka kurdoherë formën e saj të jashtme, e cila është e dukshme, që do të thotë se çdo situatë juridike i korrespondon një gjendje fakti, e cila nuk është gjë tjetër veçse veshja e dukshme e situatës juridike<sup>197</sup>.

Kjo tregon se këto dy kategori në shumicën e rasteve i korrespondojnë njëra-tjetrës.

E drejta objektive është një premisë për të drejtën subjektive, pasi parashikon kushtet e lindjes dhe të realizimit të së drejtës subjektive dhe mënyrën e mbrojtjes së tyre.

Nisur nga ky arsyetim, mund të themi se e drejta subjektive civile është një mundësi juridike, e cila njihet dhe garantohet nga shteti, ndërsa e drejta subjektive është mundësia juridike që njihet nga e drejta objektive, si mbajtës i të drejtës subjektive për të kryer veprime.

Përmbajtja e marrëdhënies juridike civile, është quajtur elementi kryesor i marrëdhënies, pasi është ky element që e dallon atë nga marrëdhëniet e tjera shoqërore. Në kushte normale, të drejtat dhe detyrimet e palëve në një marrëdhënie juridike civile, lindin në të njëjtën kohë dhe si burim të vetëm kanë faktin juridik.

Palët futen në një marrëdhënie juridike civile, me qëllim për të realizuar interesa të caktuara të ligjshme, nëpërmjet njohjes nga ligji të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimit.

Detyrimi juridik civil, është veprimi ose mosveprimi i caktuar i parashikuar në ligj që do të thotë se nëse ai, nuk përmbushet në mënyrë vullnetare nga subjekti i detyrimit, zbatohet në mënyrë të detyrueshme nga organet e shtetit, në bazë të kërkesës së subjektit së

<sup>197</sup> 2.5 Objekti i marrëdhënies juridike civile mund të jetë i ndryshëm. Në një marrëdhënie juridike civile të caktuar, objekti i saj mund të jetë një ose disa sende ose veprime. Për shembull: Në kontratën e shitjes objekt nuk është vetëm sendi që do të shitet, por edhe paratë që do të merren nga pronari i sendit në formën e çmimit të sendit. E drejta subjektive, përbëhet nga tërësia e normave juridike civile, të cilat përcaktojnë normat e sjelljes së palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike civile.

të drejtës konkrete.

Duhet të kuptojmë faktin se e drejta subjektive nuk mund të kuptohet pa detyrimin e një ose disa personave, pasi sa herë bëhet fjalë për të drejtë kuptojmë dhe detyrim. Në marrëdhëniet juridike civile, e drejta dhe detyrimi nuk mund të ekzistojnë apo të kuptohen pa njëra-tjetrën.

Detyrimi juridik civil është ajo masë e sjelljes që duhet të mbahet nga personi i detyruar dhe që është parashikuar nga vetë norma juridike civile<sup>198</sup>

Subjekti i detyruar, duke përmbushur kërkesat e parashikuara në normën juridike, jo vetëm realizon detyrimin që buron nga marrëdhënia juridike civile, por edhe plotëson kërkesat dhe interesat e së drejtës subjektive civile.

Në teorinë e së drejtës civile, është pranuar se e drejta subjektive civile dhe detyrimi janë dy aspekte të kundërta së të njëjtës marrëdhënie juridike civile, në kuadrin e së cilës ato lindin dhe veprojnë.

Objekt i marrëdhënies juridike civile mund të jetë kryerja ose moskryerja, (shmangia e personit nga kryerja e një veprimi), kryerja e një pune si dhe shpërblimi i dëmit.

Me objekt të marrëdhënies juridike civile do të konsiderohet çdo gjë mbi të cilën drejtohen të drejtat subjektive dhe detyrimet juridike korresponduese.

Gjithashtu, objekt i marrëdhënies juridike mund të jenë edhe të drejtat jo materiale, si e drejta e emrit, e drejta e autorit dhe e patentës.

Për trajtimin e objektit të marrëdhënies juridike ne do t'u referohemi elementeve përbërëse të saj, ku me kryesorët janë veprimet ose mosveprimet e njerëzve, sendet, produktet e krijimtarisë intelektuale dhe të drejtat vetjake jo pasurore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë gjykuar çështjen civile me palë pjesëmarrëse – paditës: Gjon Ndreca, i paditur: Zef Ndreca, me objekt: lirim të banesës së blerë me kontratën e shitjes

<sup>198</sup> Andrea Nathanaili, E drejta civile (Pjesa e Përgjithshme).

numër 225, koleksioni datë 15.04.1998 dhe detyrimin e të paditurit ta njohë pronar të ligjshëm.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendimin nr. 499, datë 14.12.2004 ka vendosur: pranimin e kërkesë padisë.

Gjykata e Apelit Shkodër me Vendimin nr. 226, datë 20.05.2005 ka vendosur prishjen e Vendimit nr. 499, datë 14.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë më datë 24.10.2008 e ka kaluar çështjen për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore.

Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme është i vlefshëm në rast se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79,663,659 të Kodit Civil”<sup>199</sup>.

Gjithashtu, gjykata në këtë vendim thekson se “Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri”.

“Paditësi legjitimohet të ngrejë padinë e rivendikimit, nëse ai provon që është pronar mbi pasurinë e paluajtshme me anë të kontratës, trashëgimisë etj.”.

Duhet të nënvizojmë faktin se duke ushtruar një të drejtë të njohur me ligj, një marrëdhënie juridike civile e caktuar shndërrohet, dhe për rrjedhojë, krijohet një marrëdhënie juridike civile e re.

Përfundimisht, mund të themi se objekt i marrëdhënies juridike civile do të konsiderohet çdo gjë mbi të cilën drejtohen të drejtat

<sup>199</sup> Vendimi nr.1, datë 06.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përmbledhje vendimesh unifikuese të Gjykatës së Lartë 2000-2010.



subjektive dhe detyrimet juridike civile korresponduese, që personat që janë subjekt të së drejtës, kanë në këtë marrëdhënie juridike civile.

Objekt i marrëdhënies juridike civile është objekti, të cilit i drejtohen veprimet, ku pjesëmarrësit janë të detyruar të kryejnë ose moskryejnë veprime të caktuara.

Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të marrëdhënies juridike civile, tërësia e të cilave përbën përmbajtjen e saj, drejtohen mbi një objekt të caktuar, pa të cilin nuk mund të kuptohet marrëdhënia juridike civile dhe as që mund të ekzistojë.

Nga kjo nxirret si përfundim, se objekt i marrëdhënies juridike civile quhet çdo gjë mbi të cilën drejtohen të drejtat subjektive dhe detyrimet që i përgjigjen.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, parashikon një shumëllojshmëri objektesh të marrëdhënies juridike civile, ku mund të jenë: sendet, veprimet, punët ose shërbimet, produktet e veprimtarisë intelektuale dhe të mirat vetjake jo pasurore.

### 3. Llojet e marrëdhënieve juridike-civile

#### *3.1 Një marrëdhënie juridike civile mund të ketë më shumë se një objekt konkret në të cilën palët marrin pjesë.*

Teoria e së drejtës civile, ka arritur të bëjë një analizë dhe klasifikim të hollësishëm të marrëdhënieve juridike civile në këto kategori.

- Marrëdhënie juridike civile pasurore dhe marrëdhënie juridike civile vetjake jo pasurore.
- Marrëdhënie juridike absolute dhe marrëdhënie juridike civile relative.
- Marrëdhënie juridike reale dhe marrëdhënie juridike detyrimi.
- Marrëdhënie juridike civile trashëgimore.
- Marrëdhënie juridike civile shndërruese ose potestative.

#### *3.2 Marrëdhëniet juridike civile pasurore dhe marrëdhëniet juridike civile jo pasurore.*

Marrëdhënie juridike pasurore konsiderohen ato marrëdhënie juridike civile të lidhura drejtpërdrejtë me pasurinë, me marrëdhëniet e pronësisë, me marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet juridike të trashëgimisë.

#### *3.3 Marrëdhëniet juridike vetjake jo pasurore.*

Marrëdhënie të tilla, konsiderohen ato marrëdhënie juridike civile, që kanë të bëjnë më të mira jo materiale, jo pasurore, të cilat nuk mund të tjetërsohen dhe që janë të lidhura ngushtësisht me personin të cilit i përkasin, qoftë ky person fizik ose juridik.

Këto lloj marrëdhëniesh kanë të bëjnë me të drejta vetjake, si e drejta e emrit, e autorit, e shpikjes etj. Kjo ndarje ka rëndësi ligjore sepse lidhet me mënyrën e mbrojtjes dhe pasojat që vijnë nga cenimi i së drejtës subjektive.

#### *3.4 Marrëdhëniet juridike civile absolute dhe relative.*

Absolute quhen ato marrëdhënie juridike civile, në të cilat mbajtësi i të drejtës subjektive nuk ka një person të caktuar por një numër të pa caktuar personash.

Vetëm kur vërtetohet fakti juridik i parashikuar nga norma juridike, lind, ndryshohet ose shuhet marrëdhënia juridike civile.

Në përshtatje me këtë, ligji iu jep rrethanave të caktuara vlerën, fuqinë e faktit juridik dhe me vërtetimin e tyre lidh lindjen, ndryshimin ose shuarjen e një marrëdhënie juridike civile si dhe të të drejtave dhe detyrimeve.

Detyrimi i personave të tretë në këtë rast, nuk lidhet me kryerjen e një veprimi të caktuar, por me shmangien nga kryerja e veprimeve që do të cenonin tagrat e mbajtësit të së drejtës subjektive.

Këtu përfshihen marrëdhëniet juridike që burojnë nga e drejta e pronësisë, nga e drejta e trashëgimisë, nga e drejta e autorit dhe nga të drejtat vetjake jo pasurore.

Në këtë rast, në momentin e reagimit, cenimit të së drejtës nga mbajtësi i të drejtës absolute ndaj veprimit të personit të tretë, marrëdhënia juridike prodhon efekt ligjor rehabilitues duke vendosur të drejtën e cenuar.

### ***3.5 Marrëdhëniet juridike civile relative.***

Kjo kategori marrëdhëniesh juridike civile karakterizohet nga fakti që mbajtësit të së drejtës subjektive i përgjigjet detyrimi i një ose disa personave të caktuar. Të tilla janë marrëdhëniet juridike civile kontraktuale ose të detyrimit që burojnë nga shkaktimi i demit.

E drejta e ngritjes së padisë në këto lloj marrëdhëniesh lind që në momentin që mbajtësi i detyrimit duhet të kryente veprimin ose kur ai nuk kryen veprimet që duhet t'i kryente.

### ***3.6 Marrëdhëniet juridike civile reale dhe të detyrimit.***

Marrëdhënie juridike civile reale janë ato marrëdhënie juridike civile, në të cilat mbajtësi i së drejtës subjektive, mund të ushtrojë të drejtat e tij, pa pasur nevojë që të kërkojë kryerjen e veprimeve nga persona të tretë. Këto lloj marrëdhëniesh juridike, kanë si pikë referimi pronësinë dhe të drejta të tjera që burojnë prej saj.

***3.7 Në marrëdhëniet juridike civile të detyrimit,*** përfshihen ato marrëdhënie juridike civile, në të cilat mbajtësi i së drejtës subjektive për të realizuar të drejtën e tij duhet të ndihmohet nga persona të tjerë që janë personat e detyruar pa veprimet e të cilëve, ai nuk mund të ushtrojë tagrat e tij.

Ndryshimi themelor ndërmjet marrëdhënieve juridike reale me ato të detyrimit, është se marrëdhëniet juridike reale kanë për objekt një send të individualizuar, ndryshe nga marrëdhëniet juridike civile të detyrimit që mund të kenë për objekt edhe sende të përcaktuara në gjini ose veprime të tjera që kanë të bëjnë me kryerjen e një pune, shërbimi ose produktet e krijimtarisë intelektuale.

### ***3.8 Marrëdhëniet juridike civile të trashëgimisë.***

Të tilla, janë ato marrëdhënie që lindin për shkak të vdekjes (mortis causa) së personit që është pronar i një pasurie të caktuar dhe që lidhen me kalimin e pronësisë së personit të vdekur (trashëgimlënësit) personave të tjerë (trashëgimtarëve).

Faktet juridike janë burim për lindjen e të drejtave subjektive civile dhe të detyrimeve juridike që i përgjigjen, të cilat përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënies juridike civile. Këto shpesh shërbejnë si katalizator për lindjen e marrëdhënies juridike civile të caktuar.

### ***3.9 Marrëdhëniet juridike civile shndërruese ose potestative.***

Te kjo kategori marrëdhëniesh, ushtruesi i së drejtës nuk ka kundrejt vetes një person të detyruar, nga i cili të kërkojë që ai të kryejë ose të moskryejë një veprim të caktuar në dobi të tij, por disa të tillë.

Këto marrëdhënie nuk ekzistojnë në mënyrë të pavarur, por ato lindin dhe ushtrohen në lidhje dhe në bazë të një marrëdhënieje juridike civile tjetër, ekzistuese, dhe shërbejnë për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike civile me karakter pasuror.

Mbrojtja e të drejtave civile, ndodh në ato raste kur subjektet e marrëdhënies juridike civile nuk përmbushin detyrimet e tyre, atëherë lind nevoja që të mbrohen të drejtat subjektive.

Me mbrojtje të së drejtës subjektive civile kuptohet realizimi i tyre duke përdorur fuqinë shtrënguese të shtetit në rastet kur ato cenohen nga subjekti i detyrimit.

Mbrojtjen e së drejtës subjektive civile e kemi në tre forma: të përgjithshme, të posaçme dhe të jashtëzakonshme.

Mbrojtja e të drejtave subjektive me anë të gjykatës, arbitrazhit ose me ndërmjetësim është mënyra e përgjithshme.

Instrumenti për të vënë në lëvizje gjykatën është padia.

E drejta e padisë, në kuptimin material quhet mundësia e njohur me ligj mbajtësit të së drejtës subjektive civile për të realizuar mbrojtjen e së drejtës së cenuar, duke kërkuar zbatimin e ligjit.

Për të mbrojtur të drejtat civile ka rëndësi edhe prapsimi (exceptio), të cilin e kemi dy llojesh: substancial dhe procedural.

Prapësimi mund të përdoret si mjet mbrojtje, vetëm atëherë kur qëndron brenda objektit të kërkesë padisë.

Në rast se prapësimet dalin jashtë kufijve të objektit të kërkesë padisë, i padituri duhet të përdorë si mjet mbrojtje efikas kundërpadinë.

Mënyra e posaçme ose mënyra administrative.

Mbrojtja e të drejtave subjektive.

#### 4. Realizimi i të drejtave subjektive civile

**4.1** Mbrojtja gjyqësore luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e marrëdhënieve juridike civile nga çdo cenim i të drejtave pasurore ose vetjake jo pasurore.

Kjo mënyrë mbrojtjeje ka rëndësi edhe për faktin tjetër që marrëdhëniet juridike të garantohen nga çdo veprim ose mosveprim i paligjshëm, nga një autoritet gjyqësor siç është gjykata.

Megjithatë, vitet e fundit si rezultat i revolucionarizimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tij me atë ndërkombëtar, është bërë e mundur që çdo mbajtës i të drejtës, i cili mendon se është cenuar nga veprime ose mosveprime të paligjshme mund t' i drejtohet zyrave legale që merren me zgjidhjen e çështjeve jashtëgjyqësisht ose gjykatës së arbitrazhit.

Doktrina juridike civile, ashtu si dhe ligji material civil, vë theksin se marrëdhëniet juridike civile dhe janë një pjesë e marrëdhënieve shoqërore të cilat rregullohen me ligj.

Ndryshimet e shpejta në ekonomi, do të diktojnë një legjislacion më të avancuar në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve juridike civile.

Shkalla e përsosmërisë së legjislacionit në këtë drejtim është e ndërvarur nga niveli i marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore.

Sa më të shpejta të jenë ndryshimet në shoqërinë e një vendi, aq më shpejt do të ndryshojnë normat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridike civile të tij.

#### 4.2 Rëndësia juridike e marrëdhënieve juridike.

Fillimisht, duhet të theksohet fakti që marrëdhëniet juridike civile në historinë e legjislacionit shqiptar, përcaktimin më të konsoliduar e kanë pasur në Kodin Civil të Zogut<sup>200</sup>.

Në këtë kod, janë respektuar të gjitha parametrat ligjorë dhe bashkëkohorë për marrëdhënien juridike civile. Kjo mënyrë e krijimit të marrëdhënieve juridike, u ndërpre për një periudhë 45 vjeçare me vendosjen e regjimit të marrëdhënieve socialiste në vendin tonë.

Në këtë periudhë, sfera e veprimit të marrëdhënieve juridike civile u kufizua shumë dhe si subjekt kryesor i tyre ishte shteti, me subjekte të tjera juridike të komanduara po prej tij.

Pas vitit 1991, me shkatërrimin e marrëdhënieve të ekonomisë së centralizuar, vendin e saj e zuri zhvillimi ekonomik kapitalist. Një revolucion i vërtetë u aplikua edhe në fushën legjislative, ku legjislacioni i vjetër u abrogua dhe vendin e tij e zuri legjislacioni i ri i orientuar në frymën e vendeve perëndimore.

Ky ndryshim thelbësor, u ndje domosdoshmërisht dhe në marrëdhëniet juridike civile.

Marrëdhëniet kapitaliste, që lindën në fushat kryesore të jetës, epiqendër të tyre kanë marrëdhëniet juridike civile.

Zhvillimet e reja në politike dhe ekonomi në mënyrë të padiskutueshme reflektojnë domosdoshmërinë e bërjes së një kompleksi ligjesh bashkëkohore, duke drejtuar ekonominë dhe në tërësi vendin tonë, drejt shtetit ligjor.

Marrëdhëniet juridike civile në këtë vrull ndryshimesh, pësuan një hov të rëndësishëm dhe rrënjësor zhvillimi.

Shumë shpejt, marrëdhëniet juridike civile u ngritën në nivelin e statit që kërkonte zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i vendit.

Mendoj se duke qenë se vendi ynë është në periudhën e tranzicionit dhe marrëdhëniet juridike civile janë të prekura nga kjo periudhë, e cila nuk është shumë produktive për ekonominë dhe stabilitetin ekonomik të vendit.

<sup>200</sup> Kodi Civil i Zogut i vitit 1929.

Evolucioni i marrëdhënieve juridike, po shkon drejt konsolidimit duke ndikuar në ekonominë e vendit dhe duke kontribuar për forcimin e shtetit ligjor.

Ashtu si çdo kategori të së drejtës, doktrina juridike bashkëkohore duke pasur si pikë referimi edhe legjislacionin aktual në këtë fushë, ka arritur të përcaktojë tiparet kryesore të marrëdhënies juridike civile, të cilat janë:

1. Subjektet që marrin pjesë në marrëdhënie juridike civile janë të pavarur nga njëri-tjetri. Kjo do të thotë se pjesëmarrësit e një marrëdhënie juridike civile karakterizohen nga parimi i barazisë. Këtij parimi nuk i zbehet kuptimi edhe në rastet kur njëra palë në një marrëdhënie juridike civile, është vetëm mbajtëse e të drejtave dhe tjetra vetëm mbajtëse e detyrimeve, pasi gjatë realizimit të të drejtës dhe përmbushjes së detyrimit, asnjëra nga palët nuk mund të ndërhyjë në veprimtarinë e palës tjetër.
2. Palët për të siguruar përmbushjen e detyrimeve përdorin masat me karakter pasuror.
3. Marrëdhëniet juridike civile kanë si kusht për lindjen e tyre vullnetin.
4. Dispozitat ligjore përcaktojnë kushtet dhe rrethanat që duhet të ekzistojnë për lindjen e marrëdhënieve juridike si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve, ndërsa marrëdhënia juridike civile krijohet vetëm kur subjektet i ushtrojnë efektivisht të drejtat, kur krijojnë të drejta dhe detyrime të parashikuara në normën juridike.

Marrëdhëniet juridike civile kanë jo vetëm një përhapje të madhe, por edhe larmishmëri të spikatur, të cilat janë në vartësi të zhvillimit me ritme të shpejta të marrëdhënieve kapitaliste në marrëdhëniet e prodhimit dhe shkëmbimit në të gjitha fushat e jetës.

Në gjithë këtë larmishmëri të marrëdhënieve juridike civile, duhet të kemi në konsideratë faktin që ato janë të ndërvarura nga një sërë faktorësh, si ato ekonomikë, politikë, kulturorë dhe socialë të vendit.

Kjo tregon se rritja ekonomike dhe zhvillimi kulturor, janë

përcaktues në shtimin e marrëdhënieve juridike civile.

Në ekonominë kapitaliste, me zhvillimin që mori ky sistem ekonomik dhe shoqëror, lindi nevoja e krijimit të bashkimeve të veçanta të njerëzve<sup>201</sup>.

Që në shekullin XIV u formuan organizmat e lundrimit detar, të cilat u pasuan më vonë me ato industrial, tregtar si dhe bankat të cilat kishin si qëllim të financonin, nëpërmjet kredisë këto subjekte juridike.

Pushteti dhe konsensusi janë kuptime të një debati të përjetshëm rreth së drejtës.

## Përfundime dhe rekomandime

Në marrëdhëniet juridike civile, rol të rëndësishëm luan zbatimi i ligjit ne hapësirën dhe frymën e ndërveprimit të palëve, të cilat kanë si qëllim parësor përmbushjen e interesave të tyre pasurore ose vetjake jo pasurore.

Dhënia e kuptimit të normës juridike dhe përzgjedhja e saj për të realizuar qëllimin e palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike civile, ka të bëjë me interpretimin e ligjit.

Një marrëdhënie juridike civile mund të ndërtohet në forma të ndryshme, që do të thotë mund të jetë e heshtur, e shkruar në një akt zyrtar ose në shkresë të thjeshtë, e folur me zë ose veprime interpretative, ku kuptimi i një fjale ose grup fjalësh, mund të shkaktojë kuptime të ndryshme të palët.

Kjo do të thotë se në marrëdhënien juridike civile subjektet duhet të tregohen jo vetëm të sinqerta për qëllimin e marrëdhënies juridike civile, por ai duhet të shkruhet me një gjuhë të kuptueshme për to.

Marrëdhënia juridike, në disa raste, tejkalojnë parashikimin në ligj. Kjo kërkon që ajo të mos bjerë ndesh me dispozitat urdhëruese të ligjit, në të kundërt, ajo nuk mund të prodhojë pasojat e kërkuara nga palët.

Konteksti i marrëdhënies juridike civile, kërkohet të jetë në frymën që përcjell ligji dhe zhvillimi shoqëror.

<sup>201</sup> Franc S. Galgano, E Drejta Private, f.101.

Në marrëdhëniet juridike civile, palët lypset të përcjellin mesazhe të zhvillimit dhe progresit shoqëror, duke anashkaluar pengesat artificiale dhe të përkohshme, qofshin këta administrative apo shoqërore.

Në raste të veçanta, mjegullimi i të kuptuarit të situatës juridike dhe faktike të shprehur nga palët në marrëdhënie juridike civile, mund të vijë edhe për shkak të paqartësisë së hartuesit të saj, (në rastet kur përshkrimi i marrëdhënies juridike civile nuk i është besuar juristit të duhur).

Për të shmangur dykuptimësinë ose paqartësitë e ndryshme të marrëdhënies juridike civile, instrumenti që përdoret në këto raste është interpretimi. Teoria e të drejtës, bazuar në normat juridike, ka dhënë dy lloje kriteresh të interpretimit, të cilat janë: *interpretimi subjektiv*, i cili bazohet në qëllimin e përbashkët të palëve dhe, në *interpretimin objektiv*, i cili bazohet në mirëbesimin ose elemente të tjera objektive.

Marrëdhëniet juridike civile në Shqipëri për shkak të stadi relativisht të ulët të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike, ende nuk kanë ndjerë hapat e duhura.

Kjo situatë juridike do të vazhdojë të jetë përsa kohë që niveli ekonomik dhe shoqëror do të jetë në këto parametra zhvillimi. Por, nisur nga kjo situatë, ne kemi mundësi, që në një të ardhme jo të largët, të ngremë në nivelin e shteteve më të zhvilluara, marrëdhëniet juridike civile.

Për të arritur rezultatet e dëshiruara, në radhë të parë, kërkohet formimi profesional në nivele shkencore bashkëkohore të punonjësve të të drejtës, të cilët në jo pak raste në praktike, keqmenaxhojnë vullnetin e palëve që marrin pjesë në marrëdhënie juridike civile.

E meta kryesore e juristëve në praktikë, mendoj se vjen nga mungesa e formimit juridik si dhe nga njohja jo si duhet e praktikës së vendeve të tjera të zhvilluara në këtë fushë.

Faktor tjetër, i cili pengon ecjen përpara të marrëdhënieve juridike, është edhe mungesa e aseteve ekonomike të njerëzve si dhe mungesa e edukimit ligjor të tyre në fushën e së drejtës.

Në praktikën gjyqësore, hasen mjaft raste, ku pjesëmarrësit në një marrëdhënie juridike civile edhe pse kanë pasur dëshirën dhe vullnetin pozitiv për të realizuar përmbushjen e një marrëdhënie juridike, hartuesi i dokumentit (noteri në shumicën e rasteve ose subjekt tjetër i autorizuar nga ligji) ka bërë që kjo nismë të dështojë.

Por, rastet nuk mungojnë edhe atëherë ku vetë palët, me qëllim jo të mirë hyjnë në një marrëdhënie juridike civile, jo për të realizuar atë çfarë ata kanë parashikuar në momentin fillestar ose në raste të tilla, ku njëra palë sillet me keqbesim me palën tjetër.

Paraqitëm këtë tablo me jo pak problema, me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit shoqëror se praktika në fushën e marrëdhënieve juridike civile është në një gjendje të tillë, e cila duhet të përmirësohet sa më shpejt, me synimin e ecjes në rrugën e standardeve të shteteve perëndimore, të cilët dallohen për një ekonomi, legjislacion dhe jurisprudencë moderne. Ky përfundim, nuk mohon aspak progresin e marrëdhënieve aktuale juridike civile, të cilat janë të pranishme sot në terrenin praktik. Por, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe dëshirën e mirë për të arritur eficiencën e të mirave materiale ose jo materiale, do të donim të projektonim dhe të ndërtonim një trase të profilit më pranë BE për të ardhmen.

Detyrë e rëndësishme, nga ana e punonjësve të praktikës që merren me këtë fushë, është ndërgjegjësimi i palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie, se rezultati i kërkuar pozitiv, arrihet vetëm atëherë kur legjislacioni dhe praktika bashkëkohore janë në themelet e marrëdhënies juridike civile.

Gjithashtu, orientimi i gabuar i palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie të tillë nga juristët më duket një premisë e gabuar, e cila do të çojë në pengimin e zhvillimit me ritmin e kohës të marrëdhënies juridike civile.

Kjo do të thotë se kërkohet më shumë punë, më shumë vullnet, me qëllim që njerëzit e drejtësisë të përcjellin te publiku frymën e shtetit të së drejtës.

Perceptimi i të ardhmes së marrëdhënieve juridike civile në këtë nivel, tregon për një angazhim serioz dhe profesional si për studiuesit

e të drejtës, ashtu dhe për punonjësit e praktikës gjyqësore.

Vetëm arritja e një bashkëpunimi të tillë, mund të garantojë përmbushjen me sukses të qëllimit të legjislatorit në momentin e hartimit të ligjit dhe synimeve konkrete të subjekteve, që marrin pjesë në marrëdhënie juridike civile të caktuar.

Kjo do të thotë se nga të gjithë aktorët e këtij procesi, si ata që merren me studime teorike dhe ata që zbatojnë në praktikë këtë pjesë të ligjit material civil, kërkohet më shumë punë dhe përkushtim për të arritur synimin, që është implementimi i marrëdhënies juridike civile në jetën e përditshme shoqërore, të cilat nxisin progresin e iniciativës së lirë në marrëdhëniet ekonomike.

Mungesa e një praktike të konsoliduar, shtrun si domosdoshmëri që në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës duhet t'i lihet një hapësirë e konsiderueshme studimit dhe trajnimit, si të studentëve ashtu edhe punonjësve të praktikës gjyqësore me qëllim që të kuptohen drejt ndryshimet që kanë pësuar marrëdhëniet juridike civile me hyrjen në fuqi të Kodit Civil.

## Bibliografi

1. Nathanaili, Andrea., E drejta civile (Pjesa e Përgjithshme).
2. Franc.S.Galgano, E drejta private.
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998 (me ndryshimet).
4. Kodi Civil i vitit 1929.
5. Kodi Civil i vitit 1982.
6. Kodi Civil i vitit 1994.
7. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.
8. Benxhaman N.Kardozo, Natyra e procesit gjyqësor.
9. Vendime Unifikuese të Gjykatës së Lartë.

## ZBATIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË LIDHJE ME KODIN PENAL

Dr. Ela ELEZI<sup>202</sup>

### Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë u krijua në vitin 1992 si një organ me një pozitë të veçantë në sistemin shtetëror. Kushtetuta në Nenin 124 parashikon se: “Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”<sup>203</sup>. Kështu Gjykata Kushtetuese nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor shqiptar, por ka një varg kompetencash specifike, ndër të cilat mund të përmendim: kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve e marrëveshjeve ndërkombëtare, kushtetutshmërinë e partive politike, kërkesës për referendum dhe verifikimin e rezultatit të tij, verifikimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe deputetëve, mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, gjykimet në lidhje me shkarkimin e Presidentit të Republikës dhe të gjyqtarëve të lartë, dhe shqyrtimi i ankesave të individëve për shkeljen e të drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë karakter specifik: ato janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim. Ligji për Gjykatën Kushtetuese në Nenin 81 garanton ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate.

---

<sup>202</sup> Specialiste në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese.

<sup>203</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.

Në rastin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve, i lihet në dorë organit legjislativ të plotësojë boshllëkun ligjor të krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. *Zbatimi* në mënyrën e duhur është shumë i rëndësishëm për funksionimin e të gjitha organeve shtetërore dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë. Garancitë kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit lejojnë gjyqtarët të mbrojnë të drejtat dhe liritë e individit të parashikuara nga ligji. Megjithatë, këto garanci kushtetuese dhe mbrojtja ligjore e humb rëndësinë e saj nëse vendimet gjyqësore nuk zbatohen. Me kalimin e kohës, moszbatimi efektiv i vendimeve mund të cenojë besueshmërinë e sistemit ligjor dhe shtetit të së drejtës.<sup>204</sup>

Në këtë artikull do të përqendrohemi në rastet kur Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Kodi Penal u miratua me Ligjin nr. 8795 datë 27.01.1995, tre vjet përpara miratimit të Kushtetutës. Ky fakt ndoshta solli që disa dispozita të tij të mos ishin në përputhje me Kushtetutën dhe parimet demokratike. Gjithashtu në mjaft raste lufta kundër kriminalitetit ka sjellë ashpërsim të dënimeve që jo gjithnjë kanë qenë në pajtim me frymën e Kushtetutës.

Si shumë ligje të tjera, edhe Kodi Penal i është nënshtruar shqyrtimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila në mjaft raste ka shfuqizuar dispozita të cilat vinin në kundërshtim me Kushtetutën. Shfuqizimi i dispozitave rrjedhimisht sjell moszbatimin e tyre dhe në rastet kur krijohet boshllëk ligjor, detyrimin e Kuvendit për t'i zëvendësuar me dispozita të reja.

Më poshtë do të analizojmë disa nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Kodin Penal dhe masat që ka marrë Kuvendi i Shqipërisë për të zbatuar këto vendime.

### ***Vendimi nr. 13, datë 29.05.1997***

Një nga vendimet e para të Gjykatës Kushtetuese është vendimi me objekt: “Shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit nr.8175, datë 23.12.1996 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

<sup>204</sup> ABA-CEELI, *Survey of Legislative Frameworks for the Enforcement of Judgments*, CEELI Research Paper Series, Washington, D.C., July 2003, p. 1.

Ligji në fjalë parashikonte për veprat penale të parashikuara nga nenet 5, 7-10, 12-14/2, 15-23/1, 24, 28-34, 37-40 të ligjit dënime fikse, si p.sh: (Neni 76 - Vrasja e kryer me dashje dënohet me njëzet e pesë vjet burgim). Ligji gjithashtu parashikonte në disa raste vetëm minimumin e dënimit dhe jo maksimumin.

Gjykata në vendimin e saj çmoi se parashikimi i sanksioneve (dënimeve) fikse në normat e sipërpërmendura të Ligjit nr. 8175, datë 23.12.1996, binte ndesh me një sërë parimesh (dispozitash) të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal, sidomos për mënyrën e caktimit të dënimit, për rrethanat lehtësuese e rënduese (nenet 47-50), të cilat kur konkurrojnë, vlejné, pa përjashtim, për çdo vepër penale. Sanksionet fikse eliminojnë mbrojtjen përse i përket përcaktimit të shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer e të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cunguar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë.<sup>205</sup> Këto norma gjithashtu cenonin të drejtat dhe liritë themelore të individit. Në këtë mënyrë do të krijohej mundësia për shpërpjesëtim të dukshëm ndërmjet masës së dënimit dhe rrezikshmërisë së veprës e të personit, duke u cenuar kështu garancia kushtetuese për një gjykim të drejtë.

Në fund të vendimit Gjykata u shpreh se i takonte Kuvendit Popullor të bënte rregullimin ligjor edhe për sanksionet e këtyre normave të reja për t'i përshtatur me kërkesat kushtetuese.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi me Ligjin nr.8279, datë 15.01.1998, shfuqizoi në tërësi Ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996.

Pavarësisht këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, në Kodin Penal ndeshen përsëri dënime fikse. Kështu në Nenet 109 paragrafi 3, 109/b paragrafi 3, 221 paragrafi 2 dhe Nenin 334 parashikohet si dënim fiks dënimi me burgim të përjetshëm. Përveç faktit se kjo vjen në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ky lloj dënimi është dënim më i rëndë që aplikohet, dhe nuk mund të mbetet si dënim fiks, pasi në këtë mënyrë cenohen të drejtat dhe liritë e individit.

Përveç dënimit fiks në kod parashikohen edhe dënime si jo më pak se pesë vjet (Nenet 288, 289, 290, 292), jo më pak se shtatë vjet

<sup>205</sup> Vendim nr. 13, datë 29.05.1997, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 1997 – 1999, f.38.

(Neni 232) apo jo më pak se dhjetë vjet (Nenet 73, 231). Këto dënime parashikojnë kufirin minimal, por pa parashikuar atë maksimal, i cili presupozohet të jetë tridhjetë e pesë vjet. Ky lloj diskrecioni është i dëmshëm dhe cenon të drejtat dhe liritë e individëve të akuzuar për një vepër penale, e cila në bazë të këtyre dispozitave mund të dënohen nga 5 deri në 35 vjet, edhe për vepra me rrezikshmëri të vogël.

### ***Vendimi nr.65, datë 10.12.1999***

Rëndësi historike pati dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 65, datë 10.12.1999, për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dënimit me vdekje. Ratifikimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 6 të saj detyruan Republikën e Shqipërisë të shfuqizonte dënimin me vdekje në kohë paqe nga të gjitha dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit Penal Ushtarak. Dënimi me vdekje parashikohej në 16 nene të Kodit Penal (29/1, 31, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 109, 141, 208, 209, 219, 221, 230 dhe 334). Heqja e tij ishte rrjedhojë e detyrimit të shtetit për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, siç parashikohej dhe në Kushtetutë. E drejta e jetës qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore.

Dënimi me vdekje nuk i përgjigjej qëllimit të dënimit penal, i cili përfshin momente të rëndësishme që përgjithësisht ndikojnë tek i dënuari, siç janë riedukimi, izolimi, përpjekja për integrimin e tij në shoqëri etj. Masat e tjera penale që përmban Kodi Penal, duke filluar nga gjoba, burgimi deri në 35 vjet, apo burgimi i përjetshëm, si një alternativë e dënimit me vdekje, janë plotësisht të mjaftueshme, të cilat jo vetëm që përmbushin më mirë qëllimet e dënimit penal, por kur ato zbatohen me rigorozitet nga organet gjyqësore, ushtrojnë ndikimin e padiskutueshëm për ndëshkimin e fajtorëve dhe për një luftë efektive kundër kriminalitetit.

Dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë që parashikojnë dënimin me vdekje nuk i përmbaheshin edhe frymës së Kushtetutës dhe cenonin përmbajtjen thelbësore të të drejtës për jetën dhe dinjitetin njerëzor.

Por heqja e dënimit me vdekje dhe detyrimi i Kuvendit të

Republikës së Shqipërisë për të bërë këto ndryshime thelbësore në Kodin Penal, bëri që ky dënim të zëvendësohej me dënimin me burgim të përjetshëm. Në kod ky dënim parashikohet në 25 dispozita. Në mjaft raste të tjera ai madje parashikohet si dënim i vetëm ose i shoqëruar me gjoba në shuma të mëdha.

Ekzistenca e dënimit me burgim të përjetshëm është i domosdoshëm në rastin e kryerjes së krimeve të rënda dhe ai është plotësisht i justifikuar. Por është e nevojshme analiza e parashikimit të tij në Kodin Penal, pasi në raste të caktuara ai parashikohet si dënim për krime që nuk e justifikojnë këtë lloj dënimi ose për krime pasojat e të cilave vijnë nga pakujdesia.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj trajtoi edhe boshllëkun ligjor që do të krijonte vendimi i saj. Për këtë problem, Gjykata Kushtetuese nënvizon se “... me shfuqizimin si antikushtetues të dënimit me vdekje, i përket ligjvënësit shqiptar që të rishikojë me frymën e Kushtetutës dhe të këtij vendimi të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me dënimin me vdekje dhe në veçanti dispozitat e Kodit Penal, të cilat parashikojnë sanksionet, me qëllim që të harmonizohen në tërësi dënimet që duhen zbatuar ndaj personave që kryejnë këto vepra penale, duke parashikuar dënimet alternative dhe evitimin nga këto dispozita konkrete të dënimeve fikse”.<sup>206</sup> Në këtë rast ky vendim është ekzekutuar sepse boshllëku ligjor i krijuar për shkak të shfuqizimit të dispozitave, objekt shqyrtimi, është plotësuar menjëherë nga organet që kishin detyrimin për të bërë rregullimin ligjor.

Me Ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, Kuvendi i Shqipërisë vuri në zbatim vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar në Nenin 79 të ligjit: “Në nenet 73, 74, 78, 79, 109 paragrafi i dytë, 141, 208, 209, 219, 221 paragrafi i dytë, 230 dhe 334 hiqen fjalët “a me vdekje”.”

### ***Vendim nr.11, datë 02.04.2008***

Tjetër qëndrim i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Kodin Penal është edhe shfuqizimi i Neni 315: “Dhënia e një vendimi të padrejtë”. Kjo dispozitë parashikonte marrjen në përgjegjësi penale të gjyqtarit për një vendim të formës së prerë, kur dihet se ky vendim

<sup>206</sup> Vendim nr. 65, datë 10.12.1999, Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 1997 – 1999.



është i padrejtë.<sup>207</sup>

Ky nen i Kodit Penal mund të linte shteg për abuzime, pasi nëse një palë në proces nuk do të ishte e kënaqur me vendimin e dhënë nga gjyqtari, do kishte mundësinë të bënte një kallëzim penal të padrejtë, duke cenuar kështu pozitën dhe pavarësinë e gjyqtarit.

Kështu, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ky nen vinte në kundërshtim me Kushtetutën, pasi gjyqtarët duhet të jenë të pavarur në vendimarrjen e tyre dhe të aftë të veprojnë pa ndikime, presione, kërcënime ose ndërhyrje. Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës. Vendimet e gjyqtarëve mund të shqyrtohen dhe vlerësohen vetëm nga një gjykatë më e lartë.

Për të siguruar të drejtat e shtetasve në një proces civil ose penal janë parashikuar një varg dispozitash në Kodin Penal si korrupsioni aktiv ose pasiv i gjyqtarit apo shpërdorimi i detyrës, të cilat sigurojnë dhënien e një vendimi të drejtë dhe shmangien e abuzimit. Gjithashtu e drejta e ankimit i siguron shtetasit për sigurimin e efektivitetit të sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Shfuqizimi i këtij neni është shprehje e depenalizimit, në këtë rast jo të kryer nga shteti me anë të një reforme ligjore, por nga gjykata.

Pavarësisht se ky nen konsiderohet si nul dhe nuk mund të zbatohet më pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë në dy ligjet e mëvonshme me të cilat ka ndryshuar Kodin Penal, nuk e ka shfuqizuar formalisht atë.

### ***Vendim nr. 1, datë 12.01.2011***

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht se nuk ka si objekt shqyrtimin e Kodit Penal, lidhet ngushtë me të. Vendimi ka si objekt: “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën, i Nenit 90 të Ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkuesit në kërkesën e tyre pretendonin se Neni 90 i Ligjit

<sup>207</sup> Vendim nr.11, datë 02.04.2008, Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 2008.

nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, që parashikonte si veprë penale “ushtrimin pa licencë të këmbimit valutor”, bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, të sanksionuar nga Neni 29 i Kushtetutës. Ligjvënësi duhet të parashikonte dispozitat penale në Kodin Penal ose dhe në ligje të tjera, me kusht që ato të miratoheshin me një shumicë të cilësuar prej tri të pestat e deputetëve.<sup>208</sup> Ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” bën pjesë në kategorinë e ligjeve që miratohen me shumicë të thjeshtë të deputetëve.

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale. Dispozita, që e klasifikon një veprim të caktuar si veprë penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim. Gjykata çmon se delegimi që ka bërë ligjvënësi në paragrafin e dytë të Nenit 1, shkronja a, të Kodit Penal për përfshirjen e dispozitave penale edhe në ligje të tjera, nuk është argument për të justifikuar miratimin e dispozitave të reja penale me ligje të thjeshta

Gjykata, në vijim të arsytimit të saj, e sheh me vend të theksojë se shpërndarja e normave juridiko penale në ligje të ndryshme, si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në zbatim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 23 datë 1.3.2012, për disa ndryshime në Kodin Penal.

Në këtë ligj, përveç dispozitave të tjera u shtuan një sërë dispozitash të tjera në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese.

Kështu u shtua një seksion i ri në Kreun III të Kodit Penal, Seksioni IV/1 “Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive

<sup>208</sup> Vendim nr. 1, datë 12.01.2011, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2011, Tiranë.

financiare” me dy nene të reja, përkatësisht Neni 170/c, Ushtimi pa licencë i veprimtarisë bankare, i cili parashikon se ushtimi i veprimtarisë bankare nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar në fuqi, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Dispozita parashikon edhe kryerjen e veprës penale në rrethana cilësuese, kur kanë ardhur pasoja të rënda.

Neni i dytë i shtuar është Neni 170/ç, Ushtimi pa licencë i veprimtarive financiare, që parashikon ushtimin e një ose disa veprimtarive financiare të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim.

Në vijim Ligji nr.23, datë 01.03.2012, shtoi dhe gjashtë dispozita të reja në Kodin Penal, të cilat përveçse ishin kërkesë e MONEYVAL të Këshillit të Europës, ishin edhe në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjashtë dispozitat u shtuan nga Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”: Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar Neni 143/a/2, Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë Neni 143/a/3, Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre Neni 143/a/4, Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar Neni 143/a/5, Fshehja e pronësisë Neni 143/a/6, Tregtimi i paligjshëm i titujve Neni 143/a/7. Përveç përfshirjes në Kodin Penal, u bë edhe unifikimi i terminologjisë të përdorur nga ligji dhe nga Kodi.

Dispozita “Manipulimi i tregut”(Neni 143/a/1) e shtuar në Kodin Penal vinte si rrjedhojë e shfuqizimit të Ligjit nr.8080, datë 01.03.1996 “Për letrat me vlerë”.

Dy nenet e fundit i përkasin veprave penale në sferën ekonomike dhe janë “Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale, i marrë nga Ligji nr.9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë intelektuale” dhe Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit nga Ligji nr. 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”.

Dispozita të tjera të shtuara në Kodin Penal janë edhe ato që kanë lidhje me veprat penale që prekin sistemin demokratik të zgjedhjeve. Dy dispozitat parashikoheshin nga Kodi Zgjedhor në Nenet 169 dhe

170, Votimi më shumë se një herë dhe Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve.

Një tjetër vendim i Gjykatës Kushtetuese ka shfuqizuar nenin që parashikonte veprë penale në ligjin “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me arsyetimin se “parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barasvlershëm me të nga fuqia juridike”.<sup>209</sup>

Ky vendim përcaktonte qartë se veprat penale të veçanta nuk mund të parashikohen në ligje të cilat miratohen me një shumicë të thjeshtë. I mbetet në dorë Kuvendit të bëjë kontrollin e të gjitha ligjeve që përcaktojnë vepra penale, që në reformën e ardhshme të Kodit Penal të bëjë shfuqizimin e tyre dhe t’i parashikojë ato në Kodin Penal.

#### ***Vendim nr. 19, datë 01.06.2011***

Një tjetër vendim i Gjykatës Kushtetuese është dhe ai nr. 19, datë 01.06.2011,<sup>210</sup> i cili shfuqizon paragrafin VIII të Nenit 34 të Kodit Penal, që parashikonte shndërrimin e gjobës në burgim, në rast se i dënuar nuk paguante gjobën në afatin e caktuar.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese shpreh dekriminalizimin e kësaj norme, me arsyetimin se dënimi penal përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative: nga njëra anë qëndron funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale, pasi kërcënim, se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo nga shtetasit që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër qëndron funksioni i parandalimit të posaçëm, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij në mënyrë që, pas kryerjes së dënimit, të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale.

Dënimi me gjobë lind si një mënyrë për të shmangur dënimin me burgim, pasi konsiderohej si më e drejtë që personi të mund të

<sup>209</sup> Vendim nr. 23 datë 08.06.2011, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2011, Tiranë.

<sup>210</sup> Vendim nr. 19, datë 01.06.2011, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2011, Tiranë.

paguante një shumë të hollash për vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore, pa pasur nevojë që të privohej nga liria. Qëllimi i dënimit me gjobë, duhet trajtuar në kuptimin që funksioni riedukativ mund të përmbushet edhe nga pagesa e një shume të caktuar, pa qenë nevoja që personi të privohet nga liria vetjake.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese vendosi papajtueshmërinë e paragrafit 8 të Nenit 34 të Kodit Penal me Kushtetutën, me arsyetimin se gjyqtari, gjatë konvertimit, duhet të ketë mundësinë të hetojë në lidhje me shkaqet që kanë çuar në mos shlyerjen e gjobës dhe, çka është më e rëndësishme, duhet të ketë mundësinë të caktojë dënimin më të përshtatshëm për secilin shkelës, në përputhje me funksionin riedukues të sipërpërmendur.

Gjykata vëren se gjyqtari, që bën konvertimin e gjobës, duhet të ketë mundësinë që të caktojë të gjitha llojet e dënimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, mbi të gjitha, të ketë mundësinë të përdorë masat alternative të dënimit me burgim.

Me ligjin nr.23 datë 01.03.2012, Kuvendi i Shqipërisë bëri edhe ndryshime në Nenin 34 të Kodit Penal. Kështu janë bërë ndryshime që cilat janë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese si:

1. *Në fillim të paragrafit të gjashtë shtohen fjalitë me këtë përmbajtje: “Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to.”.*
2. *Pas paragrafit të shtatë shtohen katër paragrafë me këtë përmbajtje: “Kur i dënuari nuk e paguan gjobën dhe gjoba nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur pesë mijë lekë për një ditë burgim.”.*

*Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:*

- a) *shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;*
- b) *kryerjen e një pune me interes publik.*

*Nëse gjykata urdhëron kryerjen e një pune në interes publik zbatohen rregullat e Nenit 63 të këtij Kodi.*

*Nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim.”.*

Në këtë mënyrë Neni 8 u zgjerua dhe u sqaruan rrethanat kur mund të bëhet konvertimi i dënimit me gjobë në burgim, në mënyrë që të respektohen të drejtat dhe liritë e individit edhe në procesin penal.

### ***Vendim nr. 47, datë 26.07.2012***

Vendimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese që lidhet me Kodin Penal është vendimi nr. 47 datë 26.7.2012.<sup>211</sup> Objekt i këtij vendimi ishte shfuqizimi i neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal dhe të gjitha dispozitave që përmbajnë dy dënime kryesore. Këto nene janë përkatësisht veprat penale të “falsifikimit ose përdorimit të vulave, stampave ose formularëve” dhe të “falsifikimit të akteve të gjendjes civile”.

Reforma ligjore e viteve 2003- 2004 në Kodin Penal parashikoi dhënien e dy dënimeve kryesore në kuadër të rritjes së luftës kundër kriminalitetit. Kërkuesi pretendon se ky parashikim, me burgim dhe me gjobë, është antikushtetues, pasi, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën.

Gjykata në arsyetimin e saj vlerësoi se dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore dhe në thelb të ndryshëm nga njëri tjetri dhe se ndikimi i secilit prej tyre mbi të dënuarin, dhe procesin riedukativ ndaj tij, është shumë i ndryshëm, pasi qëllimi i dënimit me burgim është i kundërt nga ai i dënimit me gjobë dhe për rrjedhojë, përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me heqje lirie në një sërë dispozitash penale, ndërhyr në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin e dënimit.

Parashikimi *apriori* i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, jashtë kriterëve të analizuara më lart, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit

<sup>211</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.47 datë 26.07.2012, www.gjk.gov.al

e si rrjedhë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, gjithsesi nuk e ndalon gjyqtarin të japë krahas dënimit me burgim edhe dënim me gjobë kur ndodhemi para kushteve të Nenit 34 paragrafi i pestë i Kodit Penal: “*për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita penale parashikon vetëm dënimin me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë nga 100 mijë deri në 5 milion lekë*”.<sup>212</sup>

Kështu, në përfundim Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të Nenit 29, paragrafi i fundit, të Kodit Penal, i cili parashikon se “*Dënimi me burgim dhe me gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi*” si dhe shfuqizimin e neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal në pjesën që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim.

Shfuqizimi i paragrafit të fundit të nenit 29, me një interpretim të gjerë na bën të nënkuptojmë se gjyqtari i zakonshëm në shqyrtimin e veprave penale që parashikojnë dy dënime ka në diskrecionin e tij të japë njërin nga dënimet e parashikuara nga dispozita. Vendimi i gjykatës ndalon dhënien e të dyja dënimeve apriori, por nuk përjashton dhënien e njërit prej dënimeve më vete.

Megjithatë me reformën ligjore nr.144/2013, Kuvendi i Shqipërisë shfuqizoi pjesën që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim në 44 nene.

Megjithatë amendimet e reja të Kodit Penal nuk janë më zgjidhja efektive. Ai duhet hartuar si Kod i Ri.<sup>213</sup>

## Konkluzione

Nuk mund të mohojmë që Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (1995) u ndërtua në bazë të parimeve demokratike dhe shërben

<sup>212</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995 me ndryshime.

<sup>213</sup> Abdiu, F. Mbi domosdoshmërinë e hartimit të një Kodi Penal të ri, Revista Avokatia 2, Prill 2012, Tiranë, f.69-83.

për mbrojtjen e vlerave të rëndësishme shoqërore në luftimin e kriminalitetit. Zbatimi i vendimeve gjyqësore në përgjithësi dhe atyre të Gjykatës Kushtetuese në veçanti është një parakusht për forcimin e shtetit të së drejtës. Në bllokun e vendimeve të kësaj gjykate qëndrojnë edhe vendimet që lidhen me Kodin Penal.

Siç u theksua dhe më lart, pothuajse të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar nga Kuvendi i Shqipërisë në reformat ligjore të këtyre viteve. Sigurisht ekzistojnë ende disa probleme që duhet të rishikohen si disa dënime fikse të mbetura në kod.

Kodi Penal që nga miratimi i tij në vitin 1995 i është nënshtruar një varg reformash që kanë ndryshuar thelbësisht strukturën dhe përmbajtjen e tij. Mendoj se ka ardhur koha të miratohet një kod i ri penal, i cili të jetë në përputhje me standardet kushtetuese dhe europiane dhe të ruajë qëndrueshmërinë e tij sa më gjatë.

## Bibliografia

1. ABA-CEELI, *Survey of Legislative Frameworks for the Enforcement of Judgments*, CEELI Research Paper Series, Washington, D.C., July 2003
2. Abdiu, F. Mbi domosdoshmërinë e hartimit të një Kodi Penal të ri, Revista Avokatia 2, Prill, 2012, Tiranë.
3. Studim me temë: Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Drejtoria e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese 30.06.2008
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
5. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 1997 – 1999, Tiranë.
6. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2008, Tiranë.
7. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2011, Tiranë.
8. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.47 datë 26.07.2012, www.gjk.gov.al
9. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995 me ndryshime.

## **PAGA E PUNËS SI KATEGORI JURIDIKE, EKONOMIKE DHE SOCIALE**

MA. Artan ÇELA - Prof. Dr. Kudret ÇELA.

### **Hyrje**

Në literaturën juridike dhe ekonomike klasike, puna përkufizohet si veprimtari mendore ose fizike e njeriut, me qëllim sigurimin e të ardhurave ekonomike<sup>214</sup>. Ndërsa në literaturën juridike më të re: “Puna (labor, work) përcaktohet si shërbim, zbatim i aftësive mendore ose fizike<sup>215</sup> ose karakterizohet si veprimtari që ushtrohet në drejtim të një rezultati të dobishëm të caktuar<sup>216</sup>. Sikurse del qartë, qëllimi për të siguruar të ardhura, përbën elementin bazë, i cili jep konturet e vërteta të marrëdhënies së punës dhe, njëkohësisht, evidenton faktin që ndodhemi përpara një marrëdhënie të tillë. Këto të ardhura, që punëmarrësi i siguron nga ofrimi i punës së tij, përbëjnë pagën. Dhe asnjë çështje që lidhet me punën, nuk është më shumë thelbësore se çështjet që lidhen me pagën, sepse për një njeri dhe fëmijët e tij, jeta lidhet ngushtësisht me shumën e të ardhurave që ai fiton<sup>217</sup>. Pra, është pikërisht elementi i pagës, ai i cili më qartë se çdo element tjetër, përcakton se nuk ndodhemi përpara një pune të detyruar apo një

<sup>214</sup> Bureau Of Bussines Research, Bulletin No.25, Labor Terminology, Cambridge 1921, f.49.

<sup>215</sup> “Black’s law dictionary”, U.S.A, 1991, f.605.

<sup>216</sup> “Vocabulaire juridique”, Paris 1990, f.816.

<sup>217</sup> Andrews, John B Labor Problems And Labor Legislation, American Association For Labor Legislation 1919, f.23.

pune të kryer brenda në familje, por përpara një pune të pagueshme, tipike për një marrëdhënie juridike pune të pranuar me vullnet të lirë nga punëmarrësi. Vështruar në një prizëm të gjerë termi pagë shërben për të përcaktuar të gjitha të ardhurat e përfituara nga një person në këmbim të punës së tij. Ky koncept kaq i thjeshtë, mbyllur brenda një fjalie të vetme, përbën në fakt elementin më delikat e më të vështirë për t’i dhënë përgjigje. Aq i vërtetë është ky konstatim, saqë shumë prej diferencave midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, lindin, rriten dhe shndërrohen në mosmarrëveshje, pikërisht për çështje që lidhen me pagën. Në teori, punëdhënësi dhe punëmarrësi duhet të shihen si partner në punë, dhe ajo që fitojnë nga puna, duhet të ndahet në mënyrë të drejtë midis tyre, në bazë të kontributit që kanë dhënë për këtë produkt. Ka pikëpamje që shprehet se puna njerëzore, duke qenë krijuese e komoditetit dhe e pandashme nga qenia njerëzore, nuk mund, dhe nuk duhet të jetë subjekt i ligjit të kërkesës dhe ofertës në përcaktimin e vlerës së saj monetare<sup>218</sup>. Sipas kësaj pikëpamje, mendohet se numri i punëmarrësve të punësuar dhe atyre që kërkojnë punë rritet çdo vit, duke rritur në mënyrë të padiskutueshme edhe supermacinë e punëdhënësit. Kjo e bën rolin e këtij të fundit përcaktues në marrëdhëniet e punës, duke i dhënë atij pushtetin e formulimit të çdo kushti të marrëdhënies së punës, një prej të cilëve, dhe më i rëndësishmi është paga. Kjo pikëpamje ndesh në kundërshtimin e natyrshëm, prandaj edhe paga është objekti i këtij shkrimi, duke trajtuar disa nga çështjet më të rëndësishme, të cilat lidhen me të, si përkufizimi, teoritë respektive, kategorizimi i saj, dhe përcaktimi i pagës së drejtë<sup>219</sup>.

### **1. Kuptimi i pagës në marrëdhëniet juridike të punës**

**1.1** Si kategori juridike, paga e punës është shpërblimi në të holla që punëdhënësi detyrohet t’i japë punëmarrësit kundrejt punës efektivisht të kryer në përshtatje me parimet e sanksionuara në

<sup>218</sup> Peters P, John, Labor And Capital, A Discussion Of The Relations Of Employer And Employed, G.P.Putnam’s Sons, 1902, f.200.

<sup>219</sup> E.Ghera “Diritto del lavoro”, Bari 2012, f.141, 149.

Kushtetutë dhe në legjislacionin e punës<sup>220</sup>. Ashtu siç u nënvizua edhe më sipër, në një kuptim të gjerë, termi pagë nënkupton të gjitha të ardhurat e siguruar nga punëmarrësi në shkëmbim të punës së tij. Ndërsa, në një plan më të ngushtë, termi pagë nuk nënkupton të gjitha të ardhurat e siguruar nga çdo lloj pune, por vetëm të ardhurat e siguruar nga një punë e kryer për llogari të një punëdhënësi. Në këtë kuptim, nuk do të konsiderohen pagë të ardhurat e siguruar nga një punë autonome. Edhe doktrina klasike shprehet se, termi pagë shërben për të përcaktuar jo të ardhurat e siguruar nga të gjitha llojet e punëve të bëra për llogari të tjerëve, por vetëm të ardhurat e siguruar nga puna e bërë nga një punëmarrës për llogari të një punëdhënësi. Edhe pse ky përkufizim kufizon konceptin e pagës, përsëri shërben për të qartësuar elementet e domosdoshme për t'i konsideruar këto të ardhura si pagë. Ndërtimi i pagave të punës kryhet duke mbajtur parasysh se ato nuk janë vetëm një shpenzim i posaçëm i prodhimit, por janë burimi kryesor i të ardhurave të punëmarrësit dhe një ndër faktorët kryesorë të rritjes së rendimentit të punës e të përmirësimit të treguesve të prodhimit.

**1.2** Akti më i lartë normativ, që sanksionon pagat e punës në vendin tonë, është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>221</sup>. Në nenin 49 të këtij akti, përcaktohet se: “secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë”.

Ky rregullim kushtetues gjen pasqyrim të hollësishëm edhe në aktet e tjera normative si në, Kodin e Punës, Ligjin “Për kompetencat në caktimin e pagave”, Ligjin “Për ratifikimin e Konventës së ONP”, Nr.131, me titull “Caktimi i pagës minimale” etj. Në këtë kuadër të gjerë ligjor që rregullon pagat në Republikën e Shqipërisë, duhen evidentuar vendimet e Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”. Megjithatë, përveç këtyre akteve të rëndësishme ligjore që parashikojnë pagat, studiues të njohur në fushën e marrëdhënieve të punës, nxjerrin në pah faktin se piramida

<sup>220</sup> L.Gariget.P.S.S, Le Salaire, Librairie Bloud & Co. Paris 1907, f. 5.

<sup>221</sup> Legjislacioni ynë demokratik për pagat është ndërtuar në përputhje me konventat e ONP e në mënyrë të veçantë, me Konventën Nr.100 për shpërblim të drejtë dhe Rekomandimin Nr.90 të vitit 1951 për eliminimin e diskriminimit ndërmjet burrit dhe gruas punonjës me pagë. Vlen të nënvizohet edhe Konventa Nr.111 e ONP, e vitit 1958.

e pagave në Republikën e Shqipërisë, ka ende probleme serioze, ku ndërthuren si element komunist të shpërndarjes, ashtu dhe tregues të një kapitalizmi të egër. Vëmendje të veçantë meritojnë llojet, llogaritjet dhe diferencat e mëdha në pagat e punës të punëmarrësve (nga më i thjeshti, deri tek ato të administratës së lartë shtetërore).

Në vendin tonë paga e punëmarrësve llogaritet në vëllimin e punës së matur në sasi e cilësi, në kohën e punës dhe në klasifikimin e renditjes së punës. Në kuptim të Nenit 109 të Kodit të Punës, me termin pagë kuptohet paga bazë si dhe shtesat me karakter të përhershëm. Në këtë kuptim, nuk quhen pjesë përbërëse e pagës shpërblimet që merr punëmarrësi për shpenzimet e kryera për shkak të veprimtarisë së tij profesionale. Sipas rregullimit të përgjithshëm, punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale. Në mungesë të tyre, punëdhënësi detyrohet të paguajë pagën e zakonshme për atë lloj pune të caktuar<sup>222</sup>.

## 2. Disa teori në lidhje me pagën

**2.1** Teoria më e hershme për pagat, lidhet me doktrinën se pagat përcaktohen nga kostoja e ekzistencës së punëmarrësit. Kjo teori, supozon se supermacia absolute e punëdhënësit është krijuar nga vet – diktati i inferioritetit të punëmarrësve. Ndjekëse e kësaj teorie, është Teoria e Fondit të Pagave (Wages-Fund Theory), sipas së cilës, masa e pagave përcaktohet nga punëdhënësi. Sipas kësaj teorie, punëdhënësi mbetet faktori përcaktues në caktimin e pagës.

Teoria e mësipërme pasohet nga Teoria e Produktivitetit (Productivity Theory), sipas së cilës përcaktimi i pagës lidhet thuajse plotësisht me vetë punëmarrësin. Kështu, sipas saj, paga përcaktohet në përputhje me efikasitetin e vet punëmarrësit, dhe në lidhje me këtë çështje, punëdhënësi pothuajse nuk ka fare ndikim, por vetëm duhet të paguajë pagën. Në këtë teori, pozicionet janë përmbysur, duke i bërë punëmarrësit pronar të produktit të prodhuar. Sigurisht, kjo teori ishte produkt i kohës kur ishte rritur pushteti i organizatave sindikale dhe pozitës së punëmarrësit.

<sup>222</sup> Kudret Çela, Kontrata individuale e punës (monografi), Tiranë, 2013, f.175.

**2.2** E para teori e rëndësishme shkencore e pagës, është “Teoria e jetesës së punëtorëve” (The Subsistence Theory). Kjo teori, njihet me emra të ndryshme, si: “Teoria Natyrale e Pagave” (Theory Of Natural Wages), “Teoria Ricardiane” (The Ricardian Theory), “Ligji i Pagave të Hekurit” (Iron Law Of Wages), “Teoria e Standardit të Komfortit” (The Standard-Of-Comfort Theory) dhe Doktrina e Pagës së Jetesës (Doctrine Of A Living Wage). Autor i kësaj teorie është David Ricardo, i cili, në atë kohë e shikonte koston e jetesës si një minimum të ndryshueshëm, jo domosdoshmërisht në përputhje me koston fizike të jetës. Kjo teori, edhe pse ka pësuar ndryshime, në thelbin e saj ka mbetur e njëjtë. Sipas saj, vlera e punës përcaktohet nga vetë puna. Adam Smith dhe pasuesit e tij, e kanë trajtuar Teorinë e shpërndarjes (Theory Of Distribution), sikur ajo të ishte një degë e Teorisë së prodhimit (Theory Of Production). Pikërisht, kapitulli i parë dhe i katërt i Pasurisë së kombeve (Wealth Of Nations), evidenton pjesët përbërëse të çmimit. Kështu, sipas tij, paga shikohej si një element i koston së prodhimit. Është e nevojshme të evidentohet se askush nuk ka ndërmarrë nismën për të çuar përpara interpretimin natyralist të koston së prodhimit të punës. Kjo fjalë, gjithmonë është interpretuar si kosto e të mirave të nevojshme për të jetuar. Kështu, nga kjo pikëpamje, i vetmi ndryshim midis koston së një makine dhe punës, qëndron në faktin që kostoja e mbajtjes së një makine është më e lartë. Sigurisht, në këtë pikë, çdo kritikë e ngritur kundrejt kësaj teorie, nuk është e pajustificuar, pasi kjo analogji është ngritur duke abstraguuar faktin e qartë të diferencës midis personave dhe sendeve, e cila përbën një ndryshim thelbësor. Teoria e jetesës (The Subsistence Theory), është më së shumti një teori e çmimit të ofertës së punës. Në këtë teori supozohet se puna është një e mirë, me karakteristika pak a shumë të njëjta si të mirat e tjera, të cilat blihen dhe shiten. Sipas kësaj teorie, çmimi i ofertës së punës nuk përcaktohet vetëm nga shumatorja e nevojave, komoditeteve dhe luksit të nevojshëm për shkaqe fiziologjike, apo për shkaqe të zakonit, për të përballuar jetesën e punëmarrësit. Çmimi i ofertës së punës, nuk është një çmim i përcaktuar nga forca mbi të cilat punëmarrësi nuk ka kontroll të plotë. Ai është thjesht një parashikim, krijuar nga punëmarrësi se sa ai vlen. Në këtë vlerësim, futen shumë elemente, duke filluar me ushqimin, veshjen, strehimin dhe, duke përfshirë edhe pushimin. Çmimi i ofertës së punës nuk është një minimum nën të cilin pagat nuk mund të ulen,

ose një maksimum, sipër të cilit ato nuk mund të ngrihen. *Standardet* e jetesës nuk mund të shihen si minimume absolute. Një njeri mund të jetojë edhe me pak, ai mund të jetë i detyruar nga luhajat e industrisë, në një kohë të caktuar, të pranojë për më pak, se ajo që ai mendon se janë nevojat, komoditetet dhe luksi i jetës që ai mendon në mënyrë të natyrshe. Çmimi i ofertës të punës është thjesht një parashikim, një vlerësim, sipas të cilit, punëmarrësi është përgatitur të qëndrojë dhe për të cilin, nëse nevojitet, ai është i përgatitur të ngulmojë.

Por, mangësia më e madhe në këtë teori qëndron në neglizhimin e çështjeve që lidhen me çmimin e kërkesës së punës. Nëse puna është një e mirë, ajo nuk ka vetëm çmimin e ofertës, por edhe çmimin e kërkesës.

**2.3** Teoria e Fondit të Pagave (The Wages-Fund Theory), në një masë të caktuar, mund të kondiserohet si bashkimi i dy teorive: Teorisë së jetesës (The Subsistence Theory) dhe Teorisë së produktivitetit të punës (The Productivity Of Labor Theory). Kështu, kjo teori mund të konsiderohet një teori e kërkesës dhe ofertës, por që e trajton kërkesën dhe ofertën nga një pikëpamje gati objektive. Sipas kësaj teorie, kërkesa dhe oferta janë të fiksuara. Kështu, sipas saj, oferta nuk është e lidhur me çmimin, por qëndron e pavarur prej tij, dhe shkaqet, të cilat përcaktojnë ofertën, duhen kërkuar jashtë kësaj teorie. Nga ana tjetër, shkaqet të cilat përcaktojnë kërkesën, edhe pse nuk përjashtohen plotësisht, e shikojnë atë në lidhje me sasinë dhe jo me çmimin. Duhet nënvizuar se është shumë e vështirë të vizatosh një vijë të qartë ndarëse midis Teorisë së jetesës (Subsistence Theory) dhe Teorisë së fondit të pagave (Wages-Fund Theory). Ndryshimi midis tyre, në një masë të gjerë, qëndron në rëndësinë e përcaktimeve të bërë midis tregut dhe pagave natyrore. Kështu, në përcaktimet e termave të bëra nga Ricardo, pagat natyrale (natural wages), përcaktohen të jenë diçka, nëpërmjet së cilës mund të mbahet kategoria e punëmarrësve. Nga ana tjetër, paga e përcaktuar nga tregu, mund, që në një shoqëri të përmirësuar, për një kohë të papërcaktuar, të jetë në mënyrë konstante mbi normën natyrore. Duhet nënvizuar se pagat e përcaktuara nga tregu (Market Wages), në ndryshim nga pagat natyrale (Natural Wages), kanë qenë subjekt i diskutimeve të shumta, dhe teoria e pagave (The Theory Of Wages), e cila u formulua gradualisht nga

ekonomistet midis Ricardos dhe J.S.Millit, ishte qartësisht një teori e pagës së përcaktuar nga tregu (A Theory Of Market Wages). Megjithatë, veç këtyre zhvillimeve, duhet pranuar se doktrina e pagës natyrale (The Doctrine Of Natural Wages) nuk u refuzua. Vetë pagat duhet të vlerësohen duke u nisur nga dy këndvështrime: - si një pjesë e produktit ose të ardhurave të shoqërisë, e cila i është shpërndarë punëmarrësit, ose si një shumë komoditetesh, e gatshme për konsum, të cilën një punëmarrës mund të sigurojë në mënyrë individuale. Problemet që lidhen me pagat, dhe ato që lidhen me pagat për individë, janë krejtësisht të ndryshme. Kështu, e para përfshin një diskutim, i cili ka të bëjë me pagat e përgjithshme, e që mund të lidhet me diskutimet për pagat mesatare, ndërsa e dyta, ka të bëjë me diskutimet dhe përshkrimet e shkaqeve se përse paga e “A” është kështu, dhe më shumë ose më pak se ajo e “B”. Duhet nënvizuar se Teoria e Fondit të Pagave (The Wages-Fund Theory) diskuton kryesisht problemet që lidhen me pagat e përgjithshme, duke u marrë pak ose aspak me diskutimet në lidhje me pagat e veçanta. Kjo është një teori që lidhet me burimin, nga të cilat pagat paguhen, më shumë se sa një teori, e cila shpjegon diferencat aktuale në lidhje me pagat e përfituara. Nga ana tjetër, Teoria e jetesës (The Subsistence Theory), kryesisht është një teori që studion pagat e veçanta. Nëpërmjet çdo ndryshimi në drejtim të njohjes së standardeve të jetës si elastike, Teoria e jetesës (The Subsistence Theory), u bë gjithmonë e më tepër një teori e pagës së veçantë, duke shpërfillur në këtë mënyrë problemet e përgjithshme.

Problematika e përcaktimit të pagave të veçanta, është padyshim më interesante midis të dyjave, por ajo lidhet ngushtësisht me përfundimet shkencore. Kështu, Teoria e fondit të pagave (The Wages-Fund Theory), i përkushtohet plotësisht diskutimit të burimit prej së cilës paga paguhet, si dhe ligjeve të cilat rregullojnë shumën e fondit të pagave. Kjo teori, nuk kontribuon në mënyrë serioze në diskutimin e pagave të veçanta, por pranon se pagat e veçanta mund të rriten ose ulen vetëm si rrjedhojë e pagave të tjera. Teoria e Fondit të Pagave (The Wages-Fund Theory), është një teori e ofertës dhe kërkesës dhe natyrshëm diskuton ofertën dhe kërkesën për punë si dhe forcën që sjell ekuilibrin midis tyre. Kjo teori mund të formulohet në mënyrë të përshtatshme, duke marrë në konsideratë propozimet në lidhje me

disa çështje, sidomos me atë, që së pari, lidhet me ofertën për punë.

Teoria origjinale e Fondit të Pagave (Wages – Fund Theory), pranon se shumica e pasurisë, e cila shkon për punën, përcaktohet nga punëdhënësi, gjë e cila qëndron thelbësisht e vërtetë edhe në interpretimin e modifikuar që i bëhet Fondit të Pagave (Wages Fund).

Nga ana tjetër, baza e kësaj teorie, përbën edhe gabimin thelbësor të saj. Kështu, gabimi thelbësor i saj qëndron në trajtimin e ofertës dhe kërkesës si të fiksuara. Megjithatë, për post kësaj, duhet theksuar se Teoria e Fondit të Pagave (The Wages-Fund Theory), në fund të fundit, është mjeti më i përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve të lidhura me pagën. Është pikërisht kjo teori, e cila njihet që ekzistojnë dy anë të ekuacionit.

**2.4** Teoria e Produktivitetit të Punës (The Productivity Of Labor Theory), u zhvillua si kritikë e Teorisë së Fondit të Pagave (Wages – Fund Theory). Paraprakisht, evidentojmë se është e vështirë të kuptosh diferenca thelbësore midis këtyre dy teorive, për shkak edhe të faktit se të dyja teoritë mbështeten në lidhjen që qëndron midis pagave të larta dhe produktivitetit të lartë. Pikërisht, nisur nga kjo e vërtetë, njëra teori mbështet faktin se pagat e larta paraprijnë dhe nxisin rritjen e produktit, i cili, në kohë, justifikon pagat e larta, ndërsa teoria tjetër, mbështet të kundërtën e së parës. Kështu, sipas kësaj të fundit, pagat e larta paguhen atje ku efënca e punës është e madhe, dhe paguhen vetëm sepse efënca është e madhe. Megjithatë, vlen të theksohet se, të dyja teoritë kundërshtare bazohen tek i njëjti fakt, lidhja që qëndron midis pagave të larta dhe produktivitetit të lartë. Teoria e Produktivitetit (The Productivity Theory) mbështet në parimin se çmimi i kërkesës së punës përcakton pagat. Kjo teori, mohon gati plotësisht ofertën e punës, sepse e konsideron çështjen e çmimit të ofertës të parëndësishme dhe të panevojshme.

**2.5** Teoria e Negocimit të Pagës (The Bargain Theory Of Wages). Edhe në fazat industriale më të zhvilluara, shitja dhe blerja e punës ka vazhduar e bazuar në karakteristikat primitive të shkëmbimit. Çmimi i punës përcaktohet nga vlerësimi që i bën asaj punëdhënësi dhe punëmarrësi. Por, nëse punëmarrësi e vlerëson shumë lartë çmimin me të cilin ai ofron të shesë, ose punëdhënësi e vlerëson shumë ulët çmimin me të cilin ai dëshiron të blejë, asnjë shkëmbim nuk do të



realizohet. Por, përgjithësisht, nevojat e punëmarrësit dhe motivet e punëdhënësit, i tejkalojnë këto vështirësi. Teoria e çmimit të ofertës së punës, nuk kërkon të jetë në kundërshtim me teorinë e çmimit të kërkesës së punës. Të dyja mund të jenë njëkohësisht të vërteta, dhe të dyja janë njëkohësisht të nevojshme për një formulim të plotë. Teoria e Fondit të Pagave (The Wages-Fund Theory), e cila u prezantua më lart, është bashkimi i dy teorive të tjera të mëdha. Sipas saj, pagat përcaktohen vetëm nga konkurrenca. Kështu, konkurrenca midis punëdhënësve, tenton të rrisë pagat, ndërsa konkurrenca midis punëmarrësve për punë, tenton të ulë pagat. Në këto kushte, oferta dhe kërkesa e punës është e një rëndësie përcaktuese. Por, sigurisht që konkurrenca, edhe pse një faktor i rëndësishëm, nuk është i vetmi faktor përcaktues i pagave. Kështu, pozita e fortë ose e dobët e punëmarrësit, përcaktohet vetëm pjesërisht nga numri i konkurrentëve për punë. Në këto çështje, kërkohet të merret në vlerësim në mënyrë të padiskutueshme edhe njohja e punëmarrësit në lidhje me kushtet e përgjithshme të ofertës dhe kërkesës, të cilat do të përbëjnë avantazh për të në vlerësimin e forcës së pozitës së tij dhe dobësisë së punëdhënësit, gjë e cila do të përcaktojë edhe vendimin e tij. Fuqia e punëmarrësit, si një negociator, varet nga njohjet e tij në lidhje me tregun, avantazh të cilin e zotëron gati gjithmonë punëdhënësi si rrjedhojë e informacionit të gjerë që ai disponon. Kjo bën që pozita e tij të vazhdojë të jetë më e favorshme se ajo e punëmarrësit. Është kjo arsyeja që në ditët e sotme, zyrat e punës, shihen si pjesë e padiskutueshme e makinerisë administrative e çdo shteti të përparuar, pasi nëpërmjet tyre, punëmarrësi mund të gjejë informacionin e nevojshëm që do t'i mundësojnë atij një negociim më efektiv me punëdhënësin, në përcaktimin e pagës së punës

Një tjetër element, i cili e vështirëson punëmarrësin në vëzhgimin e këtij informacioni të rëndësishëm, ka të bëjë me metodat e rimbursimit të përdorura nga punëdhënësi. Kështu, ky sistem trukimi, kufizon mundësinë e punëmarrësit për sigurimin e informacionit të saktë në lidhje me tregun e punës. Një prej këtyre elementeve të përdorura nga punëdhënësit, ka të bëjë me ndryshimin midis pagës reale dhe pagës. Kështu, për punëmarrësin, është gati e pamundur të përcaktojë pagën për të siguruar informacionin e

nevojshëm përballë punëdhënësit. Kësaj, po t'i shtohen edhe metodat e ndryshme të pagesës<sup>223</sup>, ka të njëjtin efekt të punëmarrësi, duke e bërë për të, më të vështirë sigurimin e informacionit. Informacioni nuk është fuqi, vetëm në rastin kur të dy, si punëdhënësi dhe punëmarrësi e disponojnë atë, dhe në këtë pikëpamje, punëdhënësi ende është më i fortë se punëmarrësi. Nga ana tjetër, për shkak se punëmarrësi duhet të jetojë nëpërmjet punës së tij, është pikërisht ai, që më shpesh, kërkon punëdhënësin, se sa punëdhënësi të ndjekë punëmarrësin. Në këtë pikëpamje, punëdhënësi duhet parë si qendra e tërheqjes.<sup>224</sup>

Duket se asnjë teori nuk është mjaftueshmërisht e fortë për t'u përballur me kundërshtitë e ngritura kundër saj, sepse asnjë prej këtyre teorive nuk është e përshtatshme për të shpjeguar të gjitha faktet. Megjithatë, njohja me këto teori, dhënia secilës prej tyre vendin që i takon, evidenton se asnjë prej tyre nuk është plotësisht e gabuar apo plotësisht e drejtë, por njohja me to, parimet që ato përcjellin, na sigurojnë një parim përcaktues, se cila pjesë e këtyre teorive është e vërtetë dhe cila jo, duke na dhënë në këtë mënyrë konturet e një teorie të plotë.<sup>225</sup>

### 3. Kategoritë e pagave.

Koncepti i pagës është shumë kompleks. Për një njohje sa më të plotë të saj, është i nevojshëm, evidentimi i kategorive të ndryshme të pagës.

**3.1** Kategoria e parë e pagave i klasifikon ato në dy grupe të mëdha: pagat nominale dhe reale (salaire nominal et salaire reel). Me pagë nominale (salarie nominal), kuptohet shuma e parave që punëmarrësi siguron nga puna e tij. Ndërsa, me pagë reale (salaire reel), kuptohet sasia e të mirave ose të objekteve të tjera të dobishme që punëmarrësi mund të sigurojë nëpërmjet kësaj shume parash. Paraja në vetvete ka veçse vlerë shkëmbyese. Ajo çfarë në të vërtetë përbën çmimin, është mundësia për të shkëmbyer, në këmbim të gjërave të nevojshme për jetën. Por, jo kudo dhe gjithmonë, me të

<sup>223</sup> Në bazë të orëve, punës së kryer etj.

<sup>224</sup> David Ricardo.

<sup>225</sup> J.Pelissier – G.Anzero – E.Docke “Droit du travail”, Paris 2013, f.445 – 452.

njëjtën shumë parash mund të blihen të njëjtat objekte.

**3.2** Kategoria e dytë, lidhet me kategorizimin që i bëhet pagës: në të holla, në natyrë dhe pagë mikse ose e përzierë (salaire en especes, salaire en nature et salaire mixte). Përgjithësisht, paga e punëmarrësit e paguar në para, përbën pagën në të holla (salaire en especes).

Ndonjëherë, paga punëmarrësit i paguhet në të mira, apo në mallra, dhe kjo përbën pagën në natyrë (salaire en nature). Kur paga e punëmarrësit paguhet një pjesë në para dhe, një pjesë në të mira ose mallra përbën pagën mikse ose të përzierë (salaire mixte).

**3.3** Kategoria e tretë, dallon pagën në pagë në kohë dhe pjesë (salaire au temps et salaire aux pieces). Në pagën në kohë (salaire au temps), punëmarrësi paguhet në bazë të orëve, ditëve, ose muajve të punës. Paga për orë (salaire a l'heure), është e zbatueshme vetëm në një numër të caktuar industrish, dhe ka avantazhin e të siguruarit të punëmarrësit një pagesë fikse, duke evituar orët jashtë orarit. Disavantazhet në lidhje me këtë formë pagese, kanë të bëjnë me faktin që përgjithësisht, në këtë formë pagese, nuk bëhet diferencimi midis punëmarrësit të mirë dhe punëmarrësit të zakonshëm, duke favorizuar në këtë mënyrë dembelizmin në punë dhe prodhimin sa më pak të jetë e mundur gjatë kohës së punës.

Me pagë në pjesë ose në copë (salaire aux pieces), kuptohet paga që punëmarrësi merr në përpjesëtim me kohën që ka vënë në dispozicion të punëdhënësit të vet, por paga që punëmarrësi përfiton në përpjesëtim me punën që ka bërë. Në këtë kuptim, punëdhënësi e paguan punëmarrësin në bazë të tonëve të karbonit të nxjerrë, këpucëve të prodhuara etj. Kjo formë pagese bën që, jo rrallë punëmarrësi të prodhojë më shumë, në mënyrë që të rritet paga e tij. Nga ana tjetër, paga në bazë të prodhimit, mund të praktikohet në tri mënyra të ndryshme: Në disa raste, nga një punëmarrës që punon vetëm, dhe siguron nëpërmjet punëdhënësit punën dhe pagën. Në disa raste të tjera paraqitet nga një grup punëmarrësish të bashkuar, për të zbatuar së bashku një punë, dhe për të ndarë midis tyre çmimin e punës. Ndërsa, rastet e tjera, lidhen me kontraktimin. Kontraktimi është regjimi juridik, nëpërmjet të cilit një punëmarrës kontraktin personalisht një punë, të cilën ai do ta realizojë. Paga në pjesë (copë), sjell disa përparësi të pamohueshme në krahasim me pagesën në kohë. Kështu, kjo formë page stimulon vet aktivitetin e

punës, duke e nxitur punëmarrësin të prodhojë sasi më të mëdha, në mënyrë që të sigurojë më shumë të ardhura. Nga ana tjetër, kjo formë page dhe pune, e bën punëmarrësin më të pavarur nga punëdhënësit, duke i mundësuar atij që të jetë më pranë familjes, pasi këtë punë, ai mund ta kryejë edhe në shtëpi. Shqetësimi për këtë formë page lidhet me cilësinë e produktit. Kështu, punëmarrësi duke synuar të prodhojë sa më shumë, në mënyrë që të sigurojë sa më shumë të ardhura, për vetë dhe familjen e tij, mund të neglizhojë cilësinë e produktit që prodhon.

**3.4** Kategoria e katërt, e klasifikon pagën në pagë direkte dhe indirekte (salaire direct et salaire indirect). Paga direkte (salaire direct), është ajo që i jepet punëmarrësit nga punëdhënësi në bazë të marrëveshjes së arritur midis tyre. Ajo përfshin pagën aktuale apo pagën jo aktuale, të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Paga e jashtëzakonshme përbëhet nga mbipagat, primet dhe pjesëmarrjet në fitime.

Pagat indirekte (salaire indirect), nuk janë gjë tjetër veçse subvencionet<sup>226</sup> e dhëna nga punëdhënësi.

**3.5** Kategoria e pestë, i ndan pagat në pagë minimale dhe maksimale (salaire minimum et salaire maximum). Me Pagë Minimale (salaire minimum), duhet kuptuar ajo që i jepet punëmarrësit për të siguruar jetesën. Paga minimale ligjore duhet kuptuar ajo pagë që caktohet nga shteti me qëllim parandalimin e shfrytëzimit të punëmarrësit dhe nevojave të tij.

Me Pagë Maksimale (salaire maximum), kuptohet paga më e lartë, paga ekstreme që punëdhënësi nuk duhet ta kalojë, me qëllim mos tejkalimin e kostove të veta dhe interesit të punëmarrësit për të punuar. Ajo nuk mund të shkojë përtej, pa siguruar fitime.

**3.6** Kategoria e gjashtë, e klasifikon pagën në pagë të drejtë dhe pagë konvencionale<sup>227</sup> (juste salaire et salaire conventionnel). Me pagë të drejtë (juste salaire), duhet kuptuar ajo pagë që kompenson në mënyrë të drejtë punën e bërë nga punëmarrësi. Kjo nënkupton shpërndarjen e drejtë të fitimeve të siguruara nga produkti, në

<sup>226</sup> Subvencionet janë pjesë e pagës. Me këtë term duhet kuptuar avantazhet e ndryshme që punëdhënësi i jep punëmarrëse të vet në formën e çmimit të reduktuar të strehimit, ngrohjes, subvencionet për fondin e pensioneve etj. Këto, zakonisht përfshihen te kushtet plotësuese të kontratës individuale të punës.

<sup>227</sup> Paga për të cilën është rënë dakord, pranuar nga të dyja palët.

përpjesëtim me punën e bërë nga punëmarrësit për prodhimin e këtij produkti. Pikërisht, përcaktimi i pagës së drejtë përbën edhe pjesën më të vështirë në përcaktimin e pagës.

Me paga konvencionale (*salaire conventionnel*), kuptohet ajo pagë që është diskutuar dhe është rënë dakord nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Kjo pagë është rezultat i një marrëveshje kontraktore. Pikërisht, bazuar në këtë marrëveshje, kjo pagë mund të rritet aq shumë sa të ngatërrohet me pagën e drejtë, ose në të kundërt, mund të ulet aq shumë sa të cenohet të drejtat dhe nevojat e punëmarrësit. Nëse rregullat e drejtësisë do të zbatoheshin rreptësisht, pagën konvencionale dhe pagën e drejtë do t'i dallonte vetëm emri. Këtyre dy formave të pagesës, mbi të gjitha që prej Manifestit Papal, *Rerum Novarum*<sup>228</sup>, besohet se i duhet shtuar paga e drejtë (e ndershme). Paga e ndershme, është ajo që vjen në përputhje me mosdiskriminimin, nën të cilën ajo shpërblen në mënyrën e duhur dhe spontane dhe jo nëpërmjet detyrimit. Por, kjo zgjidhje nuk duhet keqkuptuar me bamirësinë. Kështu, për shembull, nëse një punëmarrës i lidhur nëpërmjet një kontrate pune, gjatë një dite punon shumë më mirë se të tjerët, punëdhënësi i jep atij një pagesë më të lartë, e cila është kërkesë e ndershmërisë, e mosdiskriminimit, e zbatimit të barabartë të ligjit të pagave.

**3.7** Kategoria e shtatë, i klasifikon pagat në paga individuale dhe paga familjare (*salaire individual et salaire familial*). Paga individuale (*salaire individual*), është ajo për përcaktimin e së cilës, punëmarrësi shihet si një individ i izoluar. Dhe shqetësimi i vetëm në këndvështrim të kësaj page, është vetëm sigurimi i nevojave personale të punëmarrësit. Në këtë kategori page nuk merren në konsideratë nevojat e bashkëshortes ose fëmijëve që punëmarrësi mund të ketë në ngarkim.

Ndërsa në pagat familjare (*salaire familial*), punëmarrësi vlerësohet si kryetari i një familjeje, së cilës, nëpërmjet punës së tij, duhet t'i sigurojë ushqimin e çdo dite. Për të përcaktuar këtë lloj page, nuk duhet të merren parasysh vetëm nevojat e punëmarrësit, por edhe nevojat e atyre që varen prej tij. Paga familjare është ajo që i korrespondon nevojave të mbajtjes së një familje punëmarrëse.

<sup>228</sup> Letër Papale, e publikuar në 15 maj 1891 nga Papa Leon – XIII. Ajo përbën tekstin hyrës të doktrinës sociale të Kishës Katolike.

Nga ana tjetër, vetë paga familjare, kategorizohet në pagën familjare relative, absolute dhe kolektive.

Paga familjare relative (*salaire familial relative*), ka për pikë nisje pohimin e Manifestit Papal (*Rerum Novarum*), sipas së cilës pagat nuk duhet të jenë të pamjaftueshme për ekzistencën e punëmarrësit të ndershëm. Sipas saj, punëmarrësi duhet të marrë një pagë të tillë që të bëjë të mundur jetesën e tij së bashku me familjen me një normë që rritet në përputhje me nevojat e familjes dhe të numrit të fëmijëve. Në ndryshim me sa më sipër, mbështetësit e pagës familjare absolute (*salaire familial absolu*), nuk marrin parasysh numrin e fëmijëve dhe nevojat e veçanta të një familje. Sipas kësaj nënkategorie, shpërblimi është i njëjtë për të gjithë punëmarrësit që kryejnë të njëjtën punë.

Nënkategoria e tretë, ka të bëjë me pagat familjare kolektive (*salarie familial collectif*). Në këtë rast, mbështetësit e kësaj nënkategorie page, mendojnë se nuk është e nevojshme që paga e vetme e punëmarrësit të shërbejë për të mbuluar të gjitha nevojat e një familjeje të vendosur në kushte normale. Ata mendojnë se për këtë shërbejnë bashkimi i pagave, paga kolektive e të gjithë anëtarëve të një familjeje, duke siguruar në këtë mënyrë nevojat e zakonshme, të tashme dhe të ardhshme të kësaj familje. Kështu, punës së babait, ata i bashkojnë punën e nënës dhe fëmijëve, kur nëna dhe fëmija janë të aftë për punë, për të siguruar pagën familjare.

**3.8** Kategoria e tetë, i dallon pagat në pagat e tanishme dhe pagat natyrore, ose të nevojshme, apo normale. Paga e tanishme (*salaire courant*), është ajo që Ricardo i përcaktonte si të ardhurat që merr në fakt punëmarrësi në përputhje me raportin e kërkesës dhe ofertës. Kjo pagë ndryshon në përputhje me vendet, madje dhe brenda të njëjtit vend. Ajo ndryshon në përputhje me profesionet e ndryshme.

Paga natyrore (*salaire naturel*), e njohur edhe si paga e nevojshme (*salaire necessaire*), ose paga normale (*salaire normal*), nuk kuptohet njësoj në të gjithë botën. Kështu, diku, paga natyrore ngatërrohet me pagën e drejtë, dhe përfaqëson ato të ardhura që punëmarrësi siguron nga puna e tij, bazuar në të drejtën natyrore. Sipas autorëve të tjerë si, Smith, Ricardo, Malthus, Turgot, J.B.Say, Bastiat, Stuart Mill, H.Geroge, paga natyrore, është shuma rreptësisht e domosdoshme për punëmarrësin për të jetuar. Në të gjitha llojet e punëve, shkruan

Turgot, paga e punëmarrësit duhet të jetë e tillë dhe, në fakt është e tillë, që thjesht siguron atë që është e nevojshme për jetesën.

Sipas ekonomistëve, paga natyrore ngatërrohet me pagën minimale, gjë e cila nuk është e saktë<sup>229</sup>.

#### 4. Regjimi juridik i sistemit të pagave në vendin tonë

**4.1** Analiza e regjimit juridik të sistemit të pagave të punës në vendin tonë, nënkupton një sqarim paraprak të vetë sistemit të pagave. Sistemi i pagave është i domosdoshëm për organizimin e drejtë të pagës së punës. Pikërisht, me ndihmën e këtij mekanizmi, realizohet diferencimi i pagës së punës sipas sasisë, cilësisë, kualifikimit, vjetërsisë, vështirësisë, rrezikshmërisë së punës etj. Në këtë mënyrë synohet të vendosen raporte të drejta në pagën e punës në përputhje me parimet që e përshkruajnë këtë sistem. Paga e punës të punëmarrësve teknikë e administrativë, ndërtohet mbi një sistem të tillë, masa e së cilës varet nga detyra që kryen punëmarrësi, vëllimi dhe kompleksiteti i punës, si dhe një kompleksitet faktorësh të tjerë si rëndësia e degës, kualifikimi, vjetërsia e punës sipas specialitetit të punëmarrësve.

Sistemi i pagës së punës quhet mënyra me të cilën përcaktohet raportin ndërmjet punës së kryer nga punëmarrësi, të matur sipas treguesve të caktuar dhe masës së shpërblimit që i takon për atë punë. Mund të thuhet se, në marrëdhëniet juridike të punës, sistemi i pagave të punës përfaqëson në vetvete tërësinë e të drejtave që vendosin raportin ndërmjet masës së pagës të punëmarrësve, d.m.th. pagës së punës dhe masës së punës së kryer.

**4.2** Legjislacioni ynë, i pagave të punës, nisur nga format themelore të organizimit të punës që zbatohen në vendin tonë, njeh këto sisteme kryesore të pagave të punës: pagë me kohë, pagë sipas punës së kryer (pagë në njësi, në detyrë ose me komision), pagë në funksion të rezultateve të ndërmarrjes (me pjesëmarrje në fitim ose në xhiron e të ardhurave).

Këto sisteme të veçanta pagash, përcaktohen nga veçoritë themelore të degës ose sektorit përkatës. Dallimet midis sistemeve

kryesore të pagës së punës, përcaktohen nga karakteri i ndryshëm i metodës me të cilën matet puna e punëmarrësit të këtij ose atij sektori. Kështu, nëse masa e pagës së punës përcaktohet mbështetur në kohëzgjatjen e punës, d.m.th. në njësinë e kohës (orë ose ditë), gjatë së cilës punëmarrësi ka kryer punë, kjo përbën sistemin e pagës në kohë. Në rastet kur paga mbështetet në normën e punës ose të prodhimit, do të kemi sistemin e pagës në copë. Ndërsa, kur mbështetet në rezultatin e ndërmarrjes, do të kemi sistemin e pagës me pjesëmarrje në fitim.

Sidoqoftë, vlerësimi i llojeve të ndryshme të punës, për të caktuar formën e pagës së punës, merr në çdo rast një rëndësi të veçantë<sup>230</sup>.

#### 5. Paga e drejtë

**5.1** Ashtu siç kemi evidentuar edhe më sipër, një prej problematikave më të mprehta në lidhje me pagën, është përcaktimi i pagës së drejtë<sup>231</sup>. Pikërisht, detyrimi i pagesës së punëmarrësit me çmimin e punës së tij, përbën një detyrim fillestar të drejtësisë. Ndër detyrat kryesore të punëdhënësit, është dhënia e çdokujt prej punëmarrësve të vet pagën e përshtatshme. Një pagë është e drejtë kur paguan drejt punën e punëmarrësit dhe i siguron atij një pjesë në shpërndarjen e fitimit, në përputhje me pjesën që ka kontribuar në prodhim. Kjo pagë, në rrethana normale nuk duhet të jetë e pamjaftueshme për të siguruar ekzistencën e punëmarrësit. Sigurisht, përcaktimi i masës së drejtë të pagës, nuk është e thjeshtë. Për ta përcaktuar atë, duhen marrë parasysh disa çështje kryesore.

**5.2** Fillimisht evidentojmë se lehtësisht mund të dallohen dy lloje pagash të drejta: pagën e drejtë absolute dhe pagën e drejtë relative.

Paga është e drejtë, në një kuptim absolut, kur ajo jo vetëm përfaqëson mirë standardet që i shkojnë punëmarrësit, në përputhje me çmimin që shitet në treg produkti i prodhuar prej tij, por gjithashtu, i siguron atij të ardhura të mjaftueshme për një jetesë të ndershme. Paga e drejtë relative, është kur ajo përfaqëson saktë pjesën që i takon

<sup>230</sup> Kudret Çela, Kontrata individuale e punës (monografi), Tiranë, 2013, f.183.

<sup>231</sup> Codice Europeo del Lavoro, Milano 2009, f.418, 421, 428, 436, 448, 457.

<sup>229</sup> L.Gariget.P.S.S. Le Salaire. Librairie Bloud & Co. Paris 1907, f.10.

punëmarrësit nga çmimi i shitjes së produktit që ai prodhon, por duke i hequr taksat e nevojshme që duhet për t'i siguruar një jetesë të ndershme punëmarrësit në kushtet e konkurrencës ose të shkaqeve të tjera. Paga e drejtë relative, duhet të jepet nga punëdhënësi pa cenuar ligjet në fuqi. Ndërsa, paga e drejtë absolute nuk mund të jepet gjithmonë, por gjithmonë punëdhënësi duhet të bëjë gjithçka që varet prej tij, për t'i siguruar këtë lloj page punëmarrësit.

**5.3** Sigurisht, përcaktimi i pagës së drejtë ka pasur edhe mbështetjen e vet doktrimore. Kështu, sipas teorisë së Shkollës Liberale, kontrata e punës është një kontratë si gjithë të tjerat, dhe i përket palëve të saj, të debatojnë e të arrijnë kushtet e kësaj kontrate. Në kushtet kur kontraktuesit janë vërtetë të lirë, dhe çdo mashtrim i mundshëm në lidhje me këtë kontratë është eliminuar, atëherë në çastin e nënshkrimit të kontratës, i kërkohet vetë palëve të respektojnë kushtet e caktuara në këtë kontratë.

Rrjedhimisht, kur punëmarrësi ka pranuar një pagë jashtë çdo trysnie ose joshjeje, kjo pagë do të konsiderohet si një pagë e drejtë. Në këto kushte, punëdhënësi duke paguar këtë lloj page, përmbush të gjitha detyrimet para ligjit. Sa më sipër, ligji mund të veprojë vetëm në kushtet kur punëdhënësi shkel atë që ka premtuar. Sipas kësaj shkolle, çdo pagë e arritur si rrjedhojë e një debati të lirë midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, është natyrore dhe normale. Kundërshtitë në lidhje me këtë teori kanë të bëjnë me atë se nuk merr parasysh faktin që kushtet e palëve kontraktuese janë shumë të ndryshme. Kështu, në kushtet aktuale të zhvillimit industrial, punëmarrësi nuk gjendet në të njëjtin raport si punëdhënësi, për shkak se ai ndodhet në kushte inferioriteti kur bëhet fjalë për të debatuar në lidhje me kushtet e kontratës së punës. Ky fakt është njohur edhe nga Adam Smith, kur shprehet se: “vërtetë nevojat e të dyja palëve janë të njëjta, por nevojat e punëmarrësit janë më urgjente se ato të punëdhënësit. Punëdhënësi mund të presë, ndërsa punëmarrësi jo”.

Po kështu, sipas kundërshtarëve të kësaj teorie, liria e pretenduar e punëmarrësve nuk është veçse sipërfaqësore. Punëmarrësi, nuk mund të kundërshtojë masën e pagës së propozuar nga punëdhënësi, edhe në kushtet kur ajo është e pamjaftueshme. Ai vetëm mund të zgjedhë midis pranimit të pagës që i është ofruar, ose të mbetet i papunë.

Por, papunësia është uri për atë dhe fëmijët e tij. Pra, midis këtyre dy mundësive, punëmarrësi pranon të zgjedhë edhe një pagë më të ulët se sa të qëndrojë i papunë.

**5.4** Teoria e Shkollës Socialiste mbi pagën e drejtë, e përfaqësuar nga K.Marks, mbështetet në mohimin e të gjitha llojeve të pagave, duke theksuar që pagat duhen zëvendësuar me një regjim të vetëm, të barabartë dhe që i përgjigjet më mirë aspiratave legjitime të punëmarrësve. Kjo teori është antikushtetuese, regresive, sepse nuk mban parasysh faktin se njerëzit nuk janë të barabartë nga pikëpamja e aftësive, formimit profesional, përkushtimit në punë etj.

Sipas teorisë së mësipërme, kapitali, i përfaqësuar nga punëdhënësit, në mënyrë të padrejtë ka monopolizuar një pjesë të prodhimit. Kështu, sipas kësaj teorie regresive, të gjitha të ardhurat e punëdhënësve nuk janë gjë tjetër veçse puna e papaguar e punëmarrësve, që ai e quan mbi vlera kapitaliste.

Kundërshtitë në lidhje me këtë teori absurde marksiste që shqyrtojmë, lidhen *së pari* me faktin që punëdhënësit kanë të drejtë legjitime të mbajnë një pjesë të të ardhurave, në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në këtë prodhim. Sigurisht, që janë tri elementet që marrin pjesë në prodhimin e një objekti material. Këto janë: puna fizike, puna intelektuale dhe kapitali, dhe secili prej këtyre faktorëve ka të drejta reale. Kështu, punëdhënësi nuk duhet parë gjithmonë si një financues i fondeve. Në pjesën më të madhe të rasteve, ai merr pjesë aktive në punën e kompanisë, duke e drejtuar atë. Në këto kushte, roli i tij është i konsiderueshëm në funksionin rregullator, në organizimin dhe shqyrtimin. Dhe suksesi përfundimtar i ndërmarrjes varet, në një pjesë të madhe nga vetë punëdhënësi.

*Së dyti*, edhe në rastet kur punëdhënësi do të ishte vetëm një financues i fondeve, përsëri ai ka të drejtë të mbajë një pjesë të të ardhurave, për shkak të riskut që punëdhënësi merr nga angazhimi në ndërmarrje. Kështu, punëmarrësi paguhet gjithmonë, pavarësisht se produkti mbetet në magazinë, ose se shitet me një çmim më të lartë, duke ndikuar në çmimin përfundimtar të saj. Në këtë mënyrë, punëmarrësi, në ndryshim nga punëdhënësi, nuk merr asnjëherë rrezikun, pasi të ardhurat e tij nuk lidhen me shitjen e produktit.

*Së treti*, edhe në rast se asnjë rrezik nuk do t'i shkactohej punëdhënësit, ai përsëri duhet të ketë të drejtë të mbajë një pjesë të fitimeve të ndërmarrjes së tij, si rrjedhojë e të ardhurave që financon në të. Kështu, paraja duhet të shihet në dy këndvështrime: si mjet shkëmbimi dhe si mjet prodhimi. Si mjet i shkëmbimit, vlera e parasë është e papërfillshme, në ndryshim me vlerën që ajo ka si mjet i prodhimit. Vlera që ka kapitali i investuar nga punëdhënësi në ndërmarrje, nuk mundet veçse të vlerësohet me vlerën e vetë punës. Në këtë kuptim, është pikërisht kapitali i punëdhënësit, ai i cili i mundëson punëmarrësit ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Teoria e fundit në lidhje me pagën e drejtë, përfaqësohet nga shkolla Malthusiane. Kjo mbështetet në parimin që varfëria është e keqja më e madhe prej së cilës mund të vuajë një shoqëri. Kjo teori, synon reduktimin e lindjeve, duke diktuar shtimin e numrit të beqarëve. Në kuptim të kësaj teorie, martesë shihet si një luks.

Duhet nënvizuar se kjo doktrinë është e papranueshme dhe vjen ndesh me natyrën njerëzore. Nuk mund dhe nuk duhet të ketë dallime midis të pasurve dhe të varfërve, punëdhënësve dhe punëmarrësve. E drejta duhet të jetë e njëjtë për të gjithë. Kështu, të gjithë që hyjnë në moshën e martesës, duhet të kenë të drejtën për të menduar për të krijuar një familje. Dhe kjo është një e vërtetë që askush, as para Malthus-it, nuk ka menduar ta vërë në dyshim<sup>232</sup>.

## Përfundime dhe rekomandime

Sikurse del qartë nga analizat e parashtruara më lart, të ardhurat e siguruar në formën e pagës së punës, përbëjnë elementin më të rëndësishëm të një marrëdhënie pune. Aq i vërtetë është ky fakt, sa në rastin që arrihet dakordësia ndërmjet palëve në lidhje me pagën që do të paguhet për një punë të caktuar, marrëveshja midis punëdhënësit dhe punëmarrësit quhet e arritur, dhe do të kemi një marrëdhënie pune. Është pikërisht ky elementi bazë i një kontrate pune, pa të cilin do të kishim çdo gjë tjetër, përveçse një marrëdhënie pune.

Paga, është qëllimi i punës së punëmarrësit. Futja e tij në këtë

proces varësie, lidhet pikërisht me nevojën e domosdoshme për të siguruar të ardhurat e nevojshme për jetesën e tij dhe të familjes. Nga ana tjetër, pikërisht nën efektin e këtij stimulimi, që është paga, punëdhënësi arrin të sigurojë punën e punëmarrësit, duke realizuar në këtë mënyrë, rritjen e të ardhurave të veta.

Teoritë e ndryshme juridike që analizojnë pagën e punës, hedhin dritë mbi kompleksitetin e saj, lidhjen e ngushtë që ajo ka me punëmarrësin, punëdhënësin dhe marrëdhënien e krijuar midis tyre.

Përcaktimi i saktë i vlerës së pagës dhe regjimi juridik i drejtë i saj, përbën një tjetër problem të rëndësishëm dhe, njëherazi kompleks, i trajtuar shpesh dhe që vazhdon të jetë aq shumë pjesë e diskutimeve.

Autorët e këtij artikulli kanë mendimin se ende asnjë pagë nuk është ajo që duhet të jetë. Kjo dikton vazhdimin dhe thellimin e studimeve të saj si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit që e parashikon atë. Do të sugjerohet që përmirësime të ndjeshme të bëhen së shpejti në Kodin e Punës, në kuadrin e reformimit të tij. Në fund të fundit, në një botë ku gjithçka ka një çmim, është paga, elementi që përcakton pozitën, vlerën, aftësinë e një njeriu në shoqëri. Pikërisht, për të rritur vlerën e pagës së vet, një individ shkollohet, kualifikohet, specializohet dhe kërkon përsosjen e vazhdueshme të tij. Në kushtet kur ky tregues, siç është paga, nuk vlerësohet drejt në raport me aftësitë dhe punën e punëmarrësit, shumëçka tjetër vihet në diskutim, sepse aktualisht, paga është e vetmja busull shoqërore e asaj që ne jemi në shoqëri.

Do të rekomandonim gjithashtu, si një kërkesë të kohës, që në kurikulat e fakulteteve të drejtësisë të zinte një vend të veçantë “E drejta e pagës së punës”, e cila mund të zhvillohej edhe si një modul lënde me zgjedhje, madje edhe në shkollën e Magjistraturës. Edhe nismat dhe oponencat për hartimin dhe përsosjen e legjislacionit të pagave të punës, sipas nesh, duhet të mbajnë dhe bashkautorësinë e shoqërisë civile.

<sup>232</sup> Garriguet, Louis. *Salair*. Librairie Bloud & Co. Paris, 1907, f.33.

## Bibliografi:

1. L.Gariget P.S.S, Le Salarire, Libraire Bloud & Co, Paris, 1907.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
3. Kodi i Punës.
4. Çela, Kudret., Kontrata individuale e punës, (monografi) Tiranë, 2013.
5. Graham, William. The Wage Of Labour. Cassell And Company. LTD.1921.
6. Bureau Of Bussines Research, Bulletin No.25. Labor Terminology, Cambridge 1921.
7. Diritto del lavoro 2012.
8. Droit du travail, 2013.
9. J.Pelissier – G.Anzero – E.Docher, Droit du travail, Paris 2013.
10. G.Pera, M.Papaleoni, Diritto del lavoro, Padova 2003.
11. Reno, Conrad. Labor And Capital, A Discussion Of The Relations Of Employer And Employed. G.P.Putnam's Sons, 1902.
12. Stone, Gilbert. A History Of Labour, George G. Harrap & Co LTD.
13. Ryan, John A. A Living Wage. The Macmillon Company. 1920.
14. Schaffner, Margaret A. Exemption Of Wage. Wisconsin Free Library Commission 1906.
15. Smith, Adam. The Wealth Of Nations. London J.M.Dent & Sons LTD.
16. Rogers, James E. Thorol. Six Centuries Of Work And Wages. Swan Sonnenschein And Co, LIM. 1909.
17. Gompers, Samuel. Labor And The Employer. E.P.Dutton & Company.
18. Taussing. F.W. Wages And Capital, An Examination Of The Eages Fund Doctrine. D.Appleton And Company.
19. Përmirësimi dhe zhvillimi i politikës së pagave, Tiranë 1995.
20. F.Grassini, Salari e partecipazione, Padova.
21. Deklarata Universal e të Drejtave të Njeriut, 1948.
22. Konventa dhe rekomandime të O.N.P.
23. Karta Sociale Europiane ( e rishikuar ).
24. I nuovi contratti di lavoro, Trento, 2005.
25. Codice Europeo del lavoro ( Collana di diritto del lavoro ), Torino 2009.
26. Black's Law dictionary.
27. Vocabulaire juridique, Paris 1990.

## LLOJET E PADISË ADMINISTRATIVE DHE REGJIMI JURIDIK I TYRE

MA. Erajd DOBJANI

Avokat

Doktorant në Departamentin e së Drejtës Publike, UT

Në këtë prag të fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, menduam se do të ishte më e përshtatshme që këtë hapësirë të dhënë në revistë ta shfrytëzonim për një prezantim të mjetit më të rëndësishëm procedural që vë në lëvizje mekanizmin e kontrollit nga gjykatat administrative: padinë administrative. Pas së gjithash, pa këtë të fundit, gjykatat administrative nuk do të ekzistonin.

Në bazë të Ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, mund të dallojmë tri lloje të padisë administrative, që mund të përdoren nga personi i cili ngre padinë, të veçura në përmbajtjen e tyre nga njëra-tjetra: padia administrative mbi ligjshmërinë; padia administrative e juridiksionit të plotë; si dhe padia administrative e ndëshkimit.

### 1. Padia administrative mbi ligjshmërinë

Padia administrative mbi ligjshmërinë përbën mënyrën e zakonshme dhe kryesore të kontrollit të administratës publike, në mënyrë që të mbrohet e drejta objektive, pra të mbrohet parimi i ligjshmërisë. Padia administrative mbi ligjshmërinë mund të përkufizohet si padia që ngrihet kundër çdo veprimi administrativ dhe që ka për qëllim të sigurojë respektimin e ligjshmërisë duke i kërkuar gjykatës administrative

anulimin e aktit administrativ për shkaqe paligjshmërie objektive. Bëhet fjalë për të mundësuar dhe siguruar kontrollin e ligjshmërisë së akteve administrative (akt administrativ në kuptimin e gjerë). Kur ngrihet padia administrative mbi ligjshmërinë, e vetmja çështje juridike që i shtrohet për zgjidhje gjykatës është nëse akti administrativ (akt administrativ në kuptimin e gjerë) është i ligjshëm apo i paligjshëm, duke ngritur shkaqe pavlefshmërie të bazuara mbi shkeljen e të drejtës objektive: shkelje të një norme kushtetuese, ndërkombëtare, ligjore, jurisprudenciale apo nënligjore. Kështu, nuk bëhet fjalë që gjykatës t'i kërkohej që paditësi të njihet titullar i një të drejte kundrejt administratës publike, ose që gjykatës t'i kërkohej që ta detyrojë administratën publike të përmbushë një detyrim ndaj paditësit. Me padinë administrative mbi ligjshmërinë e aktit bëhet fjalë vetëm që gjykata të vendosë mbi ligjshmërinë e aktit, duke u shprehur nëse akti është i ligjshëm apo i paligjshëm dhe nëse është i ligjshëm duke e lënë aktin në fuqi, ndërsa nëse është i paligjshëm duke e anuluar aktin. Gjykata nëse e anulon aktin, nuk do të shprehet mbi tërheqjen e pasojave juridike që vijnë me anulimin e tij, këto pasoja juridike që vijnë me anulimin e aktit tërhiqen nga vetë organi administrativ që ka nxjerrë aktin duke e revokuar atë. Gjykata mjaftohet vetëm me anulimin e aktit të paligjshëm.

Në parim, duhet që padia administrative të ngrihet nga paditësi dhe të argumentohet dhe të mbrohet nga paditësi. Gjithashtu, administratës publike të paditur duhet t'i jepet mundësia që të argumentojë dhe të mbrojë arsyet e nxjerrjes së aktit administrativ dhe ligjshmërinë e tij. Por, Ligji "Për gjykatat administrative" në Nenin 3, pika 4, rreth parimeve të gjykimit administrativ, ka parashikuar si parim të gjykimit administrativ mundësinë e gjykatës administrative, në varësi të natyrës së çështjes, për ta shqyrtuar padinë administrative mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi, si dhe përsëri si parim të gjykimit administrativ, detyrimin e gjykatës që të mos e pushojë gjykimin në rast se nuk paraqiten palët. Këto dy rregulla gjejnë zbatim pikërisht me padinë administrative mbi ligjshmërinë pasi kjo e fundit, siç e thamë, është padi me karakter objektiv. Për rrjedhojë, natyra e çështjes që i parashtrrohet për shqyrtim gjykatës, ligjshmëria e aktit administrativ, çështje me interes publik, justifikon që gjykata ta shqyrtojë atë vetëm mbi bazë aktesh shkresore dhe në rastin kur

palët nuk paraqiten në gjykim edhe pse janë thirrur dhe kanë dijeni rregullisht, sidomos pala paditëse, natyra objektive e çështjes justifikon gjithashtu që gjykata të mos e pushojë gjykimin.

Në gjendjen aktuale të legjislacionit shqiptar, padia administrative mbi ligjshmërinë ndahet në dy padi të ndryshme: në *padinë administrative mbi ligjshmërinë e zakonshme* dhe në *padinë administrative mbi ligjshmërinë e posaçme*, që mund të përshkruhet me termin *padi prefektorale*.

### **1.1 Padia administrative mbi ligjshmërinë e zakonshme**

Neni 17, pika 1, germa a), c) dhe d) të Ligjit "Për gjykatat administrative" përcaktojnë se "*1. Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;... c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;... d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;...*". Nga kjo dispozitë duhen saktësuar dy gjëra: së pari, natyra e pavlefshmërisë apo ligjshmërisë (absolute dhe relative) që do të kërkohej nga paditësi; së dyti, lloji i aktit administrativ (akti administrativ këtu marrë në kuptimin e gjerë) që do të kundërshtohet nga paditësi.

#### **1.1.1 Pavlefshmëria absolute**

Germa c) dhe d) të pikës 1 të Nenit 17 të Ligjit "Për gjykatat administrative" ["*1. Padia ngrihet:... c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;... d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;...*"], përcaktojnë se padia administrative mbi ligjshmërinë mund të ngrihet me objekt "konstatimin e pavlefshmërisë absolute" për aktin administrativ dhe me objekt "konstatimin e paligjshmërisë" për sa i përket veprimit administrativ. Termi "konstatim i paligjshmërisë", që përbën risi në të drejtën administrative shqiptare, duhet kuptuar si sinonim i kërkimit të pavlefshmërisë absolute, kjo edhe për faktin se germa d) e pikës 1 të Nenit 17 të lartpërmendur, vazhdon duke përcaktuar pasojat e konstatimit të paligjshmërisë, duke u shprehur kështu "që nuk



prodhon pasoja juridike”.

Regjimi juridik i pavlefshmërisë absolute të së drejtës administrative, që ne nuk do t'i hyjmë këtu, përveçse sipërfaqësisht, rregullohet nga Nenet 115, germa a), 116 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative. Mjafton këtu të themi se aktet administrative absolutisht të pavlefshme janë aktet e nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin, që do të thotë se akti administrativ do të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm, pra sikur nuk ka ekzistuar kurrë dhe sikur nuk ka prodhuar kurrë asnjë pasojë juridike: kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; si dhe kur akti administrativ është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

### 1.1.2 Pavlefshmëria relative

Germa a) e pikës 1 të Nenit 17 të Ligjit “Për gjykatat administrative” (“1. Padia ngrihet:... a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;...”) përcakton se padia administrative mbi ligjshmërinë mund të ngrihet me objekt “shfuqizimin” e aktit administrativ. Termi “shfuqizim” i përdorur nga dispozita e lartpërmendur referon te nocioni i pavlefshmërisë relative.

Regjimi juridik i pavlefshmërisë relative të së drejtës administrative, që ne nuk do t'i hyjmë këtu, përveçse sipërfaqësisht, rregullohet nga Nenet 115, germa b), 118 dhe 119 të Kodit të Procedurave Administrative. Mjafton këtu të themi se aktet administrative relativisht të pavlefshme janë aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshëm, që do të thotë se akti administrativ do të konsiderohet si i pavlefshëm nga momenti që shfuqizohet, pra sikur ka ekzistuar dhe ka prodhuar pasoja juridike deri në momentin që shfuqizohet nga gjykata.

### 1.1.3 Lloji i aktit që do të kundërshtohet

Për sa i përket pavlefshmërisë absolute, padia administrative mbi ligjshmërinë mund të ngrihet kundrejt akteve administrative dhe veprimeve administrative.

Në bazë të Nenit 2, pika 1 të Ligjit “Për gjykatat administrative”, akt administrativ është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nënligjor normativ. Ndërsa pikat 2 dhe 3 të të njëjtit nen të të njëjtit ligj, përcaktojnë se akt administrativ individual është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, si dhe akt nënligjor normativ është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.

Në bazë të Nenit 2, pika 7, të Ligjit “Për gjykatat administrative”, veprim administrativ është akti administrativ, kontrata administrative, si dhe veprimi tjetër administrativ. Siç e thamë më lart, akti administrativ përfshin aktin administrativ individual dhe aktin nënligjor normativ. Për sa i përket kontratës administrative, ajo përkufizohet në Nenin 6 të Kodit të Procedurave Administrative si një marrëveshje, ku të paktën njëra nga palët, është organ i administratës publike, e cila synon të krijojë, të ndryshojë ose të anulojë marrëdhënie juridike në fushën e së drejtës publike. Veprimi tjetër administrativ, që është tërësisht një koncept i ri në të drejtën administrative shqiptare, përkufizohet si çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm.

Për rrjedhojë, për sa i përket pavlefshmërisë absolute, dalim në konkluzionin se aktet administrative (akti administrativ individual dhe akti nënligjor normativ) mund të kundërshtohen nëpërmjet padisë administrative mbi ligjshmërinë në bazë të Nenit 17, pika 1, germa c) të Ligjit “Për gjykatat administrative”. Gjithashtu, aktet administrative mund të kundërshtohen nëpërmjet padisë administrative mbi ligjshmërinë në bazë të Nenit 17, pika 1, germa d) të Ligjit “Për gjykatat administrative” duke kërkuar konstatimin e paligjshmërisë së tyre sepse bëjnë pjesë te veprimet administrative. Dallimi midis dy objekteve të ndryshme të padisë administrative mbi ligjshmërinë për sa i përket aktit administrativ (konstatimi i

pavlefshmërisë absolute dhe konstatimi i paligjshmërisë), sjell interes për sa i përket legjitimitit të paditësit për të kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute apo konstatimin e paligjshmërisë. Për sa i përket konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, dihet se secila palë e interesuar mund të kërkojë pavlefshmërinë absolute (Neni 117, pika 2, K.Pr.Adm), ndërsa nëse bëhet fjalë për konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ, ligjvënësi ka vënë kusht që paditësi për t'u legjitimuar në kërkimin e konstatimit të paligjshmërisë duhet të ketë interes të arsyeshëm. Nocioni i interesit të arsyeshëm do të mbetet për t'u interpretuar nga gjykata administrative: në varësi të gjerësisë apo të ngushtësisë në interpretimin e këtij nocioni nga gjykata administrative, do të varet edhe legjitimitimi i paditësit për të kërkuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ në bazë të Nenit 17, pika 1, germa d) të Ligjit "Për gjykatat administrative". Mendojmë se paditësi që kërkon të kundërshtojë një akt administrativ për pavlefshmëri absolute, duhet ta bëjë këtë në bazë të germës c) të pikës 1 të Nenit 17 të Ligjit "Për gjykatat administrative", duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, pasi për këtë kërkim çdo palë që ka interes (të arsyeshëm ose jo) është e legjitimuar në këtë kërkim. Ndërsa kërkitimi i pavlefshmërisë absolute i aktit administrativ në bazë të germës d) të pikës 1 të Nenit 17 të Ligjit "Për gjykatat administrative", duke kërkuar konstatimin e paligjshmërisë, bën të nevojshëm që paditësi të legjitimohet duke justifikuar një interes të arsyeshëm.

Ndërsa veprimet administrative të tjera (kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ), për sa i përket pavlefshmërisë absolute, duhet të kundërshtohen nëpërmjet padisë administrative mbi ligjshmërinë vetëm në bazë të Nenit 17, pika 1, germa d) të Ligjit "Për gjykatat administrative" dhe paditësit, për t'u legjitimuar, do t'i duhet të justifikojë interesin e arsyeshëm.

Për sa i përket pavlefshmërisë relative, vetëm aktet administrative (akti administrativ individual dhe akti nënligjor normativ) mund të kundërshtohen nëpërmjet padisë administrative mbi ligjshmërinë duke ngritur shkaqe të pavlefshmërisë relative. Për sa i përket akteve të tjera të natyrës administrative, kontratat dhe veprimet e tjera administrative, këto nuk mund të kundërshtohen nëpërmjet padisë

administrative mbi ligjshmërinë, duke ngritur shkaqe të pavlefshmërisë relative, por vetëm duke ngritur shkaqe të pavlefshmërisë absolute.

### **1.2 Padia administrative e posaçme: padia prefektorale**

Ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", ka parashikuar një mekanizëm kontrolli të ushtruar nga prefekti, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në çdo qark, rreth ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike vendore, sipas të cilit prefekti i kërkon gjykatës administrative kompetente të shfuqizojë, për shkaqe paligjshmërie, aktet e miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki dhe qarqe. Në bazë të Nenit 6, germa d) të këtij ligji, prefekti "është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qarqe". Kreu III i Ligjit "Për prefektin" në Nenet 14, 15 dhe 17, përcakton mënyrën se si efektivisht prefekti verifikon ligjshmërinë e akteve të administratës publike vendore.

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të administratës publike vendore nga prefekti kryhet vetëm mbi aktet me karakter normativ, që sipas Nenit 2, pika 3, të Ligjit "Për Prefektin" janë "aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të tyre". Aktet normative për të cilat prefekti ka kompetencë për verifikimin e ligjshmërisë të parashikuara në Nenin 2, pika 3, të Ligjit "Për Prefektin" korrespondojnë me aktet e parashikuara nga Neni 116, pika 2 e Kushtetutës që parashikon se "Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe". Për rrjedhojë, bëhet fjalë për aktet e nxjerra nga organet e qeverisjes vendore dhe që kanë perimetër zbatimi lokal për komunën, bashkinë ose qarkun, ku organi publik vendor vepron dhe ushtron kompetencat e tij.

Për sa i përket iniciativës së kontrollit, prefekti ka tre mënyra për fillimin e kontrollit të ligjshmërisë: 1) mënyra e parë, që është edhe më e zakonshme, ka të bëjë me detyrimin e çdo organi të qeverisjes vendore në qark që të depozitojë tek prefekti të gjithë aktet me karakter normativ të nxjerra prej tij, brenda 7 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti për aktin e depozituar nga organi i qeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e aktit në zyrën

e protokollit të prefektit; 2) mënyra e dytë ka të bëjë me detyrimin e prefektit, që të paktën dy herë në vit, të verifikojë në vend ligjshmërinë e akteve të qeverisjes vendore; dhe 3) mënyra e tretë është rasti kur prefekti vihet në lëvizje nga ankesat e shtetasve.

### **1.2.1 Detyrimi i organeve të qeverisjes vendore për depozitimin tek prefekti të akteve me karakter normativ**

Procedura e zakonshme për verifikimin e ligjshmërisë, që i korrespondon mënyrës së parë për verifikimin e ligjshmërisë, është parashikuar nga pika 2, germa b) i), ii) të Nenit 14 të Ligjit “Për Prefektin”. Sipas kësaj procedure, prefekti është i detyruar që brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të aktit në zyrën e tij të protokollit, të shprehet për ligjshmërinë e tij. Në rastin kur prefekti vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, atij i lind e drejta t’ia kthejë aktin organit përkatës të qeverisjes vendore që e ka nxjerrë, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Organi i qeverisjes vendore është i detyruar të rishqyrtojë aktin dhe mund ta mbajë aktin në fuqi siç është, ose ta revokojë atë. Vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore pas rishqyrtimit të aktit depozitohet përsëri pranë prefektit sipas së njëjtës procedure dhe afati të ndjekur në depozitimin e parë. Deri këtu kemi të bëjmë vetëm me një kontroll administrativ dhe jo gjyqësor mbi ligjshmërinë e akteve normative të nxjerra nga organet e administratës publike vendore.

Padia prefektorale fillon më tej. Ka dy mënyra: i) ose prefekti ushtron padinë prefektorale mbasi akti është depozituar për herë të dytë në zyrën e tij, sipas procedurës së lartpërmendur. Në këtë rast, kur prefekti vëren përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, ai nuk mund t’ia rikthejë aktin organit të qeverisjes vendore, por duhet t’i drejtohet gjykatës administrative kompetente, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të këtij akti normativ; ii) ose prefekti, kur vëren shkelje ligjore në aktin e depozituar për herë të parë sipas procedurës së lartpërmendur dhe vlerëson se kthimi i aktit organit të qeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, atëherë i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën administrative të kthimit të aktit të lartpërmendur, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente.

### **1.2.2 Detyrimi i prefektit për verifikimin në vend të akteve normative të qeverisjes vendore**

Sipas procedurës së verifikimit në vend të ligjshmërisë, që i korrespondon mënyrës së dytë të verifikimit të ligjshmërisë, të parashikuar nga Neni 15 i Ligjit “Për Prefektin”, prefekti është i detyruar, kur nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në ligje të tjera, që të paktën dy herë në vit të verifikojë ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organet e qeverisjes vendore, si dhe në organizmat që krijohen pranë tyre. Këtu duhet kuptuar se prefekti ka detyrimin ta ushtrojë këtë kontroll ligjshmërie dy herë në vit, por ka mundësinë e plotë që ta ushtrojë këtë kontroll edhe herë të tjera brenda vitit nëse i ka ezauruar dy kontrollet e detyrueshme. Padia prefektorale ushtrohet nëse gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë, prefekti vëren akte të cilat nuk janë depozituar tek ai sipas procedurës së zakonshme të lartpërmendur. Në këtë rast, prefekti ka të drejtë të kërkojë në mënyrë direkte pavlefshmërinë e këtyre akteve pranë gjykatës administrative kompetente.

### **1.2.3 Shqyrtimi nga prefekti i ankesave të shtetasve**

Mënyra e tretë për verifikimin e ligjshmërisë është parashikuar nga Neni 17 i Ligjit “Për Prefektin”, sipas të cilit prefekti shqyrton gjithashtu ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore. Në rast se akti i ankimuar nga shtetasi nuk është depozituar më parë tek prefekti nga organi i qeverisjes vendore sipas procedurës së zakonshme të lartpërmendur, prefekti ka dy mundësi që i ushtron sipas vlerësimit të tij diskrecional: ose i kërkon organit të qeverisjes vendore që ka nxjerrë aktin që të depozitojë këtë akt në zyrën e prefektit dhe në këtë rast, kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefekti ka të drejtë të vëre në lëvizje procedurën e zakonshme për verifikimin e ligjshmërisë të lartpërmendur, të parashikuar nga pika 2, germa b) i), ii) të Nenit 14 të Ligjit “Për Prefektin”; ose prefekti zbaton direkt procedurën e verifikimit në vend të ligjshmërisë të parashikuar nga Neni 15 i Ligjit “Për Prefektin”.

## 2. Padia administrative e juridiksionit të plotë

Padia administrative e juridiksionit të plotë është një padi ku gjykata administrative ka fuqi dhe pushtet që përtej anulimit të aktit administrativ, të shprehet edhe mbi dhënien e një dëmshpërblimi dhe më përgjithësisht, gjykata ka fuqi dhe pushtet që të konkludojë në zëvendësimin e aktit administrativ që kundërshtohet me vendimin eventual të saj. Kjo padi ka për qëllim kryesor mbrojtjen e të drejtave subjektive në çështjen konkrete që gjykatës administrative i paraqitet për shqyrtim dhe kjo e fundit i jep vetë zgjidhje çështjes administrative konkrete të paraqitur.

Padia administrative e juridiksionit të plotë lidhet në mënyrë të pakundërshtueshme me mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe për rrjedhojë bën pjesë domosdoshmërisht në kategorinë e padive subjektive. Por kjo nuk do të thotë se çështja që do t'i shtrohet për shqyrtim gjykatës nuk mund të përfshijë edhe kërkimin e anulimit të aktit administrativ, që përbën padinë mbi ligjshmërinë e aktit dhe që i përket kategorisë së padive objektive. Në fakt, kjo padi administrative e merr emrin e saj si “e juridiksionit të plotë” nga fakti që gjykata administrative përpara së cilës është paraqitur kjo padi ka pushtet apo fuqi që i lejon që të vërë në zbatim dhe të mbrojë të drejta subjektive, dhe që të bëjë më shumë sesa vetëm të anulojë aktin administrativ të kundërshtuar. Për rrjedhojë, padia administrative e juridiksionit të plotë mund të përfshijë padinë administrative mbi ligjshmërinë, por kur e bën këtë, ndryshon nga padia administrative mbi ligjshmërinë për faktin se gjykatës administrative i kërkohet që të bëjë më shumë sesa vetëm anulimi i aktit administrativ të kundërshtuar, duke e detyruar administratën publike të tërheqë pasojat e anulimit të aktit dhe duke i dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes konkrete, kështu për shembull duke i akorduar paditësit edhe dëmshpërblim. Ky është dallimi midis padisë administrative mbi ligjshmërinë dhe padisë administrative të juridiksionit të plotë.

Dispozitat e Nenit 17 me titull “Objekti i padisë”, në pikën 1, germat b), ç), dh), e), ë), f) dhe g) të Ligjit “Për gjykatat administrative”, bëjnë pjesë në kategorinë e padisë administrative të juridiksionit të plotë. Sipas këtyre dispozitave, padia ngrihet: “... b) për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin

e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ; ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë; dh) për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik; e) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit; ë) për përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar kur është rasti dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jokompetent; f) për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm; g) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike”. Nga sa mësipër rezulton se në rastin kur padia e ngritur do të ketë si objekt të saj një ose disa prej dispozitave të lartpërmendura, gjykata administrative është e detyruar që në rastin kur paditësi ka të drejtë, të bëjë më shumë sesa vetëm anulimin e aktit administrativ, pra t'i japë zgjidhje mosmarrëveshjes administrative konkrete.

Rastet e mosmarrëveshjeve administrative që hyjnë në fushën e zbatimit të padisë administrative të juridiksionit të plotë janë, për shembull, përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës publike, përgjegjësia kontraktore e organeve të administratës publike, mosmarrëveshjet administrative në lidhje me kundërvajtjet administrative, mosmarrëveshjet administrative në lidhje me tatimet, mosmarrëveshjet administrative në fushën e të drejtës së urbanizimit, mosmarrëveshjet administrative në fushën e pensioneve dhe kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, etj.

Në aspektin praktik, kur gjykatës do t'i duhet të shprehet edhe mbi çështjen e ligjshmërisë së një akti administrativ, përpos kërimit të germave b), ç), dh), e), ë), f) dhe g) të pikës 1 të nenit 17 të Ligjit “Për gjykatat administrative”, të lartpërmendura, kjo padi do të ketë në objektin e saj edhe kërkimin për shfuqizim tërësisht apo pjesërisht apo konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, apo konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ dhe për rrjedhojë bazë ligjore edhe germat a), c) ose d) të pikës 1 të Nenit 17 të Ligjit “Për gjykatat administrative”. Cilësimi i padisë administrative si padi e juridiksionit të plotë apo

si padi mbi ligjshmërinë e aktit do të varet nga ajo që pala paditëse i kërkon gjykatës. Nëse paditësi i kërkon gjykatës thjesht shfuqizim apo konstatim pavlefshmërie pa tërheqjen e pasojave, padia mbetet padi administrative mbi ligjshmërinë e aktit, ndërsa nëse paditësi, përpos kërimit të anulimit të aktit, shton edhe kërkimin e tërheqjes së pasojave nga ky anulim, atëherë padia do të konsiderohet si padi administrative e juridiksionit të plotë.

### 3. Padia administrative e ndëshkimit

Kjo padi administrative është totalisht e veçantë nga dy të parat. Padia administrative e ndëshkimit nuk ushtrohet për të kundërshtuar një akt administrativ apo një veprim administrativ, por kjo padi ushtrohet për të ndëshkuar persona (fizikë ose juridikë) dhe me qëllim që gjykata të japë dënimin e parashikuar në ligj. Kjo padi ngrihet nga organet e administratës publike në gjykatën administrative kompetente kundër personave fizikë apo juridikë që kanë kryer një shkelje administrative dhe me qëllim që gjykata t'i ndëshkojë këto persona me një masë represive, ose dënim me gjobë, ose dënim me heqje lirie deri në 30 ditë.

Duke qenë se masa administrative e dënimit me gjobë apo masa administrative e heqjes së lirisë, konsiderohet si masa administrative të rënda, atëherë këtu ka prevaluar ideja se vendimi për marrjen e këtyre masave nuk mund të lihet apriori në vlerësimin diskrecionar të organeve të administratës publike. Kështu, Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" dhe Ligji "Për gjykatat administrative", kanë parashikuar se është gjykata ajo që do të vendosë për marrjen e këtyre masave me kërkesën e bërë nga organet e administratës publike përkatëse. Pra, në ndryshim me paditë administrative mbi ligjshmërinë dhe të juridiksionit të plotë, këtu kontrolli që i bëhet veprimeve të organit administrativ është kontroll *apriori* (përpara se organi administrativ ta marrë masën administrative) dhe jo kontroll *aposteriori* (mbasi organi administrativ ta ketë marrë masën administrative).

Megjithëse në Nenin 17 të Ligjit "Për gjykatat administrative", padia administrative e ndëshkimit nuk figuron dhe nuk është trajtuar

në objektin e padive administrative, Neni 7, germa d) dhe dh), të të njëjtit ligj, i jep kompetencë lëndore gjykatës administrative për gjykimin e të gjithë kërkesave të paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin, si dhe për gjykimin e kërkesave të paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë. Gjithashtu, Neni 7, pika 3, germa b) i Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" parashikon se "3. Kompetenca për shqyrtimin e kundërvajtjes i takon:... b) gjykatës, kur parashikohet nga ligji i posaçëm apo në rastet kur ligji parashikon dënim me heqje lirie" dhe Neni 8, pika 2, i të njëjtit ligj parashikon se "2. Në rastet kur organi kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative është gjykata, mund të vendoset dënimi: a) me gjobë; b) me heqje lirie deri në 30 ditë". Nga këto dispozita rezulton se gjykata administrative ka kompetencë për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative sa herë që ligji i posaçëm parashikon se kompetencë për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative do të ketë gjykata, si dhe sa herë që sanksioni i parashikuar për kundërvajtjen administrative është dënim me heqje lirie deri në 30 ditë. Lloji i masës represive që kërkohet të vendosë gjykata është gjithmonë ose dënim me gjobë, ose dënim me heqje lirie deri në 30 ditë, si lloje të dënimit administrativ për kundërvajtësin, parashikohen gjithmonë nga ligji i veçantë që rregullon marrëdhënien juridike në sferën sociale ku është konstatuar shkelja.

### Përfundime

Duke lenë mënjanë padinë administrative të ndëshkimit, për shkak të natyrës së saj totalisht të veçantë, padia administrative mbi ligjshmërinë dhe padia administrative e juridiksionit të plotë klasifikohen respektivisht në dy ndarje teorike: *padia administrative objektive* dhe *padia administrative subjektive*. Padia administrative objektive sjell përpara gjykatës një çështje të së drejtës objektive, që do të thotë një çështje ku për zgjidhjen e së cilës gjykatës do t'i duhet

të ndërmarrë një kontroll përputhshmërie të aktit administrativ me ligjin, pra bëhet fjalë për kontrollin mbi ligjshmërinë e aktit administrativ. Ndërsa padia administrative subjektive sjell përpara gjykatës një çështje të së drejtës subjektive, që do të thotë nëse një person fizik apo person juridik duhet të njihet ose jo si titullar i një të drejte subjektive, për shembull në fushën e përgjegjësisë kontraktore ose jashtëkontraktore, të një të drejte për dëmshpërblim, ose për shembull nëse përfiton shpërblim për pasjen e një titulli shkencor etj.

Për sa i përket të drejtës së gjyqësorit administrativ, siç ajo rezulton nga Ligji “Për gjykatat administrative”, përfundimi në të cilin dalim është se këto dy teori pasqyrohen të përziera. Nga analiza e këtij ligji, padia administrative objektive dhe padia administrative subjektive janë të veçuara, por mund edhe të përzihen me njëra tjetrën, në varësi të kërkimit të paditësit. Kjo do të thotë se paditësi në një akt-padi do të mund të kërkojë edhe kontrollin e ligjshmërisë së një akti administrativ, por edhe njohjen si titullar i një të drejte subjektive.

## Shkurtime

Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”..... Ligji “Për gjykatat administrative”.

## Bibliografia

### *Doktrinë*

1. Ermir Dobjani, E.Toska, E. Puto, Erajd Dobjani, E Drejta Administrative, Kontrolli mbi Administratën Publike, EMAL, Tiranë, 2013.
2. E. Dobjani, E Drejta administrative 1, Botim i ripunuar, Tiranë, 2007;
3. S. Sadushi, E Drejta Administrative 2, Shtëpia botuese

“GrandPrind”, Tiranë, Shtator 2008;

4. E. Dobjani, E drejta administrative 3, Kundërvajtjet administrative në Shqipëri, SHBLU, Tiranë, 2002;
5. E. Stavileci, M. Batalli, S. Sadushi, E drejta administrative, Organizimi dhe veprimtaria administrative, Prishtinë 2012;
6. B. Pollozhani, E. Dobjani, E. Stavileci, L. Salihu, E Drejta Administrative, Aspekte Krahasuese, Shkup 2010;
7. O. Gohin, Contentieux administratif, 7ème édition, Lexis Nexis, Paris, 2012;
8. P. Sandevor, Études sur le recours de pleine juridiction, LGDJ, 1964;
9. H. Le Berre, Droit du contentieux administratif, 2ème édition, Ellipses, Paris, 2010;
10. R. Rouquette, Petit traité du procès administratif, 5ème édition, 2012.

### *Legjislacion*

1. Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.
2. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.
3. Ligji Nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ligji Nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”.
5. Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

## KODI PENAL EUROPIAN<sup>233</sup>

Valbona NDREPEPAJ,  
Universiteti i Tiranës, Shqipëri,  
Nevila KULLOJKA  
Universiteti i Tiranës, Shqipëri,

### Hyrje

Për shumë juristë të flasësh për krijimin e një Kodi Penal European është akoma herët dhe shihet me skepticizëm. Një teori e tillë është më e përhapur sidomos në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit European, të cilat ndoshta nuk janë tepër të familjarizuara me situatën aktuale në të dhe me nevojat që ka tani ai dhe çfarë është e domosdoshme të krijohet për të ardhmen. Me skepticizëm sigurisht shihet edhe nga disa vende anëtare të Bashkimit European, të cilat parimin e sovranitetit e kanë ende tepër të shenjtë<sup>234</sup>. Por nga një vështrim në histori dhe situatës aktuale të Bashkimit European, sidomos pas traktatit të Lisbonës, të flasësh për krijimin e Kodit Penal European nuk është më tabu dhe e pamundur, por në mendimin tonë është domosdoshmëri dhe e ardhmja. Pikërisht dhe fokusi i këtij artikulli është të mbështesim këtë teori, të japim kontributin tonë në formën, strukturën që mund të ketë ky kod, si edhe do të ishim të lumtur që së paku ky artikull të shërbente si ngacmim për të

<sup>233</sup> Artikulli në formën origjinale është prezantuar në gjuhën angleze, më 30 tetor 2012, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare, organizuar nga IJAS, Romë.

<sup>234</sup> Një vend i tillë në mendimin tonë mund të jetë Britania e Madhe, e cila nuk e ka pranuar ende monedhën e përbashkët europiane, euron, si edhe nuk është pjesë e zonës Shengen, ndaj mendojmë se një Kod Penal European do të haste polemika atje,

sjellë në vëmendje idenë e krijimit të një kodi të tillë. Për të realizuar këtë; me anë të metodave hermeneutike dhe interpretative, ne, kemi konsultuar doktrinën dhe legjislacionin e Bashkimit European në këtë drejtim *infra* dhe kemi analizuar disa nga kodet penale kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit European, jo vetëm kaq, por edhe të atyre vendeve potenciale kandidatë<sup>235</sup>. Ne jemi ndalur vetëm në disa vende, sigurisht për arsye gjuhësore<sup>236</sup>. E kemi zgjeruar gjeografinë e Bashkimit European, për t'i paraprirë valëve të zgjerimit në të, për të shmangur problemet si në kodet penale të këtyre vendeve *supra*<sup>237</sup>, dhe sigurisht për të shmangur ndërhyrje në Kodin Penal European, duke i shërbyer kështu qëndrueshmërisë dhe seriozitetit të tij. Me këtë, ne, mbështesim edhe idenë e barazimit të Europës gjeografike me Bashkimin European, pra një Europë jo vetëm gjeografike, por e bashkuar edhe politikisht, ekonomikisht dhe në Drejtësi<sup>238</sup>.

### Zhvillimi historik

Siç e kemi cekur dhe më lart, që prej dy dekadash kanë filluar përpjekjet për krijimin e një të drejte penale europiane. Një e drejtë penale europiane ekziston sot, por ajo që na shqetëson ne është se nuk është e unifikuar, nuk është e pasqyruar në një tekst unik ligjor. Pikërisht, ne, jemi përpjekur t'i mëshojmë nevojës së krijimit të një teksti të vetëm ligjor gjatë këtij artikulli, prandaj është e nevojshme të dimë dhe se si është zhvilluar e drejta penale europiane ndër vite. Pa u ndalur në mënyrë të posaçme në arsyet që çuan në lindjen e Bashkimit European dhe historikun e zhvillimit të tij, të cilat nuk përbëjnë objekt të këtij artikulli, duhet theksuar se ky organizëm, që

<sup>235</sup> Një vend potencial kandidat, që kemi analizuar në këtë artikull, është Shqipëria,

<sup>236</sup> Edhe pas përpjekjeve të shumta është shumë e vështirë t'i gjejmë këto kode në një gjuhë ndërkombëtare,

<sup>237</sup> E kemi fjalën për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit European,

<sup>238</sup> Pra, indirekt ne jemi për kthimin e Europës në një Konfederatë, kjo nuk është as e tepruar dhe as e nxituar, për më gjerë shiko tendencat dhe deklaratat e fundit nga organet e Bashkimit European, i referohemi deklaratës së Barrosos. Madje kjo ide përforcohet edhe nga fakti që çmimin Nobel për Paqen këtë vit e mori Bashkimi European, dhe kjo tregon se gjithmonë e më shumë Bashkimi European po shikohet si një etnitet i vetëm,

në fillesat e krijimit të tij aspiroi për krijimin e një bashkëpunimi sa më efikas ndërmjet vendeve anëtare dhe ndërgjegjësimit e një identiteti europian *supra*. Ndryshe nga Këshilli i Europës, i cili përfaqëson një subjekt të së drejtës ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë shtete të pavarura të cilat ruajnë sovranitetin e tyre, Bashkimi Europian përfaqëson një bashkim shtetesh të cilat vullnetarisht kanë hequr dorë pjesërisht nga sovraniteti i tyre, për t'ia kaluar ushtrimin e tij institucioneve të kësaj bashkësie<sup>239</sup>. Edhe pse Bashkimi Europian të paktën fillimisht pati si qëllim parësor qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve etj., përpjekjet për bashkëpunimin midis autoritete gjyqësore dhe policore në nivel europian kanë filluar që me vetë krijimin e Bashkimit. Më gjithatë fusha e *Drejtësisë dhe e çështjeve të brendshme* u zhvillua më një ritëm të shpejtë pas viteve 1990. Në fillimet e Bashkimit Europian çështjet *supra* ishin në ekskluzivitetin e vendeve anëtare, u deshën të kalojnë katër dekada që këto çështje t'i besoheshin dhe Bashkimit Europian. Kjo risi sigurisht është shoqëruar më kundërshti dhe debate ndërmjet vendeve të ndryshme anëtare. Në vitin 1986 më nënshkrimin e Aktit Unik Europian, kuadri ligjor i komuniteteve europiane, pësoi ndryshimet më të thella dhe gjithëpërfshirëse si në drejtimit të kompletimit të tregut të përbashkët europian, por mbi të gjitha shpaloji dhe domosdoshmërinë që në fokusin e Komunitetit Europian të ishin dhe çështjet e Drejtësisë dhe punëve të brendshme, çështje të cilat pësuan një ridimensionim tërësor pas nënshkrimit të Traktatit të Matrihtit. Pas këtij traktati<sup>240</sup> Komuniteti filloi të quhej Bashkimi Europian dhe shënon një hap të mëtejshëm në bashkimin politik të vendeve të Bashkimit.

Ajo që ka rëndësi për efekt të këtij artikulli është shtylla e tretë e tij e quajtur Drejtësia dhe çështjet e brendshme<sup>241</sup>. Qëllimi kryesor i kësaj shtyllë ishte të shtoheshin kompetencat e Bashkimit Europian në fushën e Drejtësisë, ku si sektorë me interes të përbashkët të cilët u inkorporuan në shtyllën e tretë ishin: azili, vizat, migracioni, lëvizja e lirë e qytetarëve, lufta kundër drogës, lufta kundër korrupsionit,

<sup>239</sup> Për më shumë rreth Bashkimit Europian shih në [http://europa.eu/about-eu/eu-history/1945-1959/index\\_en.htm](http://europa.eu/about-eu/eu-history/1945-1959/index_en.htm)

<sup>240</sup> Për më shumë rreth këtij traktati lexo *ut supra*,

<sup>241</sup> *Ut supra*.

lufta kundër terrorizmit dhe çdo lloj formë të krimit ndërkombëtar. Përsëri vendimet në këta sektorë nuk merreshin në bazë të metodës ndërqeveritare, por trajtoheshin ndërmjet shteteve anëtare, pra jashtë kuadrit të Bashkimit Europian. Bazuar në traktatin e Matrihtit, bashkëpunimi në fushën gjyqësore dhe policore ndërmjet shteteve anëtare synon t'u ofrojë qytetarëve europianë liri, siguri e drejtësi, duke luftuar dhe parandaluar bashkërisht krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Ky bashkëpunim gjyqësor ka të bëjë kryesisht më zbatimin e vendimeve penale, por dhe me vendosjen e normave penale uniforme në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës. Pas pesë viteve Bashkimi Europian e pa të nevojshme të rishikojë dhe një herë traktatet e tij. Kështu, në vitin 1999 hyri në fuqi traktati i Amsterdimit. Pas këtij traktati u krijua zona e *Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë* duke u vendosur në krye të agjendës së Bashkimit Europian. Tashmë shtylla e tretë në mendimin tonë u bë më e pastër juridikisht pasi çështje të tilla si vizat, azili e migracioni u hoqën nga kjo shtyllë e kaluan në shtyllën e parë. Sipas traktatit të Amsterdimit lufta kundër krimit detyron shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme në drejtimit të: bashkëpunim më efikas ndërmjet forcave policore..., ndërmjet autoriteteve gjyqësore....,etj.<sup>242</sup>. Dhe në traktatin e Tamperit në vitin 1999 shtylla e tretë mbeti pikë kryesore në agjendën e Bashkimit Europian, ku përpjekjet u intensifikuan më tepër dhe doli në pah nevoja për përafrimin e legjislacionit duke ju shtuar pikave *supra* të traktatit të Matrihtit. Por ajo që solli risi në këtë drejtimit dhe i hapi shtegun idesë së krijimit të një Kodi Penal Europian është traktati i Lisbonës. Ky traktat parashikon shkriren e tre shtyllave të Bashkimit Europian në një të vetme, e cila do të drejtojë të gjitha fushat e bashkimit. Tashmë Drejtësia merr një rëndësi të dorës së parë, kjo shprehte dhe kërkesat e qytetarëve europianë, të cilët ndiheshin të kërcënuar nga rritja e kriminalitetit, e shkaktuar nga heqja e barrierave për qarkullimin e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve e kapitalit, e i kërkonin qeverive të tyre luftë dhe më efikase ndaj kriminalitetit. Dy nocionet qendrore të traktatit të Lisbonës janë: parimi i njohjes reciproke të gjykimeve dhe vendimeve

<sup>242</sup> Shiko për këtë struktura të tilla si EUROJUST dhe EUROPOL.



gjyqësore si dhe përafrimi i legjislacioneve<sup>243</sup>. Ajo çfarë përbën vërtet risi është krijimi i Prokurorit të përgjithshëm europian. Dy nenet kryesore të këtij traktati që të legjitimojnë për krijimin e Kodit Penal European, janë neni i tetëdhjetë e dy dhe tetëdhjetë e tre.

## Kodi Penal European

### *Pjesa e përgjithshme*

Pasi bëmë një vështrim historik se si ka evoluar e drejta penale europiane arrijmë në konkluzionin se në Bashkimin European është punuar në drejtim të unifikimit të procedurës penale<sup>244</sup>, është punuar në drejtim të parimeve të politikës penale europiane, është bërë diçka në drejtim të së drejtës penale të posaçme, por përse i përket të drejtës penale të përgjithshme nuk është marrë ndonjë hap konkret në drejtim të harmonizimit apo unifikimit të saj në rrafsh europian, madje dhe doktrina në këtë drejtim mungon. Pikërisht këtu, ne, do të përqipemi të bëjmë një harmonizim të së drejtës penale të përgjithshme në Europë, me synimin që të kodifikohet në të ardhmen, sigurisht një pretendim i tillë është i vështirë kryesisht në rrafshin praktik *prima facie*,<sup>245</sup> sepse në rrafshin teorik edhe pse në Europë kemi dy sisteme të ndryshme ligjore dhe të paktën njëzet e shtatë të drejta penale kombëtare të përgjithshme, kodifikimi është relativisht i thjeshtë. Kur flasim në rrafshin praktik, e kemi fjalën se a do të ishin të gatshëm qytetarët europianë apo ato që aspirojnë të bëhen të tillë, të heqin dorë nga sovraniteti i tyre deri në atë masë sa kodi i tyre penal kombëtar të konkurrohet nga një Kod Penal European? Kur themi Kod Penal European absolutisht, ne, nuk kemi parasysh nxjerrjen jashtë zbatimit të kodeve penale kombëtare, por ne duam që

<sup>243</sup> Për më shumë lexo Pradel.J, Corstens.G, Vermeulen.G, E drejta penale europiane, Tiranë, 2010, f. 436.

<sup>244</sup> Arritja më e madhe në këtë drejtim është krijimi i Urdhërit European të Ndalimit,

<sup>245</sup> Jemi të mendimit se kur u pranua Urdhëri European i Ndalimit, përpos polemikave që pati, pasi ishte në kundërshtim me disa parime kushtetuese të disa vendeve (lexo [http://www.eurowarrant.net/documents/cms\\_eaw74\\_1\\_EAW\\_release-270405.pdf](http://www.eurowarrant.net/documents/cms_eaw74_1_EAW_release-270405.pdf) dhe në [http://www.eurowarrant.net/documents/cms\\_eaw\\_213\\_3\\_darkanzali.text.doc](http://www.eurowarrant.net/documents/cms_eaw_213_3_darkanzali.text.doc)), Kodi Penal European në asnjë moment nuk do të ketë përplasje të tilla me Kushtetutat kombëtare,

ato vepra penale, të ngritura në rrafsh europian *infra*, të parashikuara në një sërë vendimesh kuadër, të merren dhe të inkorporohen në një tekst të vetëm ligjor, në një kod unik, dhe ndaj tyre të aplikohen të njëjtat standarde e parime *infra*. Sigurisht, natyra juridike e një organi të tillë si Bashkimi European e mundëson këtë<sup>246</sup>. Ndërsa në rrafshin teorik me gjithë vështirësitë *supra* është i realizueshëm, mjafton të jetë vullneti i mirë, të cilin ne e kemi marrë të mirëqenë.

Duke menduar se i kemi ezauruar problemet në rrafshin teorik dhe praktik më poshtë do të përqipemi të japim një ide sesi mund të jetë struktura dhe përmbajtja e Kodit Penal European, i cili në fund të fundit do të ketë pamjen e një kodi penal klasik, por me një kompetencë lëndore të kufizuar në disa vepra penale serioze.

Pas një vështrimi krahasimor të një sërë kodesh penale kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit European dhe të vendeve që aspirojnë të jenë pjesë e tij, ne arrijmë në konkluzionin se në çdo vend kuptimi për ligjin penal është i njëjtë, tërësi rregullash që parashikojnë disa veprime ose mosveprime si vepra penale.

Po të shikojmë se si ndahen këto vepra penale nga këto kode penale kombëtare<sup>247</sup>, janë ndarë përgjithësisht në krime dhe kundravajtje penale bazuar në rrezikshmërinë e veprimit ose mosveprimit penal. Sigurisht që dhe Kodi Penal European do të ecë me të njëjtën frymë me kodet kombëtare penale të vendeve anëtare, kështu në ndarjen e veprave penale do të bazohet tek ndarja klasike krime dhe kundravajtje penale, pra do të bazohet në seriozitetin e veprimit ose mosveprimit.

Duke e menduar Bashkimin European si një shtet të vetëm, duke e parë që në të gjitha vendet europiane është përfaqëuar teoria e pastër e Drejtësisë dhe e hierarkisë së normave, mendojmë se edhe për Kodin Penal European do të ndiqet e njëjta ide, burimi kryesor do të jetë traktati i Lisbonës<sup>248</sup>, i cili ka bërë të mundur lindjen e mundësisë për krijimin e tij, sepse në fund të fundit Traktatin e Lisbonës mund ta konsiderojmë dhe si një Kushtetutë të Bashkimit European. Sigurisht, ky kod do të ketë si bazë dhe parimet e së drejtës

<sup>246</sup> *Ut supra*,

<sup>247</sup> Neni 1, Kodi Penal i Shqipërisë, Neni 12, i Kodit Penal të Gjermanisë, Neni 111-1 i Kodit Penal të Francës, Neni 39 i Kodit Penal të Italisë.

<sup>248</sup> Nenet 82 dhe 83, *supra*,

penale ndërkombëtare, të pranuar nga çdo shoqëri demokratike<sup>249</sup>, ato marrëveshje ndërkombëtare të nxjerra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara<sup>250</sup>, legjislacioni dytësor i Bashkimit European, si edhe vendimet e Gjykatës së Drejtësisë në Europë kur prekin çështje penale, për aq sa është e mundur mund të jenë burim i tij dhe vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Është e natyrshme që Kodi Penal European të ketë për detyrë të mbrojtë liritë dhe të drejtat themelore të çdo qytetari european, por edhe të çdo personi që jeton brenda territorit të Bashkimit European, nga veprat penale si dhe parandalimin e tyre, por jo vetëm.<sup>251</sup>

Një nga shtyllat kryesore mbi të cilat do të ngrihet Kodi Penal European do të jetë parimi i ligjshmërisë, *nullum crimen, nulla poena sine lege*<sup>252</sup>, askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim që nuk është parashikuar në ligj si vepër penale, dhe me një lloj e masë dënimi që nuk është parashikuar në Kodin Penal European. Ky është një parim i rëndësishëm i cili shërben si bazë padiskutim për të gjitha ligjet penale, dhe si i tillë duhet të ekzistojë dhe në Kodin Penal European si një parim që përbën themelet e tij.

Një parim tjetër i rëndësishëm, të cilin është e nevojshme ta bëjmë pjesë të parimeve të mishëruara në Kodin Penal European është dhe parimi i veprimit të ligjit penal në kohë<sup>253</sup>. Përcaktimi i ligjit penal që do të aplikohet në kohë është një çështje shumë delikate dhe e ndjeshme dhe si e tillë duhet të rregullohet dhe nga Kodi Penal European, që të shmangim problemet e mëvonshme në përplasjet e

<sup>249</sup> Shiko normat *jus cogens*

<sup>250</sup> <http://treaties.un.org/Home.aspx>

<sup>251</sup> Në Kodin Penal dhe në doktrinën penale shqiptare një parashikim i tillë njihet me termin detyrat e legjislacionit penal, shiko Nenin 1\ b të Kodit Penal të Shqipërisë. Pas një leximi të kombinuar të disa kodeve penale të tjera të Bashkimit European, nuk e kanë të parashikuar shprehimisht një parashikim të tillë, por sigurisht fryma dhe ratio e tyre ka qenë të mbrojtë këto objekte, sigurisht dhe Kodi Penal European nuk do të bëjë përjashtim,

<sup>252</sup> Shiko për këtë Nenin 2 të Kodit tonë Penal, Neni 113-3 të Kodit Penal francez, Neni 1, i Kodit Penal italian, ky parim gjendet padiskutim dhe në kodin penal gjerman dhe lituan.

<sup>253</sup> Shiko për këtë nenin 3 të Kodit Penal shqiptar, Nenin 112-1 të Kodit Penal francez, Neni 2 i Kodit Penal Italian, etj.

fuqisë së ligjeve, si edhe do të ndihmojë në përcaktimin e ligjit penal favorizues në çdo rast konkret.

Për t'i paraprirë problemit të shmangies nga përgjegjësia penale për shkak të pretendimit të mosnjohjes së ligjit penal është e nevojshme që të përcaktojmë se mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, pra duhet inkorporuar dhe parimi i mosnjohjes së ligjit<sup>254</sup>. Ky parim është i rëndësishëm sepse jo vetëm prezumon njohjen e ligjit penal, por gjithashtu shmang problemet që mund të vijnë si rezultat i pretendimeve të mosnjohjes së tij, duke marrë parasysh faktin që Kodi Penal European do të zbatohet në një hapësirë gjeografike relativisht të madhe, me popullsi të lartë, me kultura të ndryshme dhe nga ana tjetër ky kod do të jetë paralel me kodin kombëtar<sup>255</sup>, dhe si e tillë shumë qytetarë, fshehur dhe pas parimit të sovranitetit mund të pretendojnë mosnjohjen e tij si rezultat i veprimit edhe të kodit penal kombëtar. Ky parim do t'i shmangte apriori këto probleme dhe do të siguronte jetësimin në praktikë të këtij kodi.

Sigurisht që Kodit Penal European nuk do t'i mungojë dhe parimi i territorialitetit, një parim i parashikuar në të gjithë kodet penale kombëtare<sup>256</sup>. Jetësimi i këtij parimi është i rëndësishëm për të përcaktuar qartë faktin se cili do të jetë territori në të cilin do të zbatohet ky kod, për t'i dhënë Bashkimit European pamjen e një vendi të vetëm. Kështu territori në të cilin do të zbatohet ky kod do të jetë territori i Bashkimit European, pra në territorin e vendeve anëtare të këtij organizmi. Gjithashtu, ky kod do të jetë i zbatueshëm dhe në anijet dhe avionët, të cilat mbajnë flamurin e vendeve anëtare të Bashkimit European. Ky parim është një parim elastik në sensin që do t'ju përshtatet valëve të zgjerimit që do të pësojë në vazhdimësi Bashkimi.

Në vazhden e parimeve që do të jenë në bazën e Kodit Penal European sigurisht që do të jetë dhe zbatimi i ligjit penal european, Kodi Penal European, për vepra penale të kryera nga shtetas

<sup>254</sup> Shiko për këtë Nenin 4 të Kodit tonë Penal dhe Nenin 5 të atij italian.

<sup>255</sup> I cili sigurisht që ka një përmbajtje të ndryshme kryesisht të pjesës së posaçme.

<sup>256</sup> Shiko për këtë Nenin 5, të Kodit tonë Penal, Në Kodin Penal gjerman seksionet 3,4, Në Kodin Penal francez nenet 113-1,2,3,4,5, Seksioni 2 në Kodin Penal lituan, Neni 4 në Kodin Penal italian.

europianë; natyrshëm që brenda territorit të Bashkimit European për qytetaret e tij do të zbatohet ky kod<sup>257</sup>, por ajo që lind si problematikë këtu është se cili ligj do të aplikohet kur një qytetar european kryen një nga veprat penale të parashikuara në këtë kod në një shtet tjetër jo anëtar i Bashkimit, nga një lexim i kombinuar dhe interpretim i disa kodeve penale kombëtare të disa shteteve anëtare të Bashkimit European, por jo vetëm arrijmë në përfundimin se dhe në këtë hipotezë ky kod do të operojë ashtu si operojnë shumica e vendeve anëtare. Dhe në rastet hipotetike kur një qytetar joeuropian, në kuptimin që mund të jetë shtetas i një vendi jo anëtar të Bashkimit, apo një person pa shtetësi kryejnë një krim brenda territorit të Bashkimit European sigurisht në bazë të parimit të territorialitetit do të shtrijë efektet ky kod. Një përfundim i tillë arrihet pas leximit të kombinuar të kodeve<sup>258</sup> të marra në analizë gjatë këtij artikulli, sepse Kodi Penal European në fund të fundit do të jetë mishërim i parimeve, instituteve dhe traditave juridiko-penale të vendeve që e përbëjnë. Në bazë të frymës së bashkëpunimit që ekziston ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit European aktualisht në fushën penale, madje kjo frymë bashkëpunimi është premisa kryesore për realizimin e Kodit Penal European, në situatën hipotetike të krijimit të tij, europeanët do të duan ta forcojnë këtë frymë bashkëpunimi në fushën penale me shtetet e tjera europiane joanëtare dhe më gjerë, ndaj në Kodin Penal European, në kuadër dhe të luftimit të krimit ndërkombëtar patjetër që duhet të përfshihet një institut i tillë si Njohja penale e vendimeve të huaja, për një qytetar european që ka kryer një veprë penale jashtë territorit të Bashkimit European dhe ndaj tij është dhënë një vendim në vendin e kryerjes së veprës penale. Një parashikim i tillë sigurisht do të bëhet dhe për arsye të realizimit sa më të mirë të qëllimit të dënimit<sup>259</sup>. Në kuadër të përmirësimit dhe ngritjes sa më lart të kësaj fryme bashkëpunimi në Kodin Penal European duhet të implementohen dhe dy institute të rëndësishme të bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale si Ekstradimit<sup>260</sup> dhe Urdhri European i

<sup>257</sup> Për këtë parim referohu neneve që kemi cituar në rastin e parimit të territorialitetit.

<sup>258</sup> *Ut supra*.

<sup>259</sup> Lexo vendimin unifikues nr.5, datë 10.10.2002, të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, <http://www.gjykataelarte.gov.al/>,

<sup>260</sup> Konventa Europiane mbi Ekstradimin, <http://conventions.coe.int/Treaty/en/>

Ndalimit<sup>261</sup>. Ekstradimi do të aplikohet në marrëdhëniet e një shteti të Bashkimit European me shtetet e tjera, ndërsa ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit European do të aplikohet Urdhri European i Ndalimit.

Nëse për gjithë çfarë u tha më lart legjislatori european nuk do ta këtë të vështirë përcaktimin e përmbajtjes së tyre sepse në vendet europiane fryma është e njëjtë, në momentin e përcaktimit të moshës së fillimit të përgjegjësisë penale situata nuk do të jetë kaq e thjeshtë jo vetëm për faktin se në këto vende ka parashikime të ndryshme për këtë<sup>262</sup>, por dhe në dokumentet ndërkombëtare<sup>263</sup> nuk jepet një parashikim i tillë. Në mendimin tonë duke marrë në konsideratë dhe faktorët biologjikë dhe psikologjikë, por dhe si e parashikon këtë, shumica e vendeve europiane mendojmë se moshë më e pranueshme do të ishte 14 vjeç.

Pa diskutim që në Kodin Penal European do të trajtohet dhe instituti i formës së fajit, siç e kemi cekur dhe më lart dhe në këtë rast ky kod do të ecë në frymën e parashikimeve dhe traditës ligjore të vendeve anëtare që e përbëjnë<sup>264</sup>. Pra, format e fajit do të jenë dy format klasike të njohura nga çdo penalist european dhe më gjerë, dashja dhe pakujdesia. Sigurisht, doktrina në Europë do të jetë e lirë që këto dy forma faji t'i interpretojë, t'i zgjerojë ose ngushtojë në kuptimin e tyre sipas rastit.

Natyrshëm që në këtë kod do të jenë të inkuorporuara dhe institutet klasike të së drejtës penale si Tentativa dhe Bashkëpunimi, ku pas një leximi të kombinuar të kodeve në të cilat jemi bazuar gjatë këtij punimi, jemi të mendimit se në momentin e ideimit të Kodit Penal European, përta i përket institutit të Tentativës të merret si shembull modeli gjerman<sup>265</sup>. Ndërsa përta i përket institutit të

[Treaties/Html/024.htm](#)

<sup>261</sup> Urdhri European i Ndalimit, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32002F0584:en:HTML>

<sup>262</sup> Neni 12 i Kodit Penal shqiptar, Neni 19 i Kodit Penal gjerman, Neni 11 i Kodit Penal lituan.

<sup>263</sup> Konventa mbi të drejtat e fëmijës.

<sup>264</sup> Neni 14 i Kodit Penal shqiptar, Neni 15 i Kodit Penal gjerman, Neni 8 i Kodit Penal lituan.

<sup>265</sup> Shiko Kreun 2, Seksioni 22, Kodi Penal Gjerman.

bashkëpunimit modeli italian<sup>266</sup> na duket më i përshtatshmi. Këto dy modele na duken më të përshtatshme sepse janë më sqaruese dhe nuk lënë shteg për interpretime të zgjeruara<sup>267</sup>.

Instituti i përgjegjësive penale të personave juridikë, mendojmë se duhet të jetë i inkorporuar në Kodin Penal Europian, duke marrë për bazë modelin italian<sup>268</sup>, i cili siç e cekëm dhe *supra* është një model në përputhje me kërkesat e ligjit penal.

Përsa i përket masës së dënimeve, ne, nuk jemi kompetentë të përcaktojmë për çdo dispozitë, sigurisht mund të themi, disa kritere që mund të udhëheqin legjislatorin europian në momentin e përcaktimit të tyre. Për shembull, do të shikohen se cilat janë tendencat<sup>269</sup>, natyra e veprave penale<sup>270</sup> dhe parimet e politikës penale europiane, të cilat janë dinamike dhe mund të ndryshojnë deri në momentin e jetësimit të Kodit Penal Europian.

Pak a shumë këtë formë dhe përmbajtje duhet të ketë në mendimin tonë pjesa e përgjithshme e Kodit Penal Europian. Kjo pjesë, sigurisht, që duhet të përfaqësojë frymën e të gjithë kodeve penale kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, por kur nga kjo tërësi kodesh në një prej tyre një institut rregullohet më mirë, më në konform të drejtave dhe lirive themelore të njeriut legjislatori europian nuk duhet të hezitohet ta marrë pikërisht këtë si model e ta inkorporojë në Kodin Penal Europian.

## Pjesa e posaçme

Në rast se hartimi i pjesës së përgjithshme *prima facie* duket i vështirë për të gjitha arsyet që kemi cekur *supra*, në fakt gjatë këtij

<sup>266</sup> Nenet 110-119, Kodi Penal italian.

<sup>267</sup> Kujtojmë se një nga kërkesat e ligjit penal është dhe saktësia, pra për të mos lënë shteg për interpretime të shumta,

<sup>268</sup> Shiko ligjin Italian për përgjegjësinë penale të personit juridik nr.231, 8.06.2001, <http://www.penaleimpresa.com/codici-di-comportamento>.

<sup>269</sup> Pra cilat dënime janë të preferueshme nga vendet anëtare dhe jo,

<sup>270</sup> Për shembull, për veprat penale me natyrë ekonomike do të ishin më efikase dënimet maksimale me gjobë, ndërsa për veprat penale me qëllime terroriste bashkëjetesa e dënimit me burgim me atë me gjobë.

punimi rezultoi që në themel të çdo vendi europian e drejta penale ka të njëjtat parime, institute dhe frymë, mund të ndryshojë vetëm germa e tyre, në këtë situatë hartimi i pjesës së posaçme do të jetë akoma dhe më e lehtë, sepse në këtë drejtim Bashkimi Europian ka punuar, janë disa vepra penale të parashikuara në disa vendime kuadër të ngritura në rrafsh europian, ndaj këtu duhet vetëm që kjo mori vendimesh kuadër të merret dhe të inkorporohet në Kodin Penal Europian. Deri në këto momente mund të themi se Kodi Penal Europian do të njohë këto figura<sup>271</sup> veprash penale: terrorizmi; shfrytëzimi seksual i të miturve; pedopornografia; trafikimi i qenieve njerëzore; vepra penale për hyrjen, tranzitimin dhe qëndrimin e parregullt; korrupsioni në sektorin privat; vepra penale për mbrojtjen e euros nga falsifikimi; mashtrimi dhe falsifikimi të mjeteve të jetesës jo në para; vepra penale në fushën e trafikut të drogës; krimet kompjuterike; vepra penale në fushën e racizmit dhe ksenofobisë<sup>272</sup>.

Sigurisht, që në momentin e krijimit, Kodi Penal Europian, do të pasqyrohet dhe me vepra të tjera penale, në varësi të faktit se çfarë e shqetëson realitetin europian për t'u ngritur në nivel mbikombëtar. Ajo që duam të theksojmë dhe një herë në këtë moment është fakti se

<sup>271</sup> Koncepti figurë e veprës penale pothuaj nuk njihet nga vendet europiane përëndimore, njohin vetëm konceptin elementet e veprës penale (Francë p.sh.), këtë koncept e kemi huazuar nga shkolla juridike ruse dhe për penalistin shqiptar është një term familjar ndaj dhe e kemi përdorur në këtë artikull, çfarë kemi bindjen se kolegët tanë të Europës Lindore e njohin më së miri.

<sup>272</sup> Shiko vendimet-kuadër korresponduese: Vendimi-kuadër “Mbi luftën kundër terrorizmit”, 13 qershor 2002 të Bashkimit Europian, vendimi-kuadër “Mbi luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe kundër pedopornografisë”, 22 dhjetor 2003; vendimi-kuadër “Mbi trafikimin e qenieve njerëzore”, 19 korrik 2002, vendimi-kuadër “Mbi forcimin e kuadrit penal kundër ndihmës së dhënë për hyrjen, tranzitimin dhe qëndrimin e parregullt”; vendimi-kuadër “Mbi luftën kundër korrupsionit në sektorin privat”; vendimi-kuadër “Mbi forcimin e luftës kundër falsifikimit të parave më anë të dënimeve penale dhe formave të tjera mbrojtëse, në kuadrin e vënies në qarkullim të euros”, 6 dhjetor 2001; vendimi-kuadër “Mbi luftën kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo në para”; vendimi –kuadër “Mbi përcaktimin e dispozitave minimale në lidhje me elementet përbërëse të veprave penale dhe të dënimeve të zbatueshme në fushën e trafikut të drogës”, 28 maj 2001, vendimin-kuadër “Mbi mbrojtjen e sistemeve të informimit”, 24 shkurt 2005; vendimi-kuadër “Mbi luftën më anë të së drejtës penale kundër disa formave dhe shfaqjeve të racizmit dhe ksenofobisë”, 11 korrik 2007.

pjesa e përgjithshme e këtij kodi, parimet, institutet që pretendohet të sanksionohen në të do të jenë në funksion vetëm të këtyre veprave penale që do të parashikohen shprehimisht në pjesën e posaçme të tij. Pra, Kodi Penal European asesi nuk do të rivalizojë kodet penale kombëtare<sup>273</sup>, këto të fundit do të kenë rëndësi aq sa kanë në këto momente që nuk ekziston një kod i përbashkët. Për ta sqaruar dhe një herë, në mendimin tonë duhet të ekzistojë një Kod Penal European vetëm për vepra penale të një rrezikshmërie të madhe, që cenojnë të tërë Bashkimin European dhe lufta ndaj tyre është më efiqase kur kemi një standard unik ligjor. Pra, Kodi Penal European bashkë me kodet penale kombëtare do të ecin paralelisht në luftën kundër kriminalitetit dhe së bashku do të jenë premisë për krijimin e një hapësire lirie, sigurie dhe drejtësie në Europë. Në bashkëpunim me njëri-tjetrin, me kompetenca të ndara dhe të qarta, do të krijojnë atë që juristët në Europë e quajnë *Opened borders, closed Europe*.

### ***A është koha për një Kod Penal European?***

Sigurisht që nëse do t'i referoheshim një të ardhmeje të largët edhe më skeptikët do të ishin dakord me krijimin e një Kodi Penal European. Dyshimet më të mëdha janë përsa i përket të ardhmes së afërt dhe akoma më shumë të tashmes. Në këtë pjesë do t'i përgjigjemi pyetjes se *'A është koha për një Kod Penal European?'* Sigurisht që kohët e fundit është bërë një punë e madhe për harmonizimin e legjislacionit penal në Bashkimin European *supra*, përpjekje të cilat kanë ecur ngadalë, por në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Janë pikërisht këto përpjekje që kanë hapur rrugën dhe kanë sjellë mundësinë e krijimit të një Kodi Penal European si finalizim i tyre in futures. Fillimisht do të analizojmë situatën aktuale në të cilën ndodhet hapësira europiane, situatë e cila mbështet dhe tregon domosdoshmërinë e krijimit të Kodit Penal European. Gjithashtu, duke nxjerrë në pah argumentet pro dhe kundër krijimit të një Kodi Penal European, do të argumentojmë më së miri faktin se ka ardhur koha e përshtatshme

<sup>273</sup> Qartësisht këto kode, pra ato kombëtare dhe Kodi Penal European, i kanë kompetencat lëndore të dallueshme, pra kur jemi para veprave *supra* do të zbatohet Kodi Penal European, për çdo vepër tjetër do të ketë hapësirë zbatimi kodi penal kombëtar respektiv.

për të hedhur një hap më tutje, për të bërë kalimin nga harmonizimi i pjesshëm në krijimin e një kodi të plotë dhe unik. Këto analiza do të na shërbejnë për të kuptuar se hapi tjetër i domosdoshëm që duhet të merret nga Bashkimi European është përgatitja sa më e shpejtë e Kodit Penal European, pasi rruga për një hap të tillë tani është e lirë<sup>274</sup>.

Situata në të cilën ndodhet tani kriminaliteti në Bashkimin European sigurisht që është shumë ndryshe nëse do ta krahasojmë me vitet e para të jetës së tij. Sigurisht që krimet tani janë bërë ndërkombëtare dhe kanë një natyrë shumë më të sofistikuar duke na çuar te krimet *quasi* perfekte. Me ndryshimin e situatës në të cilën ndodhet tani Bashkimi European na del dhe nevoja për të ndryshuar dhe përforcuar dhe mënyrën e reagimit ndaj krimet, gjithmonë e në rritje. Një mënyrë efiqase për të luftuar krimin dhe përhapjen e tij do të ishte dhe krijimi i një teksti ligjor të përbashkët, që do të ishte i njëjtë për të gjithë dhe do të sillte jo vetëm parime, parashikime, sanksione të njëjta, por sigurisht që dhe politika penale thuhet të njëjta *infra*. Niveli i krimet në Europë, përgjatë viteve ka ardhur në rritje, çka tregon për një mosefiqasitet në këtë fushë. Për të bërë përparime në këtë fushë është e nevojshme që të bazohemi dhe në një ligj të pasur, efiqas, të qartë, objektiv, gjithëpërfshirës dhe sigurisht koherent. Pikërisht, një Kod Penal European jo vetëm që do t'i përmbushte këto karakteristika, por madje do të ishte një shembull për të gjithë. Një Kod Penal European do të ishte një mjet efiqas në luftën kundër kriminalitetit, pasi ai do të mishëronte stadin e lartë të bashkëpunimit midis vendeve të Bashkimit European dhe sigurisht këmbënguljen e tyre për një Europë të pastër ndaj krimet. Pavarësisht se vendet anëtare mund të kenë politika efiqase në drejtim të uljes së kriminalitetit, Bashkimi European është një mekanizëm, i cili ka në përbërje një tërësi vendesh, të cilët duhet të veprojnë si një trup unik, prandaj është e rëndësishme që ky bashkëpunim, kjo luftë kundër kriminalitetit të kryhet jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në kuadrin e Bashkimit European *infra*.

Një problem tjetër që haset kur bëhet pyetja se a është koha për një Kod Penal European është fakti se si do të reagojnë qytetarët

<sup>274</sup> Traktati i Lisbonës i ka hapur rrugën bashkëpunimit më të ngushtë midis vendeve anëtare të Bashkimit European.

europianë ndaj një kodi të tillë? Qytetarët e Bashkimit European e konsiderojnë krimin një problem shumë thelbësor me të cilin po ballafaqohet Bashkimi European<sup>275</sup>. Ato e radhisin luftën kundër krimin si një nga katër fushat kryesore në të cilat duhet të ndalet Bashkimi European për të forcuar bashkëpunimin. Vëmë re se janë vetë qytetarët europianë të cilët e kërkojnë dhe këmbëngulin për diçka të tillë. Nga përgjigje të tilla mund të nxjerrim në mënyrë indirekte se vetë qytetarët europianë janë gati për një kod të tillë *infra*.

Duke trajtuar si argumentet kundër dhe argumentet në favor për krijimin e Kodit Penal European do të arrijmë të nxjerrim në pah ndryshimet, lehtësirat dhe sigurisht pozitivitetin që do të sillte një kod penal unik për të gjithë anëtarët e Bashkimit European. Fillimisht do të ndalemi në problemet që propagandohen nëse do të krijohet një Kod Penal European, por krahas tyre do të bashkëngjisim edhe kundërgargumentet tona.

Në radhët e skeptikëve që shohin me dyshim jetëgjatësinë e Bashkimit European dhe shprehen për pamundësinë e jetësimit dhe aplikimit të një Kodi Penal European, është sigurisht në plan të parë parimi i sovranitetit. Sipas tyre nëse do të pranohet që dhe fusha penale të rregullohet jo nga legjislatori kombëtar, por nga ai ndërkombëtar, do të ishte sikur të hiqje dorë nga parimi i sovranitetit. Në këtë rast ajo çka do të vrente si kundërgargument është fakti se kur një vend merr vendimin për të qenë pjesë e Bashkimit European, sigurisht që ka marrë parasysh faktin se do t'i duhet të bëjë kompromise në lidhje me sovranitetin, madje do t'i duhet dhe të heqë dorë nga ky sovranitet, pasi anëtarësimi në organizma të tilla këtë ka si synim, rregullimin e çështjeve në mënyrë të përbashkët. Për më tepër, ky kod do të ketë në përbërje të pjesës së tij të posaçme vepra penale të cilat tanimë kanë një rregullim nga Bashkimi European *supra*. Gjithashtu, duhet të sjellim në vëmendje faktin që legjislacioni kryesor i Bashkimit European vjen si rezultat i miratimit të vendeve anëtare, pra janë vetë këto vende

<sup>275</sup> EUROPEAN COMMISSION Brussels, 20.9.2011 COM(2011) 573 final, Communication from the commission to the European Parliament, The Council, The European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, Towards an EU Criminal Policy: Ensuring the effective implementation of EU policies through criminal law

anëtare që i hapin dritën jeshile kufizimit të parimit të sovranitetit.

Nga ana tjetër, një problem tjetër është fakti se nuk kemi të bëjmë me një vend të vetëm, i cili mishëron kulturë, vlera, tradita, zakone të njëjta, dhe madje do të ishte utopike të mendonim për një unifikim të këtyre aspekteve. Një Kod Penal European, thonë skeptikët do të na detyronte të hiqim dorë nga e shkuara jonë. Sigurisht, që secili prej vendeve anëtare ka kulturën e tij juridike, ka vlerat dhe zakonet e tij, dhe sigurisht që Kodi Penal European nuk synon t'i unifikojë këto veçanti dhe aq më tepër nuk do t'i përjashtojë apo mënjanojë ato. Përkundrazi, Kodi Penal European, me aq sa është e mundur do të përpiqet të pasqyrojë një sistem vlerash të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare, sistem i cili do të jetë i mbështetur në kulturën, vlerat dhe zakonet e çdo vendi.

Një aspekt tjetër problematik është dhe përshtatja civil law e common law. Pa dyshim që kjo është diçka e vështirë dhe skeptikët e shohin të pamundur diçka të tillë, por ne sjellim në vëmendje që si vendet e common law ashtu edhe ato të civil law kanë bërë pjesë të legjislacionit të tyre të brendshëm një sërë direktivash e rregulloresh pa bërë dallime pavarësisht sistemit që aplikojnë. Nëse diçka e tillë është arritur në këtë nivel, atëherë pse të mos e shtrijmë bashkëpunimin dhe më tej, pse të mos përpiqemi që të kemi një kod të përbashkët, sigurisht që ne nuk themi që t'i japim përparësi një sistemi të caktuar, por mund të arrihet në kompromise të kënaqshme dhe të arsyeshme<sup>276</sup>.

Problemi i mospërputhjeve të dënimeve pavarësisht se ekziston, pra kemi dënime të larmishme, ne jemi të mendimit që një Kod penal european, pavarësisht se do t'i unifikonte dënimet do të sillte pozitivitet. Një Kod Penal European do të bënte të mundur që shkelësit e ligjit të mos mund të fshiheshin as pas kufijve dhe as pas parashikimeve të ndryshme në sistemet ligjore të vendeve anëtare. Shpeshherë personat që janë kriminelë potencialë, mund të zgjedhin vendin i cili ka legjislacionin më të butë, përse i përket disa llojeve të veprave penale, dhe kështu i shmangen sanksioneve maksimale. Një

<sup>276</sup> Të përshtatësh civil law me common law është e mundur. Një shembull për ta ilustruar këtë është Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi kontratat ndërkombëtare të shitjes së mallrave (CISG 1980), e cila është hartuar duke marrë më të mirat nga dy sistemet.

Kod Penal European do të sillte standarde të njëjta duke shmangur subjektivizmin nga vendi në vend.

Problem tjetër i trajtuar nga skeptikët është dhe reagimi i qytetarëve europeanë, a do të ishin ata të gatshëm ta pranonin një gjë të tillë? Sipas tyre qytetarët europeanë nuk janë gati dhe nuk e mbështesin një Kod penal european. Por kur pyeten qytetarët europeanë se cila është fusha ku duhet të rritet bashkëpunimi, përgjigja e tyre është pikërisht në luftën kundër krimit *supra*. Sigurisht që mund të thuhet se mund të ketë dhe mënyra të tjera bashkëpunimi për të arritur rezultate pozitive në këtë drejtim dhe sigurisht që ka, por Kodi Penal European nuk do të ishte një zgjidhje afatshkurtër, por do të ishte një zgjidhje afatgjatë dhe për më tepër do t'i jepte një përgjigje të fortë dhe solide krimit.

Në mbështetje të argumenteve në favor të krijimit të një Kodi Penal European sigurisht që na vijnë në ndihmë dhe disa avantazhe që do të sillte ky kod. Kështu ekzistenca e një Kodi Penal European, inkorporimi i parimeve dhe normave të njëjta do të sillte dhe përsosjen e kodeve që kanë reflektuar probleme dhe në të njëjtën kohë do t'i shërbente lehtësimit të procedurave përsa i përket vendeve aspirante<sup>277</sup>.

Krijimi i një Kodi Penal European do të ishte një hap më tej drejt bashkimit më të fortë të Bashkimit European, dhe do t'i hapte rrugë një bashkëpunimi më të madh pasi ai do të pasohej dhe nga një politikë penale e përbashkët, e qëndrueshme dhe koherente, pasi ai do të mishëronte vullnetin e të gjithë vendeve anëtare.

Një Kod penal european do të rriste bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare si përsa i përket gjykatës, prokurorisë dhe organeve të policisë. Kështu çdo gjë do të ishte më e thjeshtë nëse në punën e tyre të përditshme këto organe do t'i referoheshin të njëjtit tekst ligjor, duke shmangur kështu përplasjet legjislative.

Pasi kemi trajtuar aspektet pozitive dhe negative që do të sillte një Kod Penal European, dhe pasi kemi trajtuar se çfarë përmbajtje do të ketë ky kod, e shohim të nevojshme të trajtojmë dhe se si do të bëhej e mundur në praktikë implementimi i një kodi të tillë. Sigurisht që

<sup>277</sup> I referohemi faktit se tani në fushën penale, legjislatori kombëtar nuk do t'i duhej më të bënte përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit European, por do t'i duhej të inkorporonte Kodin e Ri Penal.

kjo nuk do të jetë diçka e thjeshtë, për shkak të vështirësive *supra*, por si çdo hap i madh ka nevojë për frymë bashkëpunimi midis vendeve anëtare.

Për të shmangur probleme të mëdha mund të bihet dakord që fillimisht kodi të aplikohet në një numër të limituar anëtarësh, për të vënë re mbarëvajtjen e tij dhe problemet që mund të sillte ky kod. Pra, do të kishim disa vende të cilat do të zbatonin kodin më shpejt se vendet e tjera. Kjo do t'i jepte mundësinë vendeve të tjera të kenë kohën e mjaftueshme për të bërë ndryshimet dhe përshtatjet e duhura në legjislacionin kombëtar. Gjithashtu, zbatimi i tij më parë në disa vende do të shmangte dhe dështimin e tij, pasi duke parë problemet e reflektuara, ato mund të zgjidhen përpara se kodi të hyjë në fuqi në të gjitha vendet anëtare.

Më pas, në një datë të mëvonshme kodi do të hynte në fuqi në të gjitha vendet anëtare dhe do të ishte një detyrim për t'u plotësuar dhe për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit European. Kjo është një zgjidhje më afatgjatë dhe më e sigurt, por nga ana tjetër mund të kalohet direkt në zbatimin e tij në të gjitha vendet anëtare, duke qenë se ky është hapi që dihet që pason hartimin dhe miratimin e tij. Sigurisht që diçka e tillë është e mundur nëse vullneti i atyre që e mbështesin krijimin e tij është më i fortë se vullneti i skeptikëve.

Gjithashtu, ritheksojmë dhe një herë faktin që praktikisht vendet anëtare pjesën e posaçme si rregull e kanë bërë pjesë të legjislacionit të tyre të brendshëm dhe si pasojë nuk duhet të kenë probleme të shumta në këtë drejtim. Për më tepër nëse fryma e bashkëpunimit është pozitive çdo gjë është e mundur.

## Konkluzione

Të mendosh krijimin e një Kodi Penal European nuk është më një utopi. Ndërmarrja e një nisme të tillë mund të jetë në agjendën e Bashkimit European. Nuk ka asnjë problem si në rrafshin praktik ashtu dhe në atë teorik për krijimin e tij. Ky Kod nuk do të zëvendësojë Kodet Penale Kombëtare sepse kompetencat e tij territoriale dhe lëndore do të jenë qartësisht të përcaktuara duke mos lënë shteg

për përplasje ndërmjet tyre. Kodi Penal Europian, në pjesën e tij të posaçme, do të ketë disa vepra penale të rrezikshme që cenojnë të gjithë hapësirën europiane, prandaj është e nevojshme luftimi i tyre përtej nivelit kombëtar. Parimet dhe institutet e parashikuara në pjesën e tij të përgjithshme do të jenë në funksion të këtyre veprave penale, objekt i tij. Ky Kod do të jetë i zbatueshëm drejtpërdrejt, kështu nuk do të ketë problematika në drejtim të implementimit të tij nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

Me këtë artikull, ne, synojmë të sjellim në vëmendje idenë dhe nevojën për ekzistencën e Kodit Penal Europian. Do të ishim të kënaqur dhe sikur ky artikull të shkaktonte debat në radhët e akademikëve.

### *Literatura*

1. Kodi Penal i Shqipërisë
2. Kodi Penal i Francës
3. Kodi Penal i Gjermanisë
4. Kodi Penal i Italisë
5. Kodi Penal i Lituaniës
6. Shkarkuar nga <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>, 30.09.2012.
7. Traktati i Lisbonës
8. Shkarkuar nga [http://europa.eu/about-eu/eu-history/1945-1959/index\\_en.htm](http://europa.eu/about-eu/eu-history/1945-1959/index_en.htm), 30.09.2012
9. Vendime-Kuadër të Bashkimit Europian
10. EUROPEAN COMMISSION Brussels, 20.09.2011 COM (2011) 573 final, Communication from the commission to the European Parliament, The Council, The European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, Towards an EU Criminal Policy: Ensuring the effective implementation of EU policies through criminal law.

## ABSTRACT

Doktorant Klodjan SKËNDERAJ dhe Dr. Sokol MËNGJESI	Vështrim evolutiv i legjislacionit procedural penal mbi gjykimet e posaçme	209
Drnt. Evisa KAMBELLARI	A theoretical overview of criminal acts against free and democratic elections	211
MA. Laura VORPSI	The role of the judge and the lawmaker	213
Nadia RUSI (Doktorante)	Equal gender and decentralisation	215
Valbona PAJO (BALA), MA	“Popular Constitutionalism”	216
Dr. Ela ELEZI	The execution of the decisions of Constitutional Court regarding Criminal Code	217
MA. Artan ÇELA - Prof. Dr. Kudret ÇELA.	Work salary as legal, economical, and social category	219
MA. Erajd DOBJANI	Types of administrative lawsuit and their legal regime	220
Valbona NDREPEPAJ, Nevila KULLOJKA	Penal Europien Code	222



## **VËSHTRIM EVOLUTIV I LEGJISLACIONIT PROCEDURAL PENAL MBI GJYKIMET E POSAÇME**

Doktorant Klodjan SKËNDERAJ dhe Dr. Sokol MËNGJESI

Gjatë zhvillimit të procesit penal, parashikohet zbatimi i normave të caktuara, të cilat rregullojnë organizimin e zakonshëm të procedimit penal. Në rastet kur plotësohen disa kriteret specifike të përcaktuara nga vetë normat procedurale, procedimi apo gjykimi i zakonshëm mund të anashkalohet, duke u zbatuar në këtë rast gjykimet e veçanta. Parashikimi i instituteve të veçanta apo procedurave alternative të gjykimit, ka për qëllim, nga njëra anë realizimin e shpejtë dhe efektiv të gjykimit e nga ana tjetër garantimin e të drejtave të ndryshme të të pandehurit.

Gjykimet e posaçme në të gjithë vazhden e metamorfozës së legjislacionit procedural penal në Shqipëri, kanë pasur për qëllim përshpejtimin e procedurave penale, por kanë shfaqur elemente dhe karakteristika të ndryshme të zbatimit të tyre ndër vite. Llojet e gjykimeve të posaçme sipas legjislacionit aktual, karakterizohen nga binomi gjykimi i drejtpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar. Këto lloj gjykimesh nga një këndvështrim historik kanë pësuar ndryshime, ku herë-herë janë suprimuar e më pas me Kodin aktual të Procedurës Penale kanë gjetur zgjidhjen përfundimtare, duke u sanksionuar si të vetmit rite alternative të gjykimit penal në vendin tonë.

Një analizë e veçantë do t'i kushtohet kodeve të procedurave penale gjatë periudhës së sistemit monist, duke analizuar dhe frymën që karakterizonte këto lloj kodesh sipas modelit origjinal procedural të adaptuar.

Ky punim synon të analizojë evoluimin e normave procedurale që rregullojnë gjykimet e posaçme të zbatuar në Shqipëri, duke marrë në studim fillesat e legjislacionit procedural pas shpalljes së Pavarësisë, kodet e procedurave penale ndër vite dhe duke arritur në parashikimet e Kodit aktual të Procedurës Penale. Punimi do të arrijë në disa përfundime, të cilat do të shërbejnë për të kuptuar drejt domosdoshmërinë e ekzistencës së gjykimeve të posaçme. Gjithashtu në punim do të konkludohet me disa rekomandime në përpjekje për përsosmërinë e gjykimeve të posaçme në përputhje të plotë me qëllimin e tyre.

## **A THEORETICAL OVERVIEW OF CRIMINAL ACTS AGAINST FREE AND DEMOCRATIC ELECTIONS**

Drnt. Evisa KAMBELLARI  
 Department of Criminal Law,  
 Faculty of Law, University of Tirana  
 E-mail: evisa.kambellari@fdu.edu.al

The integrity and efficient operation of the electoral system are essential defining elements for the free expression of political will within society. The process of setting out precise regulations and requirements for the organization of free and fair elections as well as establishing an electoral system based on principles of democracy, should necessarily be followed by the development of proper mechanisms in order to effectively implement the given regulations in practice, as a substantial precondition for the existence of a democratic society.

To this respect, the criminal law provisions join to other juridical mechanisms in accomplishment of the final aim of maintaining a democratic electoral system by criminalizing certain behaviours, which represent a serious threat for its normal operation and of guaranteeing the rights and obligations related to the normal development of a fair electoral process. The related criminal offences are provided for by chapter X of our Penal Code, named 'Criminal acts affecting free elections and the democratic election system'. The criminal provisions provide for a number of offences referring mainly to the inviolability of

the right to a free and secret vote, obstruction of the normal electoral activity, criminalisation of various forms of influence or coercion aiming at including subjects in electoral activities contrary to the legal provisions, as well as to ensure the integrity and truthfulness of the voting results. This paper aims at presenting the main features of the commission of criminal offences related to illegal acts impinging on the normal electoral process, the grounds for applying criminal liability to such conduct, distinguishing cases when the illegal acts in question, arise out criminal liability from other illegal infractions, which may lead to administrative or disciplinary responsibility. A special attention, is also paid to the presentation of comparative aspects by confronting the relevant provisions of our penal code with the respective provisions in the Italian, French and German legislation. As a conclusion, it must be noted that the protection provided by criminal law aims at further guaranteeing the maintenance of a democratic election process, in a way that it serves to the common good and manifest the free will of the voters.

## THE ROLE OF THE JUDGE AND THE LAWMAKER

MA. Laura VORPSI

As it pertains to checks and balances, the role of the judiciary in Albania is becoming a key element in the rule of law. Today's judges are increasingly more active in their judiciary functions. This article is an analysis of the role of the judiciary: whether the judge merely "mechanically" declares the law or is also its creator, to conclusively distinguish the role between that of the judge and lawmaker.

Each entity serving the rule of law must act in compliance with the constitution and the law, without overstepping the prescribed boundaries.

Principles of separation and balance of powers are still understood as a postulate, from which there must flow the fact that: the legislative, interpretive and executive functions are separate and, therefore, they are entrusted to different branches of government. Accordingly, the legislative function belongs to the Assembly, the executive function - the executive branch and interpretive function - to the judiciary. No other branch may function as a court and exercise the role of a judge. No one may interfere in rendering justice or the issuance of decisions for particular cases. The independence of the judiciary may not be comprehended without the judge's independence within the judicial structure, which also guarantees that no judge may influence the beliefs or decision of another judge.

Article 145 of the constitution states that "judges are independent and must uphold the constitution and the law."

Interpretation is one of the most essential functions of the judiciary as an institution and of the judge as the person directly responsible for rendering justice. French constitutionalist Moris Duverger established the three functions of the judiciary as follows: 1. Respect for the hierarchy of the legal norms, 2. Interpretation of justice 3. Execution of justice.

The interpretation of the legal norms is not restrictive because their content does not always have a sole meaning. Often, they give rise to contradictions in their interpretation. Hence, it is important that the government possesses instruments to secure the legislative will for each specific case, something that is directly linked with the existence of the judiciary. In light of this, the role of national courts that interpret the legislation of the Republic of Albania is invaluable. Jeremy Bentham, in his description of the common law, has used the “judicial law” term to emphasize that the judge, unlike the commonly held view, does not merely declare the existing law but in reality he creates the law.

This declaration presupposes that there is no visible distinction between the interpretation and creation of the law. The general and the abstract (the law) may not in practice (the judicial decision) be reduced on their own accord without the judge’s interpretation and execution. The law in the courts is a highly personalized law in the context of the specific rule formulated by the judge.

## EQUAL GENDER AND DECENTRALISATION

Nadia RUSI<sup>1</sup> (Doktorante)

Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë Departamenti i të Drejtës Publike

Email: nrusi@hotmail.com

The issue of gender equality and the measures taken to guarantee it are playing an increasing role in all facets of political and social life. This article will focus on the impact that the process of decentralization at the local government level has in promoting the concepts of equal treatment and gender equality.

The purpose of this research is to show that the local authorities, governed by the principle of subsidiarity, need to ensure that men and women are given equal opportunities to part-take in all aspects of political, economical, social and cultural life.

A crucial part of this research will be to describe the national and international legal framework in the area of gender equality as well as the measures that our government has taken in implementing the acts of international character in internal justice. Particular attention will be given especially to the Convention to Eliminate all Forms of Discrimination Against Women as well as the European Convention on Human Rights.

During research, we will analyze the most important aspects of the European Charter for equality of women and men in local life, as the comprehensive regional document in regards to the problems covered in this article.

In conclusion, the last part of this research, will focus on the findings and recommendations for our local government to prevent or minimize gender discrimination.

<sup>1</sup> As Pedagog “Të drejtat e Njeriut”, në proces doktorature.

## “POPULAR CONSTITUTIONALISM”

Valbona PAJO (BALA), MA<sup>2</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

E-mail: valbonapajo@gmail.com

This article represents an effort to introduce to the reader an open contemporary discourse on the principle of popular constitutionalism and its relation to the legal constitutionalism and judicial supremacy. While, *prima facie*, it seems that each concept has a shaped identity and a concrete role in the constitutional ordering, still the elaborated thesis show a continuous struggle between them dating back in the very beginning of the history of constitutionalism in federal states (American case mainly), trying to shift in perspective, therefore, leaving always open the discourse on their importance, applicability and their effects over judicial supremacy and Court's preeminence. Through a comparative approach of various schools of legal thought, the article focuses, specifically, on the popular constitutionalists' elaboration of this school of thought, their concerns regarding what kind of institutions shall be constructed in order to make popular constitutionalism work, models of popular constitutionalism, as well as the views of other scholars, legal commentators, or academics opposing popular constitutionalism.

<sup>2</sup> Këshilltare e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të RSH, Doktorante pranë Fakultetit të Drejtësisë, UT.

## THE EXECUTION OF THE DECISIONS OF CONSTITUTIONAL COURT REGARDING CRIMINAL CODE

Dr. Ela ELEZI<sup>3</sup>

As many other laws, the Criminal Code has been subject to constitutional review by the Constitutional Court, which in many cases has repealed provisions which were declared incompatible with the Constitution. The repeal of these provisions means that they can not be applied and in cases where the legal vacuum is created, the Parliament is forced to replace them with new provisions.

The first decisions of this court regarding Criminal Code have been the abolition of the death penalty and unconstitutionality of fixed penalties. Despite the latter, there are still fixed penalties in the Criminal Code.

As an expression of the decriminalization from the court was the repeal of a provision of the Criminal Code from the Constitutional Court, Article 315 – “Giving an unjust punishment”.

The repeal of section 90 of the Law on Banks led to the adoption of a new section in the Criminal Code regarding the adoption of provisions for the protection of the normal activity of the banks.

In an another decision, the Constitutional Court repealed the eighth paragraph of Article 34 of the Criminal Code, which provided for the conversion of the fine in prison if the convicted person did

<sup>3</sup> Specialiste në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese.

not pay the fine within the time specified, the repeal of which was reflected in the amendments of 2012.

The recent decision of the Constitutional Court declared as unconstitutional the provisions of the Criminal Code which contains two principal penalties.

Almost all decisions of the Constitutional Court are implemented by the Parliament in the legislative reforms of these years. Of course there are still some problems that need to be reviewed and there is a need to adopt a new Criminal Code.

## **WORK SALARY AS LEGAL, ECONOMICAL, AND SOCIAL CATEGORY**

MA. Artan ÇELA - Prof. Dr. Kudret ÇELA.

Different legal theories that analyze labor salary, lights up its complexity, the close relation that it has with the employees, employer and the correlation established between them.

The exact definition of the value of salary and its right legal regime, constitute another important issue and, of simultaneous complex, often treated and that continues to be even more a part of the discussions.

The authors of this article have thought that no salary is what it should be. This dictates the continuation and deepening of its study and the continuous improving of the legislation that provides that. We suggest that a significant improvement should be made as soon as possible in the Labor Code, in the context of its reform. After all, in a world where everything has a price, salary is, the element that defines the position, the value, of a man in the society. Precisely, to increase the value of his salary, a person learn, qualifies, specialize and require its constant perfection. In circumstances where this indicator, such as salaries, is not fair estimated, in relation to the skills and employees work, everything else is in discussion, because currently, salary is the only social compass of what we are in society.

We would also recommend, as a requirement of the time, that the curricula of the faculties of justices “The salary of labor rights”, to occupy a special place, which may be developed as an optional module, even in the Magistrates School. Initiatives and the opposite, to design and to perfect the wage labor legislation, according to us, should keep the co-authorship of the civil society.

## TYPES OF ADMINISTRATIVE LAWSUIT AND THEIR LEGAL REGIME

MA. Erajd DOBJANI

Avokat

Doktorant në Departamentin e së Drejtës Publike, UT

This paper aims to present the most important procedural tool by which control of administrative courts is exercised over administrative acts: the administrative lawsuit. The presentation of this lawsuit includes the three types of administrative lawsuit: administrative lawsuit over the legality; administrative lawsuit of full jurisdiction; and the administrative lawsuit of correction. Administrative disputes materialize through concrete procedural tools that enable its presentation in court and therefore its judgment and resolution by the court. One of these tools, the most important one, the tool which powers the mechanism of judicial control, is the administrative lawsuit. The administrative lawsuit over the legality is the lawsuit which is filed against all administrative action and which aims at ensuring the respect of the legality by asking to the administrative court the annulment of the administrative act for causes of objective illegality. The administrative lawsuit over the legality aims at demanding to the administrative court to decide concerning the legality of the administrative act, by declaring the act legal or illegal and if legal, letting the administrative act in force, if illegal, annulling it. For this reason it is considered to be an objective administrative lawsuit. The objective administrative lawsuit brings before the court a matter of objective law, which means a matter for the resolution of which the

court shall exercise a control of compliance of the administrative act with the law, so it is the control of legality of the administrative act. On the other hand, the administrative lawsuit of full jurisdiction is a lawsuit where the administrative court has the power, beyond the just annulment of the administrative act, to decide as well concerning the allowance for indemnity and more generally, the administrative court has the power to decide to substitute to the administrative act its own decision. The administrative lawsuit of full jurisdiction is related in undeniably with the protection of subjective rights and as such it is considered to be a subjective administrative lawsuit. Whereas the administrative lawsuit of correction is a lawsuit which is not filed against an administrative act or action, but this lawsuit is filed in order to punish persons (physical or juridical) and with the aim that the court gives the punishment predicted by law. This lawsuit is filed by the organs of public administration against physical or juridical persons which have committed an administrative violation and aiming that the court punishes these persons with a repressive measure. This administrative lawsuit is absolutely special by its nature in comparison with the first two types of administrative lawsuit.

Key words: administrative lawsuit, administrative lawsuit over the legality, administrative lawsuit of full jurisdiction, administrative lawsuit of correction, objective lawsuit, subjective lawsuit, absolute nullity, relative nullity, administrative judiciary.

## PENAL EUROPIEN CODE

Valbona NDREPEPAJ,  
Universiteti i Tiranës, Shqipëri,  
Nevila KULLOJKA  
Universiteti i Tiranës, Shqipëri,

Në radhët e juristeve europianë qysh herët kanë nisur përpjekjet për unifikimin e të drejtës penale brenda shteteve anëtare të Bashkimit Europian, duke synuar hartimin e të ashtuquajturit Kod Penal Europian. Sigurisht, ka pasur disa përpjekje në drejtim të këtij unifikimi, por ende sot nuk ka një Kod Penal Europian, madje nuk ka asnjë projekt-kod të tillë, i cili pritet të miratohet. Sjellja në vëmendje e këtyre përpjekjeve dhe ideja e hartimit të një Kodi Penal Europian është dhe qëllimi i këtij punimi, i cili ngrihet mbi dy shtylla të konceptuara në formën e dy pyetjeve. Në fillim trajtohet pyetja: A është e mundur krijimi i një Kodi Penal Europian? E cila trajtohet si në rrafshin teorik (pra a ka mundësi të harmonizohen të drejtat penale të 27 vendeve për krijimin e një Kodi të vetëm penal në hapësirën europiane) ashtu dhe në rrafshin praktik (ku tashmë krijimi i Kodit Penal Europian si tekst ligjor është i mundur, por a do të pranohej nga qeveritë dhe qytetarët europianë një kod i përbashkët për ta). Pyetja e dytë që merr përgjigje në këtë punim është A është koha për një Kod Penal Europian? Do të thotë në kushtet në të cilat ndodhet Bashkimi Europian sot, a e ka të nevojshëm një kod të tillë? Për t'ju dhënë përgjigje të sakta shkencor-juridike këtyre pyetjeve janë përdorur metodat hermeneutike dhe interpretative. Në kohën kur flitet për shndërrimin e Bashkimit Europian në konfederatë të flasësh për një

Kod Penal Europian nuk është më utopi, qoftë edhe vetëm për të nxitur debat juridik.

Fjalët kyçe: Bashkimi Europian, Kodi Penal Europian, Zhvillimi Historik, Kodet Penale Kombëtare, Pjesa e Përgjithshme, Pjesa e Posaçme, Avantazhe.



